

**PRIVATIZIMET DHE ROLI I TYRE NË NDËRTIMIN E
POLITIKAVE SOCIALE EFICIENTE**

-Rasti i Kosovës (1999-2008)-

Doktoranti:

Haki Shatri

Dorëzuar:

Universitetit European të Tiranës

Shkollës Doktorale

***Në përmbushje të detyrimeve të programit të doktoratës në shkencat
ekonomike me profil Ekonomi dhe Zhvillim i Qëndrueshem për marrjen e
gradës shkencore “Doktor”.***

Udhëheqes shkencor: Prof.Dr.Luljeta Minxhozi

Nr. i fjalëve 61 000

Tiranë, Maj 2016

Deklarata e autorësisë

Nën përgjegjësinë time personale,deklaroj se ky punim i doktorates është punë origjinale dhe nuk përmban plagjiaturë. Këtë punim e kam kryer duke i respektuar standardet e njohura dhe të pranuara për studime dhe hulumtime.

Si autor i punimit jam i ndërgjegjshëm dhe përgjegjshëm për detyrimet që kam gjatë përgatitjes së punimit të doktoratës, në kuptim të përdorimit të literaturës, referimeve, citimeve,etj.

Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe referuara.

Autori

Abstrakti

Derisa në vitet 90-të të shek. të kaluar ish vendet socialiste kishin ece relativisht mirë në procesin e tranzicionit dhe pothuajse ishin në përfundim të procesit të privatizimit, Kosova po ballafaqohej me probleme politike e ekzistenciale nën okupimin Serb.

Çlirimi i vendit në vitin 1999 njeherit Kosovën e liroj edhe nga sistemi monist dhe i ekonomisë shoqërore .Përveq prapambetjes ekonomike të trashiguar nga e shkuara në at sistem ,Kosova pësoj edhe dëm në ekonomi dhe ne njerëz gjatë luftës dyvjeçare për çlirim. Bashkësisia Ndërkombëtare vendosi Administrimin e KB ne Kosovë. Ky administrim zgjati deri në vitin 2008 kur Kosova shpalli pavarësinë.

Në këtë periudhë përveq rindertimit te vendit u ndërtuan edhe institucionet shtetërore, u organizua jeta publike në arsim , shendetësi, sigurimet shoqërore dhe reforma ne sistemin ekonomik e politik.Në kuadër të reformave spikate gatishmeria për fillimin e privatizimit të pronës shoqërore dhe pritja e madhe nga ky proces .Ne këtë periudhë procesin e privatizimit e ka udhëheqe Administrata ndërkombëtare .Për këtë qëllim kanë përgatitë infrastrukturën ligjore dhe institucionale. Modeli i zgjedhur i privatizimit ishte specifik dhe nuk është aplikuar në asnjë vend tjetër.Te dhenat dhe konkluzionet nga përgatitja e këtijë punimi flasin për pak sukses apo më mirë për dështimin e privatizimit në Kosovë.

Rezultatet e analizës së ndikimit të privatizimit në dinamiken e zhvillimit ekonomik,punësimit dhe përkujdesjes shoqërore flasin për efekte të pakta e në disa segmente edhe per thellim te problemeve sidomos ne humbjen e disa mijëra vende pune si pasoje e privatizimit të pa sukseseshem. Efektet kanë munguar edhe për shkak te menyres se shfrytëzimit të mjeteve të grumbulluara nga privatizimi.

Pas kalimit te kompetencave ne institucionet e vendit prej vitit 2008 nuk ndryshoi metoda e privatizimit, procesi u ngadalesua dhe së fundit edhe u ndal. Pas verejtjeve dhe shumë ankesave për nderhyrjet në proces ,procedurat kontestimore dhe aferat e natyrave penale definitivisht procesi i privatizimit në Kosovë konsiderohet si i pa sukseseshem.

Abstract

While during the 90s of the last century, former socialist countries had moved ahead relatively well in the transition process and were almost closing the privatization process, Kosovo was facing political and existential problems under the Serbian occupation.

The liberation of the country in 1999, also liberated Kosovo from the monist system and the social economy. Besides the economic backwards inherited from the past, Kosovo suffered damages in the economy and in loss of people during two years of the war for liberation. International Community installed UN Administration in Kosovo. This administration lasted until 2008, when Kosovo declared its independence.

During this period, besides the reconstruction of the country, state institutions were established, too, the public life was organized in education, health, social protection and reforms in economic and political system. Among the reforms, it's noticeable the willingness to begin the privatization process and the high expectations from this process. During this period, the privatization process was led by the international Administration. For this very purpose, they had prepared the legal and institutional framework. The chosen model of privatization was specific and had not been applied in any other country. The data and the conclusions of this paper talk about the little success or better to say the failure of the privatization in Kosovo.

The results of the analysis about the impact of the privatization in the dynamic of the economic development, employment and social care show little effects and in some aspects even deepening of the problems, especially in the loss of thousands of jobs as a result of unsuccessful privatization. The effects were missing due to the manner the financial means collected from the privatization were used.

After the transfer of competences into domestic institutions from 2008, the privatization process did not change, the process slowed down and recently it stopped. After many remarks and complains about the interferences in the process, the disputed procedures and the criminal affairs, definitely the privatization process in Kosovo is considered unsuccessful.

Dedikimi

Atyre që punuan dhe që u flijuan për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës

Falenderim

Shpreh falenderimet më të sinqerta për udhëheqësin shkencor të këtij punimi Prof. Dr. Luljeta Minxhozi për bashkëpunim të sinqertë, përkushtim dhe ndihmë profesionale në konceptimin, hartimin dhe përfundimin e temës.

Mirënjohje dhe falenderim për stafin akademik të UET për bashkëpunim dhe përkrahje në punën time.

Shkurtesat:

PSSP	-Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshem të Kombeve të Bashkuara
UNMIK	-Administrata e Përkohëshme e Kombeve të Bashkuara në Kosovë
AKM	-Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit
USAID	-Agjencioni i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Investim e Zhvillim
CIPE	-Qendra Ndërkombëtare për Ndërmarrjet Private
ATK	-Administrata Tatimore e Kosovës
BE	- Bashkimi Evropian
FMN	-Fondi Monetar Ndërkombëtar
SHDK	-Shërbimi Doganor i Kosovës
TVSH	- Tatimi në Vlerën e Shtuar
KASH	- Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
GDP	- Bruto Produkti Vendor
BB	- Banka Botërore
OEK	- Oda Ekonomike e Kosovës
NSH	- Ndërmarrjet Shoqërore
DTI	-Departamenti i Tregëtisë dhe Industrisë
AKP	-Agjencioni Kosovar i Privatizimit
GJSK	- Gjykata Supreme e Kosovës
OSBE	-Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
MEF	-Ministria e Ekonomisë dhe e Financave
EBRD	- Banka Evropiane për Ndërtim dhe Zhvillim
IHD	-Investimet e huaja direkte

Lista e tabelave

1.Ndermarrjet e privatizuara me SPIN-ofspecial	79
2.Pasqyra e raportit të AKP-s	102
3.Ecuria e treguesve makroekonomik2001-2008	107
4.Pasqyra e eksporteve dhe importeve në periudhën 2001-2008	118
5.Pasqyra e ndërmarrjeve të privatizuara deri me 2008	123
6.Disa tregues kyq makroekonomik 2004-2008	135
7.Treguesit e tregut të punës	156
8.Varfëria dhe papunësia	157
9.Struktura kualifikuese e popullsisw sw papunw	159

Përmbajtja e lëndës

<i>Deklarata e autorësisë</i>	2
<i>Abstrakti</i>	3
<i>Dedikimi</i>	5
<i>Falenderime</i>	6
<i>Shkurtesat</i>	7
<i>Listat tabelave</i>	8
<i>Përmbajtja e lëndës</i>	9

Kapitulli I:HYRJE

a)Shtrimi i problemit	9
b) Qëllimi i studimit	11
c)Burimet e referimit	12
d)Hipotezat e punimit	16
e)Metodat dhe metodologjia e kërkimit	17
f) Mundësitë dhe kufizimet	18
g)Rëndësia e studimit	18

Kapitulli II: Tranzicioni dhe privatizimet në ish-vendet socialiste dhe vendet tjera

2.1.0.Përvoja e disa vendeve ish-socialiste në transformimin e pronës Dhe mundësia e shfrytëzimit të tyre në kushtet e Kosovës	25
2.2.0.Privatizimet dhe përvoja botërore e tij.	53

Kapitulli III.Privatizimi në Kosovë në periudhën 1999-2008, specifikat,metodat, efektet.

3.1.0.Roli i UNMIK-ut në ndërtimin e institucioneve dhe në privatizimin e pronës shoqërore në Kosovë.	56 57
--	----------

3.2.0.Metoda “SPINOF”, kostot dhe përfitimet e saj në procesin e privatizimit.	69
3.2.1.SPINOF-i Special.	77
3.2.2.Studim rasti:Tri ndërmarrje	82
3.3.0.Infrastruktura legale dhe institucionale e privatizimit.	87
3.4.0.Procesi i privatizimit nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM)	96
3.4.1.Administrimi i drejtëpërdrejtëi ndërmarrjeve shoqërore.	99
3.4.2. Likuidimi.	100
3.4.3.Kompenzimet për ish të punësuarit,	103
Kapitulli IV. Efektet ekonomike të privatizimit nga AKM në periudhën e UNMIK-ut	105
4.1.0.Ndikimet e privatizimit në tregëtinë më jashtë.	116
4.2.0.Përformanca e ndërmarrjeve të privatizuara.	119
4.3.0.Efektet e privatizimit në stabilitetin makroekonomik.	129
4.4.0. Efektet e privatizimit ne sektorin privat	139
4.4.1.Efektet e privatizimit në zhvillimin e bujqësisë.	140
4.4.2.Efektet në industri.	142
Kapitulli V.Efektet e privatizimit në politikat sociale	144
5.1.0.Vështtrim i shkurtër i gjendjes ekonomike e sociale në Kosovë	144
5.2.0.Disa aspekte të privatizimit dhe çështjeve sociale.	149
5.3.0.Efektet e privatizimit në zhvillimin demografik.	154
5.4.0.Efektet e privatizimit në tregun e punës.	157
5.5.0.Efektet e privatizimit në varfërinë ekonomike	159

VI.Përfundimet dhe rekomandimet	167
6.1.Perfundime	167
6.2.Rekomandime	180
 <i>Shtojcë :Bibliografia</i>	 184

KAPITULLI I: HYRJE

Kosova, si shteti më i ri në rajon, mbas përfundimit të luftës së fundit, përveç shkatërrimeve dhe dëmeve të mëdha materiale dhe humbjeve njerëzore ka trashëguar edhe një nivel shumë të ulët të zhvillimit ekonomik, një strukturë të pavolitshme ekonomike, papunësi të theksuar me trende rritjeje, si dhe probleme të mëdha sociale.

Rrethanat e reja të krijuara pas vendosjes së Kosovës nën protektorat ndërkombëtar, si dhe pas kalimit të fazës së rindërtimit të gjithmbarshëm dhe konstituimit të institucioneve vendore, u krijuan kushte për fillimin e reformave të gjithanshme shoqërore, dhe në veçanti atyre të sferës ekonomike dhe sociale. Çdo vonesë e këtij procesi të gjerë dhe të vazhdueshëm ka qenë e pajustificueshme dhe me pasoja për zhvillimet e vendit tonë. Tre vjet të humbura pas përfundimit të luftës, dhe para kësaj, edhe dy dekada tjera ngecjeje në zhvillim, plaçkitje permanente nga ana e pushtetit të instaluar serb, bashkë me bilansin e shkatërrimeve nga lufta, e kanë zbritur Kosovën në vendin e fundit në rajon e më gjerë, për nga niveli i zhvillimit ekonomik dhe të standardit të ulët të jetës.

Në këtë aspekt, duhet theksuar se problemi i ristrukturimit të ekonomisë dhe, veçanërisht, transformimi i pronës, paraqesin esencën e transformimit të shoqërisë kosovare dhe hapjen e shtigjeve të reja për ndërtimin e një shoqërie bashkëkohore. Prandaj, vonesat në fillimin e këtij procesi, në kushtet e ndërrimeve dhe zhvillimeve dinamike në rajon dhe më gjerë, i ashpersojnë këto probleme, e përkeqësojnë pozitën ekonomike, dhe e vështirësojnë dukshëm procesin e integritimeve ekonomike dhe globalizimit.

Të gjitha vendet ish-socialiste, këtë proces e kanë filluar që në fillim të viteve të 90-ta, dhe tani gjenden në përfundim, ose para përfundimit të këtij procesi, ku si rezultat efektet e procesit të tranzicionit ekonomik në përgjithësi, dhe atij të privatizimit në veçanti, janë të prekshme dhe lehtësisht të matshme. Kjo përvojë e këtyre vendeve mund t'i shërbejë Kosovës për vazhdimin, deri në përfundim, të privatizimit të pronës shoqërore dhe kalimin me sukses të kësaj faze tranzicionale.

Për t'u njohur konkretisht dhe për të pasqyruar besnikërisht situatën e trashëguar, është e pashmangshme që të kemi parasysh situatën pronësore, ekonomike, sektoriale dhe të faktorëve të prodhimit.

Po ashtu, duhet thënë se është i mirëqenë fakti se për shkak të rrethanave të reja të krijuara në vitet e pasçlirimit, në mungesë të funksionimit të mirëfilltë institucional, si dhe në mungesë të sundimit të rendit dhe ligjit, prona shoqërore është gjendur në rrethana të komplikuar; nga njëra anë e dëmtuar nga lufta, dhe nga ana tjetër e pambrojtur nga sjelljet e papërgjegjshme të individëve e të shoqërisë sonë. Këto rrethana, jo që nuk arritën t'i japin drejtimin e duhur të zgjidhjes së problemeve për pronat shoqërore, por rezultuan me një degradim dhe zhvlerësim të tërësishëm të këtij procesi dhe kësaj faze.

Pasojat e dominimit gjysëmshekullor të një sistemi ekonomik të dirigjuar nga pushteti, dhe pozitës koloniale të ekonomisë së Kosovës, plaçkitjes sistematike dhe shkatërrimeve nga lufta, rreziku nga degradimi dhe shkatërrimi i plotë nga lufta, e kanë bërë të pazëvendësueshme nevojën për fillimin e menjëhershëm të procesit të tranzicionit dhe të transformimit të pronës.

Në bazë të të dhënave të kohës, është vlerësuar se në periudhën e përfundimit të luftës, rreth 50% e popullsisë së Kosovës jetonte në kushte të varfërisë, prej të cilëve 17% në kushte të varfërisë ekstreme. Në anën tjetër, gjatë kësaj periudhe ndërmarrjet prodhuese të sektorit shoqëror punonin me kapacitete të reduktuara, ose në shumë raste edhe nuk kanë punuar fare. Vetëm 30% e këtyre ndërmarrjeve ishin aktive dhe vetëm 16 mijë punëtorë gjeneronin të ardhura. Prandaj, është afërmendësh konstatimi se dëmet për ekonominë e Kosovës që derivuan nga kjo situatë, dhe këto rrethana, ishin të shumëfishta dhe me pasoja të vazhdueshme për ekonominë e vendit. Reflektimi më i drejtëpërdrejtë dhe më real i kësaj mund të shprehet me shkallën e lartë të papunësisë dhe poziten e rëndë sociale të popullsisë ndër vite.

Privatizimet dhe ndikimi i tyre në ndërtimin e politikave sociale eficiente janë objekt i këtij punimi të doktoratës. Qysh në krye të herës, mendoj se ka një ndërvvarshmëri të ngushtë në mes këtyre dy çështjeve, pra privatizimit dhe ndërtimit të politikave sociale efikase. Po ashtu, në këtë punim është lehtësisht e konstatueshme se vonesat në fillimin e procesit të tranzicionit dhe privatizimit, si dhe metodat e privatizimit, të aplikuara deri më tani, nuk kanë dhënë efekte dhe rezultate të pritura në zgjidhjen e problemeve ekonomike e sociale në Kosovë. Nga ana tjetër, është i njohur fakti se vetë procesi i tranzicionit, fillimisht sjell probleme në zhvillim siç janë: debalansi i ofertës dhe kërkesës në treg, ngritja e çmimeve, humbja e tregjeve, papunësia në rritje, si dhe problemet të shumta sociale.

Së këndejmi, në këtë fazë është i domosdoshëm angazhimi i shtetit në vendosjen e balansit social me theks të veçantë në zbutjen e problemeve ekzistenciale të shtresave sociale me nevojë, masave për mbështetjen materiale të kategorive të mbetura pa punë si pasojë e efekteve të tranzicionit dhe privatizimit si dhe masave tjera sistimore për përkrahjen e kategorive tjera sociale.

Prandaj, mendoj se për zhvillimin ekonomik të vendit tonë dhe për zgjidhjen e problemeve sociale është me interes të veçantë një analizë e thellë dhe vlerësim i detajuar e profesional i rezultateve të modelit të privatizimit të pronës në Kosovë në periudhën kohore 1999-2008, periudhë kjo kur Kosova është administruar nga Kombet e Bashkuara. Konstatimet, rekomandimet dhe sugjerimet që do të dilnin nga kjo analizë do të ishin dobiprurëse dhe shumë të shfrytëzueshme që do të ndihmonin përfundimin me më shumë sukses të këtij procesi.

Rrënimi i sistemit politik dhe ekonomik në vendet postkomuniste bëri të domosdoshme nevojën e fillimit të procesit kompleks të tranzicionit, në kuadër të së cilit privatizimi zë vend kyç, dhe për më shumë është edhe parakusht i ndërtimit të ekonomisë së tregut.

Ndryshimet shoqërore në vendet e Evropës Lindore në fund të viteve të 80-ta të shekullit të shkuar, përveç demokratizimit të jetës shoqërore e politike, hapën rrugë edhe për ndryshimet e domosdoshme në sistemin ekonomik.

Në Evropën Lindore, në Shqipëri, si dhe në vendet e dala nga ish-Jugosllavia dhe ish-Bashkimi Sovjetik, dekada e fundit e shekullit të kaluar karakterizohet me reforma ekonomike dhe proces dinamik të tranzicionit. Ndërsa, për Kosovën dhe ekonominë e saj kjo është dekada më e vështirë në përpjekjen shekullore të popullit të Kosovës për mbijetesë dhe çlirim. Në vitin 1989 Kosovës iu suspendua autonomia dhe Serbia e shtri dominimin e vet, politik, policor, ushtarak dhe shoqëror, duke mbajtur nën okupim klasik të gjithë jetën në këtë pjesë të Ballkanit.

Derisa ekonomitë e të gjitha vendeve tjera të ish-Jugosllavisë, duke përfshirë këtu edhe vet Sërbisë, kishin filluar të frymonin më lirshëm, dhe kishin filluar realizimin e reformave, secili sipas mënyrës dhe specifikave të vendit, ekonomia e Kosovës u vu nën administrim të dhunshëm. Në këtë periudhë 150 mijë punëtorë shqiptarë, të inkuadruar në administratë, ndërmarrje shoqërore dhe në shërbime publike, u larguan nga puna për motive politike. Drejtorët dhe menaxherët u zëvendësuan me kuadro të sjellura nga Serbia dhe të emëruar nga Qeveria Serbe. Me vendime administrative filloi i ashtuquajti “integrimi i ndërmarrjeve të Kosovës me ndërmarrjet e Serbisë”, me çka praktikisht filloi plaçkitja e kapitalit dhe e pasurisë së Kosovës dhe bartja e saj në Sërbë.

Procesi i tranzicionit dhe privatizimit në Jugosllavinë e mbetur (*Serbia, Mali i Zi, Kosova*) në vitet 90-ta të shekullit të shkuar, realizohet vetëm në Serbi dhe Mal të Zi, por jo edhe në Kosovë. Procesi i tranzicionit dhe i privatizimit në Kosovë u shfrytëzua nga Serbia për një qëllim krejtësisht tjetër.

Pas luftës dyvjeçare (1998-1999) dhe ndërhyrjes ndërkombëtare në Kosovë, me tërheqjen e ushtrisë dhe të policisë Serbe, në bazë të *Rezolutës 1244* të KS të OKB, Kosova vihet nën protektorat ndërkombëtar dhe administrohet nga Kombet e Bashkara. Me vendosjen e Administratës së OKB-së (*e njohur si UNMIK*) organizohen zgjedhjet e para lokale e qendrore, me ç’rast themelohen Institucionet e Përkohëshme Vetëqeverisëse të Kosovës,

dhe në këtë mënyrë krijohen kushtet për fillimin e reformave shoqërore e ekonomike, pra të një tranzicioni gjithëpërfshirës. Në këtë proces fillimi i privatizimit ishte pjesa më e vështirë, për shkak të dilemave dhe paqartësive që Administrata Ndërkombëtare kishte lidhur me pronën dhe sidomos ndërhyrjeve të Serbisë nëpërmjet institucioneve ndërkombëtare për shkak të pretendimeve të saja për pronësinë e pasurive dhe aseteve ekonomike në Kosovë.

Meqë instalimi i Administratës Ndërkombëtare (*UNMIK*) e gjeti Kosovën e rrënuar nga lufta dhe ekonominë e saj pothuajse të dalë jashtë funksioni, fillimisht i tërë aktiviteti u përqendrua në rindërtimin e objekteve të banimit dhe rimëkëmbjen fizike. Kjo fazë u përmyll relativisht shpejt me përkrahjen e donatorëve dhe vendosmërisë së vet kosovarve për kthim në shtëpitë e tyre dhe mbijetesë në vendin e lirë.

Sektori shoqëror, i cili deri në fund të viteve të 80-ta përbënte mbi 60% të ekonomisë, ishte dëmtuar rëndë nga lufta. Vetëm 30% e kapaciteteve të ndërmarrjeve shoqërore ishin aktive. Me teknologji të vjetëruar, me tregje të humbura dhe me borgje të trashëguara, ky sektor u gjend para shkatërrimit dhe degradimit, edhe për shkak të sjelljes dhe papërgjegjësisë shoqërore dhe institucionale ndaj kësaj pasurie.

Sektori privat, dikur relativisht i konsoliduar dhe me një traditë në krahasim me vendet tjera ish-socialiste, pothuajse ishte shkatërruar nga lufta. Shtëpitë e banimit, ekonomitë familjare, paisjet dhe veglat bujqësore, fondi i bagëtive dhe objektet e natyrës ekonomike, ishin djegur ose plaçkitur gati tërësisht.

Në këto rrethana të rënduara ekonomike dhe sociale, vendosja e një stabiliteti social u bë e mundur vetëm me asistencën në shkallë të gjërë të donatorëve, si dhe në saje të dërgesave monetare të konsiderueshme nga diaspora, dhe prezencës së fuqishme të faktorit ndërkombëtar.

Megjithatë, i gjithë ky angazhim dhe tërë kjo asistencë e gjithanshme nuk dha rezultatet e pritura. Dy vjet më pas, konsumi i përgjithshëm ishte dyfish më i lartë se sa prodhimi vendor, importi po ashtu dyfish më i lartë se sa GDP, derisa deficiti i lartë tregëtar

mbulohej nga transfertat zyrtare dhe remitancat. Mbi gjysma e popullsisë jetonin në kushte të varfërisë, prej të cilëve 13% në varfëri ekstreme.

Në këto rrethana, në opinionin e gjerë kosovar mbretëroi një disponim dhe një shpresë se vetëm privatizimi i pronës shoqërore dhe reformat e thella ekonomike, politike e shoqërore, mund ta nxjerrin vendin tone nga gjendja e rëndë ekonomike e sociale. Pra, nuk kishte asnjë lloj rezistence apo rezerve ndaj ndryshimeve, përkundrazi, pritjet ishin shumë të mëdha.

Pavarësisht këtij disponimi dhe këtyre pritjeve shpresëdhënëse, realiteti në Kosovë kushtëzonte që reforma tranzicionale duhej nisur nga e para dhe duhej të përfshinte çdo sektor. Konsolidimi institucional, infrastruktura ligjore, infrastruktura ekonomike, ishin hapat e parë të domosdoshëm që duhej ndërmarrur për të hapur rrugë dhe mundësi për një proces reformimi dhe tranzicioni në ekonominë e vendit tonë, duke përfshirë këtu edhe fillimin e menjëhershëm të procesit të privatizimit.

Administrata e KB e vendosur në Kosovë e njohur si UNMIK ishte e organizuar në katër shtylla dhe udhëhiqej nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP).

Për çështje ekonomike dhe zhvillim ishte e ngarkuar Shtylla e IV-të. Kjo shtyllë mbulonte menaxhimin e buxhetit, politikat fiskale, monetare, dhe sistemin bankar. Pra, të gjitha aktivitetet ekonomike, përfshirë këtu edhe menaxhimin me pronën publike dhe ndërmarrjet shoqërore, ishin nën kompetencën e këtij sektori të Administratës së UNMIK-ut.

Gjatë kësaj periudhe të administrimit ndërkombëtar të Kosovës, kanë ndodhur zhvillime të shumta në sferën ekonomike dhe sociale, prandaj, ky studim në mbarështrimin e vet jep përgjigje në një listë pyetjesh që e përfshijnë këtë periudhë: Cilin model të privatizimit e zgjodhi UNMIK-u, cilat ishin politikat operacionale, cilat ishin institucionet e ngarkuara për implementimin e politikave të privatizimit, si u organizua Dhoma e Posaçme, cilat ishin problemet, dhe cilat ishin rezultatet e procesit të privatizimit në periudhën e Administrimit të Kosovës nga UNMIK-u?

Ky studim, po ashtu, pasqyron edhe faktet se si u reflektuan efektet e privatizimit në ecuritë ekonomike të vendit, cilat ishin efektet në dinamizimin e zhvillimit ekonomik, si u reflektua ky proces në ndryshimet e strukturës të ekonomisë, si ndikoi kjo në punësim, në këmbimin e mallrave me jashtë dhe çfarë efekti pati në përmirësimin e standardit të jetës gjegjësisht në zvogëlimin e varfërisë?

Ndërsa, sa i përket politikave sociale, jemi munduar që të japim informacione gjithëpërfshirëse për masat e politikave sociale që shoqëruan këtë periudhë, duke evidentuar edhe format e mbështetjes sociale që u aplikuan për kategoritë në nevojë. Brenda këtij punimi është shqyrtuar edhe kapaciteti financiar i Kosovës, i përdorur për ndërtimin e politikave sociale eficiente dhe roli i privatizimit në hartimin edhe zbatimin e këtyre politikave.

Anash trajtesës nuk kanë mbetur edhe faktet dhe analizat se në çfarë pozite dhe cili është roli i institucioneve vendore në procesin e privatizimit në periudhën e UNMIK-ut ? Si u shfrytëzua përvoja e bashkëqeverisjes në procesin e privatizimit dhe në ndërtimin e politikave sociale dhe si reagues institucionet shtetërore të Kosovës pas shpalljes së pavarësisë, dhe marrjes së mandatit për qeverisjen e vendit?

Këto, dhe aspekte tjera të lidhura me këto zhvillime brenda periudhës së cekur, janë përfshirë, analizuar dhe vlerësuar në vazhdim të punimit, dhe në formë konkluzionesh janë përmbledhur në kapitullin e fundit bashkë me rekomandimet.

Përveq kapitullit të dytë ku analizohen përvojat e vendeve ish-socialiste në tranzicion dhe në privatizim ,punimi ka tre katere kapituj analitik. Një kapitull ka për objekt shqyrtimi specifikat e privatizimit në Kosovë dhe rezultatet e këtij procesi në zhvillimin ekonomik e social të vendit deri në shpalljen e pavarësisë. Ndërsa, kapitulli tjetër analizon efektet ekonomike të privatizimit.Dhe Kapitulli I tetë analitik analizon efektet e privatizimit në politikat sociale, strukturën sociale të popullsisë, punësimin, papunësinë, masat për përkrahjen e kategorive në nevojë, si dhe aspektet tjera që lidhën me hartimin dhe zbatimin e politikave sociale eficiente.Kapitulli

Krahas këtyre elementeve duhet përmendur edhe faktin se një ndër problemet më të theksuara që kam hasur gjatë përgatitjes së këtij punimi ka qenë mungesa e të dhënave relevante për indikatorët makroekonomikë dhe ata të zhvillimit demografik. Pra, mungesa e statistikave e ka bërë edhe më të vështirë përfundimin e këtij punimi. Megjithatë, pavarësisht shfaqjes së këtyre vështirësive, boshllëku i këtyre informacioneve është plotësuar duke shfrytëzuar burime alternative, të cilat kryesisht gjinden në raportet dhe analizat e Bankës Botërore, FMN-s dhe institucioneve tjera profesionale, hulumtuese që veprojnë në Kosovë.

Është e ditur se literatura shkencore dhe profesionale lidhur me këto procese ekonomike e zhvillimore në Kosovë është kryesisht e re, dhe e cila në masë të madhe analizon ecurinë e procesit të privatizimit dhe shumë pak jep rekomandime kontributdhënëse për zgjedhjen e modelit më të përshtatshëm për procesin e privatizimit në Kosovë. Siç e kemi thënë edhe më lart, organizata të shoqërisë civile dhe institute hulumtuese profesionale, kanë organizuar konferenca periodike (*me karakter lokal, regional por edhe ndërkombëtar*). Organizimi i këtyre konferencave zakonisht ka përfunduar me nxjerrjen e konkluzioneve dhe rekomandimeve, të cilat për fat të keq nuk janë marrë parasysh nga institucionet relevante, prandaj edhe nuk janë jetësuar asnjëherë.

Është më se e vërtetë se gati e gjithë literatura ekonomike, dhe ato pak publikime, që kanë trajtuar çështjen e privatizimit dhe politikat sociale kryesisht kanë pasur përmbajtje kritike ndaj procesit. Në anën tjetër, kundrejt kësaj, raportet e institucioneve vendore shtetërore, por edhe ato të UNMIK-ut, kryesisht janë përshkruar me një natyrë afirmative dhe jokritike si ndaj procesit të privatizimit por edhe për vet rezultatet që ka nxjerrë ky proces.

Nga e tërë ajo që u tha deri më tash, dhe nga problematika që shtjellon ky punim në vazhdimësinë e vet, është e pashpjeguar se si gati për një dekadë të administrimit ndërkombëtar dhe gjashtë vjet pavarësie, me përkrahje të fuqishme ndërkombëtare, vend i lirë, më popullësi të re dhe me prirje kreative, me pasuri minerare dhe energjetike, tokë dhe pozitë gjeografike të përshtatshme, Kosova vazhdon të mbetet vendi më i pa zhvilluar në

Evropë, me shkallë më të lartë të papunësisë, me shkallë më të lartë të varfërisë, me investime të huaja në rënie, strukturë ekonomike të patransformuar?

Fakt është se edhe pas shumë këtyre viteve, Kosova vazhdon të mbetet e varur në masë të madhe nga ndihmat, asistencat dhe remitencat që vijnë nga jashtë. Për më shumë, vendi në shumicën e raporteve të organizatave prestigjioze ndërkombëtare vazhdon të karakterizohet si vend me informalitet ekonomik dhe evazion fiskal të theksuar, korrupsion dhe krim ekonomik me përmasa shqetësuese.

Edhe pas shumë këtyre viteve, vazhdojnë të na dalin pyetje se ku qendrojmë me procesin e privatizimit dhe sa larg jemi nga fundi i tranzicionit? Si do të mund të përshpejtojmë këtë proces në të mirë të zhvillimit dhe mirëqenies?

a) Shtrimi i problemit

Procesi i privatizimit, si bazë e tranzicionit dhe e ndryshimeve të sistemeve, domosdoshmërisht duhet të kombinojë në mënyrë adekuate dinamikën dhe metodën e procesit të privatizimit me stabilitetin social të vendit. Përveç kësaj, transparenca dhe respektimi i akteve ligjore dhe normative kanë rëndësi të veçantë për suksesin e këtij procesi.

Privatizimi, si proces i domosdoshëm për ndryshimet ekonomike dhe shoqërore, ka filluar më heret dhe vazhdon të realizohet në shumicën e vendeve të botës. Prandaj, gjithmonë dhe gjithëherë është në interesin tonë shfrytëzimi i përvojës, jo vetëm të ish- vendeve socialiste, vendeve të dalura nga ish- BRSS dhe ish-Federata Jugosllave. Përvoja e këtyre vendeve, analiza e mënyres së realizimit, si dhe rezultatet e arritura me këtë proces në këtë periudhë, duhet të na shërbejnë edhe neve për të matur rezultatet e arritura dhe efektet e pritura. Megjithatë, duhet thënë se para se gjithash, këto përvoja na ndihmojnë në përmirësimin e gabimeve në përzgjedhjen e modelit, politikave operacionale, organizimin institucional, si dhe në eliminimin e dobësive tjera përcjellëse deri në përfundimin e këtij procesi.

Në këtë periudhë, për të cilën po bëjmë fjalë, procesi i privatizimit në Kosovë kishte hasur në vështirësi të natyrave të ndryshme, hezitime të shumanshme dhe vonesa në realizimin dhe përfundimin e procesit. Ka ekzistuar një listë prej mëse 500 ndërmarrjesh në pronësi shoqërore, në të cilat kanë qenëtë punësuar rreth 60 mijë persona. Por, për shkak të rrethanave të luftës, këto ndërmarrje ishin jo funksionale. Vetëm 30% e tyre operonin, kurse vetëm 16 mijë persona të punësuar në këto ndërmarrje, arrinin të gjeneronin të ardhura mujore. Për më shumë, këto ndërmarrje janë karakterizuar edhe nga posedimi i teknologjisë së vjetëruar, grabitje dhe dëmtim të makinerisë prodhuese, si dhe tregje të humbura.

Në këtë kushte dhe rrethana, shumica e ndërmarrjeve publike operonin me shumë vështirësi, ndërsa ato pak ndërmarrje që ofronin shërbime të domosdoshme (*energji elektrike, ujësjellës*) ishin bërë barrë e rëndë për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës .

Në bazë të shënimeve statistikore, përgjatë periudhës 1999-2008, nën administrimin e UNMIKU-t, janë privatizuar, në mënyra të ndryshme, rreth 300 ndërmarrje të ndryshme shoqërore. Nga shitja e tyre janë realizuar gjithsej 371 milionë Euro, të cilat edhe më tutje vazhdojnë të mbahen të ngrira në Fondin e Mirëbesimit.

Në këtë periudhë, dhe përgjatë këtij procesi, ka vazhduar rritja e nivelit të papunësisë. Kontigjenti i të papunëve në Kosovë i është shtuar edhe numri i të papunëve nga ndërmarrjet pasive të sektorit shoqëror, ata nga ndërmarrjet e privatizuara e të pa aktivizuara, si dhe kontigjenti i 28 mijë të rinjve që për çdo vit i shtohet tregut të punës. Gjatë gjithë kësaj periudhe kohore, shkalla e papunësisë në Kosovë nuk ka arritur të zvogëlohet, por ka një konstantë prej rreth 40%. Në periudha të caktuara kohore, shkalla e varfërisë ekstreme ka variuar në 13 deri në 17%, kurse shkalla e varfërisë së përgjithme deri në 50%.

Pyetjet kërkimore që do të ngre janë:

1.A ishte modeli i privatizimit i zbatuar në Kosovë modeli i duhur për periudhën historike të pas luftës në këtë vend?

2. Sa ishte transparent, efikas,dhe në funksion të stabilitetit ekonomik e social të vendit procesi i privatizimit?

b) Qëllimi i studimit

Të gjithë indikatorët që disponojmë dhe analizat e zhvillimit të deritanishëm flasin për efikasitet të pamjaftueshëm të privatizimit të matur me stabilitetin makroekonomik e social të vendit.

Qëllimi i këtijë studimi është të argumentojë se pse:

- *Modeli i aplikuar i privatizimit në Kosovë nuk ka dhënë rezultate të pritura;*
- *Politikat operacionale ishin jo mjaft të përshtatshme dhe efikase;*
- *Ndërmarrjet e privatizuara, me disa përjashtime, dështuan në aktivizimin e resurseve të tyre dhe përfunduan duke iu ndërruar destinimi,u copëtuan dhe më pas pronarët e rinj i rishitën ato;*
- *Ndërmarrjet e privatizuara me **spin-of special** nuk i përmbushën obligimet kontraktuese në çështjet kyçe si: investime, punësim dhe vazhdim të aktivitetit ekonomik;*
- *Mjetet e grumbulluara nga shitja e këtyre aseteve mbeten të ngrira, të nxjerra jashtë qarkullimit, dhe, si të tilla, nuk ndihmuan por dëmtuan ekonominë e vendit;*
- *Shkalla e papunësisë dhe e varfërisë nuk u zvogëlua, ashtu siç pritej, përkundrazi, pati tendence rritjeje.*

Në bazë të rezultateve të nxjerrura në përfundim të këtijë punimi do të përpiqem të kontribuoj në gjetjen e modeleve, kahet e vazhdimit të procesit ende të papërfunduar të privatizimit, dhe ndërlidhjen e tij me ndërtimin e politikave sociale eficiente në Kosovë, çështje këto të mbetura hapur dhe të patrajuara sa duhet deri më sot.

c) Burimet e referimit

Lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë janë mbajtur disa konferenca ndërkombetare, debate publike, po ashtu janë hartuar raporte dhe publikime, analiza profesionale periodike, separate dhe shqyrtime teorike të kohëpaskohshme nga nivelet akademike, hulumtuese profesionale , institucionale si dhe nga shoqëria civile .

Literatura lidhur me tranzicionin dhe privatizimin që ka ndodhur në ish-vendet socialiste është e mjaftueshme, po ashtu ekziston edhe infrastruktura ligjore dhe të dhënat bazë që flasin mbi vlerën,efikasitetin, si dhe për perimetrat tjerë të rëndësishëm për këtë proces. Pra, shumëçka është në dispozicion, prandaj, kjo edhe na e lehtëson dhe na e mundëson që të nxjerrim konkluzionet e nevojshme.

Meqenëse procesi i privatizimit dhe ndërtimi i politikave sociale në Kosovë, për periudhën e përfshirë në analizë, është më tepër çështje praktike, për realizimin sa më të saktë dhe sa më profesional të këtij punimi, kam siguruar materiale dhe të dhëna tjera statistikore, duke filluar nga infrastruktura ligjore në fuqi e deri te veprimet operationale.

Për këtë punim, në dispozicion kemi pasë edhe të gjitha raportet vjetore të institucioneve publike, shumë rezultate dhe konkluzione të punimeve të konferencave vendore dhe atyre me karakter ndërkombëtar, të cilat për objekt diskutimi kanë pasur privatizimin. Pjesë e burimeve dhe referencave për këtë punim kanë qenë, po ashtu, edhe opinione të ndryshme të strukturave profesionale e shkencore, duke përfshirë këtu edhe reagimet e kohëpaskohshme të shoqërisë civile për këtë temë.

Me qëllim të kompletimit të burimeve dhe informacioneve lidhur me çështjen e trajtuar, kam shfrytëzuar edhe rezultatet e disa anketave të realizuara me ndërmarrjet e privatizuara si dhe opinionet publike të akterëve kyç të procesit të privatizimit .

Në përgatitjen e këtij punimi, përpos tjerash kam hulumtuar dhe siguruar në masë të konsiderueshme literaturë lidhur me ecurinë e procesit të privatizimit në vendet në tranzicion,veçanërisht të atyre ish-socialiste. Kam siguruar për shfrytëzim edhe dokumente

bazike si ligje dhe akte tjera përcjellëse, në bazë të së cilave është realizuar ky proces në këto vende.

Lidhur me privatizimin në Kosovë dhe ndërtimin e politikave sociale, po ashtu, kam siguruar dokumentacionin bazik, të gjithë infrastrukturën ligjore dhe aktet përcjellëse në fuqi.

Nga institucioni kompetent Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) kam siguruar të dhënat burimore për çdo ndërmarrje të privatizuar, çmimin e shitjes së tyre, kushtet e kontratës dhe të dhëna të tjera lidhur me likuidimin e këtyre ndërmarrjeve.

Edhe nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) kam shfrytëzuar të gjitha aktet normative dhe vendimet lidhur me masat për mbrojtjen sociale dhe mirëqenien e qytetarëve. Një burim tjetër i rendësishëm është edhe Arkivi i Kuvendit të Kosovës, nga ku kam siguruar të gjitha ligjet, raportet dhe vendimet tjera të aprovuara, që kanë qenë më se të nevojshme për përgatitjen e këtij punimi.

Po ashtu, krahas kësaj është siguruar literaturë e mjaftueshme teorike dhe analitike që është publikuar në Kosovë në këtë periudhë nga institucione profesionale-hulumtuese, bota akademike dhe nga shoqëria civile.

Në këtë kontekst duhet përmendur se një punim me shume interes, dhe i hartuar me nivel të lartë profesional, i cili pasqyron gjendjen e Ndërmarrjeve Shoqërore të Kosovës në vitet e 90-ta, është libri i z.Adil Fetahu me titull: ***”Transformimi, integrimi i dhunshëm dhe privatizimi i kapitalit shoqëror.”***

Këtu duhet përmendur edhe një Projekt Studimor të Institutit Ekonomik të Beogradit, të vitit 1993, me titull ***”Privatizimi-pervojat e gjertanishme dhe propozimi i konceptit të ri”***, që për objekt trajtimi kishte analizën e rregullativës dhe rrjedhave të privatizimit në Jugosllavinë e mbetur. Te ky projekt, që analizon modelet e privatizimit në vendeve në tranzicion dhe mundësinë e aplikimit të atyre modeleve në kushtet e Jugosllavisë, gjejmë argumente të vlefshme për procesin e privatizimit në Kosovë në vitet 90-ta, dhe veprimet

shkatërruese të okupatorit serb në ekonominë e Kosovës nën maskën e transferimit dhe të privatizimit.

Për shkak të rrethanave tepër të vështirësuar për punë kërkimore e shkencore, si pasojë e largimit nga sistemi i financimit i të gjithë arsimit (*në të gjitha nivelet*) i shkencës, kulturës dhe zhvillimit nga ana e regjimit serb, puna kërkimore e shkencore në Kosovë u vështirësua tej mase. Prandaj, faktet tregojnë se janë të pakta aktivitetet profesionale, puna shkencore dhe literatura kosovare lidhur me këtë proces që përfshin periudhën e viteve 90-ta.

Një aktivitet, i cili për mendimin tim, meriton të përmendet gjithsesi, e që ka trajtuar temën e privatizimit në Kosovë në atë kohë është Konferenca Shkencore me titull: ***"Sistemi i ekonomisë së hapur të tregut dhe tranzicioni në Kosovë"*** organizuar nga Instituti për Kërkime Ekonomike "RIINVEST", mbajtur në maj të vitit 1998.

Një vit më vonë, me përfundimin e luftës (1999) dhe vendosjen e Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë, krijohen kushtet për fillimin e procesit kompleks të tranzicionit politik, ekonomik e shoqëror, e në kuadër të tij edhe të procesit të privatizimit. Në këtë kohë, realizimi i këtij procesi në Kosovë fillon në kushte specifike për shkak të shkatërrimit të vendit nga lufta, gjendjes së rënduar ekonomike e sociale, mungesës së infrastrukturës ligjore dhe, siç është thënë më lart, ndërmarrjeve shoqërore jo-aktive e jo-funksionale.

Ringjallja e jetës shoqërore, rindërtimi i vendit dhe rimëkëmbja, pas kthimit të popullsisë së zhvendosur me dhunë, sikur ktheu optimizmin për jetë dhe kjo frymëzoi edhe botën akademike e shkencore për trajtimin e problemeve që lidhen me zhvillimin e vendit, tranzicionit, dhe integrimin ekonomik e politik të vendit. Tranzicioni ekonomik, e në veçanti privatizimi, në opinionin e gjerë kosovar përceptohej si i vetmi shans që mundëson tejkalimin e vështirësive ekonomike e sociale të vendit tonë. Në këtë kohë, procesi i privatizimit në Kosovë në fillimet e veta gjeti përkrahjen e plotë edhe të botës akademike e shkencore të vendit. Prandaj, kjo periudhë u karakterizua me një angazhim më të madh të autorëve, që për objekt hulumtimi e studimi kishin procesin e tranzicionit dhe privatizimit në Kosovë.

Në grupin e shkrimeve të rëndësishme që trajtuan disa segmente të privatizimit në Kosovë dhe aspekte tjera të problemeve sociale duhet veçuar edhe raportet e Bankës Botërore (*Njësia për Menaxhimin Ekonomik dhe Uljen e Varfërisë*). Këto raporte janë përgatitur dhe publikuar herë pas here, dhe konsiderohen të një rëndësie të veçantë, sepse në Kosovë në vitet e para të pasluftës nuk kishte të dhëna dhe statistika të besueshme, në bazë të të cilave mund të mirrëshim vendime të vlefshme për vendin. Banka Botërore dhe FMN ishin të vetmet institucione, të cilat vepronin në Kosovë dhe të cilat kishin potencialin e nevojshëm profesional dhe metodologjinë e pranueshme për trajtimin e problemeve komplekse që lidhen me privatizimin dhe problemet sociale.

Banka Botërore në bashkëpunim me UNDP, Zyrën Statistikore të Kosovës, DFID, GTZ, etj. kanë angazhuar ekipe profesionistësh dhe shkencetarësh eminentë dhe në periudhën deri në shpalljen e Pavarësisë së Kosovës (*shkurt 2008*) kanë përgatitur dhe publikuar herë pas herë materiale të kësajë natyre, të cilat ofrojnë të dhëna, analiza dhe rekomandime shumë të vlefshme për trajtimin e procesit të privatizimit dhe zgjidhjes së problemeve sociale.

Edhe OSBE në Kosovë, përmes Departamentit për Monitorimin e Sundimit të Ligjit, në një hulumtin të vet, ka trajtuar procesin e privatizimit në Kosovë. Objekt hulumtimi i këtij publikimi të OSBE-së është një segment i veçantë i privatizimit. Këtu gjejmë të analizuar rregullativen ligjore që e themelon Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, e cila ka kompetenca të veçanta gjyqësore për shqyrtimin e çështjeve të privatizimit.

Pra, kjo periudhë shënoi edhe intensifikimin e punëve kërkimore e botuese lidhur me procesin e privatizimit dhe problemet sociale në Kosovë. Instituti “RIINVEST” disa herë organizoi konferenca, tryeza dhe debate publike. Punimet, kumtesat dhe rekomandimet e nxjerrura nga këto aktivitete profesionale e shkencore, janë publikuar dhe paraqesin një bazë të mirë për vlerësimin e rezultateve të procesit të privatizimit. Nga publikimet e Institutit “RIINVEST” veçojmë: Raportin Hulumtues me titull: ***“Ndërmarrjet shoqërore dhe transformimi i tyre”***(mars 2001), ***“Privatizimi në Kosovë-përparim dhe ngecje”***(mars 2004), dhe ***“Privatizimi dhe post-privatizimi në Kosovë”***(shtator 2008).

Po ashtu, një punim me interes, cili për temë ka përshkrimin kritik të procesit të privatizimit në Kosovë, është një hulumtim i z.Robert Moharremi me titull: ***“Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe privatizimi i pronës”***,pastaj ai i Rita Augestad Knudsen: ***“Privatization in Kosovo; The International project 1999-2008”***.

Megjigjatë, për këtë punim timin, është shfrytëzuar një gamë e gjerë e literaturës nga autorë shqiptarë si dhe literaturë nga autorë të shkrimeve mbi privatizimin dhe tranzicionin nga ish-vendet socialiste. Një bibliografi bashkë me literaturën e saktë do të renditen të sistemuara në fund të këtij punimi .

d) Hipotezat e punimit

Vetem një proces efikas i privatizimit, garanton efikasitet ekonomik, rritje të GDP-s dhe të punësimit, rritje të mirëqenies së popullsisë dhe ndërtim efektiv të sistemit të sigurimeve shoqërore, prandaj,së këndejmi mund të kemi qëndrueshmëri ekonomike e sociale dhe rritje të ndjeshme e të vazhdueshme të mirëqenies sociale dhe cilësisë së jetës për qytetarët e Kosovës.

Të gjitha të dhënat empirike,të dhënat statistikore që disponojmë, hulumtimet shkencore dhe profesionale lidhur me efektet dhe rezultatet e procesit të privatizimit në Kosovë në këtë periudhë na shpënjë te:

Hipoteza 1:

- *Modeli i privatizimit, i përdorur në Kosovë, nuk terhoqi në masen e pritur për investime të jashtme shkak i të drejtës vetëm për përdorimin e pronës dhe jo i garantimit të së drejtës në pronë, sikurse në vendet tjera;*

Hipoteza 2:

- Institucionet vendore nuk kanë qenë aktivisht dhe në masë të duhur të përfshira në këtë proces. Ndërsa niveli lokal i pushtetit mbeti i përjashtuar thuajse plotësisht nga ky proces;

Duke iu referuar hipotezave të sipërenditura, vetvetiu shtrohet pyetja se çka duhet bërë për zvoglimin e pasojave dhe dobësive të manifestuara deri me tani në këtë proces, si dhe çfarë masash duhet ndërmarrë për fillimin e zgjidhjes së problemeve sociale në vendin tonë? Përmbajtja e këtij punimi, mëton që të adresojë përgjigjet në këto çështje.

e) Metodatat dhe metodologjia e kërkimit

Në pjesën e vet më të madhe, për këtë punim kryesisht është shfrytëzuar metoda e analizës cilësore me përpjekje të kapjes dhe shfrytëzimit maksimal edhe të parametrave sasiorë.

Natyrisht, bazë fillestare kanë qenë dhe mbeten rezultatet dhe përvojat që literatura e gjerë ka trajtuar nëpër kohë dhe sisteme të ndryshme, qoftë si qasje teorike apo edhe si të arritura praktike, duke ndjekur shembuj të ndryshëm të vendeve, atyre që veçanërisht kanë një të kaluar tranzicionale ekonomike e sociale identike me Kosovën.

Duke shfrytëzuar metodën e deduksionit jemi përpjekur që nga e përgjithshmja të përqendrohemi në specifikat e ekonomisë së Kosovës, për të shfrytëzuar më pas analizat karahasuese të rezultateve të arritura .

Një kujdes i veçantë i është kushtuar eliminimit maksimal të përsëritjes.

Po ashtu, duhet theksuar edhe mundësinë e lënies anash, joqëllimshëm, të ndonjë segmenti zhvillimor a statistikor, që objektivisht do të ishte i dobishëm të përfshihej në studim .Në këtë mënyrë, duke qenë se në një fazë të caktuar kohore, personalisht kam qenë i involvuar në proces të privatizimit dhe të hartimit e implementimit të politikave sociale, është krejt e mundshme që të na ketë mbetur anash ndonjë e dhënë, argument, apo konstatim, me

pretekstin se “kjo dihet dhe nuk ka nevojë të analizohet”, ose edhe për shkak të dobësive subjektive, edhe pse gjatë krejt punës, jam përpjekur maksimalisht që të iu shmangem këtyre dobësive.

f) Mundësitë dhe kufizimet

Kufizimet në realizimin e këtij studimi lidhen kryesisht me mungesën e statistikave të mirëfillta dhe burimeve të sigurta për strukturën sociale të popullsisë, strukturën moshore dhe kategoritë tjera strukturore të popullsisë, të cilat janë pjesë e këtij studimi dhe që patjetër duhet të jenë të përfshira në skemat sociale, ose në format tjera të përkrahjes, si shumë të nevojshme për ndërtimin dhe implementimin e politikave sociale .

Burimet e vetme të informacionit që janë shfrytëzuar nga institucionet shtetërore vendimëmarrese dhe ato akademike në këtë sferë janë: analizat dhe vleresimet e Bankës Botërore (BB), si dhe të disa institucioneve tjera ndërkombëtare të instaluar në Kosovë siç janë: Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) , OSBE, etj.

Të dhënat për pjesën e parë të studimit, ato që kryesisht kanë të bëjë me procesin e privatizimit, duhet thënë se janë burimore dhe të mjaftueshme për t’u analizuar, krahasuar, dhe për të na çuar deri te konkluzionet. Këto të dhëna japin mundësi për një analizë të detajuar, të saktë dhe vlerësim objektiv. Vëllimi i këtyre burimeve pashmangshëm na detyron që nga këto të dhëna të nxjerrim tregues sintetik, kurse rezultatet të prezentohen të përmbledhura me qëllim që të ruhet struktura e punimit dhe të shmanget përsëritja.

g) Rëndësia e studimit

Ky studim iu dedikohet strukturave profesionale dhe atyre akademike të vendi tsepse konkluzionet kanë rëndësi praktike, për shkak se procesi i tranzicionit dhe i privatizimit, si dhe hartimi dhe zbatimi i politikave sociale, akoma nuk kanë përfunduar, por janë në proces të vazhdueshëm. Prandaj, jam plotësisht i vetëdijshëm se rezultatet e këtij studimi do të mund të iu shërbenin institucioneve shtetërore, veçanërisht atyre kompetente për

vazhdimin e reformave ekonomike, kalimin e lehtë e me sukses të tranzicionit , përfundimin sa më të shpejtë të privatizimit si dhe hartimit dhe zbatimit të politikave sociale.

Në këtë mënyrë, synimi im përqendrohet në kontributin e mundshëm të këtij punimi, në çështjet pragmatike, veçanërisht në ato që kanë të bëjnë me hartimin dhe implementimin e politikave sociale, të përshtatshme për vendin tonë, dhe gjithsesi brenda kushteve dhe rrethanave në të cilat jetojmë, ku prioritet duhet të jetë përfundimi sa më i shpejtë i privatizimit dhe njëkohësisht zvogëlimin e dëmeve nga dobësitë e manifestuara në procesin e deritashëm të privatizimit dhe deri në përfundim të tij.

Ky punim, përveç tjerash, mëton të kontribuojë në hedhjen e ideve konkrete se si, mjetet e fituara nga shitja e ndërmarrjeve gjatë privatizimit, do të mund të shfrytëzoheshin suksesshëm për nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe rritjen e mirëqenies sociale në Kosovë. Pastaj, do të mund të diskutohej edhe mënyra më e mirë dhe më e duhur, se në cilat drejtime duhet vazhduar me reformimin e ndërmarrjeve të mëdha publike dhe ndërmarrjeve tjera të paprivatizuara gjer me tani.

KAPITULLI II: TRANZICIONI DHE PRIVATIZIMET NË ISH VENDET SOCIALISTE DHE VENDET TJERA

Ndryshimet shoqërore në vendet e Evropës Lindore në fund të viteve të 80-ta të shekullit të kaluar, përveç demokratizimit të jetës politike e shoqërore, hapën rrugën edhe për ndryshimet e domosdoshme në sistemin ekonomik.

Kështu, procesi i këtij tranzicioni, përkatësisht rrugët që duheshin ndjekur drejt një ekonomie efikase të tregut të lirë, pastaj stabilizimit dhe mëvonë edhe privatizimit të ndërmarrjeve shteterore, patën përkrahjen pothuajse të gjitha strukturave institucionale e shoqërore, pastaj edhe të botës akademike, e sidomos atyre të fushës ekonomike. Prandaj, duhet thënë se sa i përket ndriçimit të kësaj periudhe me fakte e shënime relevante, ekziston literaturë ekonomike e bollshme.¹

Edhe pse ka qëndrime të ndryshme rreth tranzicionit në vendet e Lindjes, të gjithë autorët e mendimit ekonomik, tranzicioni në sferën ekonomike nënkupton *ngritjen e efikasitetit të ekonomisë dhe transformimi i saj në një ekonomi të tregut*. Prandaj, dallimet ndërmjet mendimeve dhe teorive të autorëve të ndryshëm, janë, pak a shumë, të natyrës formale, e këtu bie në sy veçanërisht mënyra e vendosjes së prioriteteve të atyre elementëve që e dallojnë procesin e tranzicionit në ekonomi. Kur bëjmë fjalë për dallimet, duhet nënvizuar faktin se një grup konsideron se *eliminimi i tepricës së kërkesës përmes politikave monetare krijon mundësinë për hapin tjetër-krijimin e konkurrencës së tregut përmes tregëtisë së lirë dhe liberalizimit të plotë të çmimeve si dhe demonopolizimit të sektorit shtetëror për t'i hapur rrugë formave tjera të tranzicionit që kanë të bëjnë me privatizimin dhe ristrukturimin e plotë*.

Kundrejt këtij mendimi, ekziston edhe një grup tjetër autorësh prijtarë dhe përkrahës të mendimit, sipas të cilëve *rritja stabile ekonomike kërkon reforma pronësore , të çmimeve*

¹ Si më të njohurit nga ekonomistët perëndimorë që trajtuan këto çështje janë: **Lipton, Saks, Hinds, Blandshar, Dornbrush, Krugman, Samers, etj.**

dhe të sistemit bankar në tërësi. Sipas tyre, pa marr parasysh mënyrën e shtrimit të problemit, çështja e eliminimit të kërkesës së tepërt konsiderohet problem kyç në fazën e parë të tranzicionit të përgjithshëm ekonomik.

Në këtë mënyrë, duhet vënë theksin në faktet se si eliminimi i faktorëve që stimulojnë disekuilibre ndërmjet ofertes dhe kërkesës, siç janë: inflacioni dhe deficit i buxhetor në njërin anë, dhe zvogëlimi i humbjeve në ekonomi, liberalizimi i çmimeve (*reforma e çmimeve*) dhe i tregëtisë, si dhe liberalizimi i normës së interesit në anën tjetër, janë elementë të rëndësishëm për një stabilitet ekonomik, përkatësisht, për një ekuilibër të përgjithshëm makroekonomik.

Kështu, dallimi në mendime ndërmjet grupeve të autorëve të teorive për tranzicionin ekonomik, qendron në atë se sa dhe cilat elemente i konsiderojnë si bazike për një tranzicion dhe reformë të mirëfilltë ekonomike. Kësisoj, ristrukturimi i bankave dhe ristrukturimi i ndërmarrjeve për disa autorë, po ashtu, konsiderohet veprim i domosdoshëm paralel.

Duke marrë për bazë këto çka u thanë më lart, atëherë lehtësisht është e evidentueshme, se, pavarësisht specifikave që kanë vendet e ndryshme, tranzicioni ekonomik si proces duhet të kalojë nëpër të gjitha fazat e reformës tranzicionale, dhe mëpastaj, në varshmëri nga specifikat që kanë vendet respektive, këto faza mund të realizohen paralelisht ose në mënyrë sukcesive. Po ashtu, pa marrë parasysh se si renditen fazat e reformës nga autorë të ndryshëm dhe varesisht nga specifikat e secilit vend që kalon nëpër tranzicion, ekziston një karakteristikë e përbashkët e mendimit ekonomik se: *Tranzicioni për vendet me ekonomi të planifikuar është domosdoshmëri. Ky proces duhet të fillojë me eliminimin e debalansit ndërmjet ofertës dhe kërkesës, si dhe të përfundojë me përcaktimin e pronarit të ndërmarrjes dhe ristrukturimin e tyre.*

Roli i shtetit në këtë fazë të procesit, po ashtu, përcakton suksesin e reformës ekonomike. Megjithatë, disa mendojnë se: *“Pa privatizim të pronës nuk mund të bëhet fjalë për*

ndërtimin e shtetit juridik dhe përgjegjesinë e organeve shtetërore. Pa ndërtimin e një shteti të tillë nuk mund të paramendohet demokracia dhe internacionalizimi i ekonomisë “².

Prandaj, me të drejtë shtrohet pyetja: si mund të realizohet një proces i tranzicionit, përkatësisht kalimi i suksesshëm nga një ekonomi e dirigjuar në një ekonomi të tregut që do ta stabilizonte ekonominë dhe do të hapte premisa reale për një privatizim cilësor dhe të suksesshëm, dhe si rezultat do të kishim një ristrukturim zhvillimor të ekonomisë? Me fjalë tjera, kryepyetja e tranzicionit ekonomik është si të realizohet një reformë e suksesshme ekonomike?

Përgjigja në këtë pyetje nuk është aspak e lehtë dhe asnjëherë nuk është përfundimtare. Fillimisht duhet thënë se asnjë program qeverisës, sado i përkryer që mund të jetë në letër, po nuk e pati edhe mbështetjen e plotë politike e institucionale nuk mund të përfundojë me sukses, e veçmas nëse nuk shoqërohet me një program adekuat social si dhe me masa të zbatimit rigoroz.

Në të gjitha vendet ish-socialiste tranzicioni, si koncept, është i përputhshëm dhe shumë i përafërt në pjesën më të madhe të karakteristikave. Por, megjithatë një pjesë është e lidhur me specifikat dhe realitetin individual sepse qëllimi i ndryshimeve thuajse në të gjitha vendet është përfundimi i joefikasitetit dhe ngecjes. Po ashtu, në këto ndryshime tranzicionale vend kyç ka zënë vet transformimi i pronës dhe në vazhden e këtyre zhvillimeve tranzicionale, është evidente se gati të gjitha ndryshimet institucionale kanë patur për qëllim ngritjen e efikasitetit. Historikisht është i njohur fakti se lidhja ndërmjet pronës dhe efikasitetit ekonomik është qenësore dhe përcaktuese për përfundimin me sukses të tranzicionit.

Nga përvojat e shumta të atyre vendeve që eksperimentuan me formën kolektive të pronës dhe të cilat, me synim të argumentimit të epërsisë së kësaj forme të pronës ndërmorrën një

² Prof.Dr.Selman Selmanaj: *“Modeli i ekonomisë së hapur-bazë e sistemit të ri ekonomik të Kosovës”*, fjala e hapjes në Konferencën: *“Sistemi i ekonomisë së hapur të tregut dhe tranzicioni në Kosovë”*, organizuar nga **Instituti RIINVEST**, Prishtinë, 1998.

varg veprimesh reformuese, del se asnjëra nuk dha rezultatet e pritura, pra rritjen e efikasitetit ekonomik.

Për më shumë, ish-vendeve socialiste iu është nevojitur më se një gjysëm shekulli, që përfundimisht të binden për nevojën e ndryshimeve thelbësore, esencën e të cilave e përbëjnë ndryshimet pronësore në ekonomi. Dihet mirëfilli se rendi shoqëror e rregullon sistemin ekonomik përmes vendosjes së rregullave që përcaktojnë sjelljen e individit ndaj resurseve dhe përdorimin e tyre. Mënyra se si resurset disponuese të një vendi përdoren, ruhen, shfrytëzohen dhe riprodukohen, themi se përcakton efikasitetin ekonomik.

Në lidhje të ngushtë funksionale me pronën, domosdoshmerisht, qëndron tregu si formë universale e mekanizmit rregullues në ekonomi. Përcaktimi për ekonomi të tregut, ishte dhe mbetet alternativa e vetme e dëshmuar si e suksesshme. Tregu dhe prona kushtëzojnë njëra-tjetrën. Konceptet ideologjike të sistemit centralist inspiruan forma të pronës, të cilat ia rrënuan bazën ekonomise së tregut. Asnjë institucion dhe normë juridike nuk mund të vendos raport të drejtë dhe me përgjegjesi të individit ndaj pronës kolektive. Prona kolektive nuk mund të kontrollojë shpenzimin e mjeteve. Tregu në këtë aspekt është mekanizmëm shumë efikas.

Procesi i tranzicionit në vendet e Evropës Lindore ka filluar me kufizimin e monopolit shtetëror dhe ligjerimin e pronës private, përkatësisht iniciativës private dhe ka vazhduar me transformimin e pronës nga ajo kolektive në atë private. Liberalizimi i plotë i jetës ekonomike stimulon iniciativën private, zhvillon konkurrencën dhe bën barazimin e kushteve të afarizmit për të gjitha subjektet ekonomike. Liberalizmi ekonomik, para se gjithash, nënkupton *liberalizimin e çmimeve, që domosdoshmërisht shpie në vënien e raporteve midis mallrave, shërbimeve dhe faktorëve të prodhimit.*

Me liberalizimin e çmimeve pamundësohet subvencionimi dhe menjanimi i humbjeve në ekonomi nga buxheti i shtetit. Në vitet e para ky veprim pashmangshëm çon drejt problemeve në shërbimet publike, si në energjetikë, komunikacion, shërbime komunale, etj. Rritja e shpejtë e çmimeve në këta sektorë patjetër duhet të kontrollohet nga shteti, pasi që në këto lëmi mungon konkurrenca. Ndërhyrja e shtetit në këtë rast është e domosdoshme

për dy arsye: kontrollimin në rritjen e çmimeve monopolistike, dhe se dyti në garantimin e kushteve për krijimin e konkurrencës lojale duke stimuluar sektorin privat të ekonomisë. Liberalizimi i importit, po ashtu, rrit konkurrencën, por ekziston rreziku i vazhdueshëm i konkurrencës së jashtme jo lojale, për evitimin e së cilës roli i shtetit është i domosdoshëm .

Sipas një grupi autorësh³ periudha tranzitore në vendet e dala nga ish-Jugosllavia mund të ndahet në katër faza:

- ***Stabilizimi makroekonomik;***
- ***Liberalizimi;***
- ***Privatizimi;***
- ***Ristrukturimi.***

Me përjashtim të disa specifikave, këto faza të tranzicionit janë të përputhshme me ato që autorët e vendeve të ish- Bllokut Socialist kanë rekomanduar për vendet e tyre.

Meqenëse Kosova është një nga shtetet që ka dalë nga Ish-Jugosllavia , vitet e 90-ta kur filloi shthurja e Ish-Jugosllavisë njësitë e saj federale u shkëputën një nga një. Paralelisht, në të gjitha këto vende filloi periudha e tranzicionit .Prandaj, të gjitha këto vende i realizuan këto procese sipas mënyrës së vet, por e kaluara e tyre e përbashket, këto procese i karakterizoi me rrethana shumë të ngjashme. Këtu, përjashtim bën vetëm Kosova, së cilës në vitin 1989 iu suprimua autonomia me dhunë nga ana e Serbisë, ku të gjitha kompetencat iu morën, sidomos ato në fushën e ekonomisë. Për këtë, më gjerësisht do të flitet më vonë në këtë punim, por këtu do të theksojmë se në vitet e 90-ta, deri sa në njësitë tjera federative realizohet procesi i tranzicionit, në Kosovë instalohet pushteti okupues serb, bëhet emërimi i menaxherëve serbë në ndërmarrjet shoqërore, dhe vazhdon përjashtimi masiv i shqiptarëve nga puna.

³Shih: Privatizacija – Nuzhnost ili sloboda izbora; “**Jugosllavenska knjiga**”, Beograd,1994,fq.33.

2.1.0.Përvoja e ish-vendeve socialiste në transformimin e pronës dhe mundësia e shfrytëzimit të tyre në kushtet e Kosovës

Transformimet shumë dimensionale politike, institucionale dhe ekonomike , pronësore, financiare e sociale në vendet ish-socialiste kanë filluara në fund të viteve të 80-ta të shekullit të kaluar.

Për një kohë të gjatë procesi i këtyre reformave u realizua spontanisht, pasi që deri atëherë nuk kishte teori dhe praktikë e cila sqaron dhe shërben si model se si udhëhiqet ky proces. As përvoja praktike e shumë vendeve, deri në fillim të shekullit të ri, nuk krijoi një teori komplete që definon standardet e transformimit të ekonomisë së komanduar në ekonomi të tregut të lirë.⁴

Por, *“ky proces (privatizimi) nuk ka të bëjë vetëm me vendet e Evropës Lindore, por edhe me vendet e tjera duke përfshirë dhe vendet e zhvilluara të Evropës Perëndimore”*⁵

Procesi i quajtur tranzicion, i filluar para më se njezët vjetësh karakterizohet me ndryshime spektakulare. Socializmi si rend ekonomiko-shoqëror përjetoi thyerje epokale. Eksperimenti më i madh shoqëror i historisë së njerëzimit përfundoi me kolaps të plotë, duke dëshmuar se forma individuale e pronës është forma më efikase e organizimit të jetës ekonomike.

Përfundimi i sistemit institucional joefikas, i cili u dëshmuar se prodhon vetëm stagnim dhe prapambetje në krahasim me shoqëritëe tjera përparimtare, ishte esenca e ndryshimeve që vendet e bllokut socialist e vunë për objektiv të vetin. Po ashtu, është e ditur se prona është baza materiale e çdo sistemi ekonomik dhe e tërë strukturës institucionale. Së këndejmi, ndryshimet institucionale me qëllim të kthimit të efikasitetit standard dhe nëse në këto ndryshime zë vend kyç reforma pronësore atëherë kemi të vendosur një lidhje funksionale në mes të pronës dhe efikasitetit, ndërvarëshmëria e të cilave tanimë ishte dëshmuar nga teoria dhe praktika.

⁴Prof. Dr. Anastas Angjeli, *Tranzicioni dhe liria ekonomike në Shqipëri* , ‘‘GEER’’, 2007.

⁵Dr. Fatmir Mema , *“Privatizimi ne Shqipëri”*.Toena 1997.

Teoria marksiste dhe e mendimit ekonomik të ekonomisë së dirigjuar me plan ka trumbetuar efikasitetin dhe superioritetin e sistemit socialist. Në fakt, këto teori dhe apologji, përveç nga mendimi bashkëkohor ekonomik, u demantuan nga praktika, nga dështimi i sistemit të pronës kolektive. Iluzioni për prioritetin e sistemit të pronësisë kolektive dhe ekonomisë së planifikuar ndaj ekonomisë së tregut dhe pronës private, të praktikuara në Rusi pas Revolucionit të Tetorit, dhe të aplikuara edhe në vendet e tjera të bllokut socialist u demantuan nga praktika e dështimit dhe e rrënimit të ekonomive të këtyre vendeve.

Edhe pse jo plotësisht identike, por në parim të njëjta, varësisht nga niveli i zhvillimit të forcave prodhuese dhe specifikat e shteteve në veçanti, pasojat e aplikimit të këtij sistemi në vitet e 80-ta ishin aq të rënda, dhe deri diku fatale, sa që nevoja për ndryshime të shumanshme sistemore dhe institucionale nuk la vend për hamendje, por u shndërrua në domosdoshmëri.

Aktiviteti ekonomik zhvillohet në bazë të formës së pronës, institucionet përcaktojnë mënyrën e sjelljes së individëve ndaj pasurisë (*resurseve*) dhe mënyrën e përdorimit të tyre, si i ruajnë, mirëmbajnë, riprodukojnë dhe zgjërojnë ato. Pa dyshim që në lëmin e ekonomisë, tregu si formë universale dhe rregullator i ekonomisë paraqitet në lidhje të fortë funksionale me formën e pronës. Në realitet prona është baza institucionale e tregut.⁶

Këto dy kategori kanë ndërvlarshmëri. Përcaktimi për njërën, domosdoshmërisht imponon trajtim adekuat të tjetres. Të përcaktohesh për ekonominë e tregut dhe të mohosh të drejtën e pronës është absurde.

Në qoftë se do t'i referohemi dy termeve që në dukje të përafërta për pronën, për një përmbajtje mjaft të dallueshme, pra të drejtën pronësore dhe e drejta në pronë lehtë do të nxjerr konkluzionin se pa ekzistimin, gjegjësisht pa dominimin e pronës individuale,

⁶Dr. Miodrag Zec; *“Privatizacija, nužnost ili sloboda izbora”*, Bg 1994.

saktësisht të definuar, nuk ka efikasitet në shfrytëzimin(*përdorimin*) e resurseve. Përvoja ka dëshmuar inferioritetin e pronës kolektive ndaj pronës private. Parimi i mospërzierjes së shtetit në ekonomi patjetër nënkupton mbrojtjen, garantimin e pronës dhe ndërtimin e një sistemi juridik të favorshëm për ekonomi, pra të një ambienti të përshtatshëm për rritje ekonomike. Ky system, po ashtu, e kursen ekonominë nga ndërhyrjet politike dhe keqpërdorimet e forcës së shtetit.

Prona private përcakton tregun e kapitalit dhe tregun e punës. Thjesht, kapitali dhe prona nuk do të mund të jenë objekt i transaksionve të tregut nëqoftëse paraprakisht nuk janë të definuara. Si rezultat, pa pjesëmarrjen e kapitalit në treg, në shpërndarjen primare ku përcaktohet vlera e faktorëve të prodhimit nuk do të mund të matet kontributi i faktorit punë dhe prandaj nuk kemi as treg të punës.

Në aspektin e rritjes së efikasitetit, rëndësia e pronës private shprehet përmes numrit të aktorëve në vendimmarrje dhe në procesin e qeverisjes në ekonomi, nga kualiteti i vendimeve, informatave, dijes. Por, dija ka aspektin e saj dinamik, të cilin pronari privat është i interesuar që ta zhvillojë maksimalisht dhe ta aplikojë me shpenzimet e veta. Pra, progresi teknik si njëri ndër faktorët më relevantë të efikasitetit ekonomik gjen vendin e vet vetëm në sistemin e së drejtës së pronës dhe të tregut të lirë.

Në grupin e faktorëve që nderlidhin efikasitetin dhe pronën individuale patjetër zë motivi i aktorëve të prodhimit. Secili pronar vendimmarrës është i vetëdijshëm për pasojat e vendimeve dhe pasojat, gjegjësisht rezultatet e këtyre vendimeve. Kjo, sigurisht, që nuk ndodh në sistemin e vendimmarrjes ku dominon prona kolektive. Te pronarët privatë rezultatet e aktivitetit dhe vendimmarrjes janë të lidhura me të njëjtin individ. Pra, kompetencat dhe përgjegjësitë. Kjo do të thotë se pronari, prodhuesi individual, ballafaqohet edhe me rrezikun e dështimit. Kjo patjetër garanton disiplinën financiare, pa të cilën nuk mund të mendohet funksionimi i tregut.

Përcaktimi i pronësisë mbi burimet garanton edhe shfrytëzimin racional të tyre. Resurset e pambrojtura, gjegjësisht pa pronar të përcaktuar, iu ekspozohen shfrytëzimit të

pamëshirshëm, jo racional dhe degradues. Vargu i argumenteve që flasin për prioritetin e pronësisë private ndaj pronës kolektive për sa i përket efikasitetit ekonomik është i gjatë, por për qëllime të këtij punimi mjaftojnë këto. Nëse kësaj i shtohet edhe përvoja nga e kaluara që në kujtesën tonë është e freskët, teoria e mendimit ekonomik ndryshe pothuajse nuk ekziston. Së këndejmi, bazuar në përvojat që kaluan dhe rëndësinë e pronës private në rritjen e efikasitetit të ekonomisë, të gjitha ish-vendet socialiste, pa hezitim, i hyjnë procesit të tranzicionit në të cilin transformimi i pronës është faza më e rëndësishme e tij. Krahas stabilizimit makroekonomik, liberalizimit dhe ristrukturimit, privatizimi është faza më komplekse dhe që zgjatë më së shumti.

Pa dyshim që tranzicioni ka tiparet e veta të veçanta në çdo vend. Ajo që është e përbashkët për të gjitha vendet ka të bëjë me ndryshimet shoqërore lidhur me demokratizimin e jetës shoqërore-politike, kurse, ndryshimet ekonomike në rritjen e efikasitetit të afarizmit dhe transformimit në ekonomi të tregut të lirë.

Disa të tjerë, përfaqësues të mendimit ekonomik të ish-vendeve socialiste, në kuadër të tranzicionit në ekonomi, privatizimin e rendisin si fazë të tranzicionit në vendin e tretë. Sipas tyre, privatizimit i paraprin faza e eliminimit të tepicës së kërkesës, konkurrencës së tregut dhe që pasohet me fazën e konsolidimit të sistemit të shëndoshë bankar dhe financiar. Pas fazës së privatizimit në fund vije deri te ristrukturimi.

Vendet me ekonomi të shkatërruar, veçanërisht Kosova që posa kishte dalë nga lufta, me nivel të ulët ekonomik, të trashëguar, vendi më i pa zhvilluar në Evropë, me ekonomi të shkatërruar nga lufta, natyrisht që, në kuadër të tranzicionit dhe reformave në ekonomi, vëmendje të posaçme do t'i kushtonte stabilitetit makroekonomik, buxhetor e fiskal me elemente të theksuara të programeve sociale.

Derisa në Shqipëri *“sfida më e madhe e tranzicionit ishte kalimi nga faza e një ekonomie tërësisht të paralizuar dhe të bazuar në ndihmat ushqimore dhe emergjente, te programi dhe zbatimi i reformave konkrete dhe komplekse, tek politikat e zhvillimit që do të transformonin rrënjësisht marrëdhëniet ekonomike shoqërore mes njerëzve, mentalitetin e*

*tyre, institucionet, legjislacionin dhe modelin qeverisës, për të bërë të mundur hapjen ndaj botës, zhvillimin e rritjes ekonomike të qëndrueshme e të ekuilibrave të ekonomisë si dhe reduktimin e varfërisë në bazë të një strategjie kombëtare”.*⁷

Është vështirë të nxirret ndonjë përfundim për rezultatet e përbashkëta të privatizimit në vendet e Evropës Lindore për shkak të mungesës së të dhënave burimore dhe të krahasueshme. Megjithatë, nga burimet që disponojmë mund të nxirren disa rezultate për vende veç e veç. Një përvojë të veçantë, shumëdimensionale dhe të dobishme për të shfrytëzuar në kushte të ekonomisë së Kosovës ,për shkak të ngjajshmërive të sistemeve politike dhe ekonomi në të kaluarën paraqet privatizimi në vendet e ish-bllokut socialist, Shqipëri dhe në vendet e dala nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë.

Metodat e privatizimit ne vendet ish socialiste kryesisht kanë qenë si vijon:

Rikthimet; shteti rikthen ish pronarëve . e aplikuar me sukses ne Ceki, Estoni.

Shitjet e drejtëpërdrejta; Praktika te vendeve kapitaliste. Janë aplikuar në Gjermaninë Lindore, Estoni, Hungari, Poloni dhe Shqipëri. Ështe synuar shitja investitorëve të huaj.

Blerjet nga punonjësit dhe drejtuesit;Kjo metodë është aplikuar në Poloni/punonjësit/, Rusi/drejtuesit/.Rumani, Slloveni, Sllovaki, Kroaci, Maqedoni,Shqipëri.

Privatizimet massive; Emitimi i kuponëve të privatizimit. Aplikuar në Ceki, Letoni, Lituani, Shqipëri, Armeni, Kazakistan⁸.

⁷Prof. Dr.Anastas Angjeli; *“Tranzicioni dhe liria ekonomike në Shqipëri”*, fq. 27

⁸ Më gjerësisht te Adrian Civici:” Transformimi i madh” , UET PRESS, Tiranë, 2014

Në Rusi procesi i privatizimit ka filluar më së voni. Pas disa reformave në organizimin shtetëror, më 1991, dhe pas marrjes së kompetencave nga ana e republikave për udhëheqjen e reformave në politikën ekonomike nga Federata Ruse nxirret një ligj gjithpërfshirës për privatizim, të cilin e pasojnë shumë akte tjera normative dhe rregullore e dekrete. Për shkak të kundërshtimeve të shumta të interesave, në njërën anë kërkesat e punëtorëve për kushte të benificuara, dhe në anën tjetër përfaqësuesit e qeverisë reformatore që insistonin në pjesëmarrjen e sa më shumë blerësve të jashtëm. Së fundmi, çështja zgjidhet me kompromis. Punëtorët fitojnë lehtësira në blerje dhe në menaxhim të disa ndërmarrjeve të mëdha, por me ligj bëhet e mundur që aksionet të shiten ose të barten. Qëllimi i fundit është që përmes tregut sekondar më vonë të ndryshojë struktura e pronarëve.

Disa ndërmarrje në Rusi nuk kanë mundur të privatizohen si p.sh. *Industria Atomike*, limanët etj. Mirëpo, këtu është karakteristike se roli i punëtorëve, pra i vetë ndërmarrjes, në percaktimin e rregullave të privatizimit, ristrukturimi paraprak dhe korporatizimit është shumë i madh. Përkufizimet janë bërë në programet vjetore të privatizimit nga ana e shtetit. Sipas planit vjetor të shtetit disa ndërmarrjeve nuk u është mundur të privatizohen, disa të tjera (*me mbi 10 mijë punëtorë*) kanë mundur të privatizohen vetëm me leje nga një komitet i veçantë shtetëror. Disa kanë qene të lira të privatizohen, dhe disa tjera janë privatizuar, por për një kohë janë menaxhuar nga kompanitë e fuqishme Holding.

Procedurat e privatizimit kanë dalluar për ndërmarrjet e vogla nga procedurat e privatizimit të ndërmarrjeve të mëdha. Ndermarrjet e mëdha janë obliguar të përgatisin planin e privatizimit, por paraprakisht ka qenë e nevojshme të korporatizohen. Ky grup i ndërmarrjeve ka përfaqësuar pothuajse masën kryesore të fuqisë ekonomike të Rusisë. Lehtësirat për blerje nga punëtorët kanë qenë të ndara në tri kategori.

Ndërmarrjet e mesme dhe ato të vogla janë privatizuar sipas rregullave të veçanta, që përgjithsisht kanë qenë të thjeshta dhe janë realizuar përmes tenderëve publikë. Karakteristikë e privatizimit në Rusi janë vauqerët, paratë e privatizimit. Si aplikohet kjo? Çdo shtetas rus nga 1 tetori 1992 ka marrë nga një çek të privatizimit (*vauqer*) në vlerë prej

10 mijë rublash. Vlera e një Vauqeri ishte vlera e katër të ardhurave mesatare personale të vitit 1992. Shpërndarja e Vauqerëve është bërë nga banka e përcaktuar. Vauqerët nuk kanë mundur të përdorën për qëllime tjera dhe e kanë pasur të kufizuar afatin e përdorimit. Vauqerët kanë mund të blihen dhe madje edhe t'u shiten edhe shtetasve të huaj.

Privatizimi në Rusi ka qenë i decentralizuar dhe procedurat janë bërë për çdo ndërmarrje në veçanti. Edhe pse në vitin e parë janë privatizuar 1/3 e ndërmarrjeve të Rusisë, në vazhdim procesi është komplikuar, rezultatet kanë munguar dhe vetë sistemi nuk ka qenë koherent. Sistemi i Vauqerëve, i kombinuar me sistemin e aksioneve të punëtorëve, nuk dha rezultate për arsye të njohura. Prandaj, u nevojitën masa të reja me qëllim të kalimit të aksioneve në duar të pronarëve të jashtëm, koncentrimit të aksioneve, përmirësimit të efikasitetit të menaxhmentit.

Vendet e dala nga ish-Bashkimi Sovjetik, **Estonia, Lituania dhe Letonia** janë një rrëfim i veçantë për suksesin e modelit të aplikuar.

Specifike në **Letoni** është se procesi i privatizimit nuk është administruar nga një institucion qendror por sipas dikastereve. Për shembull: tokat janë privatizuar nga Ministria e Bujqësisë e kështu më rradhë. Privatizimi i tokës ka qenë më i suksesshëm dhe është realizuar relativisht shpejt. Për këtë është nxjerr ligj i veçantë. Toka iu është kthyer ish-pronarëve dhe pretendentëve me kusht që ta punojnë, por vetëm deri 50%, gjysma tjetër iu është dhënë të punësuarve. Paraprakisht ndërmarrjet bujqësore janë privatizuar dhe ristrukturuar. Aksionet kanë mundur të blihen dhe të shiten. Kritikët e këtij sistemi, edhe pse e konsiderojnë të suksesshem, i bëjnë një varg vërejtjesh procesit.

Në **Lituani** pronarëve të tokave u janë kthyer pronat e tyre sipas këtyre formave: kthimi i parcelave të njëjta, kthimi në lokacion tjetër, por ekuivalent, dhe kur nuk kishte mundësi fare atëherë përmes Vauqerëve, të cilët kanë mundur të shërbejnë për blerjen e pronave. Edhe në këtë vend është nxjerr Ligji për Reformën e Siperfaqëve të Tokës. Me këtë janë themeluar shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat më vonë procesit të privatizimit i sollen shumë probleme.

Në **Estoni** janë nxjerr disa ligje lidhur me privatizimin, dhe të gjitha e kanë shfuqizuar njëra-tjetrën. Mirëpo, Ligji për Reformën e Tokës Bujqësore nuk i mundëson askujt pronësinë, por vetëm shfrytëzimin e tokës. Edhe në këtë vend, përveç ish-pronarëve, një pjesë iu është shpërndarë të punësuarve në formë të Vauqereve.

Në sferat tjera ekonomike privatizimi në Estoni ka filluar pas aprovimit të konceptit të privatizimit nga Kuvendi i Estonisë. Ky vendim është baza e nxjerrjes së Ligjit mbi Parimet e Reformës Pronësore. Faza e parë e reformës parashihte infrastrukturën ligjore dhe fillimin me privatizim të disa ndërmarrjeve të mëdha. Faza tjetër vazhdon me ndërmarrje të vogla dhe të mesme, dhe hapi i fundit privatizimi masiv i ndërmarrjeve të mëdha. Me ligj, objekt i privatizimit përcaktohen ndërmarrjet që vlera e tyre arrijnë deri në 500 mijë rubla. Nëse ndërmarrjet ishin nën administrimin e organeve të pushtetit lokal, iniciativën e merrte pushteti lokal dhe në rast se një ndërmarrje ishte nën kompetencën e pushtetit qendror-ndonjë ministrie, iniciativa mirrej nga ai institucion. Pronaret duhej të ishin shtetas të Estonisë.

Në Estoni privatizimi është bërë sipas këtyre metodave: në garë kush ofron plane afariste më të mira, përmes shitjes së aksioneve dhe shitjes me licitacion të lirë. Me forma të ndryshme janë favorizuar të punësuarit (*për një përqindje të pjesëmarrjes*).

Për shkak të problemeve të shumta të krijuara në këtë fazë të tranzicionit, si ndërrimi i valutës, inflacionit etj, ligji është plotësuar dhe ndryshuar disa herë. Ndryshmi më i madh qëndron në hapjen e mundësisë së kompanive të regjistruara në Estoni të bëjnë privatizime. Është themeluar një ndërmarrje pranë Ministrisë së Ekonomisë që të bëjë privatizimin. Kjo ndërmarrje i ka kryer të gjitha përgatitjet për privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore. Më vonë (1992), për privatizimin e ndërmarrjeve të mëdha janë nxjerr rregulla të reja .

Privatizimi masiv në Estoni është aplikuar duke shpërndarë vauqere për ish-pronarët, për kontribut në punë të gjithë shtetasve si dhe për kontribut për punë në bujqësi. Pak a shumë, kjo metodë është e ngjajshme me atë në vendet tjera, ashtu siç është e ngjashme edhe metoda e shitjes spontane, ku defekte të shumta e përcollën këtë proces, e sidomos ato të

përfitimit të udhëheqësve dhe menaxherëve duke i përvetësuar ato me çmime të ulta dhe makinacione tjera gjatë procesit të ristukturimit dhe privatizimit.

Edhe në **Lituani** me fillimin e reformave dhe tranzicionit, pas pavarësimit, aplikohet valuta vendore (*litas*), nxirren ligje për ndërmarrësinë private dhe ndërmirren masa për terheqjen e investimeve të huaja. Por, kjo nuk jepte rezultate pa definimin e pronësisë. Për këtë qëllim qeveria merr vendim që urgjentisht të privatizohen dy të tretat e pronës shtetërore. Për realizimin e këtij vendimi janë shpërndarë *vauqere* për qytetarët, të cilët mund të kthehen në para, të shndërrohen në aksione të ndërmarrjeve të shitura me licitacion, ose të pasurisë tjetër si: banesa, toka etj.

Privatizimi në Lituani është bërë përmes metodës së privatizimit masovik dhe përmes shitjes për valutë të fortë. Gjatë procesit të privatizimit janë nxjerr disa ligje, është formuar **Komiteti Qëndror për Privatizim**. Në përgatitjen e privatizimit përmes valutës së fortë, privatizimi është bërë përmes shitjes direkte investitorit, por edhe përmes tenderëve. Në këtë proces kanë ofruar ndihmë institucionet ndërkombetare si USAID etj.

Në **Letoni** privatizimi ka filluar më së voni. Si pasojë e këtyre vonësive kriza ekonomike është thelluar. Presionet e Rusisë dhe presionet e brendshme sollën deri te rrënimi i ekonomisë së vendit. Privatizimi filloi me metoda të përziera, por kryesisht përmes shpërndarjes së *vauqereve* dhe shitjes personave fizikë dhe juridikë. Kompetent për procesin e privatizimit në këtë vend ishin Parlamenti, Qeveria, Ministrinë dhe Organet Lokale. Metodatat e privatizimit janë përcaktuar nga Ministria e Ekonomisë dhe kanë qenë të ndryshme për ndërmarrjet e vogla dhe të mëdha. Ndërmarrjet e vogla janë privatizuar përmes tenderëve, auksionit, shitjes të të punësuarit dhe personat fizikë.

Ndërmarrjet e mëdha janë privatizuar përmes tenderëve, shitjes së aksioneve, lizingut dhe likuidimit.

Në **Bullgari** nuk kishte vullnet politik për fillimin e reformës, kurse privatizimi nuk është paraparë si pjesë e tranzicionit. Është vërejtur ndikim i madh i ish-pronarëve, si dhe

konfrontimet e mëdha politike rreth çështjeve parimore të privatizimit, të cilat e kanë vështirësuar dhe vonuar fillimin e privatizimit deri në thellimin e krizës ekonomike e sociale.

Me nxjerrjen e Ligjit për Privatizimin, janë përcaktur rregullat për privatizimet e vogla dhe mënyra e korporatizimit të ndërmarrjeve të mëdha, pronar i të cilave mbetet shteti deri me rastin e privatizimit. Me ligjin e ri, të aprovuar pas tre vjetësh debati e konfrontimi, përcaktohen rregullat për angazhimin, tenderimin, dhe kontrollin e privatizimit.

Sipas ligjit, **Agjensioni i Privatizimit** përgatit planin vjetor të privatizimit në bashkëpunim me Qeverinë dhe atë plan e aprovon Kuvendi, së bashku me buxhetin vjetor. Këto plane vjetore përmbanin shumë elemente të buxhetit, si të hyrat e mundshme nga privatizimi, sektorët prioritarë, shpenzimet e këtij procesi, mjetet që mund të ndahen për çështjet sociale, shkalla e integritetit të Bullgarisë në EU dhe në ekonominë globale, tregu i kapitalit, etj. Përjashtim nga ky proces bënin degët specifike si: *prodhimi i armëve, energjëtika, xehtaria, nafta dhe hekurudha*. Janë caktuar kuotat e vlerave dhe janë caktuar organet kompetente të privatizimit. Të gjitha janë grupuar në tri kategori.

Është mundësuar participimi i punëtorëve në blerjen e privilegjuar të aksioneve . Kjo shansë iu ofrohet punëtorëve me dy vite stash pune, por shumica e blerjes shkon deri në 20 % të vlerës së ndërmarrjes, kurse ato iu jepen punëtorëve me 50% lirim. Aksionerët e kësaj kategorie nuk kanë të drejte vote për tri vjet.

Nga mjetet e privatizimit janë krijuar disa fonde, si ai i Mbulimit të Shpenzimeve, Fondi i Përbashket deri në 20% për sigurime sociale dhe Fondi për Zhvillimin e Bujqësisë. Pjesa e mbetur ka shkuar në Fondin për Zhvillim dhe Rindërtim.

Nga shitja e ndërmarrjeve të nivelit lokal, ndarja është e njëjtë me përjashtim se gjysma e tyre janë destinuar për fondin komunal. Në vlerësimin e pasurisë kanë ndihmuar ekspertët e jashtëm dhe agjensionet e licencuara, kurse, privatizimi është bërë përmes shitjes të blerësit strategjikë, bisedat e drejtpërdrejta, licitacionit publik, shitjes së pjesshme, ose të tërë ndërmarrjes përmes tenderit ,si dhe blerja nga të punësuarit. Ndërmarrjet e korporatizuara

kanë mundur të shiten perms *lizingut* deri në 25 vjet, si dhe shitjes me këste, kurse, pasuria i kalohet blerësit proporcionalisht me pagesën. Këtu, kishte edhe shitje të kushtëzuara me investime, punësim etj. (*Ngjajshem me Spinoff-in Special në Kosovë*). Të huajt nuk kishin të drejtë në bartjen e pronësisë. Toka iu është kthyer pronarëve sipas gjendjes së vitit 1946, pra para kolektivizimit. Ata që nuk kishin prona më parë mund të bëhen pronarë me kushtin që ta punonin së paku 10 vjet . Edhe pasuritë tjera si: objektet industriale, fabrikat, banesat që kanë mbetë në formën e parë, iu janë kthyer ish-pronarëve. Është shumë interesane forma masovike e privatizimit në Bullgari. Çdo qytetari të Bullgarisë, që dëshiron të marr pjesë në privatizimin e ndërmarrjeve të mëdha dhe atyre të mesme, shteti i jep kredi në formë të boneve në vlere prej 1100 \$. Në këto raste, qytetari ka mund të merr pjesë në blerje në një ndërmarrje ose holding. Të gjitha këto nuk e kanë çënuar 20% të të drejtës së të punësuarve për blerje.

Vlen të evidentohet se nga i gjithë procesi, privatizimi i banesave ka qenë më i suksesshmi, pastaj privatizimi në zonat e urbanizuara, gjegjësisht kthimi i ish-pronarëve, ku shpejt dhe pa problem pasuria e konfiskuar iu është kthyer ish-pronareve. Në këtë proces kanë ndodhë edhe defekte, që lidhen me privatisimin ilagal dhe të ashtuquajtur të heshtur. Përgjithësisht ky proces në Bullgari ka qenë i stërzgatur, shumë i kritikuar, shumë ingarkuar me procedura dhe ka dhënë shumë pak rezultate në drejtim të ristruktuimit të ekonomisë.

Një formë e vetëqeversjes punëtore kishte filluar në **Poloninë** vitet e 80-ta si pasojë e mosefikasitetit të ekonomise centraliste të planifikuar. Më pas, lëvizja e fuqishme sindikale e njohur si “*Solidarnost*” imponoi fillimin e privatizimit spontan të udhëhequr nga menaxherët dhe këshillat e punëtorëve. Një proces zyrtar i privatizimit ka filluar me nxjerrjen e Ligjit për Privatizim në vitin 1990. Me këtë ligj percaktohet, si obligim, studimi i fizibilitetit dhe mënyra e përcaktimit të vleres së pasurisë para privatizimit. Të huajve iu mundësohet blerja deri në 10% e vlerës, por me pelqimin e shtetit, ndërsa punëtorëve deri në 20% e aksioneve me 50% lirim. Nxjerrja e ligjit në praktike ka bërë bartjen e vendimmarrjes në Ministrinë e Financave. Komercializimi ka qenë modeli i privatizimit të ndërmarrjeve të mëdha. Kjo metodë është iniciuar nga punëtorët, janë vlerësuar nga

ekspertët, dhe pas përcaktimit të vlerës së aksioneve të gjitha kanë kaluar në pronësi të shtetit. Shitja është bërë përmes sistemit të aukcioneve. Në vitet në vijim janë shfrytëzuar modelet e aukcionit, konkursit dhe shpalljes publike. Por, është shfrytëzuar edhe metoda e bisedave direkte me investitorët e huaj.

Si model tjetër për privatizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe atyre të mesme është shfrytëzuar likuidimi, si teknikë me çka ndërmarrja pushon së ekzistuari. Sipas këtij modeli shitet e gjithë ndërmarrja, ose një pjesë e saj, mëpastaj themelohet një ndërmarrje e re nga investitori dhe Ministria, e cila blen një pjesë të pasurisë, ose të punësuarit dhe menaxherët, themelojnë një ndërmarrje, të cilën dhe pastaj marrin në shfrytëzim nga shteti. Ndërmarrjet e pa perspektivë dhe ato jo aktive janë privatizuar përmes metodës së bankrotimit.

Meqenëse procesi i privatizimit rrjedhte shumë ngadalë, shteti hartoi një program tjetër privatizimi përmes resturktuimit. Megjithatë, duhet thënë se privatizimi në Poloni ka rrjedhë ngadalë, me probleme dhe me shumë vërejtje. Interesimi i investitorëve të huaj ishte nën pritshmërinë, dhe krejt kjo ndodhi si rezultat i jostabilitetit makroekonomik të vendit.

Për Poloninë është karakteristike privatizimi masiv që ka mbështetje të plani i *Sachs-it* për bartjen pa pagesë të pasurisë nga shteti të investitorët institucionalë që formoheshin nga shteti si fonde investive. Teknika e shitjes ishte si në vijim:

Njërit fond i jepeshin 33% e aksioneve, shteti mbante 25%, të punësuarit 15% , kurse fondet tjera 27% të aksioneve. Aksionet lejoheshin të shitbleheshin ndërmjet fondeve. Prandaj, kishte një lloj konkurrence ndërmjet fondeve, ku fondi bartës (33%), merrte përgjegjësinë e menaxhimit. Më në fund, pronësia mbi fondet është bartur të qytetarët përmes shpërndarjes së aksioneve për çdo qytetar të Polonisë.

Privatizimi masiv në Poloni ka bazën në teoritë e akademikëve të njohur si: Sachs, Lipton etj.

Hungaria ka kaluar një rrugë ndryshe nga vendet tjera në tranzicion. Më herët, ky vend, ka aplikuar elemente të ekonomisë së tregut. Privatizimin nuk e kanë marrë si çështje të ngutshme, ose si proces që duhet realizuar me çdo kusht, por janë udhëhequr nga parimi i dobisë më të madhe makroekonomike mbi parimin që procesi i ri duhet të jetë më i suksesshëm sesa ai i vjetri. Nisur nga kjo, këtu qëllimi i privatizimit është përcaktuar nga çmimi i ndërmarrjes dhe maksimumin e të hyrave të shtetit nga privatizimi.

Hungaria nuk ka pasë krizë të thellë ekonomike, sikurse ka ndodh me vendet tjera, prandaj thuajse në komoditet janë filluar reformat ekonomike në sferën e liberalizimit të çmimeve, tregtise së jashtme, pronësisë, etj. Privatizimi në fillim ka qenë spontan dhe i decentralizuar, më vonë është rritur kontrolla e shtetit.

Në fillim ndërmarrjet vetëqeverisëse janë korporatizuar (*njësoj si në Poloni.*). Agjensioni ka marrë në pronësi ndërmarrjet vetëqeverisëse. Hungaria ka qenë më e hapur ndaj investitorëve të huaj. Metoda, që është predikuar, ka qenë ajo e konkurimit dhe licitacionit. Njëra mënyrë e shitjes ka qenë shitja direkte nga agjensioni i ndërmarrjeve shtetërore. Mënyra tjetër ishte privatizimi spontan, dhe modeli i tretë ai i privatizimit të ndërmarrjeve të vogla zejtare, shërbimeve etj. Kjo nuk dha shumë rezultate, për shkak të procedurave që zbatonte agjensioni. Një metodë tjetër e privatizimit, e aplikuar në Hungari, ishte ajo që investitorët ofronin ofertën e tyre te agjensioni dhe në këto raste fitonte ofertuesi më i mirë.

Me qëllim të shpejtimit të procesit dhe rritjes së efektivitetit, qeveria hungareze vazhdimisht ka kërkuar rrugë dhe modele të reja deri te kreditimi i blerjes dhe shpërndarja gratis e kapitalit shtetëror. Prandaj, vlen të theksohet se Hungaria është shembull i tërheqjes së investitorëve të huaj.

Gjermania Lindore procesin e tranzicionit e ka kryer në mënyre krejt specifike. Bashkimi me Gjermaninë Federale e ka sjellë ekonominë e kësaj pjese në rrethana të pavolitshme. Kushtet e tregut të lirë, valuta e përbashket, humbja e tregjeve etj. e kanë shkaktuar rënien e aktivitetit ekonomik për 50 %. Megjithatë, faza e tranzicionit për këtë vend ishte shumë më

e lehtë, sepse ky vend u bë pjesë e një shteti të fuqishëm ekonomikisht dhe për tejkalimin e problemeve ndau dhjetra miliarda DM nga buxheti i vendit.

Privatizimi në këtë vend është bërë përmes agjencisë, e cila të gjitha ndërmarrjet i vuri nën administrim dhe kontroll. Kjo Agjenci ishte publike me liri veprimi në nivel korporate. Po ashtu, ky institucion, kishte shkallë të lartë pavarësie në veprim, nuk i përgjigjej askujt dhe kishte karakter të përkohshëm, prandaj, duhej të shuhej me përfundimin e procesit të privatizimit. Agjencia kishte për detyrë të ndajë ndërmarrjet në njësi të vogla, të ristrukturojë ato apo të mbyll ato të pasuksesshmet dhe natyrisht të bëjë shitjen e tyre te pronarët privatë.

Karakteristikë e privatizimit në Gjermaninë Lindore mund të nxirret metoda, të cilën Agjencia paraprakisht i aftësonte ndërmarrjet për konkurrentshmëri duke i ristrukturuar dhe aftësuar struktura të menaxhuese. Me rastin e vendimit për privatizim, kriter bazik ka qenë vazhdimi i modernizimit dhe rritja e produktivitetit, aftësia për sigurimin e lëndeve të para, rritja e forcës ekonomike të rajonit dhe kontributi në buxhetin e shtetit.

Krahas çmimit, element me rëndësi ishte përcaktimi i blerësit që garanton ruajtjen e punësimit dhe investime. Në rast të rritjes së investimeve, dhe shtimit të vendeve të punës kishte zbritje në çmim të blerjes. Format më të rëndomta të shitjes ishin shitja e drejtpërdrejtë, përmes ofertës së disa blerësve, shitja publike e kufizuar në disa blerës dhe shitja publike dhe aukcioni. Në procesin e privatizimit në Gjermaninë Lindore kujdes maksimal i është kushtuar interesit kombëtar dhe shumë pak barazive, ose të drejtës individuale. Pjesën më të madhe të ndërmarrjeve i kanë privatizuar ndërmarrësit nga Gjermania Federale. Duke marrur parasysh specifikat e këtij vendi, në fazën e tranzicionit, mund të nxirret përfundim se me ndihmën e Gjermanisë Perendimore, pas bashkimit, ky proces kaloi tepër shpejt dhe lehtë edhe përkundër problemeve të caktuara. Megjithatë, mund të vlerësohet si vendi që në mënyrën më të suksesshme e ka kryer procesin e privatizimit.

Në **Rumani** ndryshimet kanë ndodhur me revolucion. Por, ky vend deri atëherë ka qenë vend i centralizuar dhe diktatorial. Vendi pësoi rrënim të mënjëhershëm të ekonomisë. Përveç ndryshime të mëdha në sistemin politik, nxjerrja e **Ligjit për Privatizimin** ndihmoi

shumë në shndërrimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri aksionare, të cilat më pastaj janë privatizuar. Është formuar Agjencia e Privatizimit. Këtu, privatizimi është kryer në 3 faza: *shndërrimi i ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri aksionare, ndarja gratis e 30% të ndërmarrjeve shtetërore dhe shitja e 70% të ndërmarrjeve shtetërore.*

Sipas Ligjit për Sektorët Strategjikë, janë formuar ndërmarrjet autonome, të cilat ishin në pronësi të pronarëve, por kontrollohej nga shteti. Pjesa tjetër e ndërmarrjeve u shndërruan në shoqëri aksionare dhe iu nënshtruan procesit të privatizimit.

Privatizimi i sipërfaqeve bujqësore dhe i banesave është realizuar sipas ligjeve të veçanta.

Në Rumani, nga shitja janë formuar gjashtë fonde, nga të cilat një fond shtetëror dhe të tjerët fonde për pronën private. Kështu, rreth 30% e vlerës iu janë ndarë falas të gjithë banorëve të moshës madhore.

Si përfundim, është vlerësuar se privatizimi në Rumani nuk i ka dhënë rezultatet e pritura dhe kjo matet me shkallën e zhvillimit ekonomik, standardin e ulët jetësor, papunësi dhe investime të pakta të huaja.

Çekosllovakia:- është karakteristike për nga niveli maksimal i pronës shtetërore, centralizimit dhe planifikimit rigoroz. Poashtu, është shumë spektakulare mënyra e ndërrimit të sistemit dhe tejkalimi i tranzicionit me shumë pak probleme ekonomike. E gjithë faza e parë e tranzicionit është tejkaluar me një shkallë papunësie prej 7%, kurse prodhimi i kishte rënë vetëm 16%, dhe ate vetëm në dy vitet e para. Nuk kishte shumë rritje çmimesh. Në filozofinë e tranzicionit ka dominuar veprimi i shpejtë. Meqenëse popullsia nuk kishte kapital të mjaftueshëm për blerjen e pronës, dhe duke mësuar nga përvoja e Polonisë dhe vendeve të tjera, në procesin e privatizimit, përveç shitjes, u shfrytezua edhe privatizimi përmes shpërndarjes pa pagesë. Fillimisht u bë restituimi i pronës pronarëve të parancionalizimit, filloi procesi i privatizimit për ndërmarrjet me deri 500 të punësuar, dhe kryesisht atyre zejtare, tregtare dhe shërbyese. Ndërmarrjet që do të privatizoheshin, paraprakisht obligoheshin për përgatitjen e planit, vlerësimin e pasurisë,

mënyrën e organizimit dhe menaxhimit. Me këto plane mund të konkurronin edhe blerësit e jashtëm, me çka u mundësua një konkurrencë në ofrimin e opcioneve.

Privatizimi është bërë përmes shitjes direkte të blerësit të percaktuar më parë, licitacionit, konkursit, transferit pa pagesë, etj. Në strukturën e shitjeve, transferi pa pagesë përmes *Vauqereve* kishte një pjesëmarrje mjaft të lartë, edhe interesimi i qytetarëve ishte shumë i madh. Njëkohësisht janë themeluar rreth 400 fonde private, të cilat i blenin *vauqeret* dhe pronarëve u garantonin fitime të mira. Pas dy vjetësh filloi shpërndarja e aksioneve për ndërrmarjet e privatizuara. Berza e *vauqereve* u bë më e njohura në vendet në tranzicion.

Si përfundim, modeli çekoslovak i privatizimit masiv, përmes *vauqereve*, tregoi epërsi dhe mundësi për tejkalimin e shumë problemeve në procesin e privatizimit. Kjo mund të ishte model edhe për vendet tjera, sidomos respektimi i drejtësisë në shpërndarje, masiviteti, formimin e investitorëve institucionalë (*fondeve*) dhe shpërndarjen e gjerë të pronës. Roli i jashtëzakonshëm i liderëve politikë të vendit në atë kohë ishte i theksuar si z. V. Havel, dhe V. Klaus. Edhe privatizimi i bankave është realizuar paralelisht me privatizimin e pjesëve të reja të ekonomisë, dhe poashtu kryesisht përmes *vauqereve*.

Në vendet e shkëputura nga **ish-Jugosllavia** privatizimi ka filluar në të njëjtën kohë me vendet tjera të bllokut socialist .

Slllovenia ishte njësia federale me e zhvilluar në ish-Jugosllavi. Në fakt, sistemi vetëqeverises jugosllav mundesonte zhvillimin e një ekonomie të hapur ndaj botës dhe me treg gjysëm të hapur. Ky vend u shkëput nga Federata Jugosllave më 1991. Ishte pjesa me e zhvilluar, struktura ekonomike dominohej nga industria, kishte një tregti të zhvilluar me jashtë dhe atë në tregjet e vendeve perëndimore. Menjëherë pas pavarësisht ky vend filloi me programin e privatizimit, përkatësisht tranzicionit. Fillimisht me reformën monetare për të vazhduar me stabilizimin makroekonomik dhe privatizimin.

Te ky vend, privatizimi në fillim është realizuar në bazë të ligjit të vjetër Jugosllav, por të amandamentuar e pastaj është nxjerr ligji i ri mbi privatizimin. Procesit të privatizimit i kanë

paraprirë debate dhe polemika të ashpra dhe në sfond janë paraqitur shumë modele, por në fund janë sintetizuar në dy modele:

- 1) *Privatizimi gradual, pa nderhyrje por me mbikëqyrje të shtetit përmes agjencive të specializuara. Ky privatizim ka qenë kryesisht intern.*
- 2) *Modeli i dyte ishte i ngjashëm me modelin polak: privatizim i shpejtë, masiv, përmes shpërndarjes gratis të aksioneve. Ligji i ri zgjodhi një mënyre të kombinuar ndërmjet shpërndarjes masive të aksioneve, blerjes interne dhe shitjes komerciale.*

Me qëllim të realizimit të procesit të privatizimit, Sllovenia formon Agjensionin e Privatizimit në funksion të kontrollit dhe mbikëqyrjes, ndërsa Fondi për Zhvillim kishte funksionin e shitesit të pasurisë. Shitjet direkte janë realizuar nga vet ndërmarrjet, me pëlqim të Agjensionit, ndërsa për shitjen e aksioneve të kapitalit shoqëror kontratën e lidhte *Fondi për Zhvillim*. Blerësit i jepeshin 51% e pjesëmarrjes, 1/4 iu jepej, pa konpenzim, të punësuarve, dhe pjesa tjetër ish-pronarëve. Kriteri i shitjes nuk ishte vetëm çmimi por edhe plani zhvillimor, investimet dhe punësimi i garantuar. Metodë kryesore e privatizimit ishte shitja interne, e veçanërisht të ndërmarrjet e vogla dhe ato të mesme. Kjo metodë e privatizimit është realizuar përmes shndërrimit në kompani *Holding*, por kishte raste të shndërrimit të ndërmarrjeve edhe në *shoqëri aksionare*, aksionet e se cilës i barteshin kompanisë *Holding*, që krijohej dhe që bëhej pronar dhe shites i ndërmarrjes së vjetër. Problemi më i madh i modelit slloven të privatizimit lidhet me pasigurinë e vendeve të punës, në rast të mospasurisë të ndërmarrjes së privatizuar. Mënyra e ndarjes së certifikatave falas të pronësisë nuk e garanton suksesin edhe të ndërmarrjet jorentabile, vlera e aksioneve të cilave mund të binte në berzën e letrave me vlere. Problem tjetër u paraqet edhe roli pasiv i aksionerëve në menaxhimin e ndërmarrjeve, sidomos në vitet e para derisa të filloi shitja e aksioneve në treg. Problem të vaçantë kanë paraqitur ndërmarrjet jorentabile, të cilat paraprakisht duhej sanuar, ristrukturuar dhe në fund edhe privatizuar. Te kjo kategori e ndërmarrjeve veçanërisht tproblem paraqet mbyllja e një numri të madh të vendeve të punës.

Nga modeli Slloven i privatizimit mund të nxirret mësimi i mundësisë së pasurimit të individëve në vend të sigurimit të efikasitetit të ndërmarrjeve të privatizuara, si dhe problemin e ndërmarrjeve të mëdha në falimentim, sanimi i të cilave ju paraprinë rristruktuimit dhe privatizimit.

Në **Maqedoni** privatizimi ka filluar duke u bazuar në Ligjin Federativ të Jugosllavisë. Edhe pse Maqedonia u pavarësua më 1991, ajo deri më 1993 nuk arriti të këtë ligjin e vet dhe ta themeloi Agjencinë për Transformimin e Pronës. Metodatat e privatizimit kanë qenë të ndryshme për ndërmarrje të vogla, të mesme dhe të mëdha. Ndërmarrjet e vogla janë privatizuar me blerje interne 51% dhe pas 5 vjetve ka pasuar blerja e pjesës tjetër ose shitja e pjesëve të ndërmarrjes përmes shitjes së aksioneve. Ndërmarrjet e mesme janë shitur në tërësi, ose pjesërisht dhe blerjes së ndërmarrjes nga menaxhmenti, dhënia e aksioneve për investime plotësuesedhe shndërrimi i borxheve në aksione. Edhe ndërmarrjet e mëdha janë privatizuar me të njëjtat metoda, por për këto kishte edhe mundësi dhënien me *lizing*, shitja pas likuidimit dhe transformimit të ndërmarrjes, e cila ishte në likuidim të borxhit në aksione pronësie. Në Maqedoni nuk është aplikuar metoda e privatizimit masiv, por ka pasur lehtësira për të punuarit në ndërmarrjet e privatizuara.

Përfashtim në proces kanë bërë: ndërmarrjet publike, shërbimet, monopoli natyror dhe ndërmarrjet bujqësore, të cilat nuk janë të privatizuara. Karakteristikë tjetër e privatizimit në Maqedoni është se procesi është përcjell me parregullësi të shumta dhe nuk ka dhënë rezultate të pritura.

Në **Kroaci**, procesi ka filluar, poashtu i bazuar në Ligjin Federativ, dhe i cili ka mundësuar dhënien e aksioneve të të punësuarve dhe qytetarëve me lëshime të mëdha. Pas pavarësisë së Kroacisë është nxjerr Ligji mbi Transformimin e Ndërmarrjeve Shoqërore dhe Ligji për Agjencinë për Ristrukturim dhe Zhvillim. Ky institucion kishte kompetencë për kontrollën dhe mbikëqyrjen e procesit të privatizimit. Agjencia kishte kompetencë në përzgjedhjen e blerësit, çmimit dhe kushteve tjera të shitjes. Ndërmarrjet janë përcaktuar vet për formën privatizimit, por patjetër u është kërkuar pëlqimi i Agjencisë.

Procesi i privatizimit në Kroaci është penguar për shkak të rrethanave të krijuara nga lufta me Serbinë, rrethana këto që e shtynë në plan të dytë këtë proces, krijuan vështirësi ekonomike, inflacion të lartë dhe probleme tjera përcjellëse.

Sipas ligjit kroat, përjashtim nga procesi i privatizimit kishin bankat dhe institucionet tjera financiare edhe agjensionet e sigurimeve pasi që ato ishin shndërruar në shoqëri aksionare, ose SH.P.K., si dhe tokat bujqësore të nacionalizuara nga sistemi komunist.

Sipas ligjit në Kroaci të drejtë pjesëmarrjeje në privatizim kishin personat fizikë, të punësuarit, të punësuarit në ndërmarrje tjera, investitorët, të besuarit, Fondi Pensional, Fondi Kroat i Zhvillimit, pronarët e dikurshëm etj..

Transformimi i ndërmarrjeve në shoqëri aksionare (sh.a) është bërë përmes shitjes, investimit, shndërrimit të investimeve në pjesëmarrje dhe pronësi dhe në bartjen e të gjitha aksioneve Fondit Pensional. Për mënyrën e transformimit vendos vetë ndërmarrja, kurse pëlqimin dhe mbikëqyrjen e bën Agjensioni.

Karakteristikë e privatizimit në Kroaci është se në fillim ndërmarrjet janë transformuar nga ndërmarrje shoqërore në ndërmarrje me pronësi shtetërore. Ky transformim konsiderohet hap i mirë sepse të paktën është definuar pronari. Mirëpo, edhe kjo nuk i dha rezultatet e pritura, dhe sidomos nuk pati sukses në ndërprerjen e parregullësive. Pas përfundimit të luftës, shteti përcaktohet për privatizim përmes shitjes së aksioneve. Kështu, mund të nxirret përfundim se Kroacia nuk pati vullnetin dhe kurajon e privatizimit me metoda të vendeve tjera në tranzicion dhe të përfundojë me sukses këtë fazë të tranzicionit.

Procesi i privatizimit në **Jugosllavinë e Mbetur**(*Serbia me Kosovën e okupuar dhe Malin e Zi*), u zhvillua në rrethana krejtësisht specifike për shkak të sistemit specifik të saj. Fillimisht, specifike e fillimit të procesit të tranzicionit dhe posaçërisht privatizimit, ishte prona shoqërore, pa titullar të mirëfilltë. Specifikë tjetër ishte edhe dispozita kushtetuese, e cila Këshillat e Punëtorëve i definonte si autoritetin e vetëm vendimmarrës për transformimin e pronës. Nxjerrja e Ligjit mbi Qarkullimin e Kapitalit Shoqëror nuk ofroi zgjidhje se kush do të mund të pranonte paratë nga shitja eventuale e pronës shoqërore. Një

zgjdhje e ofruar në formimin e fondeve republikane dhe krahinore, të cilat do të pranonin paratë nga privatizimi, statusi i të cilave është i pa definuar. Por, pse do të vëndosnin Këshillat e Punëtorëve për shitjen e pronës shoqërore nëqoftëse paratë nga privatizimi do të derdheshin në Fond, në të cilin këto nuk kishin kurrëfarë interesash dhe kur kjo i zhveshte nga çdo formë e pronësisë?!

Dispozitat e Ligjit mbi Kapitalin Shoqëror dhe Ligjit mbi Pagesën e të Ardhurave Personale stimulohet iniciativa për transformimin e pronës, përmes lehtësirave në privatizim, lehtësirave kreditore, si dhe pagesës së të ardhurave në formë të aksioneve.

Vlerësohet se Ligji Federativ, përveç që përcaktoi ristrukturimin pronësor organizativ, qeverisës dhe prodhues, përcaktoi edhe dy modelet që do të aplikoheshin gjatë procesit të privatizimit në Jugosllavinë e mbetur. Dy modelet që përcaktonte ky Ligj ishin shitja dhe privatizimi intern. Karakteristikat e modelit federativ, për dallim nga ato republikane, është autonomia e vendimmarrjes nga ana e organeve vetëqeverisëse të ndërmarrjeve, mundësia e zgjedhjes së lirë të strategjisë dhe procedurave të transformimit, decentralizimit, realizimit gradual të privatizimit dhe minimizimi i rolit të shtetit në proces. Në këtë periudhë privatizimi intern, përmes aksioneve, ka qenë dominues.

Mënyra e qasjes ndaj këtij problemi, ka mundësuar vjedhjen, keqpërdorimin dhe manipulimet e ndryshme, sepse prona shoqërore nuk ishte e mbrojtur, ishte e pa definuar dhe si e tillë në vete bartte shumë kundërtënie. Për rritjen e efikasitetit të ndërmarrjeve autoritetet kishin para vetes shumë dilema që lidheshin me dinamikën e procesit të privatizimit. Cili në fakt ishte motiv i këtij procesi; definimi i pronës, apo rritja e efikasitetit? Problem në vete paraqiste edhe harmonizimi i interesave të akterëve në "lojë" si të punësuarit aktualë, pensionistëve, shtetit, etj. Kush merr vendim për transformim dhe cilat do të jenë politikat operacionale dhe cilat institucione do të realizojnë këto operacione?

Fillimisht procesi është realizuar përmes ndryshimeve statutore, bashkimit dhe unifikimit të ndërmarrjeve pa asnjë lloj kontrole. Kjo fazë ka qenë e dëmshme veçanërisht për ndërmarrjet e Kosovës. Në këtë periudhë, siç është përmend edhe në fillim të këtij punimi,

autonomia e Kosovës ishte suspenduar me dhunë, kurse udhëheqjet legjitime të ndërmarrjeve kosovare ishin suspenduar dhe në vend të tyre ishin emëruar drejtorët e dhunshëm nga ana e Kuvendit të Serbisë. Këto udhëheqje, të instaluara dhunshëm, bënë bashkimin e ndërmarrjeve kosovare me ndërmarrjet në Serbi duke i shndërruar ato në njësi, ose pjesë të tyre. Ky proces i dhunshëm u quajt proces i “integritit të ndërmarrjeve”. Udhëheqjet e dhunshme të instaluara ndërmorrën veprime të paligjshme dhe kryen transaksione, përmes të cilave pronësia e këtyre ndërmarrjeve u tjetërsua.

Transformimi i pronës shoqërore në këtë periudhë ka ndodhur edhe përmes zvogëlimit të kësaj prone si rezultat i humbjeve, pagësës së pagave pa punuar, dhënie e kredive të lira, transformimi i sistemeve të mëdha në ndërmarrje publike, si edhe transformimi i ndërmarrjeve shoqërore në shoqëri aksionare.

Baza institucionale e transformimit të pronës ishte themelimi i Fondit për Zhvillim të Republikës së Serbisë në bazë të Ligjit Mbi kushtet dhe Procedurat e Transformimit të Pronës Shoqërore në Forma tjera Pronësore.

Për dallim nga vendet tjera në tranzicion, Fondi mund të transformohej në shoqëri aksionare me pëlqimin e qeverisë dhe me 51% të kapitali shtetëror. Pra, dominimi i shtetit në politikat e Fondit ishte i përcaktuar me ligj . Në vendet tjera pjesëmarrja e fondeve ose e pronës shtetërore ishte nën 50%. Përveç programit të nxitjes së rikutimit, konsolidimit financiar dhe prodhues të ekonomisë ,*Fondi kishte rol të pastërt politik, pasiqë angazhohej në krijimin e kushteve dhe rrethanave për kthimin e serbëve dhe malazëzve në Kosovë*⁹. Në këtë aspekt, në interes të argumentimit të këtij veprimi qëllimkeq dhe të paligjshëm, po shkëpusim një pjesë nga një studim i cekur disa herë në këtë punim, e që është konstatim i vet studiuesve serbë të procesit të privatizimit e që ka të bëjë me funksionin e Fondit lidhur me transformimin e ndërmarrjeve në Kosovë:

“Fondi drejtëpërdrejt inicion marrjen e ndërmarrjeve në Kosmet (Kosovë,v.j.) përmes bartjes së aksioneve në Fond, ose në ndërmarrje tjetër në pjesën qendrore të Republikës; kjo formë e nominimit pronësor zhvendos pronësinë jashtë ndërmarrjes. Fondi do të i shes

9 Më detalisht në :”Privatizacija,Nuzhnost ili sloboda izbora”,Grup Autorësh, Beograd.1994, fq 222

akcionet e veta në treg, me çka do të iniciojë ndryshimin e përkohshëm të pronës dhe strukturës qeverisëse;Fondi në këtë rast është iniciator tranzitor, i cili modelon dhe përshpejton procesin e transformimit¹⁰.

Me pjesëmarrjen e këtij Fondi në Kosovë janë transformuar 235 ndërmarrje.

Një institucion tjetër që u përfshi në transformimin e pronës ishte Agjencioni për Përcaktimin e Vlerës së Kapitalit shoqëror, që po ashtu ishte institucion me karakter shtetëror dhe publik. Ky Agjencion përcaktonte vlerën e pasurisë shoqërore dhe kontrollonte procesin e transformimit.

Në procesin e privatizimit në Jugosllavinë e Mbetur kemi pasë dy kahe të zhvillimeve. Derisa në fuqi ishte Ligji Federativ në proces ka dominuar procesi i quajtur **rikapitalizim i ndërmarrjeve**, shitja e kapitalit dhe bartja e fondeve .Rikapitalizimi sipas **Ligjit Republikan (Serb)** nuk ishte atraktiv. Me Ligjin Republikan shitja e kapitalit bëhet më atraktive. Modeli i tretë i bartjes së kapitalit aplikohet ekskluzivisht për ndërmarrjet nga Kosova.

Deri në shpartallimin e ish-Jugosllavisë, privatizimi në bazë të Ligjit Federativ më dinamik ka qenë në Slloveni dhe në Serbi, kurse më i ngathët në Kroaci dhe në Maqedoni. Në Kosovë ky proces ka qenë krejtësisht politik dhe është udhëhequr nga shteti (*Beogradi*).

Si përfundim, procesi i privatizimit në të gjitha ish-vendet socialiste ka zgjatur gjatë gjithë dekenies së fundit të shekullit të kaluar. Edhe pse i stërzgatur dhe me shumë probleme e dilema, përvoja e krijuar mund të shfrytëzohet nga vendet, të cilat për shkaqe dhe rrethana specifike, siç është rasti i Kosovës, më vonë e kanë filluar procesin e tranzicionit dhe privatizimit.

Pasqyrë krahasuese e metodës së privatizimit ne vendet e dala nga Ish Jugosllavia

¹⁰Po aty ,fq.223

Vendi	Fillimi i procesit	Baza ligjore	Institucionet	Metoda e privatizimit
Sllovenia	1991	Ligj. Jug. Ligj. Mbi Privatizimin	Agjencia e Privatizimit Fond.Zhvillim	Shpërndarja masive Blerja interne Shitja Komerciale
Maqedonia	1991	Ligj. Jug.	Agjencioni për Transf. e Pron.	Blerjet interne/51%/ Shitja e akcioneve/49%/ Shitja masive/ nd.mesme/ Blerja nga menaxh.dhe lizing/nd.m/
Kroacia	Lufta Vonesë	Ligj. Jug. Ligj për Transf.pron.	Agjencia për Ristr dhe zhvill. Transf.pron.	Privatizimi përmes shitjes,invest. Përfashtim Bankat, inst.Fin.Sigur. Tokat bujqësore të nacionalizuara.
Serbia&MZ	1991	Ligj.Jug. Ligji për Transf.Pr.Shoq.	Fondi për Zhvillim	Privatizim intern dhe shitje
Kosovë	2003	Ligji për AKM	AKM Dhoma e Pos.	Komercializimi Spin-of, Spin-of Special,likuidim.

Analiza e këtij procesi në këto vende flet për mungesën e përvojës në transformimin e pronës. Kjo i shtyri këto vende që me rastin e përcaktimit të modelit të privatizimit të përcaktohen për modele të përziera, pra për aplikimin e përnjëhershëm të disa modeleve. Shiquar nga aspekti i së kaluarës historike, këto vende kishin përvojë në transformimin e pronës, nga prona private në pronë shtetërore përmes nacionalizimit dhe shtetëzimit. Por, ky proces ka qenë shumë më i thjeshtë, është realizuar shumë shpejt dhe nuk ka qenë aspak human, i drejtë dhe ligjor. Prandaj, kjo përvojë e së kaluarës nga kjo formë e transformimit të pronës këtyre vendeve nuk mund të iu shërbejë si përvojë pozitive me rastin e fillimit të tranzicionit dhe të privatizimit. Procesi i tranzicionit dhe i transformimit të pronës nuk mund të bëhet me revolucion, është proces i ndërlikuar, i ndjeshëm dhe shumë i vështirë për t'u përfunduar me sukses dhe për qëllime të parashtruara me program. Në shumicën e vendeve në tranzicion, metodat e privatizimit ishin mjaft të ngjajshme. Ndryshojnë vetëm disa teknika të ekzekutimit ,psh. ngjajshmëri shohim te Polonia dhe Maqedonia, te Serbia dhe Kroacia. Te një numër i madh vendesh shohim ngjajshmëri në shpërndarjen e *vauqereve*. Po ashtu, ngjajshmëri në kombinimin e metodave të privatizimit kanë të gjitha vendet në tranzicion. Në këtë kompleksitet metodash dallojmë dy koncepte: mendimi teorik akademik rekomandonte shpërndarjen pa kompenzim të pasurisë, kurse institucionet financiare mbështesnin shitjen e aseteve. Kjo, më tepër i përngjante metodës së aplikuar në vendet kapitaliste. Qeveritë e vendeve si: Hungaria dhe Polonia shpresonin që me metodën e shitjes do të mundësonin futjen e kapitalit të jashtëm në vënd, të përfundojnë shpejt dhe në mënyrë efikase këtë proces. Përvoja tregon së këto pritje nuk u realizuan as për së afërmi. Blerësit, qoftë vendorë apo investitorë të jashtëm, nuk treguan interesim të posaçëm për blerjen e ndërmarrjeve shtetërore. Përgjithësim nga vendet e tranzicionit mund të konsiderohet ish-Çekosllovakia, e cila që udhëhequr nga Havel dhe Klaus, të cilët implementuan metodën e privatizimit falas . Ky proces kaloi shpejt, me sukses dhe mund të shërbejë si shembull suksesi. Pak a shumë, këtë sistem e përvetësoi edhe Rusia, e më vonë Polonia, Rumania dhe një varg vendesh të dala nga ish-Bashkimi Sovjetik. Modeli i privatizimit pa pagesë, ose i *vauqereve* para vendeve në tranzicion, shtroi një varg dilemash

ndër të cilat dilema e mënyrës së ndarjes së kësaj pasurie; të gjithë qytetarëve, apo vetëm një shtrese të popullësisë, dhe a duhet ndarje e barabartë për të gjithë? Të gjitha vendet kanë ofruar lehëtësira për të punësuarit, të cilët vendosin të blejnë ndërmarrjet e veta. Të disa mbetet një pjesë e madhe për blerësit e jashtëm, kurse te disa vende nuk pati pothuajse kurrfarë beneficionësh për të punësuarit si në: Çeki, Poloni, Hungari dhe në Gjermani. Shpërndarja e *vauqerëve* solli dilema në mënyrën e shpërndarjes. Disa vende këto pasuri i ndanë barabartë për të gjithë shtetasit, disa i favorizuan të punësuarit, kurse disa vende, përmes kësaj metode, dëshiruan të përmirësojnë padrejtësinë e bërë më herët nga shteti me rastin e shpronësimit, ose ajo e kompenzimit për të rënë në luftë (*Kroaci*). Në të gjitha vendet në tranzicion, në procesin e privatizimit janë ndarë ndërmarrjet të vogla dhe të mesme nga ndërmarrjet e mëdha. Grupi i parë kishte të bënte kryesisht me ndërmarrjet zejtare, trgtare dhe hoteliere. Privatizimi i këtyre ndërmarrjeve është bërë me shitje me para në dorë, dhe, normalisht, ka përfunduar shumë shpëjt, me përjashtim të Bullgarisë .

Në vendet e dala nga ish-Jugosllavia ngajshmëritë në metodat e privatizimit janë më të mëdha se sa dallimet. Në këto vende specifike është se fillimi e procesit e kanë përcjellë vendin me ngjarje të cilat procesin e kanë zhvendosur në plan të dytë. Procesi i shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, luftërat, procesi i pavarësimit dhe karakteri specifik i pronës shoqërore, ishin rrethana specifike të këtyre vendeve në krahasim më vendet tjera në tranzicion.

Mënyra e shitjes, si metodë e privatizimit e përcaktuar fillimisht nga shumë vende, ishte shkaku i ngadalësimit të këtij procesi, por në rrjedhën e ngadaltë kanë ndikuar edhe procedurat e komplikuar teknike. Një problem i veçantë, në procesin e privatizimit, ka ndodh edhe për faktin se sistemi ekonomik në këto vende pothuajse ishte rrënuar, kurse lidërshipi i tyre lëkundej rreth fillimit të procesit të privatizimit. Kjo i shkaktoi dëme të mëdha ekonomisë së këtyre vendeve. Këtu, përjashtim bënë vetëm Serbia, së cilës për habi procesin e privatizimit ia ndihmoi shumë shkalla e lartë e inflacionit, mirëpo sistemi i aksioneve të ndërmarrjeve konzervoi mënyrën e vjetër të afarizmit, prandaj edhe rezultatet e këtij procesi ishin të pakëta.

Orientimet politike të qeverive të vendeve në tranzicion ndikuan shumë në dinamikën e këtij procesi. Këtu, shembull pozitiv është Çekia, kurse shembull negativ është Ukraina, elita politike e së cilës bllokonte procesin për shkak të interesave personale dhe beneficioneve të elitës ekonomike. U gjetën dy zgjidhje për këtë çështje tepër delikate: kthimi i pasurisë së njëjtë ish-pronarëve, dhe si variant tjetër-kompenzimi për vlerën e pronës së nacionalizuar. Por, ky nuk ishte problem i vetëm që frenonte procesin e privatizimit. Privatizimi pa kritere dhe pa ligj, në fillim të tranzicionit bëri që shumë nga elita ekonomike dhe politike të përfitojnë pasuri në mënyrë të paligjshme. Për të cilën më pas, shumë vende u detyruan ta rishikojnë procesin. Ky rishikim solli problem dhe vonesa në privatizim. Shembull për këtë është Sllovenia. Për këtë shkak, shumë vende hoqën dorë nga rishikimi procesit.

Dhe së fundmi, duhet shtruar pyetja: sa pati sukses tërheqja e investitoreve të huaj përmes këtij procesi dhe si u realizua kjo?

Fillimisht përkrahja teknike dhe bashkëpunimi në trajnimin e ekspertëve, financimi i projekteve hulumtues edhe mbështetja teknike, ka dinamizuar procesin e privatizimit në vendet në tranzicion. Angazhimi i bankave edhe institucioneve tjera, në baza komerciale, ishte mënyrë e shkëlqyer që kompani të specializuara të ofronin shërbime në përgatitjen e procesit, duke ndihmuar në përcaktimin e vlerës së asetëve, në ristruktuimin e ndërmarrjeve, hulumtimin e tregut dhe shërbimeve tjera të komercializuara. Normalisht, mënyra më e drejtpërdrejtë dhe më e dobishme ishte blerja direkte e ndërmarrjeve nga ana e investitorëve të huaj. Por, pjesëmarrja e kapitalit të huaj në procesin e privatizimit, në vendet në tranzicion, nuk ishte as për afër pritshmërisë.

Në **SHQIPËRI**, për dallim nga vendet e tjera socialiste, nuk u eksperimentua me reforma, përmes të cilave synohej kapërcimi i vështirësive ekonomike e sociale dhe rritja e efikasitetit ekonomik. Mbyllja dhe vetizolimi përforcuan sistemin centralist në ekonomi. Mirëpo, as Shqipëria nuk mundi t'i rezistoi valës së ndryshimeve shoqërore e ekonomike. Tranzicioni në Shqipëri nuk filloi dhe nuk u realizua në bazë të një strategjie organike të përpunuar. Në fillim të këtij procesi, kryesisht dominonin dy koncepte,

krejtësisht të kundërta, mbi ecurinë e tranzicionit. Koncepti i parë favorizonte idenë e shkatërrimit të gjithëçkaje nga sistemi i kaluar, favorizonte reformat e shpejta, dhe dominohej nga qëllime politike e ideologjike. Edhe ve tprocesi i privatizimit ishte i kësaj natyre, dhe nuk realizoi synimin e vet themelor për rristruktuimit dhe rritjen e efikasitetit ekonomik.

Koncepti tjetër preferonte ndryshimet graduale duke respektuar traditën, dhe duke u mbështetur në faktorët objektivë. Por, cili model i ekonomisë së tregut do të ishte më i suksesshëm duke iu përshtatur traditave dhe zhvillimit ekonomik e social në të kaluarën?

Gjendja ekonomike në Shqipëri, në fillim të tranzicionit, ishte identike me vendet e tjera ish-socialiste, por e shprehur më vrazhdë dhe më me shumë pasoja për shkak të nivelit të ulët të trashëguar ekonomik e social. Reforma filloi me masa liberale të përziera me elementë të “**terapisë shok**”. Qëllimi ishte rimëkëmbja dhe stabiliteti financiar. Edhe në Shqipëri reforma fillimisht e solli prodhimtarinë e vendit (*sidomos atë idividuale*) në krizë të thellë: largimet nga puna, zbritjen e pagave, rritjen e shumëfishtë të çmimeve, dhe pashmangshëm rritjen e varfërisë.

Në fazën e parë të privatizimit në Shqipëri, karakteristikë ishte synimi për privatizim të shpejtë dhe total të pasurisë me objektivë që deri në fund të dekadës të privatizohej mbi 90% e produktit vendor. Mendohej që pas privatizimit të bëhej rristruktuimi .Pra, me këtë rast, primare ishte shpejtësia dhe jo efikasiteti ekonomik.

Modeli i privatizimit masiv përmes shpërndarjes së letrave me vlerë ish-të punësuarve, në vend të privatizimit të mirëfilltë, solli deri të përqëndrimi i tyre në duar të disa spekulatorëve duke e humbur kështu qëllimin e shpërndarjes. Kjo përvojë negative ndikoi që faza e dytë të sjellë ndryshime në procesin e privatizimit duke i bërë kriteret ekonomike dominuese. Në Shqipëri , privatizimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme prodhuese dhe shërbyese ndodhi në etapën e parë. Mirëpo, meqë procesi kishte ndodhur shpejt, pa u analizuar dhe pa kriteret ekonomike, ndërmarrjet e privatizuara shumë shpejt ndërruan vëprimtarinë dhe u nxorrën jashtë përdorimit.

Fillimisht procesi i privatizimit është realizuar në formë të centralizuar përmes bordeve të privatizimit dhe AKP-s. Më pas , u formuan bordet e privatizimit nëpër rrethe dhe qarqe të vendit, të cilat në kompetencë kishin ndërmarrjet me vlere 0,5 milion \$ dhe që punësonin deri 300 punonjës. Privatizimi është kryer kryesisht me ankand dhe simbolikisht janë dhënë edhe me qira.

Etapa e dytë përfshiu ndërmarrjet e mëdha prodhuese dhe shërbyese.”Privatizimi në shkallë të gjerë i ndërmarrjeve përfshinte të gjitha ndërmarrjet me mbi 300 punëtorë dhe me vlerë mbi 500 mijë \$. Në Programin e Qeverisë ,privatizimi masiv shihej si forma kryesore për t’u përdorur në atë fazë”¹¹. Fillimisht, është zhvilluar pa kriter edhe pa përvojë të duhur, më pas (1996) themelohet Ministria e Privatizimit, e cila kishte për detyrë të vendosë rregullat dhe procedurat e privatizimit. Po ashtu, është nxjerrur edhe **“Strategjia e privatizimit në Shqipëri 1994-1996”**. Baza e kësaj strategjie është privatizimi i shpejtë, privatizimi total, pastaj rishtruktimi, kurse objektivat e privatizimit ishin: rritja e efikasitetit ekonomik, reduktimi i rolit të shtetit në ekonomi, ndërprerja e ndikimit të shtetit në ekonomi, krijimi i kushteve për reformën ekonomike, si dhe kompenzimi i grupeve shoqërore - kompenzimi i ish-të përndjekurve politikë, përmes bonove të thesarit .

“Privatizimi i tokave Bujqësore kishte filluar qysh në shpërbërjen e kooperativave me 1991 dhe përfundoi mbrenda dy vitesh

Privatizimi i shtëpive dhe banesave i filluar me 1990 përfundoi mbrenda një viti’¹²

Për formën direkte të privatizimit nuk kishte kurrëfarë kufizimesh, përveç detyrimit për mos ndërrim të destinimit për dy vjet. Por, pronarët e rinj shumë shpejt i shitën këto prona me çmime shumëfish më të larta. Duket se privatizimi i apartamenteve të banimit ishte hapi më i qëlluar në të gjithë këtë proces, në të gjitha aspektet, përveç faktit që shitja u realizua me një çmim jashtëzakonisht të ulët.

Procesi i privatizimit masiv nisi në fillim të vitit 1995.Përgjatë këtijë viti u shpërnda vala e parë e kuponëve dhe u prezentua një ligj i ri mbi fondet investive”¹³

¹¹ Minxhozi,Malaj & Xhepa:”Tranzicioni Ekonomik,” UET Press, Tiranë, 2015

¹² Po aty

Përgjithësisht vlerësohet se procesi i privatizimit në Shqipëri ka dhënë efekte të kufizuara, por për më shumë ky proces është përcjell me problemet dhe mangësi të theksuara. Përvoja e Shqipërisë dhe e vendeve tjera, që më herët kishin filluar këtë proces, mund të shfrytëzohen si mësim i mirë për Kosovën, e cila këtë proces realisht e filloi një dekadë më vonë.

2.2.0 Privatizimi dhe përvoja botërore e tij

Pas Luftës së Dytë Botërore fillon epoka e “artë” e shtetëzimeve e cila vazhdoi për afër 30 vite. Në fillim të viteve të shtatëdhjeta fillon debati mbi privatizimet, kurse në vitet e tetëdhjeta e nëntëdhjeta u realizuan privatizimet masive në vendet më të zhvilluara kapitaliste në tërë botën.

Në vitet e nëntëdhjeta filloi tranzicioni dhe privatizimi në vendet e Bllokut lindor. “Diferenca ndërmjet tyre qendron në faktin se ndërsa në vendet e zhvilluara kapitaliste bëhej fjalë për “reduktim të shtetit dhe pronës shtetërore nëpërmjet të privatizimeve”, kryesisht si pasojë e inefficiencës së sektorit publik, në rastin e dytë, për vendet në tranzicion kishim të bënim “me një ndryshim strukturor të kalimit nga sistemi i planifikimit të centralizuar drejt tregut të lirë” dhe liberalizim të ekonomisë me qëllim që të ndërtohej sistemi kapitalist”¹⁴

Paralelisht privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore ka ndodhë kudo në botë, por kryesisht në vendet në zhvillim. Metodatat e privatizimit në vendet kapitaliste janë të ndryshme, por ato kryesisht mund të përmbledhen në tri kryesore: 1) *metoda e shitjes publike të aksioneve*; 2) *shitja private e aksioneve dhe* 3) *marrja me qira e ndërmarrjes nga të punësuarit e saj*. Secila nga këto metoda i ka anët e veta pozitive, por edhe të dobësive.

¹³ Më gjërësisht në: Minxhozi, Malaj & Xhepa “Tranzicioni Ekonomik”, UET Press, Tiranë, 2015

¹⁴ Adrian Civici: “Transformimi i madh”, UET Press, Tiranë, 2014, fq.119.

Sipas të dhënave të Bankës Botërore, në vitet e tetëdhjeta në vendet e Europës Perendimore janë privatizuar 145 ndërmarrje shtetërore. Nga këto në Britaninë e Madhe 1/3, pastaj për nga numri vjen Italia, Spanja, Franca, etj.

Por, cili ishte qëllimi i privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore? Mëqenëse numri i vendeve që kanë realizuar procesin e privatizimit është i madh, niveli i zhvillimit i ndryshëm dhe poashtu rrethanat e ndryshme ndryshojnë edhe qëllimet e privatizimit, por kryesisht mund të përmbliidhen në këto: heqja e subvencionimit të tyre nga buxheti, shkarkimi i shtetit nga barra e qeverisjes së këtyre ndërmarrjeve, efikasiteti, shtimi i të hyrave nga kapitali shtetëror, konkurentshmëria e tregut, zhvillimi i sektorit privat. Vlen të theksohet se qëllimet e privatizimit në vendet e zhvilluara dhe qëllimet e privatizimit në vendet në zhvillim ndryshojnë, por dy qëllimet themelore janë të perbashketa: rritja e efikasitetit dhe shkarkimi i buxhetit nga subvencionimi i këtyre ndërmarrjeve. Poashtu, problemet sociale në të gjitha vendet kapitaliste që realizuan privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore zënë vend të rëndësishëm në qëllime të privatizimit.

Për qëllim të analizës sonë është interesante të veçohet procesi i privatizimit në Britaninë e Madhe. Veçanërisht privatizimi i banesave në pronesi shtetërore i cili u realizua brenda katër viteve dhe i cili solli të hyra të mëdha arkës së shtetit. Dhënia në koncesion e ndërmarrjeve publike dhe me nëfund privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore. Veçanti e këtij vendi është çasja shumë serioze dhe përgatitja për privatizimin për secilen ndërmarrje veç e veç. Procedura dhe përgatitje të posaçme janë bërë në veçanti për privatizimin e ndërmarrjeve publike më të rëndësishme si e postës dhe hekurudhave.

Privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore në vendet kapitaliste karakterizohet me blerës që kanë veprimtari ekonomike të ngjajshme apo nga ndërmjetësit financiar të fuqishëm. Përgjithësisht, të gjitha vendet kanë qenë të interesuara që kompanitë e tyre t'uua shesin pronarëve privatë të fuqishëm financiarisht pasi që ata ofronin çmime më të larta, kishin përvojën e duhur dhe garantonin realizimin e qëllimit themelor – rritjen e efikasitetit. Me përjashtim të Britanisë, e cila me qëllim të shpërndarjes harmonike të pasurisë kombëtare

ua mundësoi të punësuarve dhe menaxherëve blerjen e një kuote aksionesh më çmime të zbritshme. Vlen të theksohet që numri i aksionerëve në këto raste menjëherë posa ka filluar shitja e aksioneve është zvogëluar, meqënëse punëtorët i shiten aksionet e tyre. Një rezultat më të mirë në shitjen masive të aksioneve e gjejmë në SHBA, kurse Franca nga droja e mossuksesit aplikoi një metodë origjinale duke gjetur një të ashtuquajtur bërthamë aksionerësh që do të blinin të pakten 20% të aksioneve dhe që premtonin që nuk do t'i shesin të pakten për 5 vite. Kushti themelor nuk ishte çmimi i lartë, por përvoja, kapaciteti dhe reputacioni i aksionerëve.¹⁵

Një përvojë të veçantë, shumë dimensionale, dhe të dobishme për të shfrytëzuar në kushte të ekonomisë së Kosovës për shkak të ngjajshmërive të sistemeve politike dhe ekonomike në të kaluarën paraqet privatizimi në vendet e Ish bllokut socialist, Shqipëri dhe në vendet e dala nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë.

¹⁵ Më gjerësisht në librin: *“Privatizacia, nuzhnost ili sloboda izbora”*.

KAPITULLI III: PRIVATIZIMI NË KOSOVË , SPECIFIKAT , METODAT , EFEKTET

Me qëllim të realizimit me sukses të tranzicionit në Kosovë, si dhe ndëritmit të sistemit të ri ekonomik është i domosdoshëm transformimi i shpejtë i pronës, zhvillimi i konkurrencës së lirë, ekonomia e hapur ndaj tregut të jashtëm, funksionim i tregut të fuqisë punëtore, stabilizim i valutës, kursit devizor dhe sistemit financiar, si dhe kujdesi i shtetit për politikat sociale dhe ndërtimit të shoqërisë së hapur-zhvillimin e demokracisë liberale¹⁶.

Ky mendim akademik, pasqyron qëndrime dhe konstatime, që janë diskutuar në kohën kur Kosova ishte nën okupimin klasik .

Tranzicioni si proces i ndërlikuar nuk mund të realizohet pa përgatitje të mirëfilltë, veçanërisht pa strategji, e cila përcakton qartë qëllimet dhe mekanizmat për realizim të tranzicionit, e që,po ashtu, parashikon edhe pengesat eventuale, vështirësitë dhe mënyrën e tejkalimit të tyre.

Nga pervoja e vendeve tjera që kanë kaluar këtë fazë të zhvillimit, hyrja në tranzicion pa përgatitje paraprake dhe veçanërisht pa strategji, ka zbehur rezultatet e pritura dhe ka formësuar rezistencë ndaj proceseve .

Specifikat e tranzicionit në Kosovë mund të përmbledhen në:

- *Administrimi i Përkohshëm i Kosovës nga Misioni i OKB-së (UNMIK-u);*
- *Gjendja e rëndë ekonomike në Kosovën e pas luftës, shkatërrimet dhe dëmet e luftës, niveli i ulët i aktivitetit ekonomik në ndërmarrjet shoqërore, si dhe infrastruktura ekonomike e dëmtuar;*
- *Niveli i ulët i zhvillimit, i trashëguar prej kohësh, si dhe problemet sociale;*
- *Spektori privat me një traditë të konsiderueshme, por i shkatërruar nga lufta.*

¹⁶Sipas prof. **Iraj Hashi**, i cili ishte i involvuar në çështjet e tranzicionit në Kosovë (që nga viti 1998), si dhe në vendet e tjera në tranzicion për më shumë se një dekadë.

Pas intervenimit të bashkësisë ndërkombëtare, tërheqjes së ushtrisë dhe policisë serbe nga Kosova, me Rezoluten 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, në Kosovë vendoset Administrata e Përkoshme Ndërkombëtare (UNMIK) e cila kishte për detyrë administrimin e përkohshëm të vendit dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të institucioneve vetëqeverisëse. Edhe përkundër mangësive, problemeve dhe dilemave, vendosja e administratës së OKB-së në Kosovë mundësoi ndërtimin e institucioneve vendore, institucioneve të ekonomisë së tregut dhe të infrastrukturës ligjore, në bazë të të cilave do të realizohej tranzicioni në Kosovë.

Kushtet specifike të privatizimit në Kosovë ishin:

- *Në Kosovën e shkatërruar nga lufta, privatizimi ishte njëra nga nevojat fundamentale për zhvillimin e ekonomisë së tregut;*
- *Ndërmarrjet Shoqërore në Kosovë ishin në gjendje të mjerë financiare dhe gjendja e tyre përkeqësohej dita-ditës. Për këtë arsye privatizimi duhej të shpejtohej, në mënyrë që të ndërpritet kjo situatë;*
- *Përmirësimi i kushteve të NSH-ve ishte i pamundur me resurset e tyre të brendshme dhe investimet e jashtme ishin mëse të nevojshme për transformimin dhe ristrukturimin e tyre. Si rezultat cilado shumë e privatizimit duhej të ishte atraktive për investimet e huaja;*
- *Rregullat e AKM-së ishin miratuar nga UMNNIK-u, PSSP-ja dhe Zyra Ligjore e OKB-se. Pas shumë debateve, të gjitha këto rregulla ishin hartuar në atë mënyrë që të reflektojnë kushtet specifike të NSH-ve në Kosovë¹⁷.*

3.1.0 Roli i UNMIK-ut në ndërtimin e institucioneve dhe në privatizimin e prones shoqërore në Kosovë

Por cilat janë specifikimet që përcollën fillimin e privatizimit në Kosovë ? Në dy vitet e para të ardhjes së UNMIK-ut në Kosovë, si administratë e tranzicionit, sfida më e madhe

¹⁷ Iraj Hashi; Staffordshire University; Stoke on Trent, U.K; “Privatizimi në Kosovë, ngritjet dhe rëniet”; tryezë diskutimi organizuar nga “Forumi 2015”, Prishtinë, 2004.

ishte ndërtimi i institucioneve bazë veteqeverisëse vendore si dhe rimëkëmbja dhe aktivizimi ekonomik i vendit.

Fillimisht përpjekjet u orientuan në realizimin e programit të asistencës së donatorëve me qëllim të rimëkëmbjes dhe rindërtimit ekonomik. Sipas një dokumenti të Bankës Botërore (BB)¹⁸: *“pas nxjerrjes së Kornizës Kushtetuese dhe organizimit të zgjedhjeve të përgjithshme në nëntor 2001, përgjegjësia për administrimin e vendit ndahet midis UNMIK-ut dhe Institucioneve Vetëqeverisëse (kosovare)”*.

Përpjekjet për tejkalimin e situatës së rënduar ekonomike dhe realizimin e tranzicionit në Kosovë shkurtimisht mund të përmbledhen në këto rezultate:

- *Vendosja e stabilitetit makroekonomik, ekuilibrit ekonomik;*
- *Krijimi i bazës ligjore për ndërtimin e institucioneve dhe kuadrit për konsolidimin e sistemit fiskal dhe stabilitetit buxhetor;*
- *Krijimin e kushteve për tregtinë e lirë (konkurrencën e lirë), përfshirë këtu edhe tregtinë e jashtme;*
- *Baraspesha ekonomike në mes efikasitetit ekonomik dhe zhvillimit social;*
- *Krijimi i infrastrukturës ligjore dhe institucionale për nxitjen e iniciativës private, veçanërisht të ndërmarrjet e vogla dhe ato të mesme;*
- *Kufizimin e infrastrukturës ligjore për ndërtimin e institucioneve të sistemit monetar financiar në përputhje me standardet ndërkombëtare (stabiliteti monetar, marka , euro);*
- *Krijimi i bazës ligjore dhe institucionale për privatizimin e pronës shoqërore, konsolidimin e ndërmarrjeve publike dhe krijimin e kushteve për transformimin e tyre.*

Në fillim administrata e Kombeve të Bashkuara në Kosovë u ballafaqua me dilemën se cili është ligji i zbatueshëm në Kosovë. Në mungesë të kësaj, si zhgjidhje e përkohshme, për ta

¹⁸Raporti me numër 28880, tetor 2002, *Njësia e Menaxhimit ekonomik dhe e uljes së varfërisë*; Banka Botërore.

plotësuar vakumin ligjor, u nxorr *Rregullorja 1/99* e dt. 24/99, me të cilën rregullore u konfirmua se ligj i zbatueshëm në Kosovë konsiderohen ligjet në fuqi para datës 22 mars 1989, pra ligjet që kanë qenë në fuqi para suspendimit të autonomisë së Kosovës nga ana e Serbisë. Pra ligj në fuqi konsiderohej çdo rregollore e UNMIK-ut, ligjet që nxirreshin nga Kuvendi i Kosovës dhe ligjet që kanë qenë në fuqi deri më 22 mars 1989.

Me *Rregulloren e UNMIK-ut 1999/1*, në Nënin 6 përcaktohet si vijon: *“UNMIK-u administron pasurinë e tundshme ose të patundshme duke përfshirë financat, llogaritë bakare dhe format tjera të pronës të regjistruara në emër të Republikës Federative të Jugosllavise, të Republikës së Serbisë apo të cilitdo organ të saj, të cilat gjenden në territorin e Kosovës”*.

Pra, kompetent për të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me tranzicionin dhe privatizimin, si fazë e tij është UNMIK-u, më konkretisht *Shtylla IV* brenda tij. Këto organe administrative qysh në fillim hasën në vështirësi në realizimin e funksionit të tyre, meqenëse të gjitha ligjet e aplikushme, për sa i përket lëmise së ekonomisë nuk mund të shfrytëzoheshin për shkak se ishin ligje të nxjerra në një sistem tjetër politik, shoqëror-ekonomik dhe nuk ishin të përshtatshme për ekonominë e tregut. Së këndejmi duhet thënë se ndërtimit të kornizes ligjore nga lëmia e ekonomisë i takon krijimi i kushteve për funksionimin e mirëfilltë të ekonomisë së tregut, ndërtimin e strukturave ekonomike dhe institucioneve përkatëse.

Specifikë tjetër e tranzicionit në Kosovë ishte niveli tejet i ulët i zhvillimit ekonomik, struktura e ekonomike e pavolitshme e trashëguar, sistemi ekonomik i rrënuar dhe joefikas. Deri në përfundim të luftës ekonomia e Kosovës karakterizohej me dominim të industrisë bazike, energjetikës, ekonomisë së ujrave etj. Në ekonominë shoqërore dominonin ndërmarrjet e mëdha dhe të mesme, kurse ndërmarrjet e vogla kishin pjesëmarrje shumë të ulët (4.2%). Këto ndërmarrje në dhjetë vjet i ishin ekspozuar plaçkitjes së pasurisë së tyre. Përmes të ashtuquajturit integrim të ndërmarrjeve, pushteti okupues serb bëri bartjen fizike të pajisjeve, makinerive, pasurive natyrore dhe resurseve financiare nga ndërmarrjet e Kosovës në ndërmarrjet në Serbi.

Ne këtë periudhë ekonomia e Kosovës është dëmtuar edhe përmes ndërprerjes së investimeve në ndërmarrjet shoqërore të Kosovës .Në fakt, në këtë periudhë ka ndodhë dezinvestimi. Pra, përveç ndërprerjes së investimeve, në këto ndërmarrje amortizimi i mjeteve themelore ishte më i madh se sa investimi. Nuk kishte aktivitete të ristruktuimit dhe aplikimit të teknologjise se re. Shkalla e amortizimit ishte mbi 60% .

Sipas nje ankete të realizuar në vitin 2000¹⁹, niveli i shfrytëzimit të kapaciteteve ishte vetëm 30% .Aktive ishin vetëm 86% e ndërmarrjeve shoqërore. Aktiviteti i këtyre ndërmarrjeve 99% i dedikohet tregut të brendshem .Në këto ndërmarrje vetëm 58% e të punësuarve ishin aktivë. Mosha, përgatitja profesionale dhe arsimore e të punësuarve ishte e atij niveli që nuk mundësonte përveteësimin e teknologjise së re dhe shkathtësive për biznes bashkëkohor. Këto ndërmarrje kishin obligime të shumta (borgje të trashëguara).

Sipas të njëjtit burim, mbi 21% e kapitalit fiks të ndërmarrjeve shoqërore ishte e dëmtuar nga lufta .Dëmet më të mëdha i ka pësuar agro-industria, industria metalo-përpunuese, ajo e tekstilit, pastaj bujqësia, transporti, tregtia, etj.

Edhe sektori privat kishte pësuar dëme të luftës. Sipas një publikimi²⁰pa strehim kishin mbetur rreth 600.000 banorë. Të dhënat flasin për rreth 100.000 shtëpi të dëmtuara apo të shkatërruara. Grupi ndërkombëtar i administrimit, dëmet e kësaj kategorie i ka vlerësuar në 1.100.000.000 \$. Nga gjithsej 120.000 shtëpi të dëmtuara, të pa banueshme ishin 32.000 shtëpi, kurse të pa riparueshme ishin 47.000 shtëpi. Dëme u janë shkaktuar 750 shkollave , 135 objekteve të shëndetësisë, 609 trafave dhe 440 ujësjellësve . Sipas po të njëjtit burim me porosit e FAO-se dhe BB, është bërë një vlerësim i dëmeve të luftës në fshatra. Sipas këtij studimi: “gjatë luftës, pasuritë e fermerëve janë dëmtuar në masë. Kostoja e zëvendësimit të kafshëve të humbura, ndërtesave të dëmtuara të fermave dhe makinave bujqësore, ndonëse në mënyrë konservative, vlerësohet se kapë shumën prej 700 deri 800

¹⁹Instituti për Kërkime Zhvillimore Ekonomike “RIINVEST”; “Ndërmarrjet Shoqërore dhe transformimi i tyre”, Raport hulumtues i përgatitur në bashkëpunim me Qendrën Ndërkombëtare për Ndërmarrjet Private (CIPE), dhe i mbështetur nga USAID, Prishtinë, 8 mars 2001 .

²⁰Ismail Kastrati; “Rrënimet dhe Rimëkëmbja e Kosovës” (1998-2005), Prishtinë, 2012.

milionë dollarë amerikanë. Pjesa më e madhe e gjësë së gjallë(*lopët: 50 përqind; ripërthypës të vegjël: 65 përqind; pula: 85 përqind*), e cila e jepte rreth gjysmën e prodhimeve bujqësore, ka humbur ose është vrarë. Mbi 50 përqind e makinave bujqësore (*50 përqind e traktoreve; 75% e autokombajnave*) janë shkatërruar ose kanë nevojë për riparime. Shumë ndërtesa fermash (*stalla, hangare, e magazine*) janë shkatërruar po ashtu. Ndërsa toka djerrë dhe humbja e bagëtive është një dukuri e përgjithshme, humbja e makinave bujqësore dhe shkatërrimi i ndërtesave janë përqendruar në bashkësitë perëndimore. ‘‘Burime te tjera vleresojne demin ne sektorin e bujqesise ne vlere prej 1.5 miliarde \$ amerikane.’’²¹

Vlerësimi i dëmeve të luftës është bërë edhe nga drejtoritë për rindërtim dhe urbanizëm të komunave të Kosovës. Sipas këtyre institucioneve gjatë luftës në Kosovë janë shkatërruar 59% e numrit të përgjithshëm të shtëpive të banimit dhe të objekteve ndihmëse. Vlera e gjithëmbarshme e dëmeve kapë shumën prej 3.039.372.400 euro, nga të cilat rreth 1.8 miliardëEU të shtëpive të banimit, rreth 800 milionë euro objekte ndihmëse, ndërsa 367 milionë orendi shtëpiake.

Dëme kanë pësuar edhe objektet me vlera të larta të arkitekturës dhe kulturës si: muzetë, xhamitë, kishat dhe obekte e tjera të cilat ishin nën mbrojtjen e Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve Historike.

Gjatë ekspeditave luftarake serbe janë plaçkitur mjete monetare dhe stoli ari që kapin shumën mbi 102 milionë euro .Dëmet në objektet me rendesi publike dhe shoqërore vlerësohen në mbi 110 milionë euro, dëme në sektorin privat të ekonomisë në mbi 344 milionë euro dhe demet ne sektorin shoqëror të ekonomisë në mbi 706 milionë euro.Sipas dokumenteve dhe evidencave të bëra nga të gjitha strukturat e angahzuara për evidentimin e dëmeve të luftes, të cekura më lart, rezulton se vlera e gjithëmbarshme e dëmeve të luftës dhe e plaçkitjeve kapë shumen prej 5 miliardë e 86 milionë e 970 mijë euro.Sipas Bankës

²¹Po aty.

Botërore (BB)²² ne viti 2000 GDP kapte shumën prej rreth 1.700 milionë dollarëve, ose 900 dollarë GDP për kokë banori. Me këtë Kosova renditet në vendin e fundit në Evropë. Shkalla e punësimit apo e vetëpunësimit ishte poashtu tepër e ulët (45%), ndërsa shkalla e varfërisë tepër e lartë; varfëria e përgjithshme 50%, ndërsa varfëria e skajshme 12%. Pra, vendosja e stabilitetit makroekonomik në Kosovë nuk kishte të bënte thjesht vetëm me eliminimin e shkaqeve të krizës apo ç'ekuilibrimin ekonomik, siç ishte në vendet tjera ish-socialiste por, ishte e ngarkuar edhe me pasoja të rënda të shkaktuara nga okupimi dhe shkatërrimet e luftës. Në këtë aspekt edhe strukturat ndërkombëtare, por edhe institucionet vetëqeverisëse prioritet kishin rindertimin e vendit, rimëkëmbjen ekonomike dhe kujdesin social.

Me qëllim të vendosjes së stabilitetit ekonomik e social, që në vitin e parë të pasluftes u mobilizua një asistencë në shkallë të gjërë e donatoreve, remitancat nga diaspora dhe prania e faktorit ndërkombëtar u fuqizua. Kjo solli si rezultat rritjen e GDP për 14% në vitin 2001.²³ Investimet dhe konsumi në këtë vit ishin dy herë më të larta se sa GDP, kurse importi kishte arritur në 163% të GDP. Transferrat zyrtare dhe private kishin mundësuar mbulimin e deficitit tregtar dhe një llogarie të balancuar. Në anën tjetër, çmimet kanë shënuar një stabilitet të lakmueshëm me rritjen vetëm 2-3% në dy vitet e para të pasluftës.

Krijimi i institucioneve dhe kuadrit për stabilitet fiskal dhe buxhetor, lidhet me konstituimin e Kuvendit të Kosovës dhe formimin e Qeverisë së Kosovës më 4 mars 2002. Edhe pse Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) kishte përgjegjësi të rezervuara në fusha të rëndësishme të jetës shoqërore dhe ekonomike, ku hyjnë edhe përgjegjësitë për politikën fiskale dhe buxhetin. Në këtë mënyrë, me konstituimin e institucioneve vendore fillon kalimi gradual i kompetencave mbi burimet e sektorit publik.

Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) është themeluar më 17 janar 2000. Themelimin e ATK-së e ka mbështetur USAID i cili kontraktonte një ekspert për kryesimin e saj. Deri në vitin 2003 ky institucion kishte bashkëkryesim nga një vendor dhe një ndërkombëtar. Nga

²² **Raporti nr.24880**, tetor 2002; *Njësia e menaxhimit ekonomik dhe uljes së varfërisë*.

²³ Po aty.

viti 2003 Administrata Tatimore kalon nga UNMIK-u te Ministria për Ekonomi e Financa dhe funksionon si organizatë unike, autonome duke u mbështetur edhe më tej nga donatorë të fuqishëm si USAID, BE dhe FMN²⁴.

Shërbimi Doganor i Kosovës (SHDK) si institucion është formuar në kuadër të institucioneve të UNMIK-ut dhe ka filluar të funksionojë menjëherë pas përfundimit të luftës, pra në vitin 1999. Burimi kryesor i të hyrave buxhetore sipas *Rregullores 1999/3* ishin taksat doganore 10%, tatimi në qarkullim 15%, si dhe akciza për një numër mallrash, të cilat paguheshin në kufi. Më vonë, në vend të tatimit në qarkullim u fut TVSH me të njëjtën normë, kurse për imputet nga vendet e ish-Jugosllavise paguhej dogana vetëm 1%. Fillimisht TVSH paguanin vetëm kompanitë me mbi 50.000 euro qarkullim vjetor. Janë përcaktuar lehtësira për importuesit e kapitalit për investime, qoftë në TVSH qoftë në akciza. Në vitin 2002 aplikohet taksa e paragjykuar prej 3 %, tatimi në fitim 20% për ndërmarrjet me qarkullim vjetor mbi 100 mijë euro, si dhe tatimi në te ardhura personale. Në përgjithësi në 3 vitet e para shkalla e ngarkesës fiskale është më e ulët se në vendet tjera në tranzicion .Edhe më pas, deri në vitin 2008 niveli i ngarkesave fiskale me pak ndryshime mbetet pothuajse i njëjtë.²⁵. Të hyrat buxhetore në vendin tonë, në vitin 1999 përbënin 1/3 e shpenzimeve buxhetore, kurse 2/3 mbuloheshin nga donacionet. Në vitin 2000 të hyrat buxhetore mbulonin 52% të shpenzimeve, kurse një vit më vonë 83% të shpenzimeve. Nga viti 2005 tëhyrat buxhetore vendore mbulojnë 100% të shpenzimeve buxhetore të vendit.

Sipas të dhënave të Bankës Botërore të hyrat buxhetore në Kosovë si përqindje e GDP janë shumë më të ulta në krahasim me vendet në trazicion dhe të OECD .Në periudhën 2003-2005, dhe me pas deri në vitin 2008 kanë vazhduar përpjekjet e institucioneve për stabilizim dhe reforma strukturore. Sipas një skenari makroekonomik (*Korniza Afatmesme e Shpenzimeve-KASH*) është parashikuar një rritje mesatare vjetore e GDP prej 5% në vit,

²⁴*Burimi: Administrata Tatimore e Kosoves (ATK); Plani Strategjik 2010-2013, Prishtinë, 2010.*

²⁵*Ligji mbi Administraten Tatimore; Ligji mbi Tatimin në të Ardhura Personale, dhe Lligji mbi të Ardhurat e Korporatave.*

niveli i investimeve të stabilizohet në 30% të GDP, rënie e inflacionit nga 10% në 3%, importet të ulen në 50% të GDP. Përkundër kësaj, hendeku financiar, edhe pse ka vazhduar të bjerë, në 3 vitet e para ka qenë tepër i madh. Në pamundësi për huamarrje, për shkak të pengesave ligjore, ky hendek financiar është mbuluar nga donatorët. Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare (*buxhetore*) është mbështetur nga donatorët, të cilët në periudhën 2003-2005 Kosovën e ndihmuan me rreth 500 milionë euro. Këto donacione ishin destinuar ekskluzivisht për mbulimin e shpenzimeve të përgjithshme publike. Në këtë periudhë është konstituuar Këshilli Ekonomik Fiskal pranë *Shtyllës së IV-të* të UNMIK-ut si Institucion Këshilldhënës për Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm . *Shtylla e IV-te ë UNMIK-ut dhe Ministria e Ekonomise dhe Financave intensivisht bashkëpunonin në përgatitjen dhe procedimin në Kuvend të të gjitha ligjeve që kishin të bënin me të hyrat publike, ligjet mbi institucionet që merren me të hyrat publike dhe ligjet mbi buxhetet vjetore si dhe Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë*²⁶. Ky ligj është ndryshuar dhe plotësuar disa herë deri në vitin 2008. Me këtë akt, praktikisht edhe është rumbullakësuar infrastruktura ligjore dhe institucionale e sektorit të financave publike në Kosovë.

Në këtë fazë të tranzicionit në Kosovë kujdes i veçantë i është kushtuar krijimit të kushteve për tregtinë e lirë, konkurrencës së lirë dhe tregtisë së jashtme. Në të gjitha dokumentet shtetërore, Rregulloret e UNMIK-ut që kishin fuqinë e ligjit të aprovuar, promovohet, mbrohet dhe sanksionohet konkurrenca e lirë, gjëgjësisht cënimi i konkurrencës së lirë. Poashtu, gjatë kësaj kohe janë themeluar institucionet që promovojnë dhe garantojnë konkurrencën e lirë dhe ekonominë e tregut të lirë. Ne veçanti është rregulluar hyrja dhe dalja e subjekteve në veprimtari, qarkullimi i mallrave dhe marrëdhënieve ekonomike me jashtë. Pra, me një fjalë konkurrenca e jashtme dhe ajo e brendshme.

Një çështje tjetër, tejet delikate dhe e vështirë për t'u realizuar në këtë periudhë ishte vendosja e barazpeshës ekonomike në mes efikasitetit ekonomik dhe zhvillimit social. Për

²⁶ Aprovuar në Kuvendin e Kosovës më 12 maj 2003 dhe shpallur me rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/17

këtë arsyeje shpenzimet buxhetore dominohen nga shpenzimet për shëndetësi, arsim dhe mirëqenie shoqërore.

Pasojat e dominimit serb në vitet e 90-ta, e sidomos pasojat e luftës së viteve 1998-99 goditën rëndë standardin jetësor të popullatës së Kosovës, e cila edhe me parë ishte njësia federale më e pa zhvilluar, me shkallën më të lartë të papunësisë dhe varfërisë në ish-Jugosllavi. *Në fund të vitit 2000 në Kosovë 50% e popullsisë jetonin në varfëri, nga të cilët 12% jetonin në varfëri të skajshme.*²⁷ Pjesa tjetër e popullatës ishte shumë afër kufirit të varfërisë .Prandaj, rruga për të dalë nga kjo situatë kërkohet përmes një strategjie për zhvillimin e sektorit privat .Në zhvillimin ekonomik pritjet rritja e mundësive më të mëdha për punë. Për këtë qëllim objektivi i qeverisë për dinamizim të zhvillimit ekonomik, punësimit masiv në sektorin privat dhe përmirësim të standartit të jetës ishte i kushtëzuar me implimentimin e reformave strukturore. Me qëllim të arritjes së barazpeshes midis efikasitetit ekonomik dhe zhvillimit social, në kuader të planifikimit të politikave afatmesme, strategjia afatmesme e zbutjes së varfërisë do të konsiderohej me kujdesin e duhur. Në kuader të këtyre politikave, politikat fiskale dhe politikat e shpenzimeve të përgjithshme publike janë esenciale në këtë fazë të tranzicionit në Kosovë. Në vitet e para të pasluftes deri në vitin 2005 të hyrat buxhetore ishin të limituara dhe të pamjaftueshme për realizimin e objektivave të zhvillimit dhe mirëqenies sociale .Prandaj, një pjesë e madhe e shpenzimeve të përgjithshme publike mbulohej nga donacionet. Në periudhën deri në vitin 2005 nga gjithsej 810 milionë euro të nevojshme për mbulimin e nevojave të përgjithshme rreth 440 milionë euro janë mbuluar nga donacionet. Kjo strukturë e të hyrave është imponuar nga pa aftësia e ekonomisë për të siguruar fondet e nevojshme dhe nga mungesa e aksesit të institucioneve vendore për hua të jashtme.

Dhe së fundmi, realizimi i barazpeshes në këtë fazë të zhvillimit u kushtëzua nga forcimi i institucioneve dhe realizimi i reformave, vazhdimi i mbështetjes nga donatorët dhe ambienti i jashtëm. Paralelisht me këtë ,është paraqitë e domosdoshme rishpërndarja e

²⁷ BB-:Raporti nr. 24880, tetor 2002, Prishtinë.

shpenzimeve brenda sektorëve, përmirësimi i efikasitetit të shpenzimeve në sferën e shërbimeve sociale dhe të arsimit, si dhe përforsimi i transparencës dhe llogaridhënies. Në këtë periudhë ishte në proces formimi i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Sistemi bankar dhe financiar i Kosovës ishte shkatërruar tërësisht që në fillim të viteve të 90-ta. Banka Popullore e Kosovës si njëra ndër Bankat Qendrore në Ish-Jugosllavi ishte shuar. Bankat e Kosovës, poashtu u shuan dhe mjetet e ekonomisë edhe të qytetarëve u bartën në bankat e Serbisë. Pjesa më e madhe e këtyre mjeteve u grabitën dhe nuk iu kthyen asnjëherë pronarëve të vet. Vetëm një bankë afariste funksiononte në Kosovë 70% e kapitalit të së cilës ishin mjetet e ndërmarrjeve shoqërore. Kjo bankë kishte autorizime të kufizuara – kryente vetëm punët e këmbimit valutor, por jo edhe të qarkullimit të pagesave. Për qëllime të përmbushjes së nevojave për transferin e parave nga diaspora në atdhe, Qeveria e Kosovës në ekzil në vitin 1992 themelo iBankën “Dardania” me seli në Tiranë. Kapitali themeltar i kësaj banke ishin mjetet e grumbulluara nga fondet e 3%-shit në diasporë (*të hyra buxhetore të Qeverisë së Kosovës në ekzil*). Kjo bankë shërbeu me tepër për transferin e mjeteve buxhetore në Kosovë, por brenda rrethanave shërbeu si institucion financiar nga i cili u kredituan ndërmarrjet private kosovare. Kuptohet, veprimtaria ishte tepër e kufizuar dhe gjithmonë e rrezikuar. Pas çlirimit, kjo bankë e hapi degën e vet në Prishtinë, por për shkak të pasigurisë dhe të rrethanave të komplikuar që mbizotëronin, u detyrua të mbyllet. Në këto kushte, praktikisht t nga zero filloi ndërtimi i sistemit bankar dhe financiar në Kosovë. Me *Rregulloren nr.20/99* themelohet Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës-një formë e Bankës Qendrore. Funksionet kryesore të kësaj banke ishin: Licencimi, kontrolli dhe mbikëqyrja e bankave të rendit të dytë, licencimi, kontrolli dhe mbikëqyrja e institucioneve financiare, mbikëqyrja, kontrolli dhe licencimi i kompanimeve të Sigurimit, fondeve të pensionit, qarkullimit të pagesave dhe kujdesi për likuiditetin e sistemit bankar të Kosovës. Ky institucion kishte të gjitha funksionet e Bankës Qendrore, përveç emisionit të parave dhe udhëheqjes së politikave monetare-kreditore. Me *Rregulloren 21/1999 mbi Licencimin, kontrollin dhe rregullimin e bankave dhe institucioneve tjera financiare* krijohet mundësia e themelimit të bankave të rendit të dytë. Më pas, Autoriteti Qëndror Bankar (AQB) licenoi 7 banka komerciale me 65 degë, 5

byro të këmbimit, 12 institucione mikrofinanciare, 9 shoqata kreditore dhe kursimore dhe 3 institucione kreditore jo bankare, si dhe 8 kompani te sigurimeve.²⁸

Dy segmentet kyçe të tranzicionit në Kosovë në periudhën e administrimit ndërkombëtar të Kosovës, privatizimi dhe ndërtimi i politikave sociale do të përpunohen në kapituj të veçantë të këtij punimi. Fillimi i mileniumit të ri i gjeti shoqëritë e organizuara para sfidave që shtrohen para së ardhmes për kycjen me sukses në ndryshime dinamike që e presin shoqërinë njerëzore. Kosova si shtet i ri i dalë nga lufta dhe i shkëputur nga një robëri skllavëruese shekullore, përveç lirisë së shumë pritur trashëgoi probleme nga më të ndryshmet, ndër të cilat: shkatërrimet e luftës, niveli i ulët i zhvillimit ekonomik, probleme të shumta sociale, varferi e skajshme dhe absolute, aktivitete në rënie ekonomike dhe shkallë të lartë të papunësisë, mbyllje apo humbje të tregjeve, infrastrukturë ekonomike të dobët dhe të shkatërruar nga lufta dhe pa institucione të konsoliduara të shtetit. Me fjalë tjera, përfundimi i luftës Kosovën e gjeti pa asgjë materiale e ekonomike, përveç faktorit njeri, territorit dhe pasurive natyrore të saj si dhe përkrahjes së vazhdueshme të faktorit ndërkombëtar(*ushtarake dhe për mbijetese*). Në keto kushte filloi rindërtimi i vendit, ndërtimi i institucioneve shtetërore dhe infrastrukturës ekonomike. Por, si do të ballafaqoheshin këto institucione, të cilat morën për obligim udhëheqjen e vendit, e të cilat nuk kishin përvojë paraprake, me sfida shumë delikate të zhvillimit të ardhshëm dhe si do të mund të inkuadrohej ky vend i sapo çliruar në rrjedhat e zhvillimit epokal, në epokën e informatikës? Identifikimi i sfidave, nevojave dhe aspiratave në rrethana të veçanta, në të cilat u gjend Kosova kërkonte reagim refleksiv, kritik, gjithëpërfshirës dhe para se gjithash profesional. Institucionet qeveritare të papërvoja, në mungesë të nje programi strategjik zhvillimor, menaxhimin e situates së krijuar nga nevojat dhe kërkesat e shumta dhe mundësitë tejet të kufizuara, u realizuan përmes vendimeve *ad hoc*, shumë herë të pa harmonizuara dhe të pa konsoliduara, por gjithsesi të vështira. Gjatë kësaj periudhe, është tentuar disa herë që të përgatitet një dokument i cili do të përmbajë prioritetet zhvillimore afatgjate të Kosovës. Një kesi lloj tentimi kanë bërë së bashku Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës (ASHAK) dhe Oda Ekonomike e Kosoves (OEK). Si rezultat i tërë këtij

²⁸Dr. Gazmend Luboteni: Sistemi bankar i Kosovës dhe mundësitë e tij për të kontribuar në procesin e privatizimit. *Rinvest*, 2002.

angazhimi është përgatitur një material me emrin: **“Strategjia e zhvillimit të Kosovës”**. Një përpjekje tjetër ka bërë edhe Grupi Ndërkombëtar i Krizave (ICG) me dokumentin: **“Kosova-Strategjia për zhvillimin ekonomik.”** Qeveria e Kosovës në mandatin e parë ka përgatitur dokumentin: **“Strategjia e zhvillimit afatmesëm të ekonomisë së Kosovës (2003-2008)”**, por dokumenti nuk është finalizuar meqenëse nuk është aprovuar nga qeveria. Edhe në vitin 2004, Qeveria e Kosovës ka bërë përpjekje për hartimin e një **Strategjie** të re. Po ashtu, është formuar grupi për strategji ekonomike dhe identifikimin e projekteve. Për realizimin e tyre është bashkëpunuar me ekspertë të UNMIK-ut dhe të Paktit të Stabiliteti. Megjithatë, për fat të keq, edhe ky tentim i qeverisë dështoi. Ndërkaq, në mandatin e dytë (2004-2007) qeveria angazhoi ekspertë të pavarur ndërkombëtarë dhe vendorë për hartimin e **Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik të Kosovës**. Si rezultat, është përgatitur një draft-dokument, i cili nuk i ka plotësuar as për së afërmi pritjet e Qeverisë, dhe si i tillë ka mbetë i papërdorshëm. Ka patur edhe shume tentime tjera për hartimin e strategjive sektoriale.

Edhe mandati i tretë qeverisës (2008-2010) ka pretenduar të nxjerr një strategji-vizion të zhvillimit ekonomik. Për këtë qëllim, qeveria gjatë një vikendi në Bansko (Bullgari) ka promovuar një dokument, i cili bëri bujë mediale dhe u harrua para se të arrihe në kabinetin qeveritar.²⁹

Edhe përkundër të gjitha përpjekjeve, insistimeve dhe presioneve, Kosova deri më sot nuk ka arritë të këtë një dokument të strategjisë së zhvillimit ekonomik afatgjatë. Në mungesë të këtij dokumenti insitucionet e vendit janë shërbyer me një dokument, i cili është obligativ me **Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike**. Ky dokument përcakton kahet dhe parametrat zhvillimor për tri vite në vijim dhe njihet si: **“Korniza Afatmesme e Shpenzimeve”** (KASH). Ky dokument për nga natyra është dinamik. Të dhënat dhe parametrat e këtij dokumenti përcaktojnë prioritetet, dinamikën e zhvillimit dhe kufijtë e shpenzimeve buxhetore për periudhen trevjeçare. Kështu, duhet theksuar se ky dokument përqendrohet në përpunimin detal të të dhënave vetëm për vitin e parë kurse për dy vitet pasuese të dhënat vlerësohen, apo edhe improvizohen pasi që ato domosdoshmërisht duhet të ripunohen në vitin tjetër. Ky dokument, më tepër është parapërgatitje dhe kornize e të

²⁹Me detalisht në: Ismail Kastrati; **“Rrënimi dhe rimëkëmbja e Kosovës 1998-2008”**, Prishtinë, 2012

hyrave dhe shpenzimeve buxhetore . Nisur nga përvoja e deritanishme rezulton se prioritetet e përcaktuara në këtë dokument nuk respektohen as me rastin e aprovimit të buxhetit.

Në periudhën deri në vitin 2008 në çdo mandat qeverisës në të gjitha dokumentet e aprovuara prioritet iu është dhënë përfundimit të fazës së tranzicionit, se këndejmi edhe procesit të privatizimit. Procesi i privatizimit, i filluar dhe ndërprerë disa herë, për shkak të problemeve formale me seriozisht filloi të realizohet në vitin 2005 deri 2007 .

Qëllimi i vënies në administrim të veçantë të ndërmarrjeve shoqërore është mbrojtja e aseteve të tyre, eliminimi i problemeve, rritja e të ardhurave, kontrollimi i shpenzimeve të panevojshme rritja e vlerës së aseteve dhe përgatitja për privatizim e ndonjë pjese ose të ndërmarrjes në tërësi.

Pa marrë parasysh mungesën e përvojës në procesin e tranzicionit, e sidomos të privatizimit, dilemat rreth modelit me të përshtatshëm në kushtet e ndryshme specifike të secilit vend kushtet kryesore për sukses të privatizimit janë: baza ligjore e qartë, drejtësia, transparenca, konkurenca dhe konsensusi shoqëror”.³⁰

3.2.0. Metoda “ Spinof”, kostot dhe përfitimet e sajë në procesin e privatizimit

Me shpalljen e **Rregullorës së UNMIK-ut nr 2001/9** të datës 15 maj 2001, për **Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë**, pas konstituimit të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverises edhe pas nxjerrjes së **Rregullores se UNMIK-ut nr 2002/12** të datës 13 qershor mbi themelimin e **Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM)** u krijuan kushtet për fillimin e procesit të privatizimit në Kosovë.

³⁰ Haxhi Gashi: “Konflikti ligjor lidhur me privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore”, Instituti GAP, fq.3.

Sipas këtyre akteve ligjore, menaxhimi me pronën shoqërore, publike e shtetërore është kompetence e Perfaqësuesit Special dhe se procedurat për transformimin e pronës, po ashtu janë të rezervuara për UNMIK-un dhe PSSP-në. **Agjencia Kosovare e Mirëbesimit** është formuar me konsultime të institucioneve ndërkombetare dhe vendore me obligim që të administrojë Ndërmarrje Publike dhe prona tjera. Për AKM-në, më gjerësisht do të shkruhet në një pjesë të veçantë të këtij punimi.

AKM bën mbikëqyrjen e ndërmarrjeve shoqërore edhe pse ato vazhdojnë të menaxhohen nga strukturat ekzistuese. *UNMIK-u dhe Shtylla e IV-të* për vazhdimin e procesit të privatizimit zgjodhën një model të veçantë për Kosovën. Ky model ishte njohur si SPIN-of dhe një variant i tij “SPIN-of special”. Sipas kësaj metode, AKM-ja nga NSH ekzistuese (ose në emër të tyre) themelon një ose më shumë shoqëri aksionare me përgjegjësi të kufizuara. Këtyre shoqërive të reja ua bart të drejtat mbi pronat e NSH si dhe fitimet nga to. Ndërmarrja e Re posedon aksionet e ndërmarrjes shoqërore. AKM posedon të drejtën që këto aksione t’ia shes, ose të ia tjetërsoi Ndërmarrjes së Re (ose ndërmarrjeve) të reja. Te ardhurat nga shitja e aksioneve ruhen në një Fond të Mirëbesimit pranë AKM-së për interesa të pronareve të NSH dhe kredituesve (*nese ka pasur*). Duhet sqaruar se ndërmarrja shoqërore e mbetur ka marrë në barre të veten edhe problemet nga e kaluara. Në fakt, ajo pas bartjes së aksioneve është përgatit dhe është likuiduar sipas një procedure të veçantë. Kjo formë e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore është aplikuar në Kosovë, kurse ndërmarrjet publike dhe pronat shtetërore nuk janë privatizuar, por kanë mbetur nën administrimin e UNMIK-ut (AKM-së).

Këto rregulla dhe modeli i aplikuar në Kosovë janë përpiluar me qëllim që privatizimi të mund të realizohet pa pengesë nga kërkesat e ndryshme pronësore-këtu mendohet nga kërkesat që vinin nga Serbia, e cila Kosovën e konsideronte pjesë të veten, kurse pronën e Kosovës, si pronë të saj. Kjo, në aspektin ndërkombëtar fuqizonte administratën e OKB-së në Kosovë nga përgjegjësia eventuale, meqë Kosova ende nuk e kishte të zgjedhur Statusin e saj politik. Kjo “*procedurë e veçante është zhvilluar për ta bërë të mundur shqyrtimin e çfarëdo pretendimi të mëvonshëm kundër ndërmarrjes, derisa privatizimi të vazhdojë, duke krijuar ndërmarrjen e re me kapitalin e ndërmarrjes së vjetër (Spin-of), duke i mbajtur*

mjetet nga privatizimi, dhe duke formuar Dhomë të Veçantë që të mirret me çfarëdo kërkesë legjitime nga palët e treta pretenduese. Gjithashtu, shumica e gjygtarëve në Dhomën e Veçante janë ndërkombëtarë duke siguruar drejtshmëri”³¹

Por, “në dritën e debateve intensive per statusin pefundimtar të ndërmarrjeve në Kosovë është interesante se Spin-off-i lë pronësinë e padefinuar: Pse pronesia pas privatizimit duhet të jetë e qartë kundrejt asaj që ishte para privatizimit...Kjo paqartësi duket se është krijuar qëllimisht nga shtetbërësit ndërkombëtarë”³²

Mosdefinimi i pronarit të vërtetë dhe statusit të pronës së shitur vjen në kundërshtim me qëllimet e programuara nga shtetndërtuesit ndërkombëtarë për definimin e pronarit legjitim të pronës. Në veçanti, paqartësia e pronës është e tokat, në të cilat ishin të vendosura NSH. Zgjidhja është kërkuar në mënyrë specifike: kur të shiten asetet e NSH-ve toka e lidhur do të iu ipet me qira për 99 vjet. Sipas kësaj autoreje, korniza ligjore e privatizimit e dizajnuar nga autoritetet ndërkombëtare kompetente (*UNMIK-u*) e lë të padefinuar çështjen e pronës, sidomos të tokës, të cilën e ndan nga asetet tjera të NSH-ve. Sepse, kur ekziston një qiradhënie për tokën e marrur në shfrytëzim, atëherë patjetër duhet të ekzistojë një qirramarrës. Duket se këtë zgjidhje e gjetën përmes një rruge të padefinuar qartë, por që mbetet të definohet bashkë me zgjidhjen e statusit të Kosovës.

Një mendim më afirmativ të këtij modeli e gjejmë të analizat në një *Tryezë Diskutimi*³³, sipas të cilit *Spin-off-i* ka disa përparësi në krahasim me disa zgjidhje tjera. Mungesa e burimeve për investime kapitale të gjiros dhe regjenerimit teknologjik, kuadrot, tregjet, paraqitet si faktor limitues tek Ndërmarrjet Shoqërore, prandaj me nxjerrjen e **Rregullores mbi Organizatat Biznesore** dhe **Rregullores mbi AKM-në**, me kusht që të krijohet ambient

³¹**Riinvest: Statusi i pronës shoqërore në Kosovë, Prishtinë, 2004 fq.58**

³²Rita Augestad Knudsen: **Vepra e cituar**.

³³“Privatizimi në Kosovë, përparim dhe ngecje” dhe “Statusi i Pronës Shoqërore në Kosovë-Kontestet dhe Privatizimi”, organizuar nga “Forumi 2015, Riinvest, Soros, Kaci, Prishtinë, 2004.

përkatese institucional, paraqesin shansë dhe mundësi për tërheqjen e investitorëve potencialë. Pas themelimit të AKM-së, është bërë edhe themelimi i ***Dhomës së Posaqme*** në kuadër të Gjykatës Supreme për çështjet e AKM-së. Për fillimin e privatizimit domosdoshmerisht është kërkuar aprovimi i ***“Politikave Operacionale”*** – procedurave dhe nxjerrja e ***Rregullores për shfrytëzimin e tokës***. Keto janë aprovuar në fillim të vitit 2003, mirëpo, pengesa dhe vonesa të zgjatura janë shkaktuar nga nevoja e konsultimit të vazhdueshëm me Zyrën Ligjore të OKB-se, si dhe pritjen e aprovimit të rregulloreve dhe vendimeve nga ana e tyre. Një kohë mjaft e gjatë është kaluar në konsultime me komunitetin për gjetjen e një zgjidhjeje ndërmjet insistimit të komunave për menaxhimin e shfrytëzimit të tokave të NSH-ve, si dhe të drejtës së AKM-së për të privatizuar ato toka. Në ndërkohë, është arritur pëlqimi i OKB-së për të drejtën e punëtorëve të punësuar në NSH për shpërndarjen e 20% të vlerës së shitur.

Në maj 2003 filloi realizimi i programit të privatizimit. Në këtë kohë, është shpallur *Vala e Parë* për privatizimin e shtatë ndërmarrjeve shoqërore. Brenda afatit të ofertimit kemi patur 22 oferta. Vlera e ofertave fituese për të gjitha këto ndërmarrje ishte 4.6 milionë euro³⁴. Krejt kjo dukej si një fillim i mbarë. Më pas, kjo stimuloi AKM-në, e cila përgatiti Valën e Dytë të privatizimit me 20 ndërmarrje të reja. Në këtë valë ofertat ishin mjaft atraktive pasi që u pranuan 120 oferta, nga të cilat 23 oferta nga investitorët ndërkombëtarë. Vlera e ofertave fituese të kësaj vale ishte 24,7 milionë euro.

Të nxitur nga ky fillim i mbarë, AKM përgatiti për tenderim 158 ndërmarrje, si dhe zgjidh dilemat rreth transformimit eventuale të tyre në vitet e 90-ta. Bordi i AKM-së nga këto ndërmarrje, 64 i njeh si ndërmarrje të reja dhe i aprovon për tenderim. AKM kishte përgatitur një plan, i cili synonte që çdo muaj të tenderonte ose likuidonte deri në 25 ndërmarrje.

Më 10 shtator shpallet *Vala e Tretë* e privatizimit. Për befasi, Kryetari i Bordit të AKM-së, i cili ishte edhe Kryesues i *Shtylles së IV-të* të UNMIK-ut, anulon këtë Valë të privatizimit më 6 tetor me pretekst të rishqyrtimit të kornizës ligjore mbi privatizimin. Por, siç duket

³⁴Për të gjitha rundet e privatizimit do të jepen të dhënat në formë të plotë.

përplasjet ndërmjet anëtarëve vendorë të Bordit të AKM-së (*tre ministrave dhe përfaqësuesit të sindikatave të Kosovës*) në njërën anë, dhe anëtarëve ndërkombëtarë, në anën tjetër, rezultuan me vonesat dhe mosmarrëveshje dhe procesin e kthyen në pikën zero. U nevojitën edhe gjashtë muaj për konsultime në Selinë e OKB-s për të filluar vazhdimin e procesit të privatizimit duke e rishpallë *Valen e Tretë* të privatizimit dhe duke i aprovuar kontratat e shitjes të *Valës së Parë* dhe asaj të dytë. Mirëpo, ky vendim i Bordit nuk është implementuar sipas kalendarit dhe praktikisht procesi u ndërpre. Pas konsultimeve me Zyrën Ligjore në Nju-Jork, rezultoi se mund të vazhdohet me privatizimin sipas Rregullores në fuqi, ndërsa nga grupi i ligjeve diskriminuese të Serbise në vitet e 90-ta, përjashtohen tri ligje për rastet kur transferimi është bërë në mënyrë jodiskriminuese. Pra, me tutje procesi vazhdon me **Rregullore** të ndryshuar, duke u marrë parasysh transformimet e bëra para luftës në rast se ato janë bërë në bazë të ligjeve jodiskriminuese dhe në mënyrë jodiskriminuese. Edhe pas kësaj, mospajtimet ndërmjet Institucioneve Qeverisëse vendore dhe atyre ndërkombëtare u thelluan. Procesi poashtu u ndërpre dhe praktikisht AKM nuk e kreu funksionin themelor për çka ishte themeluar; mbrojtjen nga degradimi, rritjen e vlerës dhe efikasitetin ekonomik. Si pasojë, përveç humbjeve nga mosaktivizimi, degradimi dhe problemet me të punësuarit në ndërmarrjet shoqërore, rënia e vlerës se pasurisë dhe dekurajimi i investitoreve ishte një dëm i pallogaritshëm për ekonominë e Kosovës. Kjo ndikoi në vonesat në fillimin e reformes dhe sigurimi i stabilitetit social të vendit. Kjo situatë gjithashtu është reflektuar edhe në proceset tjera politike në vend. Sidomos demtimi i imazhit të vendit dhe në tërheqjen e investimeve të jashtme, vonesat në realizimin e standardeve për Kosovën si kusht i vënë nga bashkësia ndërkombëtare për definimin e statusit politik për Kosovën, ç'rregullimi i raporteve midis dy poleve qeverisëse të vendit dhe interferimi i Serbisë në proces.

Cili ishte rezultati i përpjekjeve për privatizim gjatë vitit 2003 deri në ndërprerjen e përkoheshme, më së miri mund të nxirret konkluzioni nga një material i përgatitur për Tryezën e Diskutimit me titull: ***"Privatizimi në Kosovë, përparime dhe ngecje"***³⁵ ku

³⁵³⁵Organizuar nga ***"Forumi 2015"***, mars 2004 në Prishtinë, fq.26.

thuhet: “Gjatë tendereve të parë janë shitur 26 ndermarje me vlerë prej 29.355.070 eu. Nga 6 blerës potencialë pesë kontrata janë nëshkruar (katër janë ratifikuar nga Bordi) për rundin e parë të tenderëve dhe për rundin e dytë nga 19 ndërmarrje deri më tani janë nëshkruar 11 kontrata. Kontratat janë nëshkruar me një shtyerje prej më shumë se tre muaj. Bordi i AKM-së nuk ka ratifikuar 12 kontrata të nëshkruara. Të gjithë blerësit kanë paguar vlerën e parapërë përveç pesë ndërmarrjeve, në të cilat fituesit janë tërhequr dhe kanë filluar negociatat me ofertuesit e dytë më të mirë...Dy blerës kanë tërhequr vlerën e paguar (Përparimi 2,298 milionë eu dhe plastika 2.875 milionë eu. për shkak të zvarritjes në periudhën pas tenderimit. Tri banka komerciale kanë kredituar investitorët gjatë raundit të parë dhe të dytë në vlerë prej 8,5 milionë euro. Bankat ankohen në situatën e përgjithshme lidhur me procesin e privatizimit, që sipas tyre ka ndikuar negativisht në procesin kreditor.”

Në prill të vitit 2004 AKM, Departamenti i Privatizimit harton *Strategjinë e Privatizimit të Kosovës*, me të cilën synon realizimin e përfundimit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në mënyrë transparente dhe efikase me qëllim të përdorimit më me efikasitet të aseteve nxitjen e zhvillimit më dinamik të sektorit privat.

Ne këtë dokument përshkruhet gjendja e 500 ndërmarrjeve shoqërore, si dhe struktura e tyre. Dokumenti përcakton se këto ndërmarrje përbënin 90% të industrisë dhe minierave në Kosovë, rreth 50 % të hapësirës tregtare të shitjes me pakicë dhe 20% të tokës bujqësore të Kosovës, si dhe sipërfaqet më cilësore me pyje të Kosovës. Më tej, dokumenti specifikon se përveç disa ndërmarrjeve shoqërore ndërtimore, të cilat aktivitetin e vet ekonomik e kishin ringjallë, si rezultat i mbështetjes së donatorëve për rindërtimin e shtëpive dhe objekteve të shkatërruara nga lufta në të gjitha ndërmarrjet tjera shoqërore asetet e tyre janë shkatërruar dhe degraduar derisa tokat bujqësore kanë mbetë djerrë. Pyjet janë pre në mënyrë të pamëshirshme.”³⁶

³⁶Strategjia e Privatizimit, Departamenti i Privatizimit të AKM-së, prill 2004.

Për shkak të dokumentacionit të zhdukur dhe paqartësive të ligjeve lidhur me definimin e pronës shoqërore, Departamenti i Privatizimit nuk ka mundur të identifikojë saktësisht numrin e NSH-ve, në dokument thuhet se 450 NSH janë identifikuar dhe janë vënë nën administrimin e AKM-së, ndërsa 50 ndërmarrje tjera, sipas dokumentacionit jo të plotë mund të jenë konvertuar në kompani aksionare përmes shitjes së aksioneve, punëtorëve të tyre. Rreth 130 ndërmarrje të vogla, për shkak të dhënave të paqarta nuk është e qartë se e kanë statusin e ndërmarrjeve shoqërore apo të ndërmarrjeve private. Prandaj, Departamenti i Privatizimit i AKM-së ka identifikuar si NSH potenciale për privatizim në bazë të akteve ligjore në fuqi, ***Ligjit për AKM-në dhe Ligjit përDhomën e Posaqme***, 450 ndërmarrje shoqërore.

Pas luftës, ndërmarrjet shoqërore 75% ishin aktive dhe punësonin numër të vogël të punëtorëve, me një përqindje të vogël të prodhimit. Kryesisht, asetet e këtyre ndërmarrjeve ishin dhënë me qira ndërmarrjeve private dhe personave të tretë, të cilët këto asete i shfrytëzuan për destinime të tjera. Së këndejmi, përmes një bashkëpunimi ndërmjet institucioneve ndërkombëtare që administrojnë Kosovën, Qeverisë së Kosovës, Shoqërinë Civile, komunitetit të biznesit, sindikateve etj, është arritur konsensus i plotë dhe bindja e thellë se privatizimi i plotë është rruga e vetme e transformimit, efikasitetit ekonomik, punësimit dhe zhvillimit ekonomik.

Në *Strategjinë e Privatizimit* vlerësohet se janë tri shkaqet e ndërprerjes së procesit të privatizimit në tetor 2003³⁷. Udhëzimet e reja të OKB në lidhje me statusin e NSH-ve (*kërkohej dokumente se një ndërmarrje është vërtetë NSH*), Vonesa e UNMIK-ut në nxjerrjen e një rrugëdalje për procesin e likuidimit të NSH-ve që kanë në pronësi sipërfaqe të Kosovës dhe kërkesa e tregtarëve të rinj për ndryshime të politikave operacionale lidhur me privatizimin.

Ekipi i privatizimit pranë AKM-së nxorri konkluzionin se rifillimi i nxjerrjes së rregulloreve dhe procedurave nuk shkon në favor të politikave aktive të privatizimit dhe likuidimit të NSH-ve.

³⁷Po aty, pika 2

Në një tryezë diskutimi vlerësohet se: *''Ndërprerja dhe zvarritja e rifillimit të privatizimit është duke krijuar vështirësi të medha në zbatimin e reformes ekonomike dhe në ndërrimin e situatës socio-ekonomike në shoqëri kosovare''*.³⁸ Veçanërisht dëme nga ndërprerja e procesit janë shkaktuar në zbatimin e Standardeve për Kosovën. Siç dihet Standardet për Kosovën ishin caktuar nga OKB-të, të cilat fokusohen në tetë fusha, plotësimi i të cilave ishte i lidhur dhe kushtëzonte definimin e Statusit politik të Kosovës.

Ndërprerja ka shkaktuar dëme duke dekurajuar investitorët e jashtëm potencialë, duke dëmtuar imazhin e Kosovës, është dekurajuar komuniteti i biznesit dhe iniciativave për investime. Kjo situatë, po ashtu është reflektuar negativisht në realizimin e synimit për ndërtimin e Kosovës vend modern, me ekonomi të tregut. Numrit të madh të problemeve që nuk kishin mundur të absorbohen sa duhet nga ana e institucioneve të brishta të vendit në sferën e politikave ekonomike. Por, në veçanti ndikimi negativ më i theksuar është reflektuar të blerësit e ndërmarrjeve në dy tenderët e parë me vonesën e nënshkrimit të kontratave, dhe si pasojë vonesën e transformimit të pronës shoqërore në prone private. Pronarëve të rinj filluan të iu anulohen kështet e kredive për blerjen e këtyre ndërmarrjeve. Në vijim ato ndërmarrje shoqërore të privatizuara e kishin ndërprerë aktivitetin ekonomik, dhe në anën tjetër blerësit nuk i mundësohej të fillojnë aktivitetin në këto ndërmarrje. Dhe efekti i trete negativ lidhet me të punësuarit në ato ndërmarrje, të cilët largohen nga puna dhe nuk marrin 20% të mjeteve që iu takojnë në cilësinë e ish të punësuarit. Pra, kemi përkeqësim të situatës sociale.

Ndërprerja e procesit të privatizimit, mungesa e komunikimit në mes AKM-së dhe institucioneve vendore, e sidomos ashpërsimi i raporteve ndërmjet aseteve kryesore në process, ishin bërë pengesë serioze të realizimit të procesit të privatizimit.

Disa dilema dhe hezitime të PSSP-së dhe AKM-së rreth vazhdimin të procesit të privatizimit dhe insistimit për ndryshimin e politikave operacionale, siç duket të ndikuara nga kërkesat e qeverisë serbe, të cilat më parë ishin refuzuar. Këto kërkesa dhe ndikimi i tyre politizuan procesin e privatizimit, shtuan apetitet e Serbisë për të futur duart në

³⁸ Forumi 2015: "Privatizimi në Kosovë: Përparësit dhe ngecjet, Prishtinë 9 mars 2004, faqe 25

pasurinë e Kosovës dhe në fund të fundit, penguan Kosovën për vazhdimin e reformave dhe zhvillimit ekonomik.

3.2.1. Metoda e Spinof-it Special

Në qoftëse Bordi i AKM-së vlerëson se një NSH është e rëndësishme për zhvillimin ekonomik, meqenëse i takon një dege, apo sektori kyq të ekonomisë së vendit apo rajonit, që punëson numër të konsiderueshëm dhe që ka një pozitë të lakmueshme në treg, pra që ka bërë emër atëherë ajo NSH privatizohet përmes **Spinoff-it special**. Në **Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12** parashihet që Bordi i Agjencisë të “*Krijoi rrethana, në të cilat Agjencia mund të kërkojë nga palët që kanë konkurruar për atë korporatë, duke përfshirë aktivitetet e propozuara, investimet dhe nivelet e punësimit, si dhe dëshmi për mjetet financiare që nevojiten për investimet e parapara në planin e biznesit, dhe të specifikojë se si gjate vlerësimit të tenderit, këto kritere do të merren parasysh nga Agjencia*”,³⁹.

Pra, privatizimi me *Spinof Special* përveç kërkesave normale të Agjencia, të parashtruar për privatizimin e ndërmarrjeve të korporatizuara, kërkon edhe kushte shtesë për ofertuesit lidhur me zotimet për investimet, punësimin dhe planin e biznesit. Përveç këtyre kritereve, në raste të veçanta mund të kërkohej dëshmia e ekspertizës së mjaftueshme për ndërmarrjet e korporatizuara, aty ku ka nevojë për licence operimi prova mbi kualifikikimin aty ku duhet të transferohet apo të rilicensohet. Në rregullat e tenderit percaktohet që për çdo ndërmarrje të komercializuar nevojitet miratimi specifik nga Bordi i Drejtorëve të AKM-së. Sipas rregulloreve të tenderit për *Spin-of Special*, ofertuesi duhet të garantojë punësimin e një numri të caktuar punëtorësh, pagesën e taksave dhe për një numër të caktuar punëtorësh të ardhurat për një shumë të caktuar para privatizimit.⁴⁰

³⁹Rregullorja e Unmikut nr.200/12 Mbi themelimin e Agjencionit Kosovar të mirëbesimit, 2002.

⁴⁰Rregullorja e UNMIK-ut numer 2002/12 “Mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit” 10.2(b)

Mund të ketë ndonjë përjashtim neqoftëse këtë e aprovon Bordi i AKM-së me propozimin e ndonje anëtari të vet, në rast se ndonjë ndërmarrje korporative është e rëndësishme për ekonominë e vendit, pra mund të bëhe t ndonjë përjashtim nga kërkesat specifike. Në këso raste, Bordi autorizon vlerësime lidhur me këto *spin-offe* speciale. Vlerësimet duhet të bëhen nga institucionet e specializuara, apo ekspertët vendorë, ose nga ata të jashtëm. Këto vlerësime nuk janë obligative për Bordin, nuk publikohen por vetëm e ndihmojnë vlerësimin e ofertave. Neqoftëse në *spin-offe* të rregullta oferta me çmim më të lartë shpallet fituese e tenderit, te *spin-offi* special, përveç çmimit, ofertuesit duhet të prezantojnë edhe: a) Projekte për investimet e ofruara; b) planin e biznesit dhe planin intenziv dhe; c) kërkesat tjera plotësuese që ka përcaktuar menaxhmenti dhe ka aprovuar Bordi.⁴¹

Një ndërmarrje e korporatizuar mund te privatizohet permes *spin-off-it special* nëse i plotëson njërën nga këto kritere: a) Ka pasë punësim dhe paga të rregullta dhe pagesë tatimi në paga për tre muaj (*filluar nga 1 shtatori deri më 30 nëntor 2002 për me se paku 300 të punesuar*) ose që b) në vitin 2002 ka realizuar të hyra të përgjithshme, së paku për 10 milionë euro. Përjashtim nga këto kritere mund të ketë vetëm për ndonjë ndërmarrje, e cila ka ndikim të jashtëzakonshëm në ekonomin e Kosovës, dhe një gjë të tillë e aprovon Bordi i AKM-së.

Në periudhën e vështuar përmes *spin-ofit special* janë privatizuar 26 ndërmarrje. Ne vazhdim po japim pasqyrën e ndërmarrjeve të privatizuara përmes metodës së *spinofit special* dhe elementet kyçe të kontraktorëve:

⁴¹Agjencia Kosovare e Privatizimit, “Raport pune”, gusht 2008-gusht 2009, faqe 66.

Ndërmarrjet e privatizuara përmes *spin-ofit* special:

Numri	Ndërmarrja	Komuna	Dt.e kontraktimit	Cmimi i shitjes	Investimet e zotuar	Punësimi I zotuar
1	Banja e Kllokotit	Viti-Gjilan	24.11.2005	1.805.550	3.100.000	201
2	Ferronikeli	Drenas	20.12.2005	30.554.371	20.000.000	1000
3	Fabrika e Tullave	Gjakove	28.07.2006	5.689.432	/	666
4	Birraria	Peje	29.06.2006	11.130.000	15.206.000	612
5	Ballkan	Suhareke	21.07.2005	1.400.000	6.000.000	375
6	Modeli	Gjakove	13.04.2008	630.000	2.200.000	170
7	Fan	Podujeve	23.03.2006	2.310.000	2.800.000	236
8	Duhani	Gjilan	14.08.2006	1.400.000	5.559.504	799
9	Mulliri Sillosi	Rahovec	11.05.2005	1.000.000	19.887.564	358
10	Veraria	Rahovec	31.07.2006	4.302.900	5.000.000	250
11	Mulliri	Fushe Kosove	10.07.2007	2.505.555	15.000.000	260
12	Fabrikat e gypave	Ferizaj	20.11.2007	3.657.000	13.200.000	360
13	Hotel Iliria	Prishtine	31.07.2006	1.610.000	3.000.000	250
14	NBI Suhareka	Suhareke	27.08.2007	4.175.999	8.600.000	345
15	Tullara	Kamenice	04.06.2008	160.189	/	80

16	Mulliri	Ferizaj	28.04.2008	568.750	5.000.000	80
17	Kosovatex	Prishtine	31.08.2006	3.112.001	4.000.000	200
18	Hotel Grand	Prishtine	13.10.2006	8.160.000	20.200.000	570
19	Magnezit Strezovc	Gjilan	13.12.2007	730.000	14.200.000	238
20	Magnezit Golesh	Lipjan	11.12.2007	810.000	16.200.000	355
21	Llamkos	Vushtrri	21.07.2005	4.151.000	15.000.000	500

Dy Ndërmarrjet e fundit, të cilat kanë lidhur kontratë me AKM-në, “Mineks” me 12.07.2010 dhe “Jugoterm” më 17.04.2012 janë tenderur në rundet e mëhershme të privatizimit, por për shkak të apelit të *Dhoma e Posaçme* deri në përfundim të procesit është vonuar nënshkrimi i kontratave. Siç rezulton nga tabela, vlera e zotuar për investime nga të gjitha keto oferta të kontraktuara kapë shumen e afër 200 milione euro, nga të cilat si të realizuara rezultojnë 171 milionë euro, ndërsa nga 8 622 vende pune të zotuar janë realizuar 7257 vende pune, ose 84% e zotimeve. Në periudhën deri në qeshor 2008 nga raportimi dhe monitorimi janë liruar 6 ndërmarrje, meqenëse i kanë përmbushur obligimet e tyre kontraktuese. Këto ndërmarrje janë: “Banja e Kllokotit” (Viti), “Ferronikeli” (Drenas), “Fabrika e tullave” (Gjakovë), “Birraria” (Pejë), “Ballkan” (Suharekë), “Modeli” (Gjakovë). Sipas të dhënave nga Raporti i AKP-së për vitin 2008, këto ndërmarrje kanë investuar 66.991 mijë euro dhe kanë punësuar 3 071 persona. Sipas Raportit të Auditorit, Ndërmarrjet e Reja “Banja e Kllokotit”, “Ferronikeli”, “Fabrika e tullave” dhe “Birraria”, përveç përmbushjes së obligimeve nga kontrata, ato po zhvillojnë një afarizëm të suksesshëm dhe për ekonominë e vendit, dhe në sektoret e vet janë bartëse të aktivitetit ekonomik. “Ferronikeli” me prodhimet e veta dhe plasimin e tyre në tregun e jashtëm ka përmirësuar bilansin e këmbimit tregtar me jashtë. Por, edhe në këtë grup të ndërmarrjeve

ka problem sidomos te dallimi midis shumës së raportuar te investimeve dhe asaj të konstatuar nga auditori. Kjo vërehet sidomos te “Ballkani” dhe “Modeli”. Kjo e fundit, po ashtu nuk i ka përmbush obligimet për punësim sepse ka të punësuar sezonalë e jo të rregullt. Po ashtu, kjo ndërmarrje nuk e ka filluar procesin e prodhimit deri në qeshor 2008. Pjesa tjetër e ndërmarrjeve që janë nën monitorimin e AKP-së, që janë privatizuar përmes metodës së *spin-ofit special* po hasin në problem dhe vështirësi. Kështu, për shembull Fan-Podujevë ka realizuar vetëm 42% te investimeve, “IDGJ Duhani” 19%, “Mulliri&Sillosi” 100% , “Veraria” Rahovec 108%, “Mulliri” Fushë- Kosovë 83%, “Fabrika e gypave”- Ferizaj 18%, Hoteli “Iliria” 78% , NBI “Suhareka” 6%, “Tullara” nuk ka zotime për investime, “Fabrika e bukës” Ferizaj 19%, “Kosovatex” 34% , “Grand Hotel” 15%, “Magneziti-Strezovc” 7%, “Magneziti-Golesh”-8% dhe “Llamkos” 10%. Këto ndërmarrje deri në qeshor 2008 kishin realizuar investime në vlerë prej 35.224 mijë euro, ose 23.8% të obligimeve kontraktuese dhe kishin punësuar 3 428 persona, ose 74.1% e numrit të obliguar me kontrate. Ky grup i ndërmarrjeve të privatizuara nuk mund të konsiderohet si storie e suksesit të privatizimit për arsye të dështimit në realizimin e vëllimit të investimeve por edhe të numrit të të punësuarve. Te numri i të punësuarve disa ndërmarrje mbajnë në evidencë numër të caktuar personash por që i paguajnë me paga minimale (80 euro) në muaj për faktin se ende nuk e kanë përfunduar investimet, apo nuk e kanë filluar procesin e prodhimit. Duhet përmendur edhe faktin se disa ndërmarrje si: “Llamkos” e Vushtrrisë pas dështimit në përmbushjen e kontratës iu janë tërhequr aksionet dhe ndërmarrja është ritenderuar. Po ashtu, në kohën kur po përgatishim këtë punim, pronarëve të “Hotelit Grand” në Prishtinë iu janë tërhequr aksionet nga AKP, prandaj procesi ka kaluar në procedurë gjyqësore për shkak të aferave korruptive dhe rasti i përfundimit tragjik (*vetvrasjes*) të Kryetarit të Bordit të AKP-së. Lidhur me problemet që u ballafaquan ndërmarrjet e privatizuara përmes *spin-offit* special kemi siguruar një Studim rasti me tri ndërmarrje të privatizuara përmes Spin-ofit special bashkajtur si pika 3.2.2. Ky konstatim i jonë argumentohet edhe me deklaratën e një pronari të një ndërmarrjeje të privatizuar përmes kësaj metode i cili shprehet : “*si përfundim mund të nxjerrim konstatimin se kjo metodë nuk i ka dhënë rezultatet e pritura, si përjashtim kjo metodë në vetë përmban elemente të politikave sociale, sepse investitorëve iu imponon investime dhe punësim të obligueshëm,*

por nuk kërkon nga ata te realizojnë afarizëm të dirigjuar nga kushtet e tregut. Duhet ritheksuar se këto ndërmarrje ishin ndërmarrje të përzgjedhura më të fuqishme dhe me vlerë më të madhe të aseteve”. Siç u tha me sipër, në asnjërën nga specifikat e percaktuara në vlerësim grupor të tyre nuk janë përmbushur obligimet kontraktuese, individualisht ndonjë ndërmarrje mund të konsiderohet e suksesshme. Por, marre në tërësi ky grup i ndërmarrjeve të privatizuara me këtë metode rezulton i pasuksesshëm dhe nuk i ka përmbushur pritjet.

3.2.2.Studim Rasti, Tri ndërmarrje

1.Ndërmarrja e Re “Grand Hotel”

Kjo ndërmarrje është privatizuar përmes Spin-off-it Special më 13.10.2006. Çmimi shitës i kësaj Ndërmarrjeje ishte 8.160 mijë Eu. Zotimi për investime ka qenë 20.200 mijë Eu (për dy vjet) dhe për punësim të 135 punëtorëve në gjashtë muajt e parë, të 270 punëtorve në gjashtë muajtë tjerë dhe të 570 të punësuarve në vitin e dytë.

Ndërmarrja “Grand Hotel Prishtina” është themeluar më 1978. Objekti luksoz është në qendër të Prishtinës me 32 mijë m², me kapacitet prej 353 dhomash me 526 shtretër, 9 apartamente, 2 rezidenca si dhe hapësira tjera si: restaurant, tavernë, kafe-bar, bar i natës dhe salla për konferenca.

Për vite të tëra “Grand Hotel Prishtina” ishte konsideruar simbol i hotilerisë së Prishtinës dhe Kosovës në përgjithësi.

Sipas raporteve zyrtare të AKP-së, nga hyrja në fuqi e kontratës deri në korrik 2009, pronari i ri ka realizuar investime në vlerë prej 3.025 mijë Eu. Ose 15% të zotimit për investime. Zotimi për punësime ishte plotësuar 100%.

Sipas raportit të auditorit të pavarur, të punësuarit nuk janë raportuar realisht pasi që ata janë të punësuar në ndërtimtari e jo në ndërmarrje. Pronari i Ri- blerësi ka kërkuar afat shtesë për realizimin e premtimeve. Bordi i AKP-së ia ka lejuar afatin shtesë dhe po ashtu ia ka mundësuar të drejtën që organizatën ta vë në hipotekë. Pronari as në afatin shtesë nuk i ka përmbushur obligimet kontraktuale për shkak të vështërsive financiare të biznesit që udhëheqë.

Më pas, Njësia e Monitorimit të AKP-s ka konstatuar se një krah (pjesë) e objektit është demoluar dhe i janë ndërruar pllakat e mermerta të fasadës dhe në vend të tyre janë vendosur plaka të aluminit. Punët për renovimin e pjesës së jashtme të objektit janë ndërprerë dhe nuk kanë vazhduar më asnjëherë.

Sipas përfaqësuesve të punëtorëve të “Grand Hotel Prishtina”, që aktualisht janë të punësuar në këtë ndërmarrje, blerësi ka qenë një konzorcium Maqedono- Kosovar (Ndërmarrje e specializuar për hoteleri). Konzorciumi është themeluar për shkaqe të plotësimit formal të kriterit të tenderit.

Gjithnjë sipas përfaqësuesve të punëtorëve aktualë, pronari, në mungesë të mjeteve ka kërkuar nga dy partnerë tjerë të bashkojnë kapitalin dhe të fitojnë bashkëpronësinë në asetet e “Hotelit Grand”. Ky veprim nuk është i lejueshëm me rregullat e AKP-së.

Meqë objekti i “Grand Hotelit Prishtina” gjendet në qendër të Prishtinës dhe disponon së paku 90 mijë m sipërfaqe toke. Konsiderohet se vetëm vlera e sipërfaqes tokësore, pa objektin vlen shumë më shumë se sa çmimi i shitjes së kasaj ndërmarrjeje. Për mos lejimin e bashkimit të aksionarëve tjerë konsiderohet se ka ndërhyrë politika. Madje, në lidhje me këtë proces, njëri nga partnerët potencial ka denoncuar publikisht strukturat e atëhershme të AKP-së për kërkim ryshfeti në këmbim të dhënies së të drejtës për bashkëpronësi .

Bordi i AKP-s pronarit ia ka zgjatë afatin për përmbushjen e obligimeve deri në fillim të vitit 2012. Meqenëse prapë nuk janë përmbushur obligimet, në maj të vitit 2012 AKP ka terhjekur akcionet dhe këtë ndërmarrje e ka vënë nën administrim të drejtëpërdrejt.

Gjatë periudhës së administrimit të drejtëpërdrejtë, ndërmarrja disi është ringjallur. Punëtorët kanë realizuar të ardhura të rritura për 25%, kanë investuar në renovim 300 mijë Eu. dhe kanë realizuar një fitim vjetor prej 85 mijë Eu. Njësia mbikëqyrëse pranë AKP ka lëshuar me qira shumë hapësira të hotelit. Me këtë rast të hyrat nga qeraja menaxhohen nga AKP.

Gjendja e tanishme e objektit është e mjerueshme. Vet objekti është në shkatërrim. Inventari është demoluar. Krah i cili duket se është rënuvuar praktikisht është demoluar. Inventari i vlefshëm është shitur dhe me paratë e fituara është ndërruar fasada.

Aktualisht në këtë ndërmarrje punojnë 92 punëtorë. Nga shkurti 2015 AKP e vënë në likuidim Ndërmarrjen “Grand Hotel Prishtina”.

Vënja në proces të likuidimit nga ana e AKP-së ndërmarrjen “Grand Hotel Prishtina” konsiderohet veprim i pa ligjshëm sepse në këtë periudhë AKP nuk ka pasë asnjë anëtar të ligjshëm në Bordin Mbikëqyrës të AKP-së. Lidhur me këtë veprim janë njoftuar zyrtarisht strukturat e Kuvendit të Kosovës si mbikëqyrëse e AKP-së.

Si përfundim, Ndërmarrja “Grand Hotel Prishtina” dikur ndërmarrje e suksesshme dhe me asete të vlefshme, për shkak të dështimit në përzgjedhjen e pronarit të aftë materialisht për investime dhe zhvillim dhe dështimit për përmbushjen e obligimeve në investime dhe punësim, kjo ndërmarrje jo që nuk është riparuar asnjëherë, pajisur dhe aktivizur në funksion të kontributit në zhvillimin e vendit por është shkatërruar dhe degraduar edhe më tutje.

2. Ndërmarrja e Re “IDGJ Duhani”, Gjilan

Sipas raportit të AKP-së, kjo ndërmarrje është privatizuar me 14.08.2006 nga kompania Mecrof Tobacco/kompani angleze/,përmes Spin-ofit special.Cmimi shitës ishte 1.400 mijë Eu.Investimet e zotuara 5.599.504 Eu. Zotimet për punësim ishin 200 punëtorë në gjashtë muajt e parë, 400 në gjashtë muajt vijues dhe në vitin e dytë e në vazhdim 799 të punësuar.

Kjo ndërmarrje është themeluar në vitin 1960 dhe ka punuar deri në vitin 1980 në kooperim me “Rothman’s International”. Kjo ndërmarrje ka pasë në kooperim 8000 fermerë kultivues duhani. Në vitet e 90-ta, për shkak të ashpërsimit të rrethanave politike prodhimi ishte ndërprerë. Paisjet e ndërmarrjes ishin ruajtur në gjendje të mirë.Ndërmarrja ka pasur në pronësi 4 ha tokë dhe tri pika tjera grumbullimi. Ndërmarrja ka prodhuar brende të ndryshme duhani. Disa nga prodhimet janë plasuar në tregjet e jashtme.

Njësia për monitorim të ndërmarrjes pranë AKP ka raportuar se pronari në dy vitet e para kishte realizuar 1.060 mijë Eu. investime në paisje dhe zyra, automjete transporti, paisje bujqësore etj. Sipas raportit të auditorit të pavarur, pronari kishte shitur në të njëjten kohë automjetet-veturat të cilat i kishte raportuar si investime për të paguar pagat e punëtorëve. Pra, ka raportuar kundërligjshëm dy herë të njëjtën vlerë. Edhe obligimet për punësim pronari i kishte raportuar jo realisht pasi që i kishte raportuar si të punësuar ne ndërmarrje farmerët kooperant si të punësuar në ndërmarrje. Punëtorët e punësuar në ndërmarrje mbaheshin në punë me paga minimale (80 Eu në muaj) me qëllim që të i shmangen tatimit në të ardhura personale.

Meqenësë pronari nuk i ka përmbushë obligimet për investime dhe punësim, Bordi i AKP-s ka marrur vendim për ndëshkim në pajtim me kontratën. Ndëshkimi për mosrealizim të investimeve ka qenë në vlerë prej 1.223 mijë Eu. kurse për punësim 1.547 mijë Eu.Blerësi në këtë periudhë nuk ka kontakt me AKP-n dhe nuk ka tregu vullnet për bashkëpunim për shkak të vështërsive që kishte me biznesin të cilin e kishte në falimentim. Për këtë arsye Bordi i AKP-së ka marrur vendim për lidhjen e marrëveshjes për përtrirjen e marrëveshjes

së zotimeve me ndërmarrjen "IDGJ Tobacco", shpk nga Shkupi. Marrëveshja është nënshkruar nga palët me 12.04.2012.

Pronari i ri ka marrë për obligim që brenda dy muajsh të realizojë investime në vlerë prej 4 mil. Eu. dhe të punësojë në fillim 14 persona, në muajin e dytë 35 persona dhe në vitin e dytë 90 persona.

Periudha e raportimit sipas marrëveshjes së novacionit ka përfunduar me 10 shtator 2014. Në raportin e Auditorit të pavarur thuhet se blerësi në këtë periudhë ka investuar 3.254238 Eu. apo 81,36% të zotimit për investime dhe 95% të zotimit për punësime.

Blerësi ka kërkuar më shkrim nga Bordi i AKP-së që të i zgjatet afati i përmbushjes së zotimeve deri në fund të shkurtit 2015.

Deri më tani, pronari nuk e ka lëshuar në punë ndërmarrjen edhe se i ka përfunduar të gjitha punët përgatitore dhe ka përmbushur zotimin për investime dhe punësim.

Pronari i "Mecrof Tobacco" deklaroi se ka investuar 4.818 mijë Eu. dhe ka përmbushur zotimet për investim. Bordit të AKP-së i ka bërë kërkesë për lirim nga mbikëqyrja me ç'rast i mundësohet edhe vënja në hipotekë për tërheqjen e kredive të reja. Fillimisht, për shkak të mungesës së Kuorumit në Bordin Mbikëqyrës të Drejtoreve të AKP, kërkesa nuk është shqyrtuar, por edhe pas kompletimit të Bordit kërkesat vonojnë të shqyrtohen për shkak të mbingarkesës dhe ngathtësisë së Bordit.

Nga të dhënat e AKP-s dhe nga biseda me pronarin e ndërmarrjes del se kjo ndërmarrje dikur profitabile, pas vitit 1999 nuk ka funksionuar. Fillimisht i ishte ndaluar puna deri në vitin 2005. Pas përgatitjes për tenderim, është privatizuar në korrik 2006. Pas dështimit, e rikontaktuar me pronarin e ri me 2012 dhe e renovuar dhe e përgatitur për startim për prodhim për shkak të pengesave formale (Vendimit të Bordit Mbikëqyrës të AKP-s) për heqjen e mbikëqyrjes, ndërmarrja ende nuk e ka filluar punën.

Ky rast studimor është edhe një argument se procesi i privatizimit nuk ka qenë efikas edhe në rastet e ndërmarrjeve dikur të suksesshme edhe në rastet kur pronarët e rinj i përmbushin obligimet kontraktuale, për shkak të mosfunksionimit të AKP. Prandaj, këto ndërmarrje nuk kanë kontribuar në ringjalljen ekonomike dhe zbutjen e problemeve sociale dhe të papunësisë në vend.

3.Ndërmarrja "LLamkos", Vushtrri

Kjo konsiderohet si ndërmarrja e parë e privatizuar përmes *spin-offi-it special* që ka dështuar. Kjo kompani ka pasur në disponim pronë në sipërfaqe prej mbi 18 hektarë dhe

objekte me sipërfaqe prej 40 mijë m². Veprimtaria ekonomike e saj ka qenë përpunimi i metaleve (bobina dhe llamarinë prej çeliku te galvanizuar). Prodhimet e saj kanë qenë të njohura dhe të çmuara edhe në tregun e jashtëm.

Ndërmarrja është privatizuar në korrik 2005 me një çmim prej 4.151 mijë Eu. Blerësi “Kremikovtzi AD” nga Bullgaria ka marrë për obligim të investojë 15 milionë Eu dhe të punësojë fillimisht 200 punëtorë e në vitin e dytë deri në 500 punëtorë.

Në periudhën dyvjeçare (të mbikëqyrjes), blerësi ka realizuar 1.545 mijë Eu. Investime ose 10 % të premtimeve, ndërsa ka punësuar 450 punëtorë ose 90% të numrit të zotuar. Për shkak të dështimit në investim dhe shkeljes së marrëveshjes, Bordi Mbikqyrës i AKP ka marrë vendim për ndëshkimin e pronarit me gjobë dhe tërheqjen e akcioneve. Ky veprim është ndërmarrur në janar 2009. Për shkak se pronari i ri ka hyrë në procesin e falimentimit, Ndërmarrja e Re “LLamkos” e ka ndërprerë prodhimin qysh në vitin 2008. Punëtorët nuk kanë marrë paga dhe Ndërmarrja e Re “LLamkos” është vënë në hipotekë nga pronari i ri duke e ngarkuar kështu këtë ndërmarrje me borgjë.

Pas procedurave të tërheqjes së akcioneve, Bordi i Drejtorëve të AKM asetet e “LLamkos Steel” sh.p.k. përmes procedurës së likuidimit ratifikon kontratën e shitjes në gusht 2011. Blerësi i ri “Coresteel” sh.p.k. mori për obligim të punësojë 437 punëtorë gjashtë muaj pas nënshkrimit të kontratës dhe të investojë 25 mil. Eu në dy vitet e para pas privatizimit.

Blerësi mori për obligim të zbatojë edhe dy faza investimesh. Pas fazës së parë mbrenda një viti e gjysmë të investoje edhe 45 mil. Eu dhe pas fazes së dytë në një vit e gjysmë të investoje edhe 30. mil. Eu. tjera. Pra, brenda pesë vitesh mori për obligim që të investojë 100 mil. Eu.

Meqenëse pronari i ri nuk ka ndërmarrë asnjë aktivitet, punëtorët janë larguar nga puna dhe prodhimi është ndërprerë, mbikqyrësi ka vendosë në janar 2015 ta ndëshkojë ndërmarrjen “LLamkos Galvasteel”. Pronari “Coresteel” sh.p.k. për shkak të borgjeve ndaj një kreditori në Mbretërinë e Bashkuar është futur në procedurë të falimentimit.

Departamenti ligjor i AKP ka përgatitur kërkesën kreditore për Ndërmarrjen “Coresteel” sh.p.k., në të cilën janë përfshirë gjobat ndëshkimore për fazën e parë, të dytë dhe të tretë. Administratori për likuidim ka njoftuar AKP se kërkesat janë refuzuar. Aktualisht Zyra Ligjore e AKP-së është duke përgatitur ankesë në këtë aktvendim të gjykatës.

Si përfundim që nga privatizimi i parë e deri me tani kjo ndërmarrje dikur profitabile është dalë jashtë funksionit, nuk prodhon, nuk punëson dhe nuk kontribuon në rritjen ekonomike dhe të mirëqenjes në vend. Pra është edhe një rast që ilustron se privatizimi në Kosovë e në veçanti privatizimet përmes spin-ofit special kanë dështuar, me pak përjashtime, dhe,

prandaj në vend që të ndihmojnë punësimin dhe mirëqenien, ish-të punësuarit kanë mbetë pa pune dhe një numër i tyre kanë nevojë për përkujdesje sociale.

3.3.0. Infrastruktura legale dhe institucionale e privatizimit

Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme (*Rregullorja 2001/9*) i rezervon të drejten dhe përgjegjësinë UNMIK-ut për të administruar pronën shoqërore, publike dhe shtetërore si dhe rregullimin e ndërmarrjeve publike dhe atyre shoqërore.

Me *Rezolutën 1244 të KS të OKB*, përveç tjerash përcaktohet mandati i UNMIK-ut për të ruajtur ligjin dhe rendin, dhe për të përkrahur rindërtimin ekonomik, në kuptim të një garantuesi e jo pronari të pronës publike dhe shoqërore.

Me këto kufizime, UNMIK-u nuk mund ta luajë rolin e ruajtësit të ligjit dhe të nxitesit të zhvillimit ekonomik, të marr masa për mbrojtjen e pasurisë nga plaçkitja dhe degradimi si dhe të sigurojë tërheqjen e kapitalit dhe investimeve nga jashtë.

AKM konstituohet si person juridik qe d.m.th. me të drejtë të plote juridike për përpilimin e kontratave, mbrojtje të pronësisë, të ngreh padi dhe të jetë e paditur. Sipas rregullores së përmendur kapitali fillestar i AKM-së ishte 10 milionë, të cilat para sigurohen nga Buxheti i Kosovës. Përgjegjësia e AKM-së nuk mund ta kalojë këtë vlerë dhe nuk mund të mbajë përgjegjësi për borxhet e ndërmarrjeve, të cilat janë nën administrimin e saj.

Me themelimin e AKM-së shuhen DTI dhe disa departamente tjera të UNMIK-ut, funksionet e të cilave i kalojnë AKM-se. Administrimi i ndërmarrjeve publike dhe shoqërore kalon te AKM nga departamentet e shuara, por funksioni i tyre i definimit dhe implementimit të politikave dhe rregullativave sektoriale nuk i kalojnë AKM-së.

Në bazë të **nenit 11.2** të *Kornizës Kushtetuese*, organet e pavarura e kanë autoritetin, obligimin dhe përbërjen e caktuar me instrumentet ligjore. Këto organe janë të pranuar nga Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse. Pra, AKM nuk është organ i institucioneve vendore, por vetëm i UNMIK-ut. Por, kush do të jete përgjegjes para ligjeve ndërkombëtare, në rast se AKM bën shkeljen e tyre, në rastet kur AKM nuk i përmbush

kriteret e shpronësimit, kritere këto të caktuara me rregullat ndërkombetare publike, kush do të jetë përgjegjes për dëmshpërblim? Në këtë rast UNMIK-u, që do të thotë OKB. Por, cili ligj e përcakton qartë përgjegjësinë e organizatave ndërkombëtare dhe si do të zgjidhet dilema e përgjegjësisë kur dihet se AKM është themeluar si institucion i pavarur në bazë të ***Kornizes Kushtetuese***.

Në bazë të strukturës drejtuese, AKM-në e përfaqëson Bordi i Drejtorëve, në përbërje të së cilës janë katër drejtorë ndërkombëtarë dhe katër drejtorë vendorë, pra një përbërje që nënkupton vendime të përbashketa vendore dhe ndërkombëtare.

Bordi i Drejtorëve është përgjegjes për veprimtarinë e AKM-së. Nga pjesa ndërkombëtare drejtorë janë *Shefi i Shtylles së IV* të UNMIK-ut për Rindërtim e Zhvillim, që sipas funksionit është zëvendës i PSSP-së, është njëherit Kryetar i Bordit, zëvendësi i tij, zëvendësi i PSSP-së për Administrim Civil dhe Drejtor Ekzekutiv i AKM-së. Nga grupi i drejtorëve vendorë, të cilët emërohen nga PSSP-ja janë tre ministra të Qeverisë së Kosovës, nga të cilët njëri i komunitetit serb dhe drejtori i katërt përfaqësuesi i Sindikatave të Pavararura të Kosoves (BSPK). Modeli është bashkë vendimmarrës, por me qëllim të sigurimit të kontrollit në rast të ndarjes së votave, kryesuesi i AKM-se kishte votën e dyfishtë (*votën e dytë*), edhe pse kjo asnjëherë nuk erdhi në shprehje për shkak se përfaqësuesi vendor nga komuniteti serb, gjithmonë ka mbajtur anën e pjesës ndërkombëtare të Bordit. Mandati i anëtarëve vendorë dhe drejtorit menaxhues ishte dyvjeçar, me mundësi të ripëritritjes nga ana e PSSP-së.

Bordi i Drejtorëve të AKM-së ka nxjerr Statusin dhe Rregulloret e punës (*politikat operationale*), si dhe strukturimin organizativ të AKM-së.

Në procesin e vendimmarrjes është vepruar sipas rregullave të përcaktuara të shumicës së anëtarëve prezent. Kuorumi është konsideruar nëse në mbledhje marrin pjesë pesë drejtor. Në raste kur Rregullorja e kërkon pjesëmarrjen në shumicën absolute, atëherë vendimi merret me pesë vota pro. Me punën e përditshme të AKM-së merret Drejtori Menaxhues, si: organizimi i mbledhjeve të Bordit, pranimi dhe shkarkimi i stafit, zbaton vendimet e Bordit dhe i përgjigjet vetëm Bordit. Bordi i përgjigjet PSSP-së, pra AKM-së, që sipas

kësaj rregulle është organ i UNMIK-ut. Bordi i AKM-së i raporon çdo tre muaj PSSP-së. Ky ka të drejtë të ndërrojë drejtoret në rast se ka arsye, por edhe të revokojë vendimet e Bordit, në rast se ato janë në kundërshtim me **Rezolutën e OKB-se**, ligjet në fuqi, ligjet e aplikueshme si dhe të caktojë auditorët e jashtëm për auditimin e AKM-së. Në rast të nevojës AKM-së, mund të ftojë policinë në ndihmë, mund të aplikojë gjopa për ndërmarrjet, apo individët që pengojnë apo keqpërdorin mjetet në dispozicion, dhe kjo do të jetë subjekt i procedurave administrative në rast të ankesave si dhe e sistemit gjygjësor. Në rast të padive eventuale ndaj AKM-së, paditë mund të paraqiten vetëm para Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, e specializuar për mospajtime ligjore administrative. Dhoma e Posaçme, e krijuar paralelisht me AKM me **Rreguloren 2002/13** për t'i mbrojtur minoritetet, ajo do të ketë në përbërje të saj tre Gjykatës ndërkombëtarë, njëri prej të cilave do të jetë kryesues.⁴² Sipas **Rregullores 2002/13**, Dhoma e Posaçme ka kompetencë ekskluzive mbi këto kategori padish, dhe vetëm në rast se e sheh të arsyeshme ajo lënden e caktuar mund ta dërgojë të ndonjë gjykate vendore. Në rast të ankesave në vendimet e gjykatave vendore, ankesat i adresohen Dhomës së Posaçme, pra ajo ka funksion të dyfishtë(*instance e parë dhe e fundit ligjore*). Dhoma ka gjithsej 5 gjykatës dhe vendimet mirren me tre vota pro. Themeluesit e AKM-së nuk e marrin mjaftueshem në konsiderim mundësinë e blerjes së pasurisë nga ana e Qeverisë së Serbisë⁴³.

Pra, nuk ekziston ndonjë rregullore, apo ndonjë dispozitë në ndonjë Rregullore që e parandalon këtë mundësi. Në anën tjetër, Qeveria e Kosovës, ndonjë institucion i saj apo Institucionet e Përkohshme dhe ato të Pushtetit Lokal në Kosovë, janë të përjashtuara nga e drejta e blerjes së aksioneve të kompanive të reja-korporatave.

⁴²Disa pikëpamje mbi Rregulloren: **"Mbi Krijimin e Agjensionit Kosovar të Mirëbesimit"**, Prezentim në Konferencën: **"Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore dhe reforma e ndërmarrjeve publike në Kosovë"**, Prishtinë, Qershor 2002.

⁴³KIPRED: Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe Privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore, Prishtinë, qershor 2005.

Një paradoks tjetër që nuk është kuptuar me kohë është fakti se mjetet e fituara nga shitja e aseteve të NSH-ve, nuk mund të përdoren për zhvillimin ekonomik të vendit, por do të ruhen në Fondin e Mirëbesimit për shlyerjen e kërkesave eventuale të ndonjë pretenduesi të pronës ndaj NSH-ve ose borgjeve të NSH-ve. Nëqoftëse kemi parasysh transaksionet dhe transformimet e bëra nga pushteti serb, në periudhën 1989-1999, atëherë rrezulton se kreditorë të vetëm mund të paraqiten kompani apo individë serbë, të cilën në periudhën e shënuar kanë përfituar nga ligjet diskriminuese dhe tani ata mund të përfitojnë dhe të kompenzohen nga mjetet e AKM-së, të ruajtura në Mirëbesim.⁴⁴

Vendimi që AKM-ja të qeverisë nën autoritetin e vet pronat e përcaktuara me ***Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/45*** mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, që përfshin të gjitha pronat komunale, pra tokat dhe ndërtesat në pronë komunale. Kjo nënkupton që AKM merr nën administrim të gjitha tokat dhe objektet komunale, dhe i përjashton komunat nga administrimi i tyre. Për më tepër, kjo rregullore i përjashton komunat nga kompetencat e planifikimit urban dhe hapësinor.⁴⁵

Një paradoks tjetër në organizimin institucional dhe ligjor është mënyra e organizimit të Dhomës së Posaçme. Edhe pse në kuadër të Gjykatës Supreme të Kosovës, ky institucion është i organizuar plotësisht si i veçantë, duke filluar prej sekretarisë, administratës por edhe rregullave procedurale të veçanta. Paradoksi qëndron në atë se për nga përmbajtja Dhoma e Posaçme është institucion ndërkombëtar, kurse Gjykata Supreme institucion vendor. Sipas kësaj, Kosova mund të konsiderohet përgjegjëse para ligjeve ndërkombëtare për veprimet e marra nga një institucion që është jashtë kompetencave të saj.

Sipas rregullores së UNMIK-ut 2002/12 ndërmarrjet e sapo formuara nga AKM-ja e gëzojnë të drejtën e shfrytëzimit të pronës, por jo edhe të drejtën e pronësisë.

Në një punim tjetër për diskutim për konferencën ndërkombëtare të përmendur më parë thuhet se *“Njëra ndër pyetjet e para që çdo investitor në botë shtron është: A posedon kompania me toka dhe objekte dhe në çfarë sigurie do të respektohen të drejtat e pronës, që*

⁴⁴Po aty.

⁴⁵KIPRED, Vepra e cituar, fq.13

unë marr”. Por, siç u tha me lart, toka dhe objektet e NSH-ve janë të paqarta për sa i përket pronësisë. Ky problem dukej se nuk do të gjente zgjidhje të shpejtë edhe pse UNMIK-u ofronte njëllë sigurie. Por, e drejta e shfrytëzimit nuk ju mundëson investitorëve tjetërsimin, apo shitjen e pronave personave të tretë, duke i vënë peng ato (*si hipoteke*) për kredi bankare, prandaj këto forma të shfrytëzimit janë të pavleshme për nevojat dhe kushtet e ekonomisë së tregut të lirë. Kjo konsiderohet si dekurajuese, sidomos për investitorët e huaj.

Statusi i pazgjidhur i Kosovës ishte pengesa kryesore që UNMIK-u nuk lejonte transformimin e pronës shoqërore në pronë private. Por, si zgjidhje garantuese, *Shtylla e IV-të* e UNMIK-ut bën reformimin ose ridefinimin e së drejtes së shfrytëzimit të pronës shoqërore duke e zgjeruar konceptin e shfrytëzimit në posedim, përdorim, tjetërsim për të drejten për venje në hipoteke në kohëzgjatje prej 99 vitesh, nga dita e miratimit të rregullores.⁴⁶

Pra, synimi është që të ridefinohet e drejta e përdorimit të pronës sa më afër të drejtës në pronë, ngjajshëm me dhënien e pronës me qira, por pa e bërë transformimin e vërtetë të pronës. Edhe pse vetëm në Kosovë, duke u bazuar në Rregullore të UNMIK-ut, vazhdonte të ekzistonte nocioni “pronë shoqërore”, derisa në të gjitha vendet e tjera të dala nga Ish-Jugosllavia me ligje dhe akte tjera, kjo formë e pronës ishte transformuar dhe nuk ekziston as si formë as si nocion.

Një çështje e hapur mbetet *tokat e Ndërmarrjeve Shoqërore* që nuk mund të korporatizohen por do t’i nënshtrohen drejtperdrejt procesit të likuidimit. Këto pasuri prap nuk do të ketë mundësi të shfrytëzojnë mënyren e modifikuar të përdorimit, pastaj komunitat edhe me këtë rregullore lihen jashtë procesit të administrimit të pronave të paluajtshme shoqërore. Dhe se fundmi kjo rregullore nuk e zgjidh problemin e dëmshperblimit të pronareve të shpronësuar me ligje diskriminuese të pushtetit komunist, të cilëve pronat iu janë nacionalizuar, apo

⁴⁶Oliver Campbell Ehite: *“Faktoret e suksesit apo dështimit të privatizimit të NSH-ve në Kosovë”*, Riinvest, qershor 2002, fq.115.

konfiskuar pa konpenzim apo demshpërblim. Moszgjidhja e këtij problemi sikur legalizon veprimet e paligjshme të shtetit komunist.

Këto çështje të zgjidhura, si dhe ato të pazgjidhura me këto rregullore të UNMIK-ut bijnë në kundërshtim me **Rezoluten 1244** të KS të OKB, në të cilën garantohet shkalla e lartë e vetëvendosjes ekonomike, që nënkupton si dhe nga kush do të shfrytëzohen burimet ekonomike të vendit. Mirëpo, këtë të drejtë nuk e shfrytëzuan Institucionet Vetëqeverisëse të Kosovës, për shkak të mosbashkëpunimit ndërmjet subjekteve politike për çështje të ndryshme, e në këtë rast edhe rreth problemit të privatizimit dhe statusit të pronës.⁴⁷

Vendimet e Dhomës së Posaçme merren me së paku votat e tre gjykatësve. Kjo Dhomë e Posaçme mund të merr vendim edhe pa zhvillim seance nëse nuk ka nevojë për kompenzim, dhe nëse Dhoma vlerëson se nuk ka fakte të mjaftueshme për ta zgjidh lëndën.

Nëse ia bëjmë një shikim përberjes së Dhomës së Posaçme lehtësisht mund të nxjerret përfundimi i dominimit absolut të gjykatësve ndërkombëtare mbi ata vendorë në përbërjen e kësaj Dhome, ku kjo gjë sanksionohet me Ligjin mbi Dhomën e Posaçme. Me Rregulloren mbi Procedurat e Dhomës së Posaçme parashiet formimi i një administrate terësisht të ndarë nga ajo e Gjykatës Supreme, pra Dhoma e Posaçme ka Sekretarinë dhe sekretarin e veçantë. Sekretari, sipas kësaj rregulloreje duhet të jetë ndërkombëtar. Rregullat e veçanta, sekretaria e veçantë dhe sekretari i veçantë i Dhomës së Posaçme e bëjnë këtë Dhomë një "Gjykatë të Posaçme Ndërkombëtare", e cila vetëm formalisht është e lidhur me Gjykatën Supreme të Kosovës.

Kjo formë e organizimit të Dhomës së Posaçme mbart me vete njëparadoks, por edhe një rrezik për Institucionet e Kosovës. Në njërin anë, formalisht ky institucion iu është bashkangjitur institucioneve vendore, por në anën tjetër, veprimet e kësaj Dhome janë jashtë kontrollit dhe ndikimit të institucioneve kosovare. Sipas këtij organizimi vendimet i marrin gjyqtarët ndërkombëtarë, ndërsa përgjegjësinë për zbatimin e këtyre vendimeve e marrin institucionet kosovare. Për rrjedhojë të krejt kësaj, si rezultat, Kosova mund të përgjigjet

⁴⁷KIPRED, Vepra e cituar,

për veprime, të cilat nuk ishin në kompetencën dhe ndikimin e saj edhe para ligjit ndërkombëtar (*pas shpalljes së pavarësisë*).⁴⁸

Pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës, më 15 qershor 2008, ligje të zbatueshme në territorin e Kosovës konsiderohen ato ligje, që janë miratuar në Kuvendin e Kosovës, e më të cilat paraprakisht janë ndryshuar dhe zëvendësuar të gjitha rregulloret e UNMIK-ut. Njëra ndër këto ligje është Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përmes të cilit ligj themelohet Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) si pasuese e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM), e cila merr të gjitha përgjegjësitë duke përfshirë këtu edhe përfaqesimin e rasteve pranë Dhomës së Posaçme.

Por, në krejt këtë proces ndryshimi, transformii kompetencash e përgjegjësish, ndodh diçka e pakuptimtë dhe konfuze. Sipas Vendimit të Dhomës së Posaçme (Nr.ASC-09-0089) ky institucion nuk e njeh Ligjin për **Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP)** duke e konsideruar se: *“Ligji i vetëm i zbatueshëm në Kosovë janë Rregulloret e UNMIK-ut, të cilat nuk mund të shfuqizohen nga Kuvendi i Kosovës”*. Pra, siç shihet nga përmbajtja e këtij Vendimi, Dhoma e Posaçme nuk e njeh AKP si subjekt juridik madje as si palë. Gjykata Supreme e Kosovës (GJSK), në kuadër të së cilës funksionon Dhoma e Posaçme ka konstatuar se me këtë veprim Dhoma e Posaçme bën shkeljen e Kushtetutës së Kosovës, meqenëse nuk i njeh ligjet e nxjerra nga Kuvendi i Kosovës, rrjedhimisht injoron ekzistimin e Kosovës si shtet i pavarur. Ky veprim i Dhomës së Posaçme bie në kundërshtim edhe me Ligjin e Procedurës Kontestimore, meqenëse shkelet parimi bazë i mundësisë së deklarimit të paleve në kontest.

Injorimi i veprimeve të Dhomës së Posaçme i ka sjell dëme të shumëfishta procesit të privatizimit në tërësi, dhe si pasojë këto dëme janë thuajse të pariparueshme. Ndër

⁴⁸ Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave: “Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe Privatizimi i Pronës Shoqërore”, Prishtinë, qershor 2005.

vendimet që sollën pasoja janë: *Vendimet e Dhomës se Posaçme lidhur me Trepçen, pastaj lidhur me Fondin e Privatizimit, rastin e Fabrikës së Tubave etj.*⁴⁹

Meqenëse procedurat që udhëhiqen për shitjen e aksioneve të një ndërmarrjeje janë të përshkruara vetëm në “Rregullat e tenderimit”, sipas të cilave Bordi i Agjencisë së Mirëbesimit mund të shtyejë apo të anulojë tenderin në çfarëdo kohe dhe për çfarëdo arsyeje sipas vullnetit të saj, Dhoma e Posaçme ka ndryshuar qëndrimet lidhur me këtë rregull. Fillimisht, Dhoma i lejonte Agjencisë së Mirëbesimit zgjedhje të gjërë për të anuluar tendere. Pastaj, Dhoma ndryshoi qëndrimin dhe kërkoi që Agjencia të veprojë në mënyrë të drejtë. Dhe në fund, Dhoma e klasifikon Agjencinë e Mirëbesimit si *organ administrativ*, ndërsa anulimin e një tenderi si një *vendim administrativ, që duhet të i përmbushë kërkesat e Ligjit mbi Procedurën Administrative*.⁵⁰

Në rast kur një ndërmarrje nuk mund t’i përmbush obligimet e veta për gjashtë muaj dhe kur obligimet tejkalojnë vlerën e pasurisë së saj, atëherë Agjencia mund të aplikojë riorganizimin e asaj ndërmarrjeje. Në këso raste, Dhoma e Posaçme urdhëron procedurat e riorganizimit, pra merret “*Vendimi për Moratorium*”. Me këtë vendim synohet që ndërmarrja të mbrohet nga kreditorët, me ç’rast gjatë periudhës së *moratoriumit* suspendohen të gjitha veprimet, dhe për çfarëdo kërkesë kundër ndërmarrjes dhe pasurisë së saj dhe mund të fillohet vetëm me pëlqimin e Dhomës. Kur një ndërmarrje vendoset nën *Administrim të Veçantë*, Dhoma e Posaçme e emëron administratorin, i cili duhet të jetë i pavarur, pra ky administrator i përkohshëm, ka pushtet për të drejtuar me ndërmarrjen, edhe pse në disa raste duhet të kërkojë miratimin e Agjencisë apo të Dhomës.

Dhoma rol të posaçëm i ka caktuar vetes edhe lidhur me miratimin e planit për riorganizimin e ndërmarrjeve. Me këtë rast, të gjitha paditë kundër Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH) dhe obligimet e tyre riformulohen dhe qeverisen sipas planit të miratuar

⁴⁹Një Studim lidhur me Konfliktin Ligjor lidhur me privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore e gjejmë të përgatitur nga Instituti “GAP”, me autor Dr.Haxhi Gashi, ass.Profesor i së Drejtes Civile/Pronësore në Fak.Juridik të UP.

⁵⁰OSBE-Departamenti i Monitorimit: “*Shqyrtimi Juridik i çështjeve të AKM nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme*”, maj 2008.

paraprkisht. Edhe përkunder rolit të theksuar të Dhomës, administratori i një ndërmarrjeje mund të refuzojë që të bejë vlerësimin e tyre përfundimtar. Pas sistemimit të ankesave dhe padive nga ana e Administratorit, Dhoma e Posaçme i shqyrton dhe trajton ato sipas prioritetit. Pas miratimit të procedurave nga Dhoma dhe konfirmimit të riorganizimit të ndërmarrjes, të gjitha, para riorganizimit, fshihen automatikisht bashkë me kërkesat e ndërmarrjes. Me këtë, ndërmarrja konsiderohet e rimëkembur dhe mund të punojë pa kufizime apo vazhdim mbikëqyrjeje.

Procedurat e shqyrtimit të ankesave në Dhomën e Posaçme janë specifike. Në rast të parashtrimit të ankesës te Dhoma e Posaçme, Kryetari i Trupit Gjykses cakton gjyqtarin raportues, i cili vlerëson rregullshmërinë formale të ankesës. Ky, pas analizës së lëndës vlerëson nëse duhet proceduar me tutje; në rast se lënda është complete vazhdohet me procedure, duke ia dorëzuar atë të paditurit. Në rast të kundërt, trupi gjykses e vlerëson lëndën si të papranueshme. Sa i përket formulimit të vendimeve, duhet nënvizuar faktin se në këtë proces, gjuha angleze ka prioritet kundrejt dy gjuhëve tjera zyrtare që aplikohen në Kosovë; gjuhës shqipe dhe asaj serbe.

*Nëse një ankesë bëhet vetëm në gjuhën angleze, ajo konsiderohet e kompletuar, por në rast se një ankesë është bërë në gjuhën shqipe ajo nga gjyqtari raportues do të konsiderohet e pakompetencë, dhe si e tillë do të refuzohet.*⁵¹

Element tjetër që duhet theksuar është fakti se deri vonë nuk është mundësuar që AKM të shqyrtojë listen e punonjësve, ndërsa as keta nuk kanë mundur të parashtrojnë ankesa te Dhoma e Posaçme. Prej vitit 2006 e këndej, me nxjerrjen e një *Urdhërese Administrative* (Nr.2006/17), AKM-së i jepet kompetencë të publikojë dhe të korrigjojë listat e punëtorëve, të cilat lista mëpastaj, nëse ka ankesa, shqyrtohen nga Dhoma e Posaçme si instancë e shkallës së dytë.

⁵¹ Lidhur me procedurat e Dhomës së Posaçme shih: **OSBE, Departamenti i Monitorimit: Privatizimi në Kosovë, maj 2008.**

Po ashtu, në rastet kur Dhoma e Posaçme i referon rastet tek gjykatat e rregullta, Dhoma mban të drejten e shqyrtimit të ankesave si shkallë e dytë.

Siç është vërejtur në bazë të analizës së akteve ligjore që janë në fuqi, por edhe të përvojës praktike, në shumicën e rasteve në vendimet e Dhomës së Posaçme nuk ka mundësi të ankesës. Themelimi i të drejtës së ankesës ndaj aktgjykimeve të Dhomës së Posaçme është mundësuar vetëm pas shpalljes së pavarësisë.

Një çështje tjetër që ka qenë shqetësuese për mbarrëvajtjen e punëve në Dhomën e Posaçme është edhe ngarkesa me funksione të shumëfishta të gjyqtarëve të kësaj Dhome. Kështu, në shumë raste, një gjykatës ngarkohej me shqyrtimin e padisë, për të cilën vendos se është apo nuk është e kompletuar, pra si gjyqtar raportues. Në fazën tjetër të shqyrtimit të lëndës, po i njëjti gjyqtar, është pjesë e trupit gjykues kur lënda i përcillet gjykatës së rregullt dhe në fund, po i njëjti gjyqtar, mund të jetë edhe në panelin shqyrtues në rishqyrtimin e të njëjtit rast.

Prandaj, përveç kësaj, është evidente se vonesat në procedurat e gjykimit, gabimet administrative dhe dobësi të tjera të natyrave të ndryshme, e kanë karakterizuar punën e Dhomës së Posaçme në periudhën kohore që është objekt shqyrtimi në këtë punim.

3.4.0. Procesi i privatizimit nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) deri në Qershor 2008

Që nga maji i vitit 2003 e deri në qershor të vitit 2008 Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKM) ka realizuar 30 raunde (vale) të privatizimit, përmes së cilave janë shitur

gjithsej **498** ndërmarrje të reja, të krijuara nga 313 Ndërmarrje Shoqërore. Ndërsa, të hyrat e gjeneruara nga ky proces i privatizimit janë 392.280.728 EU⁵², që paraqet 11.5% të GDP.

Nga 137 Ndërmarrje Shoqërore (pronarë të tokës bujqësore) në këtë periudhë janë privatizuar 112 ndërmarrje në 27 valë të privatizimit. Këto ndërmarrje kanë poseduar 23 930 hektarë (ha) ose 52% të sipërfaqes së tokës bujqësore në pronësi shoqërore. Nga të hyrat e këtyre shitjeve janë inkasuar 93,113,674 Eu, që i bie se mesatarisht një hektar tokë bujqësore është shitë për afërsisht 4000 Eu (katërmijë euro). Sipas Raportit të Punës së AKP-së : *“Çmimet e shitjes së parcelave deri në 5 ha ishin shumëfish më të larta se sa çmimet e parcelave të mëdha (ato mbi 2500 hektarë) të cilat janë shitë për më pak se 2 000 eu për hektar”*.

Ndërsa, obligimet për investime në ndërmarrjet e privatizuara përmes *Spin-ofit special* kapin shumën prej 191.3 milionë euro dhe obligimi për punësim të përafërsisht 8000 (tetë mijë) personave.

Në këtë periudhë, paralelisht me privatizimin e ndërmarrjeve të reja ka vazhduar edhe procesi i likuidimit të ndërmarrjeve të vjetra. Në periudhën shqyrtuese në proces të likuidimit kanë qenë 114 ndërmarrje .

Nëse rikapitullojmë grumbullimin financiar, atëherë konkludojmë se, të marra së bashku nga procesi i privatizimit në këtë periudhë janë realizuar rreth gjysmë miliardi euro të hyra, të cilat mbahen të ngujuara në Fondin e Mirëbesimit. Këto mjete financiare janë nxjerrë nga qarkullimi dhe si të tilla janë jashtë funksionit, pra jashtë shfrytëzimit të tyre nga ekonomia e vendit.

Sipas një ankete të realizuar me 101 ndërmarrje të privatizuara në këtë periudhë⁵³ 70% e këtyre ndërmarrjeve të privatizuara ishin aktive, ndërsa 30% joaktive. Po simbas të njëjtin hulumtim, 21% janë mikro-ndërmarrje, 42% ndërmarrje të vogla, 28 % ndërmarrje të mesme, dhe vetëm 4% ndërmarrje të mëdha.

⁵²Agjencia Kosovare e Privatizimit; *Raporti i punës*, (gusht 2008-gusht 2009).

⁵³Dervisholli-Berisha, Afërdita: *“Pas privatizimi dhe performancat e ndërmarrjeve në Kosovë”*, RIINVEST, Prishtinë 2012.

Gjysma e këtyre ndërmarrjeve janë regjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Pas privatizimit, 10% e këtyre ndërmarrjeve janë shitur ose e kanë ndërruar pronarin, ndërsa 11% u janë dhënë me qira personave të tretë.

Struktura sektoriale e këtyre ndërmarrjeve është si në vijim: ndërmarrjet prodhuese dhe ndërtimore nga 25%, shërbimet marrin pjesë me 22%, ndërsa lëmitë tjera 28%.

Për shkak të zhvillimeve të shumta jo të favorshme, edhe sot, ndërmarrjet joaktive ballafaqohen me probleme të shumta, ndër të cilat më te theksuara janë: uzurpimet, kapacitetet e limituara financiare të pronarëve të rinj dhe pamundësia e pronarëve të rinj për bartjen e pronësisë për shkaqe objektive, ku për pasojë nuk mund të marrin leje ndërtimi apo leje pune. Po ashtu, ndër problemet më të shpeshta dhe të pakuptimta janë: pengesat në ratifikimin e kontratës, borgjet e ndërmarrjes ndaj Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), regjistrimi i pronës në shërbimin katastral, borgjet për shpenzimet e energjisë në të kaluarën. Nga informacionet e marra nga pronarët e rinj del se përgatitja e pronave për privatizim nuk ka qenë në nivelin e duhur ngase pas privatizimit ka rezultuar se shumë pjesë të pronave të privatizuara kanë qenë pronë e huaj, ose pjesë të caktuara të objekteve të blera kanë qenë jashtë pronës së blerë.

Në këto rrethana, duhet theksuar se çështje tjetër me interes në procesin e privatizimit është edhe trajtimi i aspektit social të ish-punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore. Siç dihet deri në suspendimin me dhunë të autonomisë së Kosovës dhe okupimit klasik nga ana e Serbisë ('89-'90) në këto ndërmarrje kanë qenë të punësuar rreth 232 mijë persona. Por, me futjen e masave të dhunshme në ndërmarrjet e Kosovës, si dhe me emërimin e drejtoreve dhe menaxherëve nga qeveria e Serbisë, numri i të punësuarve u reduktua në 60 mijë persona. Pas përfundimit të luftës dhe vendosjes së Administratës Ndërkombëtare në Kosovë, nuk u riparian të drejtat e tjetërsuara nga pushteti serb. Pra, punëtorët edhe në rrethana të reja politico-shoqërore, mbetën jashtë mundësisë së përfitimit për kontributin që kanë dhënë këta punonjës në të kaluarën për ngritjen e këtyre ndërmarrjeve. Në bazë të Rregullorës së UNMIK-ut mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundëshme në Pronësi Shoqërore, punëtorëve të punësuar në ndërmarrjet shoqërore të privatizuara të cilët

kanë marrë pagë në tri vitet e fundit iu mundësohet të marrin 20% nga vlera e shitjes së ndërmarrjes. Listën e përpilon organi perfaqësues i punëtorve në bashkëpunim me Bashkimin e Sindikatave. Lista e këtyre punonjësve i dërgohet Dhomës së Posaçme, e cila pas shqyrtimit edhe të ankesave eventuale, i rekomandon Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) ndarjen e 20%, shumë kjo e cila vendoset në një llogari të garantuar dhe më pas u ndahet punëtorëve nga sindikata.

Në bazë të të dhënave të Raportit të Punës së AKP-së deri në qershor të vitit 2008 në këtë fond janë ndarë 76 milionë euro, por shumica, e cila u është shpërndarë punëtorëve figuron të jetë shumë më e vogël, vetëm 15,5 milionë euro.

3.4.1.Administrimi i drejtëpërdrejtë i ndërmarrjeve shoqërore

Administrimi i ndërmarrjeve shoqërore është kompetencë e AKM-së pa marrë parasysh nëse këto ndërmarrje janë transformuar apo jo. Vendosja e ndërmarrjeve nën administrim të drejtëpërdrejtë është bërë për arsye të keqpërdorimeve financiare, keqmenaxhimit dhe shpërdorimit nga ana e menaxhmentit të vetëemruar dhe të kontesteve ligjore. Vendimin për vënie nën *administrim të drejtëpërdrejtë* e merr Bordi i Drejtorëve dhe arsyetohet me përgatitjen e ndërmarrjes për privatizim, të mbrojtjes së aseteve nga keqpërdorimi, eliminimin e problemeve të ndërmarrjes, rritjen e të ardhurave dhe zvoglimin e shpenzimeve të tepërta. Në periudhën e analizuar për nevojat e këtij punimi, këtë status e kanë marrë 10 (dhjetë) ndërmarrje shoqërore dhe Kompleksi Metalurgjik “Trepça”. Ky kompleks, pra “Trepça”, qysh në vitin 1992 ishte shdërruar në shoqëri aksionare (sh.a). Pas këtij transformimi, pushteti serb i asokohshëm ngarkoi “Trepçën” me borje dhe kredi nga jashtë. Këto kredi në fakt nuk janë investuar në “Trepçë” dhe as nuk janë marrë me qëllim të përtrirjes së paisjeve dhe teknologjisë së kësaj ndërmarrjeje, mirëpo edhe përkundër këtij fakti, pas luftës, shumë nga këta “kreditorë” e kanë paditur “Trepçën” duke paraqitur kërkesa të pabazuara ndaj saj. Në këto rrethana, UNMIK-u përmes një Rregulloreje mundëson emërimin e një administratori për “Trepçën”, i cili kishte kompetencë për

riorganizimin dhe menaxhimin e plotë të saj. Megjithkëtë, deri në vitin 2006 nuk është berë asnjë levizje në këtë drejtim.

Në ndërkohë, Dhoma e Posaçme, me një vendim të saj për moratorium, përmes të cilit ngrihen të gjitha vendimet e gjykatave jashtë Kosove, sikur krijohet një siguri për asetet e “Trepçes. Por, edhe përkundër këtij vendimi, vonesat në caktimin e Administratorit, mungesa e riorganizimit dhe ristrukturimit të saj, kanë ndikuar dukshëm në degradimin dhe zhvlerësimin e aseteve të këtij gjiganti dikur profitabil.

Përtej çdo paragjykimi dhe insinuate, ka indikacione se këto veprime kanë qenë të qëllimshme, dhe, në një mënyrë ose tjetrën, të ndikuara nga qendra të huaja politike, e me gjasë të nxitura nga Beogradi.

Përgjatë kësaj periudhe, përveç humbjeve nga pasivizimi dhe ndërprerja e prodhimit, humbja e tregjeve, degradimi i minierave nga mungesa e mirëmbajtjes dhe amortizimi i tyre fizik, Kosovës dhe ekonomisë së saj, i është shkaktuar dëm i madh si rezultat i ndërprerjes së prodhimit. Po ashtu, gjatë kësaj kohe, në tregun ndërkombëtar ka pasë kërkesa për metalet me ngjyrë, dhe çmimi i tyre ka qenë shumë i volitshëm.

Prandaj, për fat të keq, në vend seky potencial të shërbejë për rritjen ekonomike dhe rritjen e eksportit, “Trepça” ende vazhdon të jetë barrë për Buxhetin e Kosovës dhe vazhdon të subvencionohet për çdo vit.

Ndërmarrjet, të cilat deri në vitin 1999 ishin në përberje të Kompleksit “Trepça”, pas lufte janë regjistruar si ndërmarrje të pavarura dhe më pas iu janë nënshtruar procesit të privatizimit.

3.4.2.Likuidimi

Nga gjysma e dytë e vitit 2005 e deri në fund të mandatit të vet (*qershor 2008*),AKM ka filluar procedurat e likuidimit të 120 ndërmarrjeve. Për një veprim të tillë AKM kishte mandat të fituar në bazë të dispozitavete Ligjit nr.03/L-067 dhe rregulloresse UNMIKU-t (Nr.2005/48). Për realizimin e këtij mandati kërkohet formimi i Komisioneve të Likuidimit

.Me qëllim të mbështetjes së Komisioneve të Likuidimit, dhe për koordinimin e aktiviteteve të Departamenteve të privatizimit dhe të Njësisë së Likuidimit, formohet Komiteti Drejtues Rajonal i Likuidimit. Ky Komitet nuk kishte politika dhe procedura unike për procesin e likuidimit, por kryente detyrat e ditës duke u mbështetur në dispozitat e ligjit në fuqi dhe në politikat operationale të AKM-së. Aktet ligjore, të cekura më parë, kanë përcaktuar procedurat e riorganizimit dhe likuidimit të ndërmarrjeve dhe pasurisë së tyre. Për ndërmarrjet nën autorizimin e AKM-së, të cilat ishin duke u likuiduar për shkak të vështirësive afariste dhe mbingarkesës me borxhe, me qëllim të riorganizimit dhe kthimit të qëndrueshmërisë së tyre financiare, në interes të kreditorëve, pronarëve dhe palëve tjera të interesuara, Dhoma e Posaçme i filloi procedurat e riorganizimit. Pas *Planit të Riorganizimit*, administratori, i cili ishte emëruar në atë ndërmarrje nga UNMIK-u, përgatiti një raport përfundimtar, të cilin ia paraqet Dhomës së Posaçme. Ky raport përmban historinë e aktiviteteve për periudhën qyshkur Dhoma e Posaçme pati vendosur Planin për Riorganizim. Pas përmbylljes së aktiviteteve, sipas Planit të Veprimit, konsiderohet se ndërmarrja është aftësuar dhe ajo mund të vazhdojë aktivitetin e sajë afarist pa mbikqyrje nga ana e AKM-së.

Ndërsa në anën tjetër, për ato ndërmarrje, të cilat Plani i Veprimit ka qenë i pasuksesshëm, gjykata vendosi për fillimin e procedurës së likuidimit. Procedurat e likuidimit fillojnë edhe për ndërmarrjet e vjetra të mbetura nga riorganizimi i ndërmarrjes dhe ndarja e pjesës së shendoshë që formonte një ndërmarrje të re pa obligime dhe ngarkesa dhe e cila tenderohej në njerën nga valët e shumta të privatizimit.

Në bazë të ligjit në fuqi, ekzistonte edhe mundësia e likuidimit vullnetar. Kjo formë e likuidimit aplikohet për ndërmarrjet me veprimtari afariste të dobët, me obligime të pashlyera dhe pa perspektivë të qartë për të ardhmen e saj. Natyrisht, likuidimi është lejuar kur ka qenë në interes të ruajtjes së pronës, vlerës së asaj ndërmarrje, si dhe pretendimeve të kreditorëve.

Procedurat e likuidimit i udhëhiqte Komisioni i cili emërohej nga AKM-ja. Në secilin komision patjetër caktohej një ndërkombëtar. Sipas rregullave në procedurat e likuidimit

ishin të parapara prioritetet sipas një renditjeje. Në këtë mënyrë, përfundimi i procedurës së likuidimit konsiderohet i përmbyllur vetëm pasi të jetë shperndarë i tërë fondi nga shitja e pasurisë së ndërmarrjes së likuiduar. Krejt në fund, Komisioni i Likuidimit dorëzon *Raportin Përfundimtar* për përfundimin e procedurave të likuidimit, dhe më pas ky proces konsiderohet si i mbyllur, qoftë funksionimi apo edhe kërkesat e reja ndaj ndërmarrjes së likuiduar.

Bazuar në Raportin e Punës së AKP-së⁵⁴, Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit (AKM) kishte filluar procedurat e Likuidimit të 120 ndërmarrjeve. Deri në qershor të vitit 2008, kishte realizuar likuidimin e 36 ndërmarrjeve, ndërsa për 70 ndërmarrje tjera, kontratat e tëcilave në ditën e përmbylljes së mandatit të AKM-së ishin të gatshme për nënshkrim, ishin bërë përgatitjet e duhura për këtë proces .Mjetet e fituara nga shitja e ndërmarrjeve përmes likuidimit kapin shumën e 4.293 mijë euro (*këtu është fjala për 36 ndërmarrje, kontrata e shitjes së të cilave është nënshkruar*). Këto para nuk u derdhën në Fondin e Mirëbesimit, dhe me gjasë ky ishte shkak i veprimit të ngadalshëm të Dhomës së Posaçme .Në Raportin e AKP-së(*të cituar më lart*)/ vleresohet se: “...shkak i tejzgjatjes se procedurave të likuidimit janë aktet ligjore në fuqi, të cilat në hartën e afateve kohore të likuidimit parashihnin procedura që zgjasin mesatarisht 19 muaj”.

Si përmbledhje e veprimtarisë së AKM-së në sferën e privatizimit do të shfrytëzojmë pasqyrën e Raportit të AKP-s

	Spin-of i rregullt		Spin-of special		Likuidim	
	Nr.nd.	Vlera	Nr.nd.	Vlera	Nr	Vlera
Kontr. e nenshk.	394	260 646 958	24	91 723 945	36	4 293 164
Kontr. në pritje	77	34 478 440	2	4 258 000	70	14 189 134

(Burimi:Rapori i AKP-së)

⁵⁴ Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP):“Raport pune”, (gusht 2008-gusht 2009).

Nga pasqyra shifet se në mandatin e AKM-s nga shitja e aseteve të ndërmarrjeve janë realizuarj 352 370 903 Euro *(për të dy format e Spinof-it) dhe nga likuidimi janë realizuar mjete në vlerë prej 4 293 164 Euro*. Por, shiquar objektivisht procedurat e privatizimit kishin përfunduar edhe për 77 ndërmarrje tjera, kontratat e të cilave në momentin e përfundimit të mandatit të AKM-s ishin të gatshme për nënshkrim.

Aspekte të tjera të punës dhe funksionimit të AKM-së, duke përfshirë këtu edhe mënyren e dorëzimit të mandatit në qershor 2008, do të jenë objekt i vlerësimit në pjesën e përfundimit të këtij punimi.

3.4.3.Kompenzimet për ish të punësuarit

Tëdrejtat e punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore që privatizohen përmes AKM-s janë të përcaktuara në Rregulloren Mbi transformimin e së Drejtës për përdorimin e pronës së patundëshme në pronësi shoqërore **(Nr.2003/13)**. Në bazë të kësaj rregulloreje, punëtorëve të punësuar në ndërmarrje shoqërore i takon e drejta për pjesëmarrje në 20% të shumës së shitjes së aseteve të asaj ndërmarrjeje. Përfaqësuesit e punëtorëve të ndërmarrjes në bashkëpunim me Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) hartojnë listën e punëtorëve të cilët e gëzojnë këtë të drejtë. Te drejtën e shfrytëzimit të 20% e kanë punëtorët e punësuar në atë ndërmarrje në momentin e privatizimit, dhe nese në atë ndërmarrje kanë punuar jo më pak se tre vjet. Lista e punëtorëve, e përpiluar nga organi përfaqësues i punëtorëve dhe Sindikata, i dërgohet Dhomës së Posaçme. Pas shqyrtimit të listës nga ana e AKM-së është e drejtë e punëtorëve të paraqesin ankesë te Dhoma e Posaçme, poqëse e konsiderojnë se në këtë proces janë diskriminuar. Pas përfundimit ligjor të të gjithë procedurës së defimit të listave, shuma ligjore e paraparë për shpërndarje për punëtorët, vihet në dispozicion në një llogari të garantuar të Sindikatave, të cilat mëpastaj e bëjnë shpërndarjen e tyre.

Mjetet e destinuar për kompenzimin e punëtorve ndahen në bazë të këtij rregulli: 75% e totalit të mjeteve iu ndahen linearisht të gjithë punëtorëve, ndërsa pjesa tjetër (*prej 25%*) iu ndahet punëtorve në bazë të viteve të punës në atë ndërmarrje.

Nga shuma e tërësishme e parave të fituara nga shitja e aseteve nga AKM , për periudhën që po flasim, punëtorëve iu takuan 70 474 180 Euro. Por, shpërndarja e kesaj shume ecte tepër ngadalë, dhe në bazë të statistikave, deri në fund të mandatit të AKM-së janë shpërndarë vetëm 15 milionë e pesëqindmijë Euro. Kjo vonesë i adresohet punës se ngathët të Dhomës së Posaçme në procedimin e listave përfundimtare. Ndërsa, komente të ndryshme me tone kritike që vijnë nga Sindikatat dhe organet tjera përfaqësuese të punëtorëve,shkakun e vonesës e adresojnë të Organet e UNMIK-ut, të mandatuara për procesin e privatizimit, e sidomos te ndikimi i faktorit serb në këtë proces. Në fakt, problemi i përfshirjes së punëtorëve serbë në lista komplikohet tej mase, për shkak se ata nuk e përmbushnin kriterin e të qenunit në punë në tri vitet e fundit para privatizimit .Këtu, është fjala për ata punëtorë serbë, të cilët deri në përfundim të luftës kishin punuar në këto ndërmarrje.

KAPITULLI IV: EFEKTET EKONOMIKE TE PRIVATIZIMIT NGA AKM NË PERIUDHËN E UNMIK-ut

Mendimi akademik dhe argumentimi teorik favorizonin privatizimin për shkak të superioritetit të dëshmuar të firmave të privatizuara në performancë më të mirë në krahasim me ndërmarrjet shtetërore (shoqërore). Kjo performance bazohet në kriterin e produktivitetit, punësimit, investimeve, gjetjen e tregjeve të reja dhe profitabilitetin e ndërmarrjeve të privatizuara.

Nga aspekti makroekonomik, rristurimi dhe privatizimi konsiderohen faktor i rëndësishëm i rritjes ekonomike. Rritja e sektorit privat kushtëzohet nga krijimi i rrethanave të favorshme biznesore, të cilat nga ana tjetër përcaktohen nga stabiliteti politik, ekonomik, liberalizimi i tregut, siguria, sundimi i ligjit, luftimi i krimit dhe korrupsionit.

Çështje tjetër, që shtron dhe e shtjellon literatura që përshkruan këtë tranzicion, është alternativa në mes të privatizimit dhe ndërmarrjeve të reja. *“Dallimi në mes të performancës së ndërmarrjeve shoqërore dhe ndërmarrjeve të privatizuara nuk është statistikisht i rëndësishëm, ndërsa performanca e ndërmarrjeve de novo është më e mirë se sa e ndërmarrjeve të privatizuara”*⁵⁵

Një aspekt tjetër, i cili duhet trajtuar me qëllim të nxjerrjes sa më reale të përfundimit lidhur me efektet e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, lidhet me faktin që ndërmarrjet shoqërore, dhe në përgjithësi sektori publik qëllim kryesor e kishin hapjen e një numri sa më të madh të vendeve të punës, pa marrë parasysh nevojën për një punësim të asaj përmase. Pas privatizimit, është e kuptueshme që pronari i ri do të mbajë në marrëdhënie pune aq punëtorë sa ka nevojë dhe nuk shqetësohet për zgjidhjen e problemit të papunësisë në nivel vendi.

⁵⁵ “Privatizimi dhe post-privatizimi në Kosovë: Një gotë gjysmë bosh apo gjysmë e plotë?”; *Raport studimor*, Forum 2015, shtator 2008, Prishtinë.

Përveç kësaj, një faktor tjetër është ndikimi i ndërrimit të menaxherëve me rastin e privatizimit në efektivitetin e ndërmarrjeve. Analizat e deritanishme kanë treguar se ndërrimi i menaxherëve ka ndikuar pozitivisht në rritjen e efikasitetit të ndërmarrjeve të privatizuara.

Si pasojë e mungesës së të dhënave ekonomike, vlerësimet për ecuritë ekonomike e nevojë për makroekonominë, nuk mund të konsiderohen të plota dhe mjaft të besueshme. Kjo për shkak të moskonsolidimit të statistikave në vitet e para të pas luftës. Një gjë e tillë, ka shkaktuar edhe korrigjimin e shpeshtë të analizave dhe vlerësimeve të ecurive ekonomike. Në këto rrethana, institucionet ndërkombëtare (*të angazhuara në Kosovë menjëherë pas përfundimit të luftës*) si FMN, BB, UNDP, etj. përmes ekipeve të ekspertëve të angazhuar në analizën e çështjeve zhvillimore dhe sociale, kanë vënë bazën e të dhënave të besueshme për periudhën e parë të zhvillimit.

Tanimë është e njohur se gjendja makroekonomike e trashëguar nga vitet e nëntëdhjeta karakterizohet me përkeqësimin e të gjithë treguesve ekonomikë: rënje e aktivitetit ekonomik, papunësi, prishje e lidhjeve ekonomike me jashtë, rënje e investimeve, inflacioni shumë i lartë dhe në fund shkatrrimet dhe dëmet e luftës.

Menjëherë pas instalimit të forcave të NATO-së në Kosovë dhe kthimit të popullsisë së shpërngulur në vend, kanë filluar përpjekjet për rindërtim dhe për fillimin e zhvillimit ekonomik. Asokohe, trendi i zhvillimit është mbështetur fuqishëm kryesisht nga investimet private, por edhe nga ndihmat nga donatorët. Këto ecuri pozitive u mbështetën fuqishëm edhe për shkak të përcaktimit të vendit për politika liberale të tregut, futjes së Euros si valutë zyrtare e pagesave, gjë që siguroi stabilitetin e çmimeve. Dhe për rezultat inflacioni ra në shkallën zero, kurse u rriten kursimet private bashkë me të hyrat nga jashtë, sidomos remitancat. Në këto rrethana edhe të ardhurat e qeverisë u rritën me ritëm të jashtëzakonshëm.

Nga një Raport i BB⁵⁶/ ecuria e tregusve makroekonomik në periudhën 2000-2008 ishte si vijon:

	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Rritja reale e BP	-	21.2	3.9	4.7	6.5	3.8	3.9	3.9	5.4
Invest./% BPV/	35.6	40.0	40.7	38.0	45.3	23.2	25.0	27.0	30.0
Bruto kursimet fam.	-	198.6	-	114.7	-	99.4	-	85.2	-71.3
Eksporti(si % e BPV)	0,5	3.0	7.4	8.2	21.7	-	9.2	10,3	10.8
Importi /si% e BPV/	-	156.4	113.7	108.3	99.2	117.4	42.1	47.1	54.8
Remitancat	73.7	52.0	42.9	43.2	42.5				
Kursimet kombëtare	44.9	38.5	14.8	7.6	7.1				
Investimet	66.9	57.7	48.3	40.5	45.3				

(Burimi: **Tab.nr.4 Raporti nr.32378-XK BB.**)

Nga ky pasqyrim statistikor, është e dukshme se në vitet e para të pasluftës, si rezultat i entuziazmit dhe angazhimit të jashtëzakonshëm për rimëkembjen e vendit, me iniciativë të fuqishme private, sidomos formimit të shumë ndërmarrjeve private shërbyese dhe prodhuese, por edhe të rifillimit të punës në shumë ndërmarrje shoqërore e publike, është realizuar një normë dinamike e rritjes së BPV.

⁵⁶Raporti nr.32378-XK; *Vlerësimi i varfërisë në Kosovë*, 16 qershor 2005 (Dokument i BB).

Aktivitetin kryesor intenziv në këtë periudhë e mundësoi ndihma e donatorëve dhe dërgesat nga diaspora. Me rënien e donacioneve, zvogëlimin e pranisë ndërkombëtare, si dhe me zvogëlimin gradual të remitancave nga viti në vit, bie intenziteti i investimeve dhe si rezultat edhe shkalla e shtimit të BPV. Njëherit, kjo periudhë shënon edhe rënien e entuziazmit që karakterizohej në dy vitet e para të pasluftës.

Për efekt të sqarimit të gjendjes financiare ekonomike fill mbas lufte, duhet thënë se çlirimi e gjeti Kosovën me vetëm 1 miliardë e 656 milion Euro, ose 898 Euro për banor që është dyfish më pak se sa në secilin vend të regjionit. Kjo rritje nuk ishte aspak inkurajuese përveç ajo e vitit 2001 kur BPV u rrit nga 1.656 milion Euro (sa ishte në vitin 2000) në 2.237 milionë Euro, ose për 21.2%. Kjo rritje ekonomike në periudhën e pasluftës i atribuohet entuziazmit për rindërtimin e vendit, dërgesave nga diaspora në mbështetje të familjeve dhe të afërmeve, donatorëve dhe në veçanti asistencës së jashtme, e cila në vitin 2000 kapte shumën prej 1.336 milionë, kurse në vitin 2001, 1.290 milionë euro.

Po ashtu, duhet theksuar se sistemimi i indikatorëve makroekonomikë që pasqyrojnë trendet ekonomike të kësaj periudhe është mjaft i komplikuar për shkak të mungesës së saktësisë dhe mospërputhjes së tyre. Kjo mospërputhje vjen në varësi të faktit se cili institucion ka prodhuar të dhënat (statistikat): FMN, BB, Ministria e Ekonomisë apo Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë. Të gjitha këto institucione kanë shfrytëzuar metodologji të veta për nxjerrjen e indikatorëve makroekonomikë dhe si rezultat analizat e tyre shumë vështirë bëhen të krahasueshme. Nga ana tjetër, shumë herë kemi indikatorë, të cilët nuk mund të i gjejmë në periudhën në vazhdim për shkak të ndryshimit të metodologjisë së llogaritjes, e të cilët nuk garantojnë vazhdueshmërinë e informacionit.

Në periudhën prej vitit 2000 deri në 2008 BPV është rritë nga 1.656 milionë euro në 3.722 milionë euro. Këto shifra janë marrë nga Departamenti i Makroekonomisë në Ministrinë e Financave dhe FMN. Mirëpo, kjo shifër është e pakrahasueshme për shkak se gjatë përgatitjes së Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) dhe përgatitjes për Konferencën e Donatorëve, e cila në nivel teknik është mbajtur në fillim të tetorit 2007, nën presionin e institucioneve vendore, në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, para

argumenteve të pa diskutueshme, ekspertët e FMN-së pruan se gjatë përllogaritjes së BPV kanë anashkuar një segment të konsumit të sektorit privat, gjë që ka sjellë nënvlerësimin e BPV. Duke pasqer bazë vlerësimet e reja, BPV për vitin 2008 është vlerësuar të jetë 3.722 milionë euro. Një rivlerësim retroaktiv i është bërë BPV edhe për periudhën 2004-2006. Në këtë rast për vitin 2004 nuk është më 2.282 milionë euro, por 3.000 milionë euro, që është për 31.5% më shumë nominalisht. Ky vlerësim është bërë bazë e kalkulimit, jo vetëm BPV, por edhe të gjithë indikatorëve makroekonomikë në periudhat pasuese. Prandaj duhet thënë se sqarimi i dilemave rreth indikatorëve makroekonomik na mundëson qasje më reale në analizën e ecurive ekonomike në periudhën e vështuar. Së këndejmi, indikatorët më të besueshëm për këtë qëllim konsideroj të jenë indikatorët me burim nga Departamenti Makroekonomik i MEF dhe FMN. Sipas këtij burimi, rritja e BPV në vitin 2005 ishte 2.7% , në vitin 2006, 4.1%, në vitin 2007 ishte 5.4, ndërsa në vitin 2008, 6.0%.

Në këtë proces, një rishikim, po ashtu, duhet bërë edhe kategorisë së BPV për kokë banori. Kështu që, vlerësimet e numrit të popullsisë do të duhet ndryshuar, meqenëse regjistrimi i popullsisë vitit 2011 rezultoi me të dhëna se në Kosovë jetojnë vetëm 1 milion e 800 mijë banorë resident, e jo siç vlerësohej 2 milionë e 200 mijë. Pra, me fjalë tjera, ky regjistrim i popullsisë tregoi se në Kosovë jetojnë 18% më pak banorë se sa vlerësohej para regjistrimit. Nëqoftëse këtë regjistrim e marrim si real (*edhe pse ka shumë rezerva lidhur me objektivitetin e regjistrimit*), atëherë është e pashmangshme edhe korrigjimi i indikatorëve të BPV për banorë për periudhën që po analizojmë. Kështu, rezulton se në vitin 2005 BPV për banorë ishte 1 842 euro, ndërsa në vitin 2008 ishte 2184 euro.

Një problem të ngjashëm rreth saktësisë së indikatorëve makroekonomikë e hasim edhe te Raporti i Bankës Botërore (BB) mbi *Vlerësimin e Varfërisë në Kosovë*. Në këto raporte analistët e BB vlerësojnë se zhvillimi në këtë periudhë ka qenë i ulët, por cilësia e të dhënave është problem. Në një Raport të BB⁵⁷ vlerësohet se *rritja reale e BPV në mes*

⁵⁷ Banka Botërore dhe Enti i Statistikave të Kosovës: *Vlerësimi i varfërisë në Kosovë*, 3 tetor 2007.

viteve 2003-2005 ka qenë e ulët dhe e paqëndrueshme. Kjo rënie e shtimit ekonomik shpjegohet me faktin e tërheqjes sëdonatorëve dhe të bashkësisë ndërkombëtare nga Kosova. Në metodologjinë e përllogaritjes së indikatorëve makroekonomikë ndryshim kishte te trajtimi i UNMIK-ut si trupë residente apo jorezidente. Këtu, veçanërisht probleme krijoheshin lidhur me përllogaritjen e Indeksit të Çmimeve të Konsumit. Ndryshimet në konsum ndikohen edhe nga supozimet rreth rritjes së popullsisë, e sidomos pas regjistrimit të popullsisë dhe përshtatjeve shtesë që bëhen për disa artikuj të konsumit.

Në këtë periudhë, struktura e ekonomisë së Kosovës, po ashtu, ishte e pavolitshme. Asokohe bujqësia ishte sektori kryesor dhe punëdhënësi kryesor në vend. Sipas të dhënave të Bankës Botërore, në këtë sektor prodhohej 25% e BPV, 16% e vlerës së eksporteve, dhe në të cilin sektor punësoheshin deri në 35% e të punësuarve të vendit. I tërë sektori ishte pothuajse informal. Zhvillimi i ngadalshëm i sektorit agrar e ka bazën në dëmet e luftës, shkatërrimin e infrastrukturës, makinerisë dhe fondit të bagëtisë. Për këtë arsye në strukturën e mallrave të importuara, prurimet bujqësore tregojnë rritje të theksueshme.

Është fakt se sot në Kosovë struktura e prodhimit të bujqësore dominohet nga drithërat. Toka e destinuar për prodhimtarinë bujqësore ka mbetur e njëjtë në tërë periudhën e analizuar dhe studiuar në këtë punim. Fondi i bagëtisë nuk tregon rritje. Në mungesë të shërbimeve këshilluese, dominimit të fermave të vogla dhe mënyrës së prodhimit, bujqësia nuk ka qenë në gjendje të kontribuojë në shtimin ekonomik në përputhje me kushtet dhe mundësitë.

Sipas Institutit për Planifikim Hapësinor⁵⁸ Kosova ka 577 mijë hektarë tokë bujqësore. Nga kjo sipërfaqe, 47.1% është tokë e punueshme, e cila dominohet nga drithërat. Pjesa tjetër është livadhe, kullosa dhe djerrina.

Struktura pronësore e tokës bujqësore dominohet nga pronësia private (88.6%), ndërsa pjesa tjetër i takon sektorit shoqëror, pra tokë e cila ende nuk është privatizuar. Toka

⁵⁸Shih "Plani Hapësinor i Kosovës: 2010-2020", Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, Prishtinë, 2010

bujqësore në Kosovë është e ndarë në parcella të vogla; prej tyre tokë e punueshme mesatarisht ka sipërfaqe (1.3 ha), kurse livadhet 0,7 ha.

Gjatë periudhës së shqyrtuar prodhimtaria bujqësore ka mbetur e njëjtë. Shfrytëzimi i sipërfaqeve bujqësore ka qenë i ulët. Rreth 70% e prodhimeve iu dedikohen nevojave familjare.

Sipas dokumentit të Bankës Botërore, (të cituar më lart) rezulton se: *sipërfaqja bujqësore në periudhën 2000-2005 është zvogluar për 19 mijë hektarë, në ndërkohë që struktura e kulturave bujqësore të mbjella me drithëra është rritë në dëm të sipërfaqeve të mbjella me perime.*

Popullsia e Kosovës dominohet nga popullata bujqësore. Aktualisht, llogaritet se rreth 1.3 milionë banorë të Kosovës jetojnë në fshat. Kjo strukturë nuk ka tendencë të ndryshimit. Familja fshatare është familje relativisht e madhe, mesatarisht ka 7.8 anëtarë. Në këtë sektor janë të punësuar rreth 30% e të punësuarve të përgjithshëm, kryesisht në sektorin informal.

Për shkak të rrethanave të viteve të '90-ta dhe pasojave të luftës Kosova kishte humbur tregun e produkteve bujqësore. Edhe pse pas luftës u ndërtua një regjim ekonomik liberal, kjo nuk i solli shumë dobi bujqësisë Kosovare, sepse ajo u ballafaqua me një konkurrencë të fortë nga importet. Në këtë periudhë, importi i produkteve ushqimore sillej nga 200 deri 300 milionë euro, ndërsa eksporti nga 2 deri në 10 milionë euro.

Në periudhën e pasluftës vlera e tokës bujqësore ishte shumë e ulët në krahasim me vlerën e tokës për destinime tjera. Së këndejmi, rezulton edhe degradimi dhe shndërrimi i destinimit të sipërfaqeve bujqësore për aktivitete tjera, veçanërisht atyre për ndërtimtari.

Në Raportin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) thuhet: *“tokat bujqësore janë privatizuar me të njëjtin destinim siç e kishin më parë. AKP-ja nuk lejon dhe nuk mund të lejojë që edhe nëqoftë se pala dëshiron të ndryshojë destinimin e një tokë të caktuar dhe*

kjo është e përcaktuar qartë në të gjitha materialet e privatizimit për tokën bujqësore. Në thelb, çështje të tilla janë qartë të rregulluara me legjislacionin e aplikueshëm si: Ligji për Planifikim Hapësinor, Ligji mbi Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjin mbi Tokën Bujqësore etj. ”

Deri në qershor të vitit 2008 AKM ka privatizuar 23.930 hektarë, ose 52 % të sipërfaqes së tokës bujqësore që e kishte nën administrim kjo Agjenci. Sipas një Raporti Studimor⁵⁹: 31 % e ndërmarrjeve të privatizuara ishin pasive, ndër të cilat 17% toka dhe kooperativa bujqësore.

Edhe pse bujqësia është sektori kryesor dhe punëdhënësi kryesor në Kosovë, pjesëmarrja e produkteve bujqësore në BPV në këtë periudhë ka pasur rënie të vazhdueshme. Kështu, nga 25% sa ishte në fillim të periudhës, në vitin 2005 pjesëmarrja e bujqësisë ka rënë në 19%, kurse në vitin 2008 në 13.4% në vitin 2008. (*Burimi: Agjencia Kosovare e Statistikave*).

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se privatizimi i tokave bujqësore nuk i dha rezultatet e pritura në rritjen e BPV, në zvogëlimin e importit të produkteve bujqësore e as në zvogëlimin e shkallës së papunësisë në zonat rurale.

Indikatorë tjetër makroekonomik shumë i rëndësishëm janë të dhënat për **tregun e punës**, të cilat duhet të trajtohen me shumë kujdes për shkak të disponueshmërisë dhe kualitetit të kufizuar. Siç dihet në Kosovë nuk ka pas regjistrim të popullsisë për një kohë të gjatë, që nga viti 1981 deri më 2011 kur është kryer regjistrimi i fundit. Kjo e vështëron shumë vlerësimin e tregut të punës.

Pas vendosjes së paqes dhe stabilitetit dhe ardhjes së ndihmave nga donatorët u shënua përparim i madh në rindërtim, stabilitet makroekonomik dhe ndërtim të institucioneve publike. Kjo rrethanë ndikoi në përmirsimin e aktiviteteve ekonomike. Edhe përkundër rimkëmbjes së shpejtë ekonomike në tri vitet e pas luftës, varfëria mbeti mjaft e përhapur. Sipas indikatorëve të Bankës Botërore (BB) rezulton se fund të vitit 2002 gjysma e popullsisë së Kosovës jetonte në varfëri . Në varfëri të skajshme jetonin 12% e popullsisë,

⁵⁹Privatizimi dhe post-Privatizimi në Kosovë: *Një gotë gjysmë bosh apo gjysmë e plotë?*, **Forumi 2015**, shtator 2008.

që do të thotë se kjo kategori nuk kishte të ardhura të miftueshme për përballimin e shpenzimeve për ushqim që garanton kërkesat minimale për kalori ditore.

Por, faktet tregojnë se papunësia e gjerë dhe mungesa e shansave për punë kanë lidhmëri të madhe dhe konsiderohen shkaktari kryesor i varfërisë. Sipas të dhënave në dispozicion në vitet e 90-ta, shkalla e papunësisë në Kosovë u rrit në mënyrë rapide, për të arritë në 68% në vitin 1999. Pas përfundimit të luftës dhe vendosjes së paqes, edhe përkunder aktivitetit të kondenzuar ekonomik, sidomos në sektorin privat, situata në tregun e punës nuk u përmirsua ndjeshëm. Sipas të dhënave që ka nxjerrë BB⁶⁰ shkalla e punësimit në Kosovë në vitin 2000 ishte 40.9%, e cila u përgjysmua në vitin 2001 dhe ra në 19.6%, kur edhe u stabilizua dhe filloi ngritja stabile në vitin 2002 për 2.2%. Njëkohësisht, shkalla e papunësisë në vitin 2000 është evidentuar të ketë qenë 12.1%. Kjo shkallë e ulët e papunësisë mund të spjegohet me mungesën e institucioneve për përcjelljen dhe evidentimin e personave të papunë në vitin e parë të pas luftës. Një vit më vonë, numri i të papunëve shënon rritje të trefishtë kur edhe kemi 41.2% të shkallës së papunësisë. Në vitin 2002 kjo papunësi rritet më tej dhe arrinë shkallën prej 47.2%. Pas këtij viti, shkalla e papunësisë mbetet pothuajse në të njëjtin nivel deri në vitin 2008.

Nga këto të dhënat del se në dy vitet e para (1999 dhe 2000) ecuritë dinamike në aktivitetet ekonomike dhe në punësim janë rezultat i një financimi të jashtëm të pasluftës dhe i ndihmave zyrtare. Por, edhe përkundër kësaj, kjo situatë nuk zgjatë shumë, meqë shumë nga donatorët dhe mbështetja tjetër, pas rimëkëmbjes fizike dhe institucionale të vendit, filluan të tërhiqeshin gradualisht.

Një dukuri tjetër negative për stabilitetin social dhe ekonomik të vendit tonë, e shfaqur që në momentin e kthimit në shtëpi pas luftës, është boshatisja e mjedisit. Në fakt, pas kthimit në trojet e veta familjet e larguara si refugjatë lufte i gjetën shtëpitë e tyre të djegura dhe të shkatërruara gati plotësisht. Për shumëkë, asgjë nga pasuria familjare nuk kishte mbetur në dispozicion. Shtëpitë e djegura, bagëtitë e plaçkitura, pajisjet dhe makineritë bujqësore të plaçkitura ose të shkatërruara, këto ishin vetëm disa nga dëmet e shumta materiale. Në këto

⁶⁰Banka Botërore : “*Studimi i tregut të punës në Kosovë*” (2003).

rrethana, familjet u detyruan të kërkojnë strehim, përmes së cilit në njëfarë mënyre i siguruan vetit një zgjidhje të përkohëshme. Është krejtësisht e kuptueshme se në një situatë të tillë, hapësira më e bollshme ishte në qytete, të cilat pjesërisht ose tërësisht kishin shpëtuar nga shkatrrimet e luftës. Por, kjo lëvizje nga lëvizje me karakter të përkohshëm, me kalimin e kohës, me adaptimin në ambientin urban, me kushte më të mira se sa në fshatrat e paurbanizuara, dhe sidomos pas fiillimit të shkollimit të fëmijëve, nga një vendqëndrim i përkohshëm u shndërrua në të përhershëm.

Kjo lëvizje e popullsisë në drejtim të qyteteve pati anët e veta pozitive në aspektin e transformimit të popullsisë nga mjedisi rural në atë urban. Por, shikuar nga këndi i mundësive për aktivitet ekonomik, të bazuar në burimet natyrore, kjo kishte rrjedhojë negative. Siç dihet një numër i madh i familjeve jetojnë nga pasuritë natyrore, sidomos në rajonet rurale. Është e ditur se mbi 90% e familjeve në fshat posedojnë tokë, mbi 55% posedojnë bagëti, 15% jetojnë nga prodhimet ushqimore vetanake, 20% e popullsisë rurale bazohen në prodhimet e pylltarisë, etj.

Një problem tjetër që lidhet me papunësinë dhe rrezikun e rrëshqitjes në varfëri paraqet shkalla e lartë e informalitetit në ekonomi. Në Kosovë, në këtë periudhë, punësimi formal ishte shumë i vogël ndërsa papunësia shumë e lartë. Si pasojë mundësia e mbetjes pa punë dhe rënia në varfëri është shumë e madhe. Të dhënat tregojnë se 90% e punëtorëve ishin në marrëdhënie pune të përhershme, edhe pse gjysma e tyre nuk kishin kontratë pune.

Një grup tjetër i të punësuarve rrezikohej të mbetej pa punë në rast se institucioni ose organizata ndërkombëtare që e punësonte tërhiqej nga Kosova. Sektorët tjerë, sidomos sektori publik punësonte përqindje të vogël për shkak të kufizimeve materiale. Institucionet qeveritare punësonin 6%, arsimi 8%, shëndëtiesia 4%. Në vitet e para të pasluftës bujqësia mbeti sektori me numrin më të madh të të punësuarve (rreth 39%), pastaj tregtia me 12% dhe ndërtimtaria me 8%-kryesisht në sektorin informal.

Ndërmarrjet e sektorit shoqëror, sipas vlerësimeve në vitin 1999, ishin deri në 60% të aktivizuara për të ngritë nivelin e aktivitetit në dy vitet pasuese në 86%, kurse numri i të punësuarve në këto ndërmarrje lëvizte nga 18 mijë deri në 21 mijë persona. Numri i

personve të regjistruar si të punësuar në këto ndërmarrje ishte përgjysmë më i madh dhe sillej nga 36 mijë në vitin 1999 në 42 mijë në vitin 2001. Ky dallim ndërmjet numrit të të punësuarve dhe numrit të punëtorëve të regjistruar rrjedh nga shkalla e aktivitetit të këtyre ndërmarrjeve, si dhe nga shkalla e shfrytëzimit të kapaciteteve të tyre, e cila nga 28% në vitin 1999 u ngrit në 42% në vitin 2002. Është interesant se numri i punëtorëve aktivë në vitin 2001 është zvogluar për 12%, ose për 3 mijë veta, poashtu është zvogluar për 10% numri i punëtorëve që marrin pagadhe rrinë në shtëpi, ndërsa ka mbetur i njëjtë numri i punëtorëve pa pagesë.⁶¹

Edhe numri i stafit udhëheqës (nga viti 2000 në vitin 2001) është zvogluar për 400 vende pune. Nga ky numër mbi 50% i takon stafit menaxherial me kualifikim superior.

Por ç'ndodhi me të punësuarit në ndërmarrjet shoqërore pas privatizimit të tyre?

Dihet mirëfilli se në sistemin e ekonomisë së dirigjuar qëllimi kyç i sektorit shoqëror ishte punësimi i sa më shumë personave, madje edhe përtej nevojave për fuqi punëtore të këtyre ndërmarrjeve. Është e natyrshme që pas privatizimit pronarët e këtyre ndërmarrjeve nuk do të mbajnë në punë numër të panevojshëm të punëtorëve. Përvoja e shumë vendeve tjera, të cilat shumë kohëpara Kosovës e kanë kaluar këtë fazë të tranzicionit, nuk jep shembuj të qartë lidhur me numrin e të punësuarve pas privatizimit. Po ashtu, gjatë këtij procesi, është dëshmuar shumë herë se kompanitë e privatizuara, që më pas janë udhëhequr nga menaxherë të rinj, k

anë pasë rezultate më të mira sesa ato që kanë mbajtur edhe më tej menaxherët e tyre të vjetër.

Në bazë të rezultateve të një ankete të realizuar nga Instituti për Kërkime Ekonomike "RIINVEST" në kuadër të përgatitjes së Raportit Studimor: "Privatizimi dhe post-privatizimi në Kosovë", edhe pse është shumë vështirë të nxjerret ndonjë konkluzion i saktë, rezulton se: *"numri i personve të punësuar në ndërmarrjet e privatizuara është më i ulët se sa para privatizimit. Kjo ulje vlerësohet të jetë diku rreth 10%"*.

⁶¹Riinvest, USAID, CIPE: "Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore dhe reformat e ndërmarrjeve publike në Kosovë", Konferencë ndërkombëtare, Prishtinë, qershor 2002.

4.1.0. Ndikimet e Privatizimit në këmbimin tregëtar ndërkombëtar

Fillimi i tanzicionit në Kosovën e pasluftës krijoi kushte për liberalizimin e tregut, gjegjësisht për importin dhe eksportin e lirë nga ndërmarrjet e regjistruara për aktivitete të qarkullimit ndërkombëtar të mallrave. Në muajt e parë të funksionimit të Administratës Ndërkombëtare në Kosovë u vendos një regjim i jashtëm tregtar bashkë me Administratën Doganore. Kjo konsiderohej me rëndësi për nxitjen e aktiviteteve ekonomike, për rindertimin e vendit dhe për krijimin e kushteve për stimulimin e eksportit.

Ekonomia e Kosovës, në periudhën e pasluftës, për shkak të nivelit të ulët të zhvillimit të trashëguar dhe shkatërrimeve nga lufta, kishte një disbalans ndërmjet ofertës dhe kërkesës aq të thellë sa që nevojat e tregut të brendshëm tejkalonin dyfish ofertën e brendshme. Kjo situatë ishte prezente edhe për shkak të pamundësisë së organizimit të procesit të prodhimit, çrregullimit të tregut të brendshëm dhe humbjes së tregjeve të jashtme. Në këtë periudhë, Kosova nuk kishte çka të eksportoje⁶².

Vënja e një tarife uniforme prej 10% nuk mjaftonte për mbrojtjen e produkteve vendore nga konkurrenca e prodhimeve të vendeve fqinje, të cilat përveçse e kishin të konsoliduar ekonominë e vet, subvenciononin edhe produktet e destinuara për eksport.

Në këto rrethana, struktura e eksportit dhe importit të mallrave është shumë e pavolitshme, qoftë si bilanc tregtar, qoftë si strukturë e mallrave. Eksporti i filluar me 18.7 milionë euro, në vitin 2000 mezi arriti në 48.9 milionë në vitin 2005 dhe për të realizuar një ngritje shumë të ngadaltë, deri në vitin 2008 kur arriti në rreth 200 milionë euro, ose në 4% tëBPV. Në anën tjetër,importi i mallrave u rrit nga afër 700 milionë, sa ishte në vitin 2001, në rreth 2 miliardë euro në 2008. Deficiti tregtar arriti në 45 % të BPV.

⁶²Riinvest,USAID,CIPE: “Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore dhe reformat e ndërmarrjeve publike në Kosovë”, Konferencë ndërkombëtare, Prishtinë ,Qershor, 2002.

Këtu, është me interes të theksohet se në strukturën e eksporteve të Kosovës dominojnë metalet bazë, të cilat marrin pjesë me 63% të eksportit të tërësishëm. Eksporti i metaleve bazë është rritë ndjeshëm vetëm pas privatizimit të **“Feronikelit”** në fund të vitit 2005. Edhe eksportet tjera të metaleve bazë kanë shënuar rritje, dhe kjo falë çmimeve të larta në tregun ndërkombëtar. Kjo rritje e eksporteve të metaleve bazë është rezultat edhe i fillimit të prodhimit në disa ndërmarrje, që në ndërkohë ishin privatizuar siç janë: **“Fabrika e Gypave”** në Ferizaj, **“Industria e Magnezitit”** në Golesh, **“Llankos”** në Vushtrri etj.

“I vetmi sektor, në të cilin prodhimi i është afruar prodhimit të para viteve të 90-ta është **‘Feronikeli’**. Kompleksi Xeharo-Metalurgjik ‘Feronikeli’ është themeluar në vitin 1984 për të prodhuar feronikel për eksport. Ky kompleks prodhonte dhe eksportonte 6.800 ton nikel në vit deri në vitin 1990, por pas vitit 1998 kompania u pasivizua. Kjo Ndërmarrje Shoqërore, deri në vitin 1998 ka punësuar rreth 2000 punëtorë, është privatizuar në vitin 2005. Më pas, pronari i ri, njëkompani greke ka investuar në rehabilitimin e kapacitetit prodhues, dhe produkti është rritur, duke u bërë kështu një nga fabrikat më të mëdha në Evropë për nxjerrjen e xehes dhe shkrierjen e nikelit, me 13 milionë ton të xehes së nikelit. Rifillimi i punës së kësaj fabrike ka pasur ndikim të madh në aktivitetin ekonomik dhe në veçanti në eksport. Deri në fund të vitit 2008 kompania ka punësuar mbi 1000 të punëtor. Vlera e eksportuar vjetore në gati 100 milionë Eu, që përfshin gati gjysmën e eksportit të tërësishëm.”⁶³

Nga numri i gjithëmbarshtëm i ndërmarrjeve tëprivatizuara 60% e tyre ishin të regjistruara si biznese për aktivitete eksportuese, por vetëm 30 % e tyre kanë patur aktivitete eksportuese. Sipas të dhënave të nxjerra nga aktiviteti i këtyre ndërmarrjeve rreth 35 % e prodhimit të tyre vjetor ishte e destinuar përeksport. Pra efektet e privatizimit të ndërmarrjeve nga viti 2006 e në vijim kanë qenë të dukshme në rritjen e eksportit . Duhet theksuar poashtu që ndërmarrjet më të mëdha eksportuese në këto dy vite të fundit janë

⁶³**Banka Botërore:** Raporti nr. 53185-XK: Kosova **“Zhblllokimi i potencialit për rritje ekonomike”, prill 2010.**

pikërisht ndërmarrjet e privatizuara. Në strukturën e eksporteve poashtu dominojnë produktet e gatshme me 65% ndaj lëndëve të para me 35%. Në vlerën e gjithëmbarshtme të eksporteve të Kosovës ,eksporti i mallrave të ndërmarrjeve të privatizuara përbën 15% te totalit te eksportit Kosovar. Importi i mallrave është rritë me një ritëm tepër dinamik. Në periudhën 2000 deri 2005 importi është trefishuar duke arritur vlerën e rreth 1.2 miliardëeuro,kurse në vitin 2008 u rrit në afër 2 miliardë euro. Por, ajo që është me brengosëse qëndron te struktura e importeve, e cila 42% përbëhet nga artikujt ushqimorë, kurse importi i paisjeve dhe makinave vetëm 20%. Deri në fund të vitit 2008 mbulimi i importit me eksport mezi arriti në shkallën 10%. Importet,të shtyra nga investimet e shumta publike, si dhe kërkesat për konsum privat, janë rritur në 50% të BPV.⁶⁴

Pasqyrë e eksporteve dhe importeve në periudhën 2001-2008 (në mijë Eu)

Viti	Eksporti	Importi	Bilanci	%
2001	10.559	684.500	- 673.941	1.5
2002	27.599	854.758	- 827.159	3.2
2003	35.621	973.265	- 937.644	3.7
2004	56.562	1.063.347	- 1.006.780	5.3
2005	56.283	1.157.492	- 1.101.209	4.9
2006	110.774	1.305.879	- 1.195.105	8.5
2007	165.112	1.576.186	- 1.411.074	10.5
2008	198.463	1.928.236	- 1.279.773	10.3

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), “Buletini Statistikor i Tregtisë së Jashtme”(2009).

Këtë deficit të madh tregëtar e kanë mbuluar paratë e derguara nga diaspora kosovare, e cila ka qenë dhe vazhdon të jetë burim shumë i rëndësishëm dhe kryesor i të ardhurave të

⁶⁴Po aty.

familjeve kosovare. Niveli i dërgesave nga diaspora kanë arritë në 15% të BPV. Kjo e dhënë mund të jetë e nënçmuar për shkak të mungesës së të dhënave të plota mbi dërgesat nga diaspora pasi që njëpjesë e tyre kryhet përmes dërgesave direkte ose sjelljes nga vet anëtarët e familjeve me rastin e vizitave të tyre në Kosovë.

Pjesën tjetër të boshllëkut të bilancit negativ tregetar me jashtë e ka plotësuar ndihma e jashtme, e cila në vitet e para të pasluftës ka qënë e konsiderueshme, ndërsa, në vitin 2008 ka rënë në rreth 8% të BPV. Pas fillimit të procesit të privatizimit, në vitin 2004, si dhe pas stabilizimit të rrjedhave politike/ngjarjet e marsit 2004/ , deri në vitin 2007 patën një rritje dinamike dhe aritën në 13% të BPV, por për shkak të ngecjes së sërishme të privatizimit në vitin 2008 , IHD pësuan një rënje të ndjeshme. Një ndikim negativ në rrjedhen e IHD vlerësohet të jetë shkaktuar nga kriza globale .

4.2.0. Performanca e ndërmarrjeve të privatizuara

Që nga themelimi, në maj 2003 deri më 30 qershor 2008, kur **Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit (AKM)** e pushon veprimtarinë e vet, ka realizuar gjithsej **30 Valë të Privatizimit**, në të cilat janë përfshirë **498 ndërmarrje të reja** dhe janë nënshkruar **397 kontrata** të shitjeve. Në këtë periudhë janë inkasuar **392.281.978 euro**.

Efektet e privatizimit në ekonominë në tranzicion është e vështirë të veçohen dhe të kuantifikohen për arsye se njëkohësisht me privatizimin, ndodhin edhe ndryshime tjera, që në një mënyrë ose tjetrën ndikojnë në efikasitetin ekonomik të ndërmarrjeve të privatizuara.

Argumentet teorike, të lansuara nga bota akademike, nxjerrin përparësitë e privatizimit ndaj formave tjera të pronës. Kështu, në studimet empirike është e ndërtuar metodologjia e matjes së efektivitetit të privatizimit dhe performancës së ndërmarrjeve të privatizuara. Me këtë rast, kryesisht ndër kriteret e performancës janë vendosur: *probabiliteti, produktiviteti, investimet, punësimi, eksportet, produktet si dhe tregjet e reja*. Sipas një studimi të EBRD-së del se *privatizimet kanë pasur ndikim pozitiv në rritjen e BVP në 25 vende të trajtuara*. Megjithatë, ky rezultat vazhdon të ndikohet esencialisht nga mjedisi biznesor, ku sundimi i

ligjit, krimi iorganizuar, korrupsioni, janë faktorë që e kushtëzojnë performancën e ndërmarrjeve të privatizuara.

Privatizimi dhe transformimi i pronës ka për qëllim rritjen e efikasitetit ekonomik. Ky proces në Kosovë është udhëhequr nga strukturat ndërkombëtare të vendosura në Kosovë në bazë të **Rezolutës 1244 të KS të KB**. Ky Mision i Përkohshëm i KB në Kosovë i njohur si UNMIK mori përsipër të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e një qeverie. Kjo administratë ishte e organizuar në katër *Shtylla*. Shtylla e IV-të e udhëhequr nga Bashkimi Europian u ngarkua me rindërtimin dhe zhvillimin ekonomik. Ishte arritë konsensusi i plotë për reforma të fuqishme në bazë të modeleve neoliberales ekonomike. Një absurd i llojit të veçantë ishte marrja e përgjegjësisë për qeverisje të një vendi, i cili zyrtarisht ende konsiderohej pjesë e Serbisë, e cila praktikisht nuk kishte asnjë rol në jetën e përditshme të Kosovës. Kjo sipas Rita Augestad Knudsen nga Instituti Norvegjez i Punëve të Jashtme ky projekt ndërkombëtar e bëri: “*ndërtimin e shtetit pa shtetësi*”. Në realitet, ky Mision asnjëherë nuk e kishte për obligim ndërtimin e shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës.

Në këto rrethana, detyra e *Shtyllës së IV-të* ishte e rëndë dhe e komplikuar. Ekonomia e Kosovës ishte e ndarë, e dobësuar prej krizave ekonomike, e shkatërruar nga lufta dhe e degraduar nga mungesa e investimeve, keqmenaxhimi dhe humbja e tregjeve duhej ringjallë. Në këtë kohë, menjëherë u përcaktua si strategji kryesore ringjallja ekonomike përmes privatizimit në një shkallë të gjërë. Fillimisht, përqendrimi i këtij angazhimi fokusohet në Ndërmarrjet Shoqërore, të cilat ishin të shtrira në një gamë të gjërë të sektoreve si: bujqesi, *miniera*, *prodhimtaria e ushqimit*, *tregti*, *ndërtimtari*, *turizëm*, *transport*, *shërbime etj.*

Në këtë kontekst, duhet pas parasysh që edhe përkundër faktit që ekonomia e Kosovës, në kuadër të ekonomisë Jugosllave, kishte një shkallë të lartë të pronësisë së përzier, pra nuk kishte një ekonomi plotësisht të shtetëzuar sikurse në rastin e Shqipërisë, megjithatë

produkti shoqëror i sektorit shoqëror përbënte 80% të produktit shoqëror të gjithëmbarshtëm⁶⁵.

Deri në fund të viteve të 80-ta, kur Kosovës dhunshëm iu suspendua autonomia, ekonomia e saj punësonte afër **232 mijë persona nga të cilët 75%** në sektorin shoqëror të ekonomisë. Ky sektor i rëndësishëm për ekonominë dhe popullsinë e Kosovës i vënë nën kontrollin e regjimit serb filloi rënien rapide në të gjitha aktivitetet, sidomos me largimin nga puna të rreth **145 mijë punëtorve**.

Me këto të dhëna duam të pasqyrojmë potencialin që kishte sektori shoqëror i ekonomisë para rrënimit dhe shkatërrimit nga lufta.

Fakti që Administrata Ndërkombëtare e vendosur në Kosovë e vuri në prioritet privatizimin e menjëhershëm të ndërmarrjeve shoqërore, edhe përkundër pengesave të mëdha ligjore dhe politike por me përkrahjen e gjërë të shoqërisë civile, institucioneve vendore në themelim dhe të botës akademike, ky proces ka kaluar pa ndonjë analizë të mirëfilltë. Për më shumë, mënyra e realizimit dhe rezultatet e procesit asnjëherë nuk kanë qënë objekt i analizave të mirëfillta. Në këtë mënyrë, asnjëherë nuk është dhënë llogari për faktin se pse edhe pas nëntë viteve të administrimit ndërkombëtar, projekti i përcaktuar si *strategjia kryesore e zhvillimit* nuk e ndryshoi situatën ekonomike e sociale të vendit, si dhe pse deri në përfundimin e Misionit të KB, në vitin 2008, rreth 44% e popullsisë jetojnë në varfëri? Askush nuk arriti të përgjigjet në pyetjet se pse pse 45% e popullsisë së aftë për punë është e papunë, pse infrastruktura rrugore është tejet e dobët, infrastruktura ekonomikepo ashtu, sidomos ,furnizimi me energji me plot pengesa, shërbimet në shëndetësi, në arsim dhe lëmi tjera tepër të dobëta?!

Gjatë gjithë kohës, me shumë të drejtë është pritë që privatizimi do të ndryshojë strukturën e subjekteve ekonomike, që do të zëvendësojë ndërmarrjet shoqërore me pak efektive me ndërmarrje private efikase, me ç'rast do të mundësohej tërheqja e investimeve të huaja dhe të vendit, të cilat në kushtet bashkëkohore të ekonomisë botërore nuk mund të ndahen. Po ashtu është pritë që privatizimi është pritë të zgjerojë fushën e investimeve të kapitalit të

⁶⁵Po aty

pronarëve individualë edhe në ato fusha në të cilat në sistemin ekonomik të kaluar nuk ka qënë e mundur të depërtohet, veçanërisht në degët e energjetikës, industrisë së rëndë dhe sektorëve tjerë strategjikë.

Privatizimi ishte shpresë e zvogëlimit tësubvencioneve të shtetit për ndërmarrjet publike. Privatizimi është pritur të jep efekte të shumëfishta në të gjitha sektoret e ekonomisë.

E tërë përgjegjësia për rezultatin e mangët të procesit të privatizimit në periudhën deri në qershor 2008, por edhe të zbatimit të politikave për liberalizimin e ekonomisë bie mbi UNMIK-un. Disa fakte dhe analiza të institucioneve vendore dhe të shoqërisë civile na drejojnë temungesa e përgjegjësisë dhe llogaridhënies së këtyre strukturave .

Privatizimi, si element kyq i tranzicionit dhe zhvillimit demokratik ka hasur në pengesa të pa parashikueshme. Së pari, vonesa e definimit të statusit politik të Kosovës, por edheinterferimi i Serbisë dhe involvimit të shumë palëve tjera në proces.

Performanca e ndërmarrjeve të privatizuara dhe suksesi i tyre varet nga rrethanat që krijojnë institucionet shtetërore, pra nga ambient i të bërit biznes. Së pari duhet thënë se krijimi i kushteve për një stabilitet makroekonomik, lufta krimit të organizuar në ekonomi, lufta kundër korrupsionit, krijimi i një infrastrukture ligjore të përshtatshme për ekonominë e tregut të lirë dhe përgjithsisht sundimi i ligjit përcaktojnë rezultatet e privatizimit si proces kyq i tranzicionit.

Performanca e kompanive të privatizuara është e vështirë të matet ashtu siç e kërkojnë kriteret profesionale të vlerësimit. Fillimisht këto ndërmarrje nuk kanë qënë aktive për një kohë të gjatë para dhe pas lufte. Aktiviteti i tyre ka qënë i ndrydhur nga masat e politikave serbe e jo aktivitet i zhvilluar sipas kriterëve të ekonomisë së tregut dhe së fundit plaçkitja e paisjeve dhe aseteve në emër të integriteteve ekonomike me ndërmarrjet e Serbisë. Pas luftës, këto ndërmarrje një kohë ishin pasive për shkak të mungesës së kapitalit, lëndës së parë dhe humbjes së tregjeve. Së këndejmi mungon baza krahasuese për vlerësimin e performancës.

Një tentim më serioz për matjen e performancës së ndërmarrjeve të privatizuara në Kosovë është bërë nga **“Forumi 2015”** në një *Raport Studimor* të vitit 2008. Për qëllime të këtij raporti është realizuar një anketë me përfshirjen e **103 ndërmarrjeve** të privatizuara, nga të cilat 23 me metodën e ***Spinof-itSpecial***, pra në anketë janë përfshirë 20 % e ndërmarrjeve të privatizuara deri në prill të vitit 2008. Në bazë të analizës së rezultateve të anketës del se nga numri i ndërmarrjeve të anketuara vetëm 66 e tyre kanë qenë aktive. Nga ndërmarrjet aktive të anketuara 60% i takonin sektorit të prodhimit, 21% shërbimeve dhe pjesa tjetër sektorit të tregtisë.

Ky anketim, po ashtu, ka vërtetuar se të gjitha ndërmarrjet e mëdha janë privatizuar përmes metodës së *Spinof-it Special*. Por, përmes kësaj metode janë privatizuar edhe disa ndërmarrje të vogla dhe të mesme. Nga anketa, po ashtu, është konstatuar se 61% e këtyre ndërmarrjeve ishin mikro dhe të vogla, 35% të mesme dhe vetëm 4-5% të mëdha.

Pasqyrë të ndërmarrjeve të privatizuara deri në prill 2008.

Spektori	% madhsia	%	lloji i pronësisë		%	statuti ligjor	%
Prodhim	59.1	Mikro	10.6	Biz. individual	50	SH.p.k	30
Tregëti	19.7	Vogla	50	Korporata	27	Sh.p.k	70
shërbime	21.2	Mesme	39.4	Ortakëri	23		
Nd. mëdha	4.5						

Burimi: Forumi 2015: “Raport Studimor; Privatizimi dhe post-privatizimi në Kosovë”, Prishtinë, 2008.

Shkalla e lartë e ndërmarrjeve jo aktive të privatizuara paraqet problemin më të madh në aritjen e pritjeve nga procesi i privatizimit. Për më tepër, anketa e realizuar ishte gati një vit pas privatizimit të raundit të fundit, pra nuk ishte faktori kohë shkaku i mosaktivitetit të këtyre ndërmarrjeve. Të gjitha ndërmarrjet joaktive janë privatizuar me *Spinof të rregullt*

dhe iu takojnë të gjitha sektorëve dhe të gjitha regjioneve të Kosovës. Në bazë të analizës së bërë nga ekspertët e *Raportit Studimor del se shumica e ndërmarrjeve të privatizuara nuk ishin aktive për shkak se pronarët e tyre nuk kishin mundësi financiare për investime të reja dhe kapital shtesë*. Pra, pronarët e rinj kishin shpenzuar të gjithë potencialin financiar për blerjen e ndërmarrjeve dhe ndërkohë iu mungonin mjetet e nevojshme për funksionalizimin e tyre. Një numër i pronarëve blerjen e këtyre ndërmarrjeve e ka bërë me qëllim të përfitimit nga shitja e pjesëve të tokave, ose të paisjeve dhe përfitimit nga shitëblerja. Më tepër kësaj forme të përfitimit i janë qasë pronarët e ndërmarrjeve, të cilat kanë qënë në afërsi të qendrave urbane dhe sipërfaqet e tokave me levërdi janë shdërruar në toka ndërtimi.

Një indikator tjetër, po ashtu mjaft i diskutueshëm, është edhe vëllimi i qarkullimit. Anketuesit kanë vërejtur se pronarët e ndërmarrjeve hezitojnë të raportojnë për vëllimin e qarkullimit. Kjo sipas analistëve të anketës vjen ngase një masë e madhe e aktiviteteve biznesore zhvillohet në sektorin informal. Vëllimi i deklaruar i qarkullimit natyrisht që varet nga madhësia e ndërmarrjes por mesatarisht ndërmarrjet e privatizuara kanë deklaruar qarkullim vjetor prej 101 mijë eurove. Një krahasim me qarkullimin e ndërmarrjeve private rezulton se ndërmarrjet e privatizuara kanë deklaruar qarkullim më të vogël se sa ndërmarrjet private. Arsyet qëndrojnë edhe në faktin se ndërmarrjet e privatizuara kanë hyrë me vonesë në treg, konsiderohet se atyre iu mungon përvoja dhe ende nuk e kanë përvetësuar tregun. Mënyra e privatizimit ka ndikuar në dinamikën e qarkullimit të këtyre ndërmarrjeve. Ndërmarrjet e privatizuara me *Spinoff Special* kanë qarkullim më të madh në krahasim me ndërmarrjet e privatizuara me *Spinoff* të rregullt. Por, ajo që befason në këtë tregues është se ndërmarrjet e privatizuara me *Spinoff Special* e kanë produktivitetin e punës për punëtorë më të ulët se sa ndërmarrjet e privatizuara me *Spinoff* të rregullt. Spjegimi duhet kërkuar te numri i madh i punëtorëve të cilët vet ndërmarrjet janë obliguar të i mbajnë në bazë të kontratës së blerjes .

Përgjithsisht ndërmarrjet e privatizuara aktivitetin e tyre e kanë filluar nga viti 2006. Analizat e afarizmit të këtyre ndërmarrjeve tregojnë se nga viti në vit rezultatet e afarizmit të tyre kanë treguar përmirësim. Një krahasim me ndërmarrjet private duket se rezultati i

afarizmit të ndërmarrjeve të privatizuara ka dinamikë pozitive dhe më intensive se sa ndërmarrjet tjera të sektorit privat. Një spjegim i pranueshëm i kësaj dinamike duhet kërkuar në faktin se ndërmarrjet e privatizuara janë të reja dhe se aktivitetin e tyre e kanë filluar nga një bazë më e ulët . Të dhënat nga anketa e cituar tregojnë se në 68% të ndërmarrjeve të privatizuara, afarizmi dhe fitimi i tyre në vitin 2007 ishte për 61% më e mirë se sa një vit më parë, kurse në ndërmarrjet tjera vetëm 38% janë deklaruar se kanë afarizëm dhe presin fitim më të madh se sa në vitin paraprak. Pra, 17% e ndërmarrjeve të privatizuara e kanë konsideruar më të keq afarizmin e tyre në krahasim me vitin paraprak, derisa 39% e ndërmarrjeve tjera private konsiderojnë se fitimi i tyre do të jetë më i vogël se sa një vit më parë.⁶⁶

Për shkak të zvogëlimit të ndihmave të jashtme dhe tërheqjes së donatorëve, rritja ekonomike në vitet 2002 deri 2005 ka qenë shumë e ngadalshme. Në këtë periudhë kanë munguar masat e politikave ekonomike, procesi i privatizimit ishte pezulluar dhe ekonomia e vendit nuk stimulohej me asnjë masë. Një kthesë pozitive është shënuar në vitin 2006 kur BPV u rrit realisht 3% dhe vazhdoi me këtë trend edhe në vitin 2007 e 2008. Pra, në këtë periudhë realizohet një rritje mesatare vjetore e BPV prej 1.5%. Kjo rritje modeste bëri që BPV për kokë banori të mos levizë gati aspak.

Nga analiza e rritjes së BPV në periudhen deri në vitin 2008, duke e shikuar ndaras nëpër vite, mund të konstatojmë se procesi i privatizimit, i cili kishte filluar më intenzivisht në vitin 2005 mund të ketë ndikuar në rritjen pozitive prej 3 % të realizuar në vitin 2006. Por, kjo nuk mund të vlerësohet dhe shikohet ndaras nga faktorët tjerë ndikues. Veçanërisht këtu duhet marrë parasysh ndikimin e rritjes së dërgesave nga diaspora dhe sektori i donatorve.

Punësimi është një indikator kyç i performancës së ndërmarrjeve të privatizuara. Të dhënat flasin për numrin e madh të të punësuarve në ndërmarrjet e privatizuara në krahasim me

⁶⁶Më gjërësisht: Prof. Ismet Gusia: *"Burimet natyrore si faktor i zhvillimit ekonomik të Kosovës"*, Prishtinë, 2010.

ndërmarrjet tjera private. Në fakt, sa i përket numrit të të punësuarve del se ndërmarrjet e privatizuara mesatarisht punësonin 126 veta, që i bie se punësojnë gati dhjetë herë më shumë se sa numri i të punësuarve në ndërmarrjet e vogla dhe në ato të mesme. Në këtë rast krahasimi i numrit të të punësuarve nuk është indikator i besueshëm për shkak se ndërmarrjet e privatizuara kishin trashëguar numër të madh të të punësuarve, prandaj numri i të punësuarve nuk e pasqyron në menyrë reale performancë e këtyre ndërmarrjeve.

Numri i të punësuarve në ndërmarrjet shoqërore në vitin 2000 *(është fjala për punëtorët aktivë)* sillej në rreth 24.700. Sipas të dhënave të kohës, ky numër kishte tendencë të zvogëlimit për shkak të rënies së aktivitetit të tyre biznesor. Pas privatizimit, kryesisht në vitin 2007, numri i të punësuarve është rritë më shpejt se sa në grupin e ndërmarrjeve tjera të sektorit privat. Numri mesatar i të punësuarve në ndërmarrjet e privatizuara është 126. Mirëpo, një indikator tjetër është mjaft domethënës. Numri i të punësuarve në ndërmarrjet e privatizura është më i vogël pas privatizimit sesa para privatizimit. Nga të dhënat e anketës së cituar rezulton se në këto ndërmarrje numri i të punësuarve ka rënë për 10%.

Numri i përgjithshëm i punëtorve, të cilët sipas obligimeve në procesin e privatizimit, duhej të mbahej në punë, është 1390, kurse ndërmarrjet duhej të punësonin edhe 400 punëtorë të rinj. Shumica e ndërmarrjeve, që janë privatizuar, sipas anketimit, nuk kanë obligime për punësim, por ato ndërmarrje mund t'i mbajnë në procesin e punës punëtorët, nëse konsiderojnë se kanë aftësi dhe shkathtësi të nevojshme për veprimtarinë punuese të ndërmarrjes. Nuk ka qenë e mundur të nxirret rezultat i saktë lidhur me punësimin në ndërmarrjet që janë privatizuar. Por, në bazë të anketave, mund të konsiderohet, se mesatarisht niveli i punësimit ka rënë.

Megjithkëtë, zhvillimi i ngadalshëm ekonomik i Kosovës ka bërë që shkalla e papunësisë në vend të rritet sidomos në vitet e para të pas luftës. Sipas Raportit të Bankës Botërore në vitin 2002 shkalla e përgjithshme e papunësisë në Kosovë ishte 42%, nivel ky i cili nuk ka ndryshuar deri në vitin 2006. Shkalla e papunësisë së meshkujve ishte pak më e vogël dhe sillej në rreth 30%, kurse shkalla e papunësisë së femrave ishte dyfish më e madhe dhe sillej në rreth 60%. Numri i të papunëve të regjistruar në vitin 2005 sillej në rreth 32 000

persona por numri real i te papunëve ishte shumë më i madh për shkak se një numër personash të papunë nuk e konsideronin më efekt regjistrimin në Entin e Statistikave të Punës pasi që kishin humbur besimin se përmes institucioneve mund të zgjidhnin problemin e punësimit. Prandaj, papunësia e regjistruar dhe shkalla reale e papunësisë në Kosovë në këtë periudhë dallohen si për nga indikatorët rlativë ashtu edhe ata absolutë.

Siç dihet, në Kosovë nuk ka pasë regjistrim të popullsisë që nga viti 1981. Mungesa e bazës së të dhënave për numrin, strukturën moshore, kualifikuese, sociale etj ka qenë evidente dhe vështirëson nxjerrjen e parametrave objektivë të aktivitetit ekonomik të popullsisë në periudhën që po analizojmë. Një e dhënë më e besueshme për numrin e të papunëve në Kosovë janë ato të **Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)**. Në Kosovë, pas luftës ka patur një lëvizje pothuajse masive të popullsisë nga zonat rurale drejt qendrave urbane. Se sa është numri i atyre që ndërruan venbanimin në këtë periudhe nuk ka të dhëna. As për struktura sociale, moshore e kualifikuese nuk ka të dhëna. Të dhënat për numrin e punë kërkuësve të regjistruar flasin se mbi 60% e tyre ishin persona me arsim fillor, 35% me arsim të mesëm dhe vetëm 1.5% me arsim universitar. Numri më i madh i të papunëve i takonte grupmoshës 25-39 vjeç.

“Në mungesë të ambientit të shëndetshëm për investime, në Kosovë papunësia mbetet shumë e lartë. Aktualisht manipulohet me të dhëna të ndryshme mbi shkallën e papunësisë. Derisa Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale evidenton shifrën e shkallës së papunësisë 42.9%, sipas vlerësimeve të lira nga institucione dhe autorë të ndryshëm, shkalla e papunësisë shkon deri në 50%.”⁶⁷

Efekti makroekonomik i privatizimit në rritjen ekonomike është i lidhur ngusht me tërheqjen e kapitalit për investime, si dhe për stimulimin e kursimit. Të dhënat flasin për një vëllim shumë të vogël të investimeve në periudhën 2005-2008. Në vitin 2008 vëllimi i investimeve private ishte vetëm 853 milionë euro, të cilat së bashku me investimet qeveritare mezi arrijnë në 1.200 milionë euro.

⁶⁷ Ismail Kastrati: *“Rrënimi dhe rimëkëmbja e Kosovës: 1998-2005”*, Prishtinë, 2012.

Nga anketa e cituar rezulton qëmbi 60% e pronarëve që kanë privatizuar ndërmarrjet shoqërore nuk kanë realizuar asnjë investim pas privatizimit, kurse vetem 9% e ndërmarrjeve pas privatizimit kanë realizuar investime në ndërtimin e objekteve të reja, 16% e ndërmarrjeve të privatizuara kanë investuar në makineri dhe paisje. Në trajnime kanë investuar vetëm 2.3% e tyre. Kjo dinamikë e ngadaltë e investimeve në ndërmarrjet e privatizuara është pasojë e mungesës së potencialit investiv të pronarëve të ndërmarrjeve të privatizuara.

Të gjitha investimet e realizuara në ndërmarrjet e privatizuara janë bërë nga fondet vetanake të pronarëve që nënkupton këtu edhe mundësinë e kredimarrjes dhe mbështetjes nga kursimet familjare. Meqenëse kushtet e blerjes përmes tenderimit favorizonin ofertën me çmim më të lartë, blerësit e pronës shoqërore shpenzonin të gjithë potencialin financiar, ose për blerje kishin shfrytëzuar kredi që për rrethanat e Kosovës ishin tepër të shtrenjta dhe me kushte kthimi tepër të pafavorshme. Në anën tjetër, prej momentit të shpalljes së blerësit deri te nënshkrimi i kontratës për blerje shpenzohej pa nevojë shumë kohë e cila, po ashtu i ashpëron vështërsitë financiare dhe investimet e reja.

Në pjesën e analizës së metodës së *Spinoff-it Special* është bërë analiza e investimeve në ndërmarrjet e privatizuara me këtë metodë. Në realitet, investimet e realizuara në këto ndërmarrje janë përafërsisht të barabartame obligimet kontraktuale. Nga informatat e AKP-së rezulton se investimet e raportuara nga këto subjekte në disa raste janë të kontestueshme dhe të papranueshme sepse dyshohet që vëllimi real i investimeve në këto ndërmarrje është më i ulët se sa vet deklarimi.

Një numër i madh i ndërmarrjeve të privatizuara, në mungesë të mjeteve për riaktivizimin e tyre, janë shitur te blerësi i ri. Është indikativ fakti që në procesin e privatizimit kapitali i huaj mer pjesë me vetëm 12%. Ky indikator tregon se procesi i privatizimit ka dështuar edhe në aspekt të tërheqjes së investimeve të huaja, qoftë në procesin e privatizimit, qoftë në investimet e pas privatizimit.

Duke analizuar performancën e ndërmarrjeve të privatizuara deri në mesin e vitit 2008, duke sintetizuar efektin e të gjithë indikatorëve në ritmin e rritjes ekonomike të vendit, mund të konkludojmë se gjatë procesit të privatizimit, realizuar në periudhën e administrimit të Kosovës nga UNMIK-u, pra deri në qershor të vitit 2008, nuk vërejmë ndonjë ndikim të theksuar pozitiv të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, nëqoftëse këto i marrim të tëra së bashku. Përgjatë kësaj, disa ndërmarrje, të cilat pas privatizimit me sukses e filluan aktivitetin biznesor duke e rimarrë tregun e humbur, duke i ripërtirë paisjet dhe duke e aplikuar teknologjinë bashkëkohore shpejt dëshmuar për vitalitetin dhe efektivitetin e sektorit privat në zhvillimin ekonomik, punësim dhe sidomos në rritjen e eksportit. Por, megjithatë ky numër është mjaft simbolik, sepse vetëm 15% kanë nivel të lartë të teknologjisë, kurse pjesa tjetër, ose janë në nivel me ndërmarrjet tjera të sektorit ose nën këtë nivel.

4.3.0. Efektet e privatizimit në stabilitetin makroekonomik dhe rritjen ekonomike

Gjatë dekadës së fundit të shekullit të kaluar, popullsia e Kosovës ka vuajtur shumë nga trazira, dhuna dhe presione të ndryshme ekonomike dhe politike. *“Në dekadën e fundit Kosovaret i ishin nështruar tranzicionit, mospërfilljes dhe përjashtimit të komunitetit shqiptar gjatë kohës së Millosheviqit, për të përfunduar me konfliktin e armatosur me 1999. Studimet ekzistuese tregojnë se në fund të dekadës, prodhimi është përgjysmuar, të ardhurat kanë kollapsuar, me pak se gjysma e tyre ishin të punësuar, dhe gjysma jetonin në varfëri”*⁶⁸. Me gjithë performancën e mirë makroekonomike, pas përfundimit të konfliktit të armatosur në vitin 1999, progresi në përmirësimin e standardit të jetës në Kosovë ka qenë i ngadaltë, i pamjaftueshëm dhe i pa barabartë.

⁶⁸Banka Botërore: **Raporti nr. 32378-XK**; “Vlerësimi i varfërisë në Kosovë, Promovim i mundësisë, sigurisë dhe pjesëmarrjes për të gjithë”, 16 qershor 2005.

Mungesa e statistikave ekonomike e vështirëson shumë vlerësimin e zhvillimeve ekonomike në vitet e para të pas luftës. Zhvillimet dinamike në periudhën e rindërtimit dhe rimëkëmbjes ekonomike nuk zgjaten shumë . Ashtu, siç ngjanë në secilin vend pas konflikteve dhe trazirave kjo rritje ishte e ndikuar nga mbështetja dhe ndihmat e jashtme dhe nga remitancat, të cilat së bashku përbënin rreth 50% të GDP. Aktiviteti ekonomik ishte në nivel shumë të ulët pasi që potenciale të vendit nuk ishin funksionalizuar, ndërsa që vetëm 1/3 e potencialit të fuqisë punëtore ishte aktive.

Përpijekjet e popullsisë së Kosovës për rindërtimin e vendit u mbështeten nga një program i gjërë i asistencës së donatorëve. Dhe kjo përpjekje rezultoi me një përparim të konsiderueshëm, i cili vuri themelet e rimëkëmbjes ekonomike dhe ndërtimit të institucioneve të shtetit, të ekonomisë së tregut dhe të përkujdesjes sociale.

Në këtë periudhë është futur marka gjermane si mjet zyrtar i pagesave dhe më pastaj konvertimi me sukses në euro. Janë ndërtuar institucionet e të hyrave fiskale, janë nxjerrë aktet normative që rregullonin politikat fiskale dhe të hartimit të buxhetit, i cili do të bazohet në rritjen e vazhdueshme të të hyrave. Ngritja e tregtisë së jashtme (*Liberale*) me një regjim transparent të tregtisë dhe të doganave, krijimi institucional dhe infrastruktura ligjore për nxitjen e zhvillimit të ndërmarrjeve private dhe të ndërmarrjeve publike, si dhe ngritja e një kuadri institucional dhe rregullator për bankat e rendit të dytë (*disa nga bankat e huaja kishin filluar veprimtarinë e tyre në Kosovë*).

Kur këtyre përpjekjeve iu shtohen edhe përpjekjet në ndërtimin e institucioneve shtetërore në nivel lokal dhe qendror, të cilat kurorëzohen me zgjedhjet e para pluraliste e demokratike për pushtetin lokal, dhe një vit më vonë edhe zgjedhjet e përgjithshme që rezultuan me konstituimin e Kuvendit pluralist të Kosovës dhe me zgjedhjen e Presidentit dhe të Qeverisë së Kosovës, rezulton se Kosova menjëherë pas luftës me përkrahjen e faktorit ndërkombëtar, paralelisht me kthimin e popullsisë së zhvendosur, rindërtimit të vendit, rimëkëmbjes së ekonomisë, kishte filluar një front të gjërë të tranzicionit. Kjo edhe është e kuptueshme dhe e pritur pasi që Kosovarët ishin të vetëdijshëm për kohën e humbur të viteve nëntëdhjetë, për prapambetjen nën okupim dhe për dëmet e shkaktuara nga lufta

në kohën kur vendet e tjera, e sidomos të gjitha ish-vendet socialiste kishin filluar dhe po realizonin me sukses ndryshimet rrënjësore në sistemin politik, ekonomik dhe social. Ato kishin bërë hapa të rëndësishëm në procesin e tranzicionit.

Kosova edhe në të kaluarën derisa ishte në përbërjen e ish-Jugosllavisë ka qenë regjioni më i pazhvilluar. Politikat diskriminuese të shtetit komunist, jo që nuk kishin ndihmuar në ngushtimin e dallimit në nivel të zhvillimit por këto diferenca në nivel të zhvillimit ishin thelluar vazhdimisht. Në prag të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, Kosova kishte rënë në nivelin e 25% të mesatarës më GDP për kokë banori. Edhe të gjithë indikatorët tjerë makroekonomik të Kosovës në krahasim me mesataren e shtetit ishin në këtë nivel. Kjo situatë është përkeqësuar edhe më tepër kur Serbia suspendon me dhunë autonominë e Kosovës, shpërben institucionet shtetërore të Kosovës, vendosë masat e dhunëshme në administratë,ekonomi dhe institucione arsimore dhe të kulturës. Largon punëtorët shqiptarë nga puna, integron ndërmarrjet e Kosovës me ato të Serbisë dhe në shumicën e rasteve i bartë asetet e tyre financiare dhe fizike në Serbi.

Në këtë situatë, popullsia e shtërnguar nga masat e egra repressive, si dhe përballja me problemet ekzistenciale, zhgjidhjen e kërkon në largimin nga vendi. Vetëm brenda një dekade nga Kosova migroi çereku i popullsisë së vendit, ose rreth 500 mijë persona. Ky ishte edhe qëllimi i regjimit serb të Beogradit, i cili i frikësohej tej mase zhvillimeve demografike të popullsisë shqiptare të Kosovës, e cila kishte normën më të lartë të shtimit demografik në Europë. (Në vitet e 80-ta ky shtim ishte 2.4% në vit). Kurse në strukturën moshore 50% e popullsisë janë deri në 25 vjet.

Në anën tjetër, shtimi demografik në Serbi në këtë periudhë kishte parashenjën negative. Një studim i ***Qendrës për Studime Demografike të Beogradit*** kishte projektuar ecuritë demografike në Serbi, përfshirë këtu edhe Kosovën. Rezultatet e këtij studimi kishin tronditur lidhshkrimin dhe demografët serb, të cilëve projeksionet iu paralajmëronin se në mesin e shekullit XXI në Serbi do të ketë më shumë shqiptarë se sa serb⁶⁹. Të alarmuar, Qeveria Serbe urdhëroi programin e masave administrative për planifikimin familjes në

⁶⁹ Institut Drustvenih Nauka, Centar za Demografska Istrazivanja, Beograd: ***"Demografski razvoj i populaciona Politika SAP Kosova"***, tetor 1988.

Kosovë. *(Ky program ishte program masash diskriminuese për zvoglimin e lindjeve të femrave Kosovare)*. Në historinë e raporteve në mes serbëve dhe popullsisë shqiptare të Kosovës ky nuk është program i parë i kësaj natyre. Por, siç duket shkenca demografike e Serbisë, e verbuar nga shofenizmi nuk kishte mësuar se zhvillimi ekonomik është faktori kyç që rregullon ecuritë demografike dhe vetvetiu sjell deri te planifikimi i familjes. Lënja në prapambeturi si dhe varfëria janë stimuluesit më të mëdhenj të shtimit dinamik demografik. Dhe kjo në fakt ndodhi në Kosovë. Për pesëdhjetë vjet të pushtetit komunist, popullsia shqiptare e Kosovës realizoi normë më të ulët të zhvillimit ekonomik dhe normën më të lartë të shtimit të popullsisë.

Për arritjen e qëllimeve të saja Serbia krijoi infrastrukturën e dominimit politik, ekonomik, social dhe psikologjik ndaj popullsisë së Kosovës. Me masat në vazhdimësitë politikave ekonomike e politike u reduktua pavarësia ekonomike, e cila deri atëhere në bazë të Kushtetutës së Ish-Jugosllavisë ishte e barabartë me pavaresinë ekonomike të njësive tjera federale. Këto masa diskriminuese dhe represive patën për pasojë:

- Rënien drastike të produktit shoqëror dhe të nivelit të zhvillimit ekonomik;
- Rënien e aktiviteteve prodhuese;
- Rënien e investimeve;
- Dëmet në të gjitha ndërmarrjet shtetërore e sidomos në sistemet e mëdha ekonomike;
- Humbjen e tregjeve e sidomos atyre eksportuese;
- Paralizën e institucioneve të sistemit financiar.⁷⁰

Sipas të dhënave nga i njëjti burim, rënia e aktivitetit ekonomik dhe e produktit shoqëror në periudhën deri në fillim të konfliktit të armatosur me 1998 ishte si vijon: Produkti shoqëror i ekonomisë ka rënë për 47,5%. Nga kjo rënia në industri rreth 72%, në hidroekonomi 77.5%, ndërtimtari 80.2%, pastaj në komunikacion, veprimtari komunale etj.

⁷⁰“*Aktivitetet ekonomike dhe zhvillimi demokratik i Kosovës*”- Projekt Studimor; RIINVEST, shtator 1998.

Rënia e thellë e aktiviteteve ekonomike pati konsekuenca të mëdha zhvillimore dhe sociale, si dhe në zhvillimin afatgjatë të ekonomisë. Për ilustrim po japim faktin se në strukturën e ekonomisë shoqërore të Kosovës, industria kishte pjesëmarrjen mbi 47% (viti 1988) dhe pastaj kjo pjesëmarrje bie në 33.8% në vitin 1996 (*viti i fundit për të cilin mund të sigurohen të dhënat zyrtare*). Në të njejtën periudhë produkti i krijuar në sektorin shoqëror të ekonomisë ka rënë nga 60% në 53%.

Në periudhën 1990 deri me 1995 produkti shoqëror ka rënë nga 1.330 mil. USD në 720 mil. USD. Pra, një rënie në vlerë absolute për afër 50%. Ky krahasim për këtë periudhë jepet për arsye se në vitet në vijim nuk kemi informacione për indikatorët makroekonomik të Kosovës.⁷¹ Sipas të njejtave burime, GDP për banorë kishte rënë nga 689 USD në vitin 1990 në 340 USD në vitin 1995. Numri i të punësuarve kishte rënë nga 245 mijë në 143 mijë.

Sipas vleresimeve të Institutit Riinvest në prag të konfliktit në Kosovë kishte 2.3 milion banorë nga të cilët rreth 469 mijë popullsi aktive ose 30% e popullsisë së përgjithshme. Këto trende negative të zhvillimit dhe aktivitetit ekonomik të popullsisë, në periudhën deri në fillimin e konfliktit, bëri që Kosova të renditet në vendin e fundit në regjion për kah produkti shoqëror i ulët. Kjo i ngushtoi mundësitë e mbajtjes së një ekuilibri ekonomik, social dhe demografik në Kosovë.

Përfundimi i luftës e gjeti Kosovën në gjendje më të rënduar edhe për shkak të shkatërrimeve nga lufta, ekzodi i popullsisë dhe traumat e luftës. Të dhënat lidhur me këtë janë paraqitë në fillin të këtij punimi. Pasqyrimi i shkurtë i situatës ekonomike, sociale dhe psikologjike, mendoj se e lehtëson të kuptuarit e zhvillimit të situatës sociale dhe të ndërtimit të politikave sociale në periudhën e administrimit të Kosovës nga Kombet e Bashkuara.

⁷¹*Burimi: Vjetarët Statistikorë të Jugosllavisë sipas viteve.*

Problemet kyçe para fillimit të etapës së zhvillimit ekonomik, pas periudhës së rindërtimit ishin ato që lidhen me momentet që e karakterizojnë çekuilibrin strukturor ekonomik. Së pari, gjendja e çekuilibruar në mes prodhimit dhe konsumit. Ashtu siç ngjanë në secilin vend që ka hyrë në tranzicion, pas shembjes së pushtetit monist dhe braktisjes së ekonomisë së dirigjuar, prodhimi nuk përmbush as për së afërmi nevojat për konsum të popullsisë. Çekuilibri në mes importeve dhe eksporteve, çekuilibri në mes ofertës së fuqisë punëtore dhe kërkesës së tregut të fuqisë punëtore dhe çekuilibri në mes të hyrave buxhetore dhe nevojave bazike për mbulimin e shpenzimeve publike.

Rimëkëmbja e shpejte e aktiviteteve ekonomike e mundësuar nga mbështetja e fuqishme e donatoreve dhe e dërgesave nga diaspora pas periudhës emergjente filloi të bjerë.

Megjithatë, rimëkëmbja e lëmive kryesore ekonomike si në industri, bujqësi dhe miniera, ishte e ngadaltë. Shumë ndërmarrje në pronesi publike e kanë të dobësuar aktivitetin e vet ekonomik. Me përjashtim të kapaciteteve gjeneruese energjetike, të cilat për shkak të rëndësise dhe vlerës së krijuar asnjëherë nuk kishin pushuar së funksionuari, pra as gjatë periudhës së luftës (1998-1999), por prodhimtaria zhvillohej me shumë probleme për shkak të vjetërsisë së paisjeve, mungesës së pjesëve rezervë dhe mundësive të kufizuara për servisimin e defekteve të shumëta në sistemin energjetik. Në përgjithësi në sektorin e energjisë kriohej 15% e BPV.

Bujqësia ishte rimëkëmbur pjesërisht nga dëmet dhe mungesa e popullsisë në periudhën e eksodit. Bujqësia shpejt arriti që të prodhojë 25% të GDP. Aktivitete me dinamike janë realizuar në sektorin e shërbimeve, të cilat në fazën emergjente përbenin 60% të GDP. Tanimë sektori privat ishte bërë bartës i zhvillimit ekonomik, kontributi i të cilit në GDP ishte 60%. Kuptohet se krejt kjo ka ndodhur në një bazë shumë të ulët ekonomike të vendit dhe në kushte kur kapacitetet e sektorit shoqëror të pa konsoliduara, të shkatrruara nga lufta dhe të pa mbrojtura nga mungesa e titullarit të pronës.

Në bazë të të dhënave të FMN-së, në periudhën 2000-2003, mbështetja e ekonomisë së Kosovës nga asistenca e jashtme në total kapë shumën prej 4.1 miliardë euro ose sa dyfishi i GDP i vitit 2003.

Në bazë të të dhënave të Bankës Botërore, GDP për kokë banori në vitin 2003 ishte 790 USD, pra mezi kishte arritë të kalonte nivelin e vitit 1990. Mirëpo, ky përmirësim i periudhës së rimëkembjes nuk është përcjellë me efekte tjera në sferën e aktivitetit ekonomik të fuqisë punëtore dhe të përmirësimit të mireqenies sociale. Papunësia dhe varfëria mbeten të shtrira gjithandej Kosovës.

Disa nga treguesit kyç makroekonomik (2004-2008).

Viti:	2004	2005	2006	2007	2008
GDP (million Eu):	2.348	2.384	2.341	2.474	2.684
Rritja e GDP për cap.(EU)	1.195	1.143	1.152	1.197	1.277

Burimi: Zyra Ndërkombëtare e Punës; Profili i sistemit të sigurisë sociale në Kosovë, Budapest 2010.

Siç është pasqyruar në tabelën e mësipërme, pas periudhës së rindërtimit dhe rimëkëmbjes, ecuritë ekonomike janë stabilizuar, por në një nivel shumë të ulët me tendencë të rënies deri në vitin 2005, kur u shënuar normë negative e rritjes së BPV për banorë, në krahasim me vitin paraprak. Tri vite tjera paraqesin stabilizim të ecurive ekonomike me tendencë të rritjes, deri në vitin 2008 kur u shënuar rritje relativisht e lartë e GDP për 5.0 %.

Por, një problem real në analizën e ecurive ekonomike, në periudhën e pas luftës në Kosovë paraqet saktësia e të dhënave. Aktualisht, FMN dhe AER-i kanë siguruar të dhënat e vlerësuara për ecurinë e indikatorëve makroekonomikë. Rishikimet e shpeshta të vlerësimeve dëshmojnë pasaktësinë e të dhënave por edhe dallimet metodologjike. Derisa FMN , UNMIK-un e trajton si kontribues të brendshëm, AER-i e konsideron edhe si kontribues rezident edhe si jorezident.

Ndryshimet në vlerësimin e shtimit demografik ndikojnë në ndryshimet e vlerësimit të konsumit. Përshtatjet e shpenzimeve të rrymës dhe ushqimit normave të shtimit

demografik, ose siç ndodhë me metodologjinë e vlerësimit të konsumit nga ana e FMN-së, të cilët në konsum e përfshijnë edhe blerjen e makinave etj. Ndryshime metodologjike në vlerësimin e ecures së parametrave makroekonomikë i bëjnë analizat tona jo mjaft të besueshme dhe të sakta. Prandaj, konsideroj se është e nevojshme të prezentohet dilema dhe problemi i shfrytëzimit të këtyre burimeve .

Me gjithë përparimin e dukshëm: *“Zhvillimi i kohëve të fundit është udhëhequr nga një lulëzim pas konfliktit të financuar nga të ardhurat zyrtare të ndihmave për zhvillim, por kjo nuk ka rezultuar në krijimin e konsiderueshëm të vendeve të punës dhe me gjasë nuk do të jetë i qëndrueshëm në mungesë të qartësisë të statusit politik të Kosovës dhe arritjes së qëndrueshmërisë së paqes dhe sigurisë për të gjithë. Derisa zhvillimi i fundit dhe pabarazia mesatare e konsumit sipas të gjitha gjasave kanë shpër në reduktimin e varfërisë në mes viteve 2000 dhe 2003, megjithatë rreth 37 % e popullatës llogaritet se jetojnë në varfëri sipas të dhënave nga anketa e buxhetit të ekonomive familjare (ABEF) 2002-2003. Kohezioni i brishtë social, kushtet e dobëta të mjedisit, dhe infrastrukturat e pakëta industriale dhe themelore mundën në vazhdimësi të rrezikojnë qëndrueshmërinë e zhvillimit ekonomik dhe ndikimin e saj në reduktimin e varfërisë.”*⁷²

Në zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien sociale zhvillimi i sektorit privat e sidomos i NVM-ve, kanë vend kyç. NVM-të janë forma më e përshtatshme për rritjen e të ardhurave dhe gjenerimin e vendeve të reja të punës. Metoda e nxitjes së zhvillimit, përmes stimulimit të ndërmarrësisë në formë të kapaciteteve më të vogla, për vendet në fazën fillestare të zhvillimit siç është Kosova, është strategji e qëlluar. Si rezultat i përshtatjes së legjislacionit, politikave ekonomike numri i ndërmarrjeve private të regjistruara menjëherë pas lufte u rrit shumë shpejt, nga 29 656 biznese sa ishin në vitin 2001 në 52 000 në vitin 2006.

⁷²Banka Botërore; Raporti nr.32378-XK, *“Vlerësimi i varfërisë në Kosovë”*, qershor 2005.

Edhe pse mungesa e statistikave ekonomike nuk mundëson vlerësimin e saktë të situatës, sfidat e ruajtjes së një rritje ekonomike në dobi të zvogëlimit të varferisë mbeten shumë të mëdha në tërë periudhën e shqyrtuar. Tërheqja e donatorëve dhe zvogëlimi i mbështetjes nga jashtë, pamundësia e institucioneve vendore për marrjen e kredive nga jashtë, si dhe baza e ulët e të hyrave buxhetore, janë një sfidë tjetër para qëndrueshmërisë fiskale dhe sigurimit të një mase të mjaftueshme mjeteve për financimin e investimeve në sektorin social.

Asokohe, çështje kritike për institucionet e reja të Kosovës ishte se si të sigurohet mbështetja për zhvillimin dinamik afatgjatë. Në kushtet tanimë të përshkruara të tërheqjes së donatorëve, bazës së ulët materiale financiare dhe pamundësisë për marrjen e kredive nga jashtë, sfidat e zhvillimit ishin të shumëta dhe të mëdha. Në rrethana të statusit të padefinuar të vendit, institucioneve të brishta, shkallës së ulët të sigurisë dhe stabilitetit politik e social, nuk mund të sigurohej në masën e duhur tërheqja e investimeve të huaja direkte e as edhe e investorëve dhe partnerëve strategjikë, përmes procesit të privatizimit. Për realizimin e politikave zhvillimore dhe të mirëqenies sociale, Kosovës iu nevojiti të mbështetej në burimet e veta financiare. Duke filluar nga viti 2004 të hyrat e buxhetit të Kosovës siguroheshin 100% nga të hyrat vetanake. Por, vëllimi i të hyrave ishte nën nivelin e nevojave dhe shumë nën nivelin e dëshiruar.

Së këndejmi, prioriteti i politikave në Kosovë u bë përcaktimi i mirë dhe efektiviteti i shpenzimeve publike. Kjo situatë e bënte të vështirë zgjedhjen dhe përcaktimin e prioritetëve strategjike afatmesme me kusht të garantimit të qëndrueshmërisë fiskale.

Në kuadër të angazhimit maksimal të potencialeve të veta për nevojat e zhvillimit ekonomik, përdorimi dhe mobilizimi i burimeve të mjaftueshme buxhetore u orientua në këto prioritete të përgjithëshme ekonomike: në nxitjen dhe rritjen e zhvillimit ekonomik, rritjen e punësimit dhe krijimin e kushteve për një ekonomi të tregut të lirë; në përmirësimin e standardit të jetës për grupet e pambrojtura përmes përmirësimit të kushteve për arsim, rritjen e cilësisë dhe përshtatjen nevojave të ekonomisë, përmirësimit të

shërbimeve shëndetësore dhe sigurimin e një administrate publike efikase, transparente dhe të aftë.

Objektivat e institucioneve të sapoformuara vendore të Kosovës, krahas institucioneve të UNMIK-ut, ishin: zhvillimi i shpejtë ekonomik, rritja e punësimit në sektorin privat dhe përmirësimi i përgjithshëm i standardit të jetës. Këto objektiva kushtëzoheshin me zbatimin e qartë të reformës strukturore shumëpalëshe, për çka nevojitej ndërhyrje në përmirësimin e mjedisit biznesor të sektorit privat, me qëllim të tërheqjes së IHD, nxitjes së konkurrencës dhe produktivitetit të ekonomisë, si dhe krijimit të kushteve për përfitime të barabarta nga zhvillimi i të gjitha grupeve në Kosovë.

Me fjalë tjera duhet thënë se; nëqoftëse këtyre angazhimeve iu bashkohën edhe përgatitjet për fillimin e procesit të privatizimit, në Kosovë pas periudhës së rindërtimit dhe të rimëkëmbjes ka filluar intenzivisht realizimi i procesit të tranzicionit.

Ndërtimi i infrastrukturës ligjore, krijimi i kushteve për nxitjen e investimeve në sektorin privat, sidomos në bizneset e reja, krijimi i kushteve dhe mjedisi të një shkalle të lartë sigurie dhe mjedisi të përshtatshëm të bërit biznes, kërkon angazhim të përqendruar dhe të gjithanshëm të të gjitha institucioneve. Siguria e përgjithshme, siguria e pronës, siguria e zbatimit të kontratave dhe siguria dhe barazia e investitorëve, mundëson tërheqjen e investimeve të huaja.

Në kuadër të këtyre angazhimeve institucionale, këtë periudhë kohore, prioritet zunë aprovimi, riformulimi dhe rrumbulaksimi i infrastrukturës ligjore lidhur me hipotekat, falimentimin, konkurrencën, të drejtat e pronës. Të gjitha këto kishin edhe një qëllim shtesë: kalimin nga informaliteti në ekonomi formale. Por, në këto rrethana nuk ishin më pak të rëndësishme as: krijimi i tregut të tokës bujqësore, rritja e kapaciteteve të organeve të gjyqësisë, ngritja e kapaciteteve të administratës tatimore dhe të doganave, si dhe zhvillimi i një sistemi efikas financiar.

4.4.0.Efektet e privatizimit në sektorin Privat

Ndërtimi i sistemit të ekonomisë së hapur të tregut ishte parakusht i domosdoshëm për mobilizimin e resurseve disponuese natyrore,financiare dhe humane.Në fakt, ky është një sistem efikas ekonomik i dëshmuar. Ndërtimi i infrastrukturës ligjore dhe institucionale ishte kusht i domosdoshëm për t’iu shmangë anarkisë dhe kaosit të trashëguar nga periudhat paraprake si dhe nga lufta. Përcaktimi i institucioneve për sistemin e ekonomisë së hapur të tregut, së bashku me strategjinë e zhvillimit të NVM-ve nënkuptojnë përcaktim për një zhvillim ekonomik dinamik dhe stabil. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë treguar shumë efikase në përshtatjen e kushteve dhe kërkesave të tregut. Po ashtu, dihet mirëfilli se NVM-të janë burim kryesor i gjenerimit të vendeve të reja të punës. Meqenëse fuqia akumuluese e ekonomisë së Kosovës ishte shumë e ulët, themelimi i NVM-ve ishte variant më i përshtatshëm pasi që për themelimin e një ndërmarrje të vogël nuk kërkohet shumë kapital themeltar. Prandaj, në tërë periudhën, deri në vitin 2008, 98% e ndërmarrjeve private në Kosovë ishin mikro ndërmarrje, 1.5% ndërmarrje të vogla dhe vetëm 0,3% janë ndërmarrje të mesme ose të vogla.⁷³

Sipas të njëjtit burim, numri i ndërmarrjeve të regjistruara në vitin 2008 ishte 62.472, nga të cilat në sektorin e tregtisë 47,2%, 35,7% ndërmarrje shërbyese dhe 15% ndërmarrje prodhuese.

Në përgjithësi, në vitet e para përforma e sektorit privat ishte modeste. Për dallim nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, ndërmarrjet mikro, që siç u tha më lartë përbenin shumicën e ndërmarrjeve, kanë shënuar rënie të qarkullimit në vijëmsi. Për nga rritja e numrit të të punësuarve këto ndërmarrje kanë treguar performancë të mirë. Ndërmarrjet private të sektorit prodhues kanë punësuar 1/3 e të punësuarve në sektorin privat. Edhe pse ky sektor u tregua mjaft vital në vitet e para të ekzistencës së vet pati mjaft barriera dhe problem në zhvillim si në atë të brendshëm, ashtu edhe të ambientit biznesor. Kryesisht barrierat e të bërit biznes lidhen me infrastrukturën, joformalitetin dhe barrierat nga niveli i ulët i zhvillimit, që kryesisht lidhen me sundimin e ligjit, korrupsionin, evazionin fiskal dhe

⁷³Instituti “RIINVEST”: *“Situata socio-ekonomike në Kosovë”*, shtator 2008.

informalitetin. Informaliteti është konsideruar si bariera e dytë e zhvillimit të sektorit privat. Përmasat e rritjes së sektorit informal në Kosovë në këtë periudhë ishin shqetësuese. Edhe pse nuk ka ndonjë analizë për ekonominë informale, vlerësohet se përpos tjerash deri në 35% e GDP është nga sektori informal. Në fillim (viti 2003), më shumë se gjysma e të punësuarve ishin të punësuar në këtë sektor, dhe punonin pa kontrata ose në ndërmarrjet e paregjistruara. Nga disa raporte të inspektorëve të punës rezulton se rreth 30% e të punësuarve në ndërmarrjet e regjistruara nuk kanë kontratë pune, pra dukuria e kalimit të informalitetit në sektorin formal.

4.4.1. Efektet e privatizimit në zhvillimin e bujqësisë

Deri në vitet e nëntëdhjeta Kosova ishte një vend industrialo agrar. Prodhimtaria bujqësore dhe peshkataria në strukturën e prodhimit vendor mernin pjesë me 24%. Kosova ka kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë. Ajo disponon me 400 mijë hektarë tokë bujqësore nga të cilat rreth 300 mijë hektarë ara dhe kopshtije.

Në strukturën pronësorë dominon sektori privat në pronësi të të cilit gjenden 88 % e sipërfaqeve bujqësore ndërsa pjesa tjetër 12% i takonte sektorit shoqëror. Pronësia mbi tokën në Kosovë ishte e plotë dhe sipas ligjit mund të shitej, falej apo të vihej në hipotekë.

Tokat bujqësore në pronësi shoqërore ishin të organizuara në kooperativa bujqësore të cilat udhëhiqeshin nga Këshillat e punëtorëve njisoj sikurse ndërmarrjet tjera shoqërore. Ky sektor punësonte 5% të të punësuarve në sektorin shoqëror të ekonomisë.

Prodhimet kryesore bujqësore ishin drithrat, bimët industriale, luledielli, panxharsheqeri, duhani, etj. Prodhimet me baze bujqësinë ishin mjaft mirë të pranuar edhe në tregjet e huaja.

Sektori privat i bujqësisë ishte mirë i konsoliduar. I ndarë në 290 mijë ekonomi, përveq për plotësimin e nevojave vetanake prodhonte edhe për treg.

Pas luftës janë evidentuar 137 ndërmarrje shoqërore/pronare të tokave bujqësore/ të cilat kishin në posedim 46 mijë hektarë tokë bujqësore. Në periudhën e analizuar deri në 2008 përmes tenderimit janë privatizuar 112 ndërmarrje me 23 930 hektarë tokë. Nga shitja janë inkasuar 93 milion Eu. Edhe keto mjete qendrojnë të bllokuara në Fondin e Mirëbesimit sikurse mjetet tjera nga privatizimi.

Në procesin e privatizimit të tokave bujqësore kanë ndodhë shkelje ligji dhe parregullsi të natyrave të krimit të organizuar duke u bartë pronësia në “ish” pronarët përmes ndërhyrjeve në dokumentet katastrale. Kjo dukuri e paligjshme ka ndodhë kryesisht në mjediset me popullsi serbe dhe në afërsi të qyteteve aty ku vlera e tokës ishte shumëfish më e lartë se sa në mjediset rurale.

Në Ligjin për tokën bujqësore të nxjerrë me 2005 Toka bujqësore definohet si pasuri natyrore me interes të përgjithshëm dhe ka mbrojtje të veçantë. Ligji njeh pronarët dhe poseduesit e tokës bujqësore. Mirëpo, ashtu siq është cekë më parë në këtë punim, Ligji për AKM, me rastin e privatizimit të ndonjë ndërmarrjeje shoqërore nuk e lejon shitjen e tokës, por e ndanë atë nga asetet dhe bleresit ia jep në shfrytëzim për 99 vite. Pra jo në pronësi. Kjo, konsideroj që është edhe njëra nga pengesat kryesore për ardhjen e investitorëve të jashtëm.

Analiza e strukture së ekonomisë së Kosovës në periudhën e pas luftës tregon se zhvillimi ekonomik është përqendruar kryesisht në bujqësi dhe shërbime, të cilat në strukturën e GDP marrin pjesë me nga 12%. Ndërtimet dhe patundëshmëritë, po ashtu për shkak të kërkesës së madhe për ndërtimin e shtëpive së bashku marrin pjesë 25% në krijimin e GDP. Edhe përkundër faktit se bujqësia na del sektori kyç i ekonomisë në këtë periudhë, pjesëmarrja e saj në strukturën e GDP është përgjysmë më e vogël se sa në vitin 1980.

Zhvillimi i ngadalshëm i bujqësisë nuk ka penguar që ky sektor të jetë bartësi kryesor i punësimit me deri në 35% të të gjitha punësimeve. Kuptohet, duke llogaritur këtu edhe pjesën informale. Ky zhvillim i ngadaltë i sektorit është pasojë e demëve të luftës, shkatërrimit të infrastrukturës, paisjeve, fondit të bagëtive por edhe i humbjes së tregjeve tradicionale të eksportit.

Struktura e produkteve bujqësore është e dominuar nga drithrat (50%). Ndërmarrjet dhe prodhimtaria bujqësore karakterizohet me ferma të vogla, të cilave iu mungojnë shërbimet konsulente. Sipërfaqet bujqësore të dedikuara për prodhimtari nuk kanë ndryshuar në krahasim me periudhën e paraluftës. Rendimentet e ulëta nuk mundësojnë ndonjë profit përveç plotësimit të nevojave familjare. As fondi i bagëtive nuk është rritur. Në përgjithësi prodhimtaria bujqësore rreth 70% i dedikohet konsumit vetanak . Derisa 30% e prodhimtarisë së destinuar tregut është prodhimtari me përparësi krahasuese.

4.4.2.Efektet në industri

Deri në fillim të viteve nëntëdhjetë industria ishte lëmia kryesore ekonomike e Kosovës. Në industri ishin të punësuar 46% të të punësuarve të sektorit shoqëror, kurse në strukurën e GDP, prodhimi industrial merrte pjesë me 40%. Ndër degët kryesore të industrisë në atë kohë vecojmë Elektro Ekoniminë, Prodhimin dhe përpunimin e thëngjillit, Metalurgjinë e zezë, Metalurgjinë me ngjyrë, Veprimtaritë metalopërpunuese, Industria kimike, e tekstilit dhe industria ushqimore. Janë të njohura komplekset e mëdha si “Trepca”, “Elekokosova”, “Ballkani”, dhe ndërmarrjet tjera të kompleksit agro industrial.

Pas luftës, me fillimin e procesit të privatizimit shumë nga këto ndërmarrje janë privatizuar, ndër to Feronikeli , Ballkani, Fabrika e Tubave ,Llamkos, Amortizerat, Fabrika e Autopjesëve, etj. Kompleksi Trepca ka mbetë nën administrimit të AKM-AKP-s dhe po punon me vështësi tepër të mëdha duke u subvencionu nga Buxheti. Ndërmarrjet tjera Industriale, përveq Feronikelit, pas privatizimit, në pamundësi të investojnë në teknologji të re, pas shitjes së inventarit dhe makinerisë së vjetëruar ose e kanë nderruar veprimtarinë ose e kanë pushuar fare.

Përveq rezultateve të mira që realizoi Feronikeli në të cilin pas privatizimit janë punësuar mbi njëmijë punëtorë dhe ka ndikuar dukshëm në rritjen e eksportit si dhe të Verarisë në Rahovec, pak nga ndërmarrjet tjera industriale kanë arritë që të rimëkëmben .

Aktualisht prodhimtaria industriale mer pjesë me 15% në prodhimtarinë e gjithënbarshme të vendit. Shumë degë mjaft atraktive tanimë nuk ekzistojnë fare si industria Kimike, veprimtaritë metalopërpunuese, etj. Prodhimi e energjise është përgjysmuar në krahasim me vitet e tetedhjeta, derisa nga Trepca eksportohen sasi të vogla xehesh të papërpunuara. Nga buxheti i vendit paguhen 2800 pensionist te parakohshëm /ish minator / të trepcës. Te gjithë të punësuarit në ndërmarrjet industriale të privatizuara që nuk janë aktivizuar janë të papunë, ose janë punësuar në sektorë tjerë.

KAPITULLI V: EFEKTET E PRIVATIZIMIT NË POLITIKAT SOCIALE

5.1.0 Vështrim i shkurtër i gjendjes ekonomike e sociale në Kosovë

Clirimi i vendit nga okupimi një shekullor serb dhe gjysmë shekulli diktaturë komuniste ushqeui shpresa të mëdha të kosovarët, të cilat shumë shpejt ua lënë vendin zhgënjimeve dhe dëshprimeve të thella... shumë njerëz, të cilët sinqerisht besonin se sapo rendi komunist të shembej, progresi drejt lirisë, demokracisë dhe prosperitetit do të ishte linear dhe i pandalshëm. Zhgënjimet që rezultuan, kur u kuptua se kjo ishte praktikisht e pamundur, ishin në proporcion të drejtë me shkallën, në të cilën njerëzit kishin besuar këtë ëndërr. Nëse shpresat tek të cilat njerëzit besojnë me pasion nuk realizohen, kjo, natyrisht, krijon deziluzione. Sa më të mëdha të jenë shpresat dhe sa më i sinqertë të jetë besimi në realizimin e tyre, aq më i thellë është deziluzioni që provohet nga dështimi i tyre.”⁷⁴

Ashtu siç është thënë më lartë në këtë punim, përfundimi i luftës në mesin e vitit 1999 popullsinë e Kosovës e gjeti në gjendje të nevojave emergjente. Mungonte ushqimi, banimi dhe mjetet higjienike. Në dy vitet e para nuk kishte as të dhëna përsa i përket profilit të varfërisë dhe problemeve tjera sociale në Kosovë. Në fakt, niveli i varfërisë nuk përfshinte vetëm aspektin material në kuptimin e shkallës së konsumit, por edhe aspekte tjera shoqërore e politike si: mungesa e shërbimeve bazike shëndetësore, arsim, uji i pijshëm, energjia etj. Pra, indeksi i zhvillimit njerëzor, krahas shkallës së varfërisë, Kosovën e rangonte në vendin e fundit në Evropë, shumë pas vendeve të fundit, vendeve të Evropës Juglindore.

Kosova, e cila tradicionalisht ka qenë pjesa më e pazhvilluar e Ish-Jugosllavisë, por jo edhe pjesa më e varfër sepse dispononte rezerva të konsiderueshme të thëngjillit, xeheve, pasurive nëntokësore dhe të fuqisë punëtore. Kjo situatë ekonomike vazhdoi të përkeqësohet gjatë viteve të nëntëdhjeta dhe kulmin e arriti në periudhën e konfliktit të armatësuar 98-99. “*Prodhimi industrial u rrënua. Prodhimi bujqësor, tek i cili mbështetet*

⁷⁴Fatos Tarifa, Ksenofon Krisafi, Eneda Tarifa: “*Paradigma e Tranzicionit Demokratik*” OMBRA GVD, fq 113.

pjesa dërmuese e popullsisë së Kosovës ra; tufat e blegtorisë humbën ose u therën; dhe një stinë mbjellësh iu iku koha. Mbi të gjitha, realisht të gjitha shërbimet e infrastrukturës dhe ato sociale si dhe sistemet e qeverisjes rreshtën tërësisht funksionimin e tyre. Pati dëmtime të ndjeshme në infrastrukturë, veqanërisht në numrin e shtëpive të banimit.”⁷⁵

Vendosje e Institucioneve Ndërkombëtare në Kosovë dhe Institucionet e Vetëqeverisjes, menjëherë pas vendosjes së paqes u përballen me sfidën e ndërtimit të institucioneve bazë qeverisëse, dhe fillimit të aktivitetit ekonomik, si dhe menagjimit të kthimit të më se një million të shpërngulurve nga shtëpitë e veta gjatë periudhës së konfliktit.

Fillimisht, për rimkëmbjen dhe rindërtimin ekonomik Kosova u ndihmua nga një program masiv i asistencës së donatorëve, i cili filloi që në qeshor të vitit 1999, pra në ditët e para të çlirimit. Nëqoftëse marrim parasysh se si rezultat i ndërtimit të institucioneve bazë dhe ndihmës së donatorëve por edhe të transfertave nga diaspora rritja e GDP në vitin 2001 e vlerësuar në terma real ishte 14%. Afër 50 mijë të huaj kishin ardhur në Kosovë për ta mbështetur në përpjekjet për rimëkëmbje dhe rindërtim por edhe për të garantuar sigurinë dhe rendin. Në këtë vit, për ilustrim, investimet dhe konsumi ishin dy herë më të mëdha se sa GDP vjetore. Për shkak të rrënimit të ekonomisë, sidomos të prodhimit, dhe nevojave të vendit për material ndërtimi, ushqimi dhe veshmbathjeve, importet arrinin në 163% të GDP të vitit 2001.

Pavarësisht rezultateve të arritura, varfëria mbeti shumë e përhapur. Në periudhën e rindërtimit të vendit, në dy vitet e para përveç faktit se afër gjysma e popullsisë ishin të varfër që do të thotë nuk kishin mundësi të i përballonin shpenzimet për ushqim me kërkesa minimale për kalori ditore ekzistonte edhe dallimi i madh në qasjen në shërbimet në shëndetësi dhe arsim. Sidomos problemet janë të dukshme në arsimin e mesëm të femrave/afër 50% e vajzave nuk ishin regjistruar në shkollën e mesme. Edhe me treguesit e shëndetësisë Kosova renditej e fundit në Evropë, sidomos brengoste shkalla e lartë e vdekshmërisë së foshnjëve.

⁷⁵BB; Raporti nr.24 880, tetor 2002, *“Kosova -Prioritetet e shpenzimeve publike afatmesme”*.

Tejkalimi i problemeve të grumbulluara nuk ishte i mundur te realizohej pa një program te reformes, e cila per synim kishte zhvillimin e shpejt ekonomik, rritjen e punesimit ne sektorin privat dhe permirësimin e pergjithshem te standardit te jetes. Pra, kërkohej zbatimi i një programi të reformës strukturore shumëpalëshe. Njëra nga tri shtyllat e kësaj reforme ishte *siguria se përfitimet nga zhvillimi do të ju jepen në mënyrë të barabartë të gjitha grupeve në Kosovë*, derisa zhvillimi intensiv ekonomik në bazë të aktivitetit në punë do të iu siguronte të ardhura për sigurimin e ekzistencës dhe prosperitetit të shtetasve. Por, jo të gjithëve. Një shkallë e zhvillimit në të cilën ndodhej Kosova në vitet e pas luftës nuk siguronte për të gjithë antarët e shoqërisë as mundësinë e punësimit e as të përfshirjes në shërbimet, në arsim, shëndetësi dhe në shërbimet tjera publike me rëndësi jetike për ekzistencë. Mendoj qe përkufizimi i bërë i përfshirjes sociale i përgjigjet më së miri nevojës dhe konceptit kosovar të përfshirjes sociale: *“Proces i cili siguron që ata që janë në rrezik nga varfëria dhe përjashtimi social të përfitojnë mundësitë dhe burimet e nevojshme për të marrë pjesë plotësisht në jetën ekonomike, sociale dhe kulturore, të gëzojnë një standard të jetesës dhe të mirëqenies që konsiderohet si standard normal për shoqërinë, në të cilën ata jetojnë. Ky koncept siguron që ata të kenë pjesëmarrje më të lartë në vendim-marrje me ndikim në jetën e tyre si dhe të kenë qasje në të drejtën e tyre themelore”*⁷⁶

Clirimi i Kosovës rezultoi me shkatërrimin e sistemit socialist të përkujdesjes sociale dhe sistemit pensional. Përveç ndryshimit të sistemit, në këtë periudhë ndodhi edhe humbja e shenimeve dhe plaçkitja e kontributeve të pensionistëve të Kosovës nga shteti Serb. Kjo situatë imponoi nevojen urgjente të reformimit të sistemit të sigurimeve sociale dhe ofrimin e të ardhurave për kategoritë me nevojë të popullsisë së Kosovës. Për këtë arsye në raportin e BB nr. 24 880 rekomandohet, përpos tjerash, edhe hartimi i treguesve të varfërisë, zhvillimi i një sistemi të monitorimit të varfërisë, profili i varfërisë dhe ofrimi periodik i të dhënave që ndihmojnë si udhëzues për përpilimin e politikave ekonomike. Po ashtu,

⁷⁶Cituar sipas: Kuvendi i Republikës së Kosovës, Letra e Bardhë, Sfidat e përfshirjes sociale në Kosovë, tetor, 2009.

rekomandohet që si objektiv i politikave sociale të përcaktohet përqendrimi tek më të varfërit.

Në sferën e arsimit rekomandohet përqendrimi në regjistrimin e vajzave dhe grupeve etnike minore të varfëra në shkollë tetëvjeçare dhe të mesme. Një aspekt tjetër i evidentuar me shumë probleme është theksuar shërbimi bazë shëndetësor për të varfërit dhe për kategoritë me të ardhura të pakta dhe për minoritetet.

Një rekomandim i posaçëm i BB i adresohet zhvillimit të kuadrit të politikave dhe planifikimit për zbatimin e strategjisë afatmesme për uljen e varfërisë.

Ndërtimi i sistemit të ri ekonomik, sistemit të ekonomisë së tregut të lirë, kërkonte zgjidhjen e problemeve që lidhen me vendosjen e ekuilibrit midis efikasitetit ekonomik, lirive individuale dhe drejtësisë sociale. Në vendet në tranzicion, ashtu si edhe në Kosovë, politikat sociale kryesisht janë realizuar nëpërmjet zvogëlimit të diferencave në paga midis kategorive të ndryshme sociale, nëpërmjet sistemit të pensioneve dhe përmes sistemit të politikave sociale. Pra, politikat sociale duhet të përcaktohen nga shteti, kurse mjetet, të cilat iu dedikohen kategorive në nevojë duhet të sigurohen nga të hyrat fiskale.

Ndërtimi i politikave sociale që mbështetet në parimet e ekonomisë së tregut kryesisht mbështetet në kalimin e funksioneve sociale nga ndërmarrja te shteti. Sipas Prof. Selman Selmanaj: *“ky kalim i funksioneve duhet të pasohet me krijimin e kushteve për funksionimin normal të tregut të fuqisë punëtore, kultivimin e shprehisë së kursimit, forcimit të sektorit privat të ekonomisë, ndërtimit të sistemit të ri të pensioneve dhe masave për mbrojtjen sociale, kalimit nga shërbimet sociale rezidenciale në shërbime sociale me bazë humanitare, kalimit nga shërbime për grupe me nevojë me shërbime për të gjithë popullsinë”*.⁷⁷ Pra, shteti duhet të përcaktojë politikat sociale, kurse institucionet shtetërore duhet të zbatojnë ato politika, por gjithnjë duke vendosë një raport të drejtë ndërmjet plotësimit të nevojave sociale dhe efikasitetit ekonomik.

⁷⁷Selman Selmanaj: *“Globalizmi dhe Tranzicioni; dilemat dhe sfidat”*, Riinvest, Prishtinë, 2006.

Ashtu siç është theksuar edhe më parë, pasojat e luftës kishin dëmtuar rëndë bazën materiale dhe standardin e popullsisë. Në këto kushte vetëm ringjallja e ekonomisë së sektorit privat do të rriste mundësinë e rritjes së punësimit, dhe standardit të jetës. Kjo shihet si shansë e nxjerrjes graduale nga varfëria e shumicës së familjeve të varfëra, me përjashtim të familjeve me varfëri të skajshme për të cilat nevojitet një nivel i veçantë i përkujdesjes sociale.

“...sendërtimi i sistemit ekonomik në Kosovë ,sipas bindjes sonë të thellë, duhet të mbështetet në sintezën e lirive ekonomike dhe në siguri e drejtësi sociale, të cilat i garanton shteti juridik. Me fjalë tjera, sendërtimi i sistemit ekonomik duhet të mbështetet në sintezën e efikasitetit ekonomik, qëllimeve të shoqërisë, liritë individuale dhe në drejtësinë sociale.”⁷⁸

“Që nga fundi i konfliktit në qershor 1999, Kosova ka përparuar në menyrë graduale drejt vetëqeverisjes. Bazuar në Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244, Sekretari i Përgjithshëm ngriti Administratën e Përkoheshme të Kombeve të Bashkuara (UNMIK), si një administratë në tranzicion. Rezoluta 1244 po ashtu parashikon që UNMIK-u të organizojë dhe mbikqyrë zhvillimin e Institucioneve të Përkohshme për Vetëqeverisjen autonome dhe demokratike në varësi të një zgjidhje politike, përfshirë mbajtjen e zgjedhjeve dhe kalimin e pushtetit, ndërkohë që këto institucione janë ngritur, kalimin e përgjegjësisë të tijë administrative. UNMIK-u ngriti katër shtylla bazë për agjencitë ndërkombëtare për të drejtuar zhvillimin politik dhe institucional në Kosovë: (i) Shtylla I për ndihma humanitare drejtuar nga UNHCR, (ii) Shtylla II për administratën civile (drejtuar nga Kombet e Bashkuara); (iii) Shtylla III për ndërtimin e demokracisë dhe Zgjedhjet (Drejtuar nga OSCE); dhe (iv) Shtylla IV për zhvillimin ekonomik dhe rindërtimin, (drejtuar nga EU).⁷⁹

⁷⁸Prof.Dr.Selman Selmanaj, Kumtesë në Konferencën: *“Sistemi i ekonomisë së hapur të tregut dhe tranzicioni në Kosovë”* 22-23 maj 1998. Prishtinë ,1988.

⁷⁹BB, *Raporti nr. 24 880*, tetor 2002,

Në fillim u ngrit Këshilli Tranzitor i Kosovës si organi më i lartë konsulltativ politik si forum i partive politike të të gjitha komuniteteve . Në fillim të vitit 2000 (*Janar*) u ngrit një strukturë e përbashkët administrative, me përfaqësues të UNMIK-ut dhe të udheheqësve vendorë. Sipas një strukture të paraparë në të katër shtyllat e UNMIK-ut u krijuan 20 departamente, të cilat drejtoheshin bashkarisht nga një këshilltar ndërkombëtar dhe një ekspert vendor. Bashkëdrejtuesit vendorë formonin Këshillin e Ministrave. Më vonë zgjidhet një **Këshill Tranzitor Administrativ (KTA)** që përbëhej nga katër ndërkombëtarë dhe katër vendorë, të cilët kishin përgjegjësi në të gjitha qështjet civile. Në vjeshtë të vitit 2000 mbahen zgjedhjet lokale dhe formohen ansambletë komunale. Në Maj 2002 u zgjodh Presidenti i Kosovës dhe u konstitua Kuvendi i Kosovës, i cili më pas zgjodhi Kryeministrin dhe Qeverinë e Kosovës. Qeveria e Kosovës e dalë nga zgjedhjet e vitit 2001 kishte 10 ministri dhe Kabinetin e Kryeministrit.

Megjithatë, *“Ndërsa Institucionet e Përkohëshme të Vetëqeverisjes kanë përgjegjësi të rëndësishme në qeverisjen e Kosovës, PSSP mbetet autoriteti më i lartë përfundimtar. PSSP nëpërmjet pushteteve që i janë rezervuar, vazhdon të mbajë përgjegjësi të drejtëpërdrejtë për ligjin dhe rendin, gjykatat, mbrojtjen e minoriteteve, përfundimin e marreveshjeve me shtetet dhe organizatat ndërkombëtare, administrimin e pronës shtetërore dhe marrjen e vendimeve në fushat kyçe të ekonomisë.”*⁸⁰

5.2.0. Disa aspekte të privatizimit dhe çështjeve sociale

Sipas ligjit në fuqi, fondi i mjeteve që krijohet nga shitja e aseteve të ndërmarrjeve shoqërore mbahet në një llogari të veçantë dhe quhet Fondi i Mirëbesimit. Ky Fond mbahet në mirëbesim për të paguar pronarët dhe kreditorët pas likuidimit të ndërmarrjeve të vjetra në pronësi shoqërore. Një pjesë e këtyre mjeteve (20%) duhet të iu paguhet ish-punëtorëve, të cilëve në bazë të Ligjit iu takojnë. Shpërndarja e këtyre mjeteve bëhet nëpërmjet **Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK)**. Përcaktimi i listës së punëtorëve, të cilët fitojnë të drejtën në bazë të Ligjit në 20%, bëhet nga një grup

⁸⁰Po aty.

përfaqësuesish të punëtorëve dhe të sindikatave. Megjithatë, në shumicën e rasteve mbetja jashtë liste e ndonjërit nga ish të punësuarit (*ose që pretendon të ketë qenë i punësuar*) ia jep të drejtën e ankimit te ***Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme***. Në mungesë të kapaciteteve, ky organ nuk arrin të shqyrtojë këto ankesa me efektivitet për çka paraqiten vonesa të stërzgjatura deri në shqyrtimin e ankesave.

Në bazë të të dhënave të AKM-s deri në qershor 2008, 20% e shumës së Fondit të Privatizimit kapte shumën prej 76 638 mijë eurosh. Nga kjo shumë, vetëm 21% ,ose 15 567 mijë euro, iu janë paguar punëtorëve. Kjo dinamikë e kompenzimit të ish-punëtorëve ka shqetësuar, jo vetëm përfituesit, sindikatat, por të gjithë opinionin e gjërë. Kjo situatë, në disa raste, ka shtyrë që këta punëtorë të injoruar të protestojnë publikisht dhe të kërcenojnë me revolta të natyrave të dhunshme nëqoftëse nuk përmbushet e drejta e tyre ligjore.

Vlerësuar objektivisht, duke patur parasysh se metoda e aplikuar e privatizimit, përveç të drejtës në 20%, nuk ka mbrojtur e as favorizuar me asnjë masë tjetër ish të punësuarit, të papunë pas privatizimit të ndërmarrjes së tyre. Dhe, prandaj, kjo metodë e aplikuar, përveç që nuk dha rezultate të pritura paraqet absurditet të llojit të veçantë. Ky absurditet bëhet edhe më i pakuptimtë karshi faktit që mjetet e Fondit të Privatizimit të ruajtura në mirëbesim, janë bllokuar, janë depozituar diku në bankat jashtë shtetit me një normë interesi të papërfillshme, madje janë nxjerrë nga qarkullimi në ekonominë e vendit dhe nuk iu paguhen as atyre që Ligji në fuqi ua garanton.

Nga një hulumtim i realizuar nga ***“Forumi 2015”***, rezulton se ndërmarrjet e privatizuara kanë bërë përppjekje për ristrukturim. Këto ndërmarrje kanë filluar me përmirsimin e metodave të prodhimit (*rreth 75% e tyre*), 13,7% kanë mbyllur linjat ekzistuese të prodhimit. Një pjesë e madhe kanë operuar me makineri dhe teknologji të kombinuar, kurse vetëm 24,2% e ndërmarrjeve të privatizuara kanë ofruar produkte dhe shërbime inovative në treg. Të dhënat, poashtu, tregojnë se vetëm 1/3 e tyre kanë filluar me prodhime të reja dhe 44% kanë filluar me metodë të re të prodhimit. Procesi i ristrukturimit është një indikator i rëndësishëm i performances së ndërmarrjeve ekonomike. Ky proces nënkupton adoptimin e sjelljeve sipas kërkesave të ekonomisë së tregut. Pritjet nga procesi i

privatizimit kanë qenë në drejtim të përmirësimit të efijencës, profitabilitetit, inovacionit dhe rritjes së vëllimit të investimeve. Ristrukturimi është një proces i domosdoshëm për sukses të ndërmarrjeve të privatizuara.

Vazhdimi i udhëheqjes të ndërmarrjeve nga strukturat e vjetra menaxhuese në shumicën e këtyre ndërmarrjeve, vazhdimi i menaxhimit nga pronarët e tyre (në 6%) si dhe pjesa tjetër e menaxhuar me forma të perziera. Kjo mënyrë e menaxhimit njëfarë dore ka bllokuar procesin e ristrukturimit. Nga përvojat e vendeve në tranzicion del se në ato privatizime, ku pjesëmarrja e kapitalit të huaj është më shumë prezente, procesi i ristrukturimit është më i thellë dhe më i suksesshëm. Ndërmarrjet e privatizuara nga kapitali i huaj në Kosovë kryesisht janë privatizuar përmes metodës së *Spinoff-it Special*, metodë kjo e cila në njëfarë mënyre paraqitet si pengesë e ristrukturimit dhe e rritjes së performances, për shkak të imponimit të kushteve të caktuara si: mbajtja e një numri të caktuar punëtorësh, edhe në rast të mos pasjes nevojë, pastaj vazhdimi i aktivitetit të njëjtë biznesor, etj.

Por, cilat ishin pengesat në zhvillimin e biznesit të ndërmarrjeve të privatizuara?

Ndërmarrjet e privatizuara kanë pasë edhe një varg pengesash për fillimin e procesit të punës. Ndër problemet më të shpeshta që kanë hasë pronarët e rinj në rastin e regjistrimit të pronës kanë ndeshë në problemin e ngarkesës tatimore nga e kaluara, pa shlyerjen e së cilës nuk ka qenë e mundur të bëhet bartja e pronës. Edhe pse këto ngarkesa realisht nuk kanë qenë barrë e ndërmarrjes së re, procedurat e regullimit të çështjes së pronësisë kanë marrë një kohë të konsiderueshme. Siç dihet në disa komuna të Kosovës, çdo shërbim publik është i kushtëzuar me fshirjen e obligimeve tatimore. Në këtë aspekt pronarët e rinj janë të diskriminuar pa të drejtë, meqenëse ata nuk janë bartës të obligimeve para datës së privatizimit⁸¹.

⁸¹Aferdita Dervishi-Berisha: *“Pas privatizimi dhe përformancat e ndërmarrjeve në Kosovë”*, Riinvest, Prishtinë, nëntor 2012.

Promblemet, me të cilat janë ndeshë ndërmarrjet e privatizuara janë kryesisht pasojë e kushteve të kontratës. Në shumicën e rasteve, pas privatizimit dhe nëshkrimit të kontratës, pronari i ri nuk e gjeti terrenin e lirë për fillimin e aktivitetit biznesor në pronën e blerë. Ndërsa në ato raste, në të cilat para privatizimit prona shoqërore ishte e uzurpuar nga individë të paligjshëm, nuk ndërmirreshin masa për lirimin e tyre, ashtu siç parashihej me politikat operationale. Një problem tjetër lidhet me mosdefinimin e saktë të kufijve kadastral të ndërmarrjes (*pronës*)⁸².

Përveç këtyre problemeve, ndërmarrjet e privatizuara janë ballafaquar edhe me një varg problemesh dhe pengesash tjera, të cilat kanë penguar rritjen e përformances së tyre. Si pengesa objektive, që më së shpeshti përmenden nga pronarët e këtyre ndërmarrjeve janë: ngarkesat e larta fiskale, procedurat administrative të komplikuar dhe të stërzgjatura, moszbatimi i ligjit, konkurenca jo lojale, korrupsioni dhe niveli i ulët i infrastrukturës ekonomike, e veçanërisht mungesa e energjisë elektrike.

Kur kemi parasysh se bizneset e privatizuara janë më të reja sesa bizneset tjera private, ballafaqimi me këto probleme si dhe tejkalimi i tyre është më i vështirë edhe për shkak se këto biznese të gjithë kapitalin e kanë shpenzuar me rastin e blerjes së ndërmarrjes. Për fillimin e punës, ripërtëritjen e paisjeve dhe rristruktuimin e ndërmarrjes, iu nevojitet kapital plotësues, të cilin mund ta sigurojnë vetëm përmes kredive të bankat komerciale. Bankat shpeshherë hezitojnë në lejimin e kredive për shkaqe krejtësisht të arsyeshme të ndërmarrjeve të privatizuara por edhe të bizneseve në përgjithësi. Bizneset e reja dhe të sapoformuara nuk e kanë të sigurtë këtë gjë!

Mungesa e politikave aktive makroekonomike, sidomos politikave fiskale dhe atyre kreditore, është njëri nga kushtet e munguara për zhvillimin dhe rritjen e përformances së rrjedhës së parasë. Në kushte të tilla, për ndërmarrjen e re çdo ngarkesë shtesë është barrë e pa përballueshme.

Të ardhurat nga privatizimi deri në qershor 2008 kapin shumën prej 392 280 mijë eurove. Këto mjete janë të bllokuara në llogari bankare, dhe si të tilla janë nxjerrë nga qarkullimi.

⁸²Banka Botërore: "Vlerësimi i varfërisë në Kosovë", tetor, 2007

Kjo shumë e parave të bllokuara paraqet rreth 15% të GDP të asaj kohe . Siç dihet bllokimi i këtyre mjeteve është bërë në bazë të Rregullores së UNMIK-u me pretekst të ruajtjes në mirëbesim e me qëllim të mbulimit të kërkesave eventuale nga kreditorë të dikurshëm brenda dhe jashtë Kosovës. E mbështjellë me petkun e ruajtjes në mirëbesim dhe të garancionit të gatishmërisë për të përmbushë obligimet eventuale, Administrata e KB në Kosovë e shtyrë nga presionet e forta të shtetit serb për kinse pronësinë dhe të drejtat pronësore në ndërmarrjet shoqërore të Kosovës, por me qëllim të hapjes së rrugës për fillimin e procesit të privatizimit u gjet ky solucion, i cili fillimisht nuk ishte i pranueshëm për palën kosovare, por u pranua si *çmim politik* me qëllim të hapjes së rrugës për fillimin e privatizimit. Gjatë tërë periudhës së Administrimit të Kosovës nga UNMIK-u, derisa administrues i këtyre mjeteve ishte AKM, të gjitha përpjekjet për zbllokimin e këtyre mjeteve, dhe hapjen e mundësisë për përdorimin e tyre për nevojat e ekonomisë dhe zgjidhjen e problemeve të shumta sociale dështuan sepse këtë nuk e lejonte administrata e KB .

Por, megjithatë, një absurd të llojit të veçantë paraqet fakti se edhe tani (*fillimi i vitit 2016*), që këto mjete janë dyfishuar në krahasim me qershorin e vitit 2008, tani kur për procesin e privatizimit kompetencën e ka një institucion vendor, (*pasardhës i AKM-së*), **Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)**. Prandaj, edhe tani, tetë vjet pas shpalljes së pavarësisë dhe ndërtimit të institucioneve të pavarura shtetërore të Kosovës, mjetet e grumbulluara në **Fondin e Mirëbesimit** kanë mbetur të ngrira dhe jashtë funksionit. Këto fonde nga dita në ditë po rriten, varësisht nga dinamika e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore. Se kur do të adresohen dhe shyrtohen kërkesat nga ana e **Dhomes së Posaçme të Gjykatës Supreme**, dhe se kur do të bëhet e mundur që një pjesë, ose të tëra këto fonde të shfrytëzohen për nevojat e ekonomisë dhe popullsisë së Kosovës, ende nuk dihet me siguri.

“Administrata e pa aftë dhe e korruptuar, jo vetëm që e shkatërroi procesin e privatizimit, i shkurtoi vendet e punës, por i la pa kurrëfarë ndihme sociale pikërisht ata punëtorë, që me dekada i kishin krijuar këto asete. Në njërën anë, Serbia i grabiti fondet e kontributeve

pensionale, në anën tjetër, Administrata Ndërkombëtare mjetet e Fondit nga privatizimi i bllokoi për interesa të pretendimeve të ndryshme, jashtë interesit të Kosovës”⁸³

5.3.0.Efektet e privatizimit në zhvillimin demografik

Sipas vlerësimeve të **Entit të Statistikave të Kosovës** (ESK), në fund të vitit 2007 në Kosovë kanë jetuar 2.130 mijë banorë⁸⁴. Sipas vlerësimeve të UNFPA rritja e numrit të popullsisë në Kosovë në periudhën e pasluftes është 34 deri 35 mijë persona në vit. Ky shtim demografik i shprehur me norma mesatare është 1.46%. Edhe vlerësimet e UNFPA-se nuk përputhen me rezultatet e regjistrimit të popullsisë. Megjithatë, një gjë është e sigurtë: shtimi i popullsisë së Kosovës në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar kanë qenë mesatarisht 2.4% gjatë gjithë periudhës. Ky shtim përcakton strukturën moshore, sociale, dhe strukturën e aktivitetit ekonomik të popullsisë aktualisht në Kosovë.

Mosha mesatare e popullsisë së Kosovës është 23 vjeç, ndërsa 1/3 e popullsisë janë nën moshën 15 vjeç dhe vetëm 6 % mbi moshën 65 vjeç. Mbi 61% e popullsisë janë në moshën ndërmjet 15 dhe 64 vjeç. Kjo strukturë e volitshme moshore e popullsisë ka bërë që kontigjenti i punës i popullsisë së Kosovës të jetë i bollshëm. Por, kapacitetet absorbuese të ekonomisë së pazhvilluar të Kosovës këtë kontigjent nuk janë në gjendje ta angazhojnë në punë. Siç është thënë edhe më parë, mungesa e regjistrimit të popullsisë për tridhjetë vjet (nga viti 1981 deri më 2011) e bënë të pamundur përcaktimin e saktë të popullsisë në moshë pune dhe të popullsisë sipas aktivitetit ekonomik. Megjithatë, **Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale (MPMS)** ka bërë vlerësimin e personave që kërkojnë punë, moshën

⁸³ Ismail Kastrati: **”Rrënimi dhe Rimëkëmbja e Kosovës: 1998-2005”**, Oda Ekonomike e Kosovës, Prishtinë, 2012.

⁸⁴ Sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 rezulton se në Kosovë jetojnë 1.800 mijë banorë. Ky ndryshim në mes vlerësimeve dhe rezultateve të regjistrimit nga shumë ekspertë është vlerësuar si deshtim i procesit të regjistrimit. Të tjerët këtë ndryshim e shpjegojnë si rezultat i shkallës së lartë të emigrimit të popullsisë.

dhe strukturën e tyre gjinore. Sipas evidencës së kësaj ministrie: numri i personave që kërkojnë punë në vitin 2008 ka qenë **334.595 persona**. Nga ky numër gati gjysma i takonin moshës 25-39 vjeç. Në bazë të të dhënave nga *Enti i Statistikave të Kosovës*, 60% e të papunëve janë punëtorë të pakualifikuar, 26% janë me shkollë të mesme, ndërsa, pjesa tjetër iu takon strukturave tjera kualifikuese.

Përkundër këtij zhvillimi të hovshëm demografik të Kosovës, gjendja e përgjithëshme shëndetësore e popullsisë së Kosovës është ndër më të dobëtat në Evropën Juglindore. Shkalla e vdekshmërisë së foshnjeve dhe jetëgjatësia mesatare e kosovarëve janë treguesit më objektiv të gjendjes së përgjithëshme shëndetësore të popullsisë. Indikator i jetëgjatësisë sillet në 67-71 moshë mesatare e femrave dhe 63-67 vjet jetë mesatare të mashkujve. Krahasuar me vendet e regjionit ky nivel i jetëgjatësisë është shumë më i ulët. Kështu, shkalla e vdekshmërisë së foshnjeve sillet nga 18 deri 44 ‰ dhe është shumëherë më e lartë se sa shkalla e vdekshmërisë së foshnjeve në vendet e regjionit, dhe deri në dhjetë herë më e lartë se sa në vendet e BE-së.

Ndër problemet tjera që e percjellin zhvillimin demografik të Kosovës janë edhe shkalla e lartë e vdekshmërisë së nënave rreth lindjes si shkalla e lartë e vdekshmërisë së fëmijve në moshën deri në 5 vjeç. Por, të dhënat flasin se gjendja shëndetësore rreth lindjes dhe në vitin e parë të jetës është jashtëzakonisht e dobët. Veçanërisht në shkaqet e vdekshmërisë rreth lindjeve ndikim të lartë kishte shkalla e lartë e abortimeve dhe abortimet ilegale.

Në periudhat e mëvonshme të jetës probleme shëndetësore paraqiten me prezencën e lartë të sëmundjeve ngjitëse dhe atyre epidemike. Tuberkuloza dhe numri i personave me aftësi të kufizuara, edhe pse kanë trend të zvogëlimit në periudhën e pas luftës, për shkak të prezencës ende të lartë mbesin probleme të mëdha shëndetësore në Kosovë.

Struktura e aktivitetit ekonomik të popullsisë është segmenti më delikat i të gjithë zhvillimit demografik. Të dhënat e mësipërme për numrin e personave që kërkojnë punë nuk e jep në tërësi pasqyrën e problemit të papunësisë dhe shkallës së aktivitetit ekonomik të popullsisë së Kosovës.

Nëqoftëse mbështetemi vetëm në të dhënat e statistikave që mbajnë në evidencë personat e regjistruar në byrotë për punësim, atëherë analiza do të jetë e mangët sepse një numër i madh i të papunëve nuk paraqitet në byrotë e punësimit për shkak se nuk shpresojnë se do të zgjidhin problemin në këtë formë. Kundruall kësaj, shteti nuk ka asnjë formë të kompenzimeve për personat e papunë. Për të ilustruar këtë po japim tabelën në vijim:

Treguesit e tregut të punës 2008

Numri i banorëve	2.153.000
Pop. e aftë për punë	64%
Pop. në moshë pune	1.371.000
Të papunë të regjistr.	335.900
Të punësuar	481.000

*Burimi:*Enti i Statistikave të Kosovës (ESK),Prishtinë, 2008.

Nga të dhënat në këtë tabelë del se ndryshimi ndërmjet numrit të popullsisë në moshë pune dhe numrit të të punësuarve është shumë më i madh se sa numri i të regjistruarve si të papunë. Është po ashtu e ditur se jo e gjithë popullsia në moshë pune është ofertë në tregun e punës, pasi që një kategori e popullsisë në këtë moshë gjindet në shkollim të mesëm apo superior, disa të tjerë në aktivitete dhe angazhime tjera si në trajnime,kualifikime ose aktivitete tjera. Megjithatë, edhe kjo formë me të gjitha mangësitë e evidences, tregon për një shkallë shumë të lartë të papunësisë në Kosovë. Nga burimi i me sipërm del se shkalla e papunësisë është 41% nga të cilët 58% femra dhe 33% mashkuj.

5.4.0.Efektet e privatizimit në tregun e punës

“Trendet e fundit të zhvillimit nuk kanë gjeneruar rritje të numrit të vendeve të lira të punës. Përkundër zhvillimit të aktiviteteve të sektorit privat që nga viti 1999, trendet e fundit të zhvillimit në Kosovë nuk janë përkthyer në krijimin e rëndësishëm të vendeve të përshtatshme të punës. Kjo, në kombinim me fuqinë e madhe dhe të re punëtore, është përkthyer në papunësi të lartë, veçanërisht në mesin e rinisë. Derisa shumica e punëve ekzistuese formale gjinden në sektorin e shërbimeve, dhe janë ngushtë të lidhura me prezencën e madhe të komunitetit të huaj, mundësitë e punësimit në sektoret industrial dhe bujqësor janë shumë të kufizuara (Banka Botërore,2003). Mungesa e lidhjes së fuqishme në mes të zhvillimit ekonomik dhe krijimit të vendeve të punës i janë mveshur: (i) vështirësisë së tërheqjes së kapitalit të huaj të domosdoshëm për revitalizimin e sektorëve të industrisë dhe të minierave; dhe (ii) konkurrencës së ashpër që i bëhet prodhuesve vendore në sektorin bujqësor si shkak i importit të subvencionuar të prodhimeve bujqësore”⁸⁵.

Për të pasqyruar më qartë lidhmërinë në mes varfërisë dhe papunësisë po japim tabelën në vijim.

Varfëria dhe papunësia

	2002/03	2005/06
Shkalla e varfrisë e të papunësuarve	40.8	49.5
Shkalla e varfërisë e të punësuarve	32.2	34.7
% e të varfërve të papunësuar	52.7	58.6
% e jo të varfër të papunë	43.5	43.3

Burimi: ABEF, të dhënat e përpunuara nga BB në Raportin Vlerësimi i Varfërisë në Kosovë, 03 tetor 2007.

⁸⁵ Banka Botërore; Raporti nr.32378-XK, *“Vlerësimi i varfërisë në Kosovë”*, qershor 2005, Kap.3, pika 7

Edhe pse menjëherë pas luftës të dy strukturat qeverisëse UNMIKU dhe IPVQ-të i dhanë vendit orientim drejt politikave të tregut të lirë, përmirësimit të klimës për investime. Pengesat më të mëdha në këtë drejtim paraqiten te furnizimi me energji elektrike, konkurenca jolojale dhe jo formale, pasiguria e lartë politike dhe vonesat në procesin e privatizimit.

Perspektiva e zhvillimit dhe e rritjes së të ardhurave në këtë periudhë kushtëzohej nga një numër faktorësh të ndërlidhur si stabiliteti politik dhe siguria, perspektiva e zgjidhjes së statusit politik të Kosovës dhe implementimi i një numri reformash, të cilat promovojnë zhvillimin e sektorit privat.

Shkalla e papunësisë në Kosovë në disa analiza vlerësohet të jetë deri në 50%, ose me i larti në Evropë. Po ashtu, në këto analiza potencohet se rritja e punësimit është esenciale për zvogëlimin e varfërisë/ ABEF/.

Nga kjo Anketë rezulton se personat e varfër 15 vjet e më shumë, më shumë janë të papunë se sa kategoria tjetër. Por, kjo vlen edhe për popullsinë e rritur në përgjithësi ku numri i të papunëve është gati i barabartë me numrin e të punësuarve.

Struktura kuaklfikuese e popullësis së pa punë

Kategoria:	Total	të papunë	Punt. me pagë	të tjerë	amvise
mosha mesatare (<i>vitet</i>)	40.1	32.5	39.6	38.5	44.1
Më pak se shkoll.fillore	13.7	4.0	0.5	3.9	19.7
Me shkollë fillore	38.2	40.1	9.7	35.9	33.9
Me shkolle të mesme	42.6	51.4	74.5	56.8	13.8

Me shkollim të lartë	5.5	4.5	15.8	3.4	0.0
Femra %	50.5	59.6	23.7	5.5	99.8
Urban %	38.2	37.5	52.5	33.2	31.6
Numr.i ant të fam.	7.2	7.5	6.5	7.8	7.3
Fam. me kryef. femër	5.6	6.2	4.7	3.9	6.0

Burimi: varfëria në konsum në Republikën e Kosovës në vitin 2009, Banka Botërore & Enti i Statistikës i Kosovës, maj 2011.

Nga sa shifet më lartë del se të papunët janë mjaft të ri (32.5 vjet), të papunët janë më të pashkolluar, vetëm 40.1% e kanë të kryer shkollën fillore, 51% shkollën e mesme dhe 4.5% shkolimin e lartë. Rreth 60% të të papunëve janë femra dhe 37.5% janë popullsi urbane.

Karakteristikat tjera të popullsisë së papunë janë identike me pjesën tjetër të popullsisë.

5.5.0.Efektet e privatizimit në varfërinë ekonomike

Edhe pas përfundimit të fazës së rindërtimit dhe në fillim të fazës së zhvillimit, Kosova ishte vendi më i varfër në region. Në vitin 2003, GDP për kokë banori është vetëm 790 USD. Në Shqipëri ishte 1537 US, Maqedoni 1860 US dhe në Bosnje Hercegovinë 1362 US.

Statistikat tregojnë së katër vjet pas konfliktit, varfëria mbetet shumë e përhapur në Kosovë. Në vitin 2002, 37% e popullsisë kanë jetuar në skajin e varfërisë, ose vija e

varfërisë së plotë me 1.42 euro për person në ditë. Edhe pse sipas eksperteve të Bankës Botërore për studimin e varfërisë, varfëria në Kosovë nuk ishte shumë e thellë.

Në varfëri të skajshme apo siç quhet edhe e ushqimit me 0,93/EU në ditë jetonin 15.2% e popullsisë.

Ky vlerësim i varfërisë është llogaritur sipas metodës së Bankës Botërore. Këto vija absolute të varfërisë bazohen në qasjen nga ana e nevojave themelore. Në këtë kontekst është llogaritur sigurimi i 2100 kalorive për person në ditë. Mirëpo përveq nevojave për konsumin e artikujve ushqimorë duhet marre parasysh nevojat për artikuj joushqimorë, e cila perbën rreth 34% të shpenzimeve të vijës së plotë të varfërisë. Cilat grupe shoqërore ekonomike vuajnë nga varfëria dhe sa është pjesëmarrja e tyre në totalin e varfërisë së skajshme? Varfëria e skajshme është joproportionalisht më e lartë te fëmijet dhe te të moshuarit. Sipas të dhënave të BB, varfëria e skajshme është më e larta te fëmijët-rreth 17.3% dhe te të moshuarit 17.1%, kurse më e ulët te të rriturit-rreth 13.3%. Kështu, 17% e familjeve me fëmijë jetojnë në varfëri të skajshme, ndërkajqë vetëm 10.7% e familjeve pa fëmijë jetojnë në kushte të varfërisë së skajshme. Pra, prezenca e fëmijve është faktor ndërlidhës me varfërinë ashtu si edhe e anëtarëve me aftësi të kufizuara. Është dëshmuar se familjet me anëtarë me aftësi të kufizuara e kanë shkallën më të lartë të varfërisë së skajshme.

Familjet, kryefamiljari i së cilës është femër janë shumë më të varfëra se sa familjet kryefamiljari, i të cilave është mashkull. Edhe niveli i arsimimit të kryefamiljarit është në lidhmëri me varfërinë e skajshme.

Në 28.2% të familjeve me kryefamiljarë të papunësuar, apo me punësim të pasigurtë jetojnë poashtu në varfëri të skajshme. Papunësia dhe varfëria, si në çdo vend tjetër, edhe në Kosovë janë të lidhura por më e shprehur është te vendet me skema të dobëta të beneficioneve për të papunët. Diçka më e ulët, por e lartë në kuptim absolut është varfëria te familjet me kryefamiljarë të punësuar ditorë.

Por, një çështje tjetër ngrihet për shqyrtim, sa ka qënë trendi i zhvillimit ekonomik në periudhën 2000-2003 favorizues për të varfërit? Nga qershori i vitit 1999, popullsia e Kosovës ka përfituar shumë nga ndihmat e donatorëve, paqja dhe stabiliteti. Mungesa e të dhënave të krahasueshme e vështirëson vlerësimin e saktë të ndryshimeve në varfëri në këtë periudhë. Edhe pse lidhjet në mes të zhvillimit dhe varfërisë mund të stimulohen duke shfrytëzuar të dhënat nga studimet. Çështja më e ndieshme qëndron në atë se disa të dhëna nuk janë të krahasueshme në mënyrë precize. Kryesisht janë dy burime të dhënash të cilat janë shfrytëzuar nga institucione si BB, FMN, etj.pra AMSJ.(Anketa për matjen e standardit të jetës) dhe ABEF-anketa e buxhetit të ekonomive familjare. Sipas AMSJ shkalla e përgjithshme e varfërisë në Kosovë në vitin 2000 ishte 50% kurse në vitin 2002 kishte rënë në 37%.Sipas të dhënave të AMSJ, hapësira e varfërisë, ashpërsia e varfërisë dhe varfëria e skajshme kanë qënë përkatësisht 15.7%, 6.8% dhe 12%. Kurse në bazë të ABEF-it kanë qënë përkatësisht 11.4%, 4.9% dhe 15.2%. Mospajtimet në mes të këtyre dy burimeve janë si pasojë e dallimeve në modulet e konsumit dhe vijave të varfërisë ekstreme.

Sido që të mirret të dhënat flasin për rënien e varfërisë absolute në dy-tri vitet e para të pasluftës. Por, ajo që është e sigurt po ashtu, në bazë të këtyre burimeve është se në këtë periudhë nuk kemi rënie të varfërisë ekstreme ose të paktën nga të dhënat që na ofrojnë këto burime nuk mund të konkludojmë për ndonjë levizje pozitive të varfërisë së skajshme.

Një vlerësim tjetër i vlefshëm për analizën e varfërisë dhe çështjeve sociale është bërë nga Zyra Ndërkombëtare e Punës: *“Sipas indeksit të zhvillimit njerëzor, Kosova është në vendin e fundit në Evropën Juglindore dhe është ndër shoqëritë më së paku të zhvilluara në Evropë. Papunësia është identifikuar si një ndër shkakëtarët kryesor të varfërisë në Kosovë. Rrethanat politike në dekadat e fundit kanë kontribuar në mungesën e investimeve, zgjerimin e ngadalshëm të bizneseve dhe numrin e ulët të krijimit të bizneseve të reja dhe po ashtu nivelin e ulët të arsimit të përgjithshëm dhe profesional”*⁸⁶

⁸⁶Zyra Ndërkombëtare e Punës 2010; “Profili i Sistemit të sigurisë Sociale në Kosovë”, fq.13

Vlerësimet e mëvonshme të varfërisë për vitin 2005 dhe 2007 nga ABEF-i, të cilat kanë përfshirë 2400 familje tregojnë se në këtë periudhë kufiri i varfërisë nuk ka ndryshuar, por në vitin 2007 në krahasim me vitin 2005 shpeshësia e varfërisë është rritur nga 43.5 në 45.1%, ndërkohë varfëria ekstreme nga 13.6% në 16.7%. Dhe një indikacion i veçantë i varfërisë që përfshin 8% të popullsisë që përjetojnë varfëri shumëdimensionale që karakterizohet më të ardhura të ulëta, pa ujë të pijshëm në shtëpi dhe pa qasje në shërbimet shëndetësore.

Në periudhën ndërmjet vitit 2002 deri 2008 pagat kanë mbetur të pa ndryshuara. Paga mesatare mujore në këtë periudhë sillet diku rreth 210 euro. Ky nivel i pagave është përafërsisht edhe te kategoritë tjera të të punësuarëve si te punëtorët me meditje, profesionistët dhe të tjerët.

Duke u nisur nga baza e zhvillimit ekonomik, tërheqja graduale e donatorëve dhe infrastruktura e dobët, nuk premtin ndonjë perspektive të zgjidhjes së problemit të varfërisë. E vetmja shpresë për ndonjë lëvizje pozitive ishte definimi i statusit politik të Kosovës, i cili do të krijonte ambient më tërheqës për investitorët e huaj duke definuar të drejtat dhe sigurinë e pronës .

“Eshtë shumë indikative së “ në përputhje me aktivitetin e ngadalshëm ekonomik, dëshmitë nga anketa e buxhetit të ekonomive familjare argumentojnë se nuk ka ndryshime në shkallën e varfërisë”⁸⁷.

Më tutje nga ky raport shohim se në këtë periudhë në njëfarë mënyrë sikur është instaluar varfëria e stagnuar. Shkalla e varfërisë së skajshme lëvizë nga 12 deri në 13% kurse ashpërsia e varfërisë ka qënë 5%. Varfëria absolute ka lëvizë në drejtim të rritjes nga 43.5 në 2003/2004 në 45.1% në 2005/2006. Përveç karakterit stagnues të nivelit të varfërisë në këtë periudhë varfëria është karakterizuar me njëfarë rritje simbolike të pabarazisë. Segmenti i parë i pabarazisë është shprehur te ndryshimi në dinamikën e zhvillimit ndërmjet popullsisë urbane dhe rurale. Popullsia rurale që përbën 2/3 e popullsisë së përgjithshme pabarazia në shpërndarje në konsum ka patur humbje negative thelbësore.

⁸⁷ Po aty

Edhe format tjera të pabarazisë kanë treguar rritje sidomos diferenca ndërmjet ekonomive familjare të pasura dhe ekonomive familjare të varfëra është rritur.

Struktura moshore e popullsisë së Kosovës është shumë e re. Numri mesatar i antarëve të familjes është 7.2 persona. Ekonomitë familjare me numër të madh fëmijësh kanë shkallë më të lartë të varfërisë.

Por, varfëria përveç në të hyra shprehet edhe në forma tjera të mirëqenies. Regjistrimi i nxënësve në shkolla fillore ka qenë pothuajse i plotë dhe atë i të dy gjinive. Në këtë aspekt nuk kemi dallime të mëdha në mes të varfërve dhe të pasurve, në mes të popullsisë urbane dhe asaj rurale. Pastaj, pjesa dërmuese e popullsisë jetojnë në shtëpi-objekte të sigurt, me energji elektrike, ujë të instaluar brenda etj.

Një kontrast më i theksuar vërehet te regjistrimi i nxënësve në arsimin e lartë. Diku rreth 20% më shumë nxënës regjistrohen në nivelet e arsimit të lartë nga familjet e pasura. Mirëpo, këto shërbime shumëherë përcillen me mangësi si psh. në zonat rurale për shkak të numrit të madh të nxënësve dhe mungesës së hapësirës shkollore numri i nxënësve në një klasë është i stërngarkuar, mësimdhënësit nuk kanë kualifikime të duhura profesionale dhe si pasojë edhe cilësia e mësimin është nën standardet.

Në këtë periudhë, po ashtu, ka qenë evidente edhe ndërprerja e shpeshtë e energjisë, problemet me furnizimin me ujë të pijshëm. Gjithnjë duke u bazuar në të dhënat e BB dhe institutit të Statistikave të Kosovës (*materiali i cituar më lart*), del se 8% e popullsisë së varfër nuk kishin ujë të instaluar e as nyje sanitare brenda shtëpisë ose ambientit ku jetojnë. Pra, kushtet higjienike i kishin tepër të rënda. Edhe shërbimet e nivelit më të lartë po ashtu kishin diferenca të të varfërit në krahasim me popullsinë e pasur. Rreth 9% nuk kishin qasje në lidhje telefonike.

“Për të përfunduar, dëshmitë e dokumentuara tregojnë se varfëria e bazuar në të hyra ka mbetur shumë e përhapur dhe ka vazhduar gjatë viteve 2003 dhe 2005. Zbërthimi i trendit të varfërisë ka treguar se ndryshimet e pabarazisë kanë patur ndikim shumë të madh në rezultatet e varfërisë së vrojtuar se sa zhvillimi. Për më tepër, këto ndryshime të

pabarazisë, gjithashtu pjesërisht spjegojnë diferencat e vërejtura në zonat urbane dhe rurale. Gjithashtu, kemi arritur në përfundim se përderisa dimensionet e varfërisë që nuk bazohen në të hyrat regojnë rezultate të mira, qasja jo e barabartë dhe cilësia e dobët janë të zakonshme. Në fund, ne kemi gjetur se një pjesë e madhe e popullsisë është privuar në shumë aspekte dhe dimensione.”⁸⁸

Për të zvogluar efektet e varfërisë, por edhe duke trashëguar nga traditat familjare në Kosovë fëmijët punojnë për të ndihmuar familjet e tyre. Në kushte normale punët e fëmijve në familje lidhen me ndihmën në punët në bujqësi, dhe në punët e shtëpisë. Mirëpo, kohëve të fundit vërehet shtimi i numrit të fëmijve që punojnë në rrugë. Kryesisht janë këta fëmijë të familjeve të varfëra dhe fëmijë pa prindër, të cilët detyrohen të punojnë në punë të ndryshme për të siguruar ekzistencën e tyre dhe të familjes. Lidhur me punën e fëmijve në Kosovë UNICEF ka bërë një studim, i cili përfshin fëmijët e moshës 6-15 vjeç. Konkluzionet kryesore të nxjerra nga ky studim janë: *“Nuk dihet numri i përgjithshëm i fëmijëve që punojnë”*.

Fëmijët punëtorë në shumicën e rasteve janë të angazhuar në shitjen e produkteve në rrugë apo treg; ata po ashtu punojnë në shtëpi apo në prodhimtarinë bujqësore.

Gjysma e fëmijëve që punojnë janë vajza. Mosha mesatare e këtyre fëmijve është 12.5 vjeç. Mosha mesatare e fillimit të punës është 10 vjeç.

Fëmijët zakonisht punojnë gjatë verës dhe më pak gjatë dimrit, ndërsa tre nga katër fëmijët punojnë gjatë tërë vitit. Ata punojnë mesatarisht 6 orë në ditë verës dhe 4 orë në ditë gjatë vitit shkollor dhe 6 ditë në javë.

- Gati 15% e fëmijëve ankohen për probleme shëndetësore.

- Gati 45% e familjeve të fëmijve të intervistuar nuk marrin ndihmë sociale.

⁸⁸BB; *“Vlerësimi i varfërisë në Kosovë”*; Vëllimi i parë: “Përshpejtimi i zhvillimit gjithpërfshirës për uljen e shkallës së gjërë të varfërisë”, tetor 2007.

- Vijimi i shkollimit është i lartë, megjithatë rreth 87 e tyre vijnë në dy tri ndërrime në shkolla.

- 13% e fëmijve që punojnë nuk vijnë në kurrëfarë shkollimi.

- Fëmijët duhet të punojnë për disa arsye dhe varfëria është arsyeja kryesore.

Të ardhurat ditore janë 7 euro në ditë, por vetëm 40% e tyre paguhen.”⁸⁹

Një ndikim të dukshëm në zvoglimin e varfërisë në këtë periudhë ka pas diaspora dhe dërgesat e tyre për familjet. Sa për ilustrim po marrim vitin 2005 kur sipas të dhënave të përgatitura nga BB shkalla e përgjithshme e varfërisë në Kosovë ishte 37.2%. Familjet që kishin së paku një anëtar të vet në emigrim shkallën e varfërisë e kishin 7% më të vogël, kurse ato familje që deklarorin që pranojnë para nga antari i familjes nga diaspora shkallën e varfërisë e kishin 7.5% më të vogël se sa shkalla e përgjithshme e varfërisë. është interesant se familjet më të punësuar jashtë vendit e kanë më të lartë shkallën e papunësisë për 4% se sa shkalla e papunësisë së përgjithshme .Rreth 60 % e të punësuarve jashtë origjinën e kanë nga viset rurale, 99% e tyre janë me përkatësi nacionale shqiptar dhe 60 % e tyre kanë të kryer shkollën e mesme.

Ndikimet ekonomike të parave të dërguara nga emigrantët janë shumë të rëndësishme dhe kjo mund të ilustruhet me përqindjen e pjesëmarrjes së remitancave në GDP të vendit. Sipas të dhënave për vitin 2005 remitancat përbënin 13.6% të GDP të Kosovës.

Pas lufte është shënuar përparim i konsiderueshëm në përmirsimin e shërbimeve shëndetsore. Shëndetësia në këtë periudhë është përkrahur nga donatorët dhe buxheti i konsoliduar. Investimi është realizuar në objekte dhe në kuadrin mjekësor.

Kjo mbështetje nuk ka qënë e mjaftueshme për shkak të një trashëgimije problemesh në sistemim shëndetësor. Popullsia e Kosovës vuan nga shkalla e lartë e semundshmërisë dhe e vdekshmërisë. Sëmundjet më të shpeshta në Kosovë janë sëmundjet e sistemit të

⁸⁹BB:Punimi i cituar,fq.19.

frymëmarrjes/32%/, sistemit tretës 14%, sistemit të qarkullimit të gjakut 8% etj, sëmundje këto karakteristike për popullsinë e vendeve të pazhvilluara.

Një vlerësim i përgjithshëm i nivelit dhe karakteristikave të varfërisë në Kosovë është dhënë nga BB dhe Enti i Statistikës së Kosovës në përmbledhjen ekzekutive të Raportit mbi vlerësimin e varfërisë në Kosovë ku thuhet: *”Rreth 45 % e popullsisë në Kosovë është e varfër, me një pjesë tjetër prej 18 % të rrezikuar nga varfëria. Mbizotërimi i niveleve të varfërisë në pjesën e parë të kësaj dekade nuk është për tu quditur duke marrë parasysh kontekstin e kushteve ekzistuese makroekonomike që karakterizohen me zhvillim të ngadalshëm, me të hyra të ulëta dhe me kufizime të shumta të shpenzimeve. Pa sigurinë që e ofrojnë emigrantët dhe paratë nga diaspora, mirëqenja e një pjese të madhe të popullsisë do të ishte shumë më e keqe. Megjithatë, është gjë pozitive fakti se varfëria është e “butë” sepse shumë njerëz janë ose pak mbi kufirin e varfërisë apo pak nën të. Niveli i varfërisë së “butë” nënkupton se një ndryshim i vogël pozitiv në të hyra, përmes zhvillimit që krijon vende të punës, mund të nxjerr shumë persona nga varfëria”*.⁹⁰

⁹⁰BB dhe Enti i Statistikës së Kosovës; *“Vlerësimi i varfërisë në Kosovë”*, tetor 2007.

Kapitulli VI: PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

6.1.Përfundimet

1.Vertetohet hipoteza e ngritur në fillim të përgatitjes së këtijë punimi se Modeli i privatizimit i përdorur në Kosovë nuk e tërhoqi masën e pritur të investimeve të jashtme.

Procesi i privatizimit i realizuar në periudhën e vështuar ka dështuar në tërheqjen e investimeve të huaja,qoftë në vet procesin e privatizimit qoftë në investimet e pas privatizimit. Në blerjen e ndërmarrjeve të privatizuara në këtë periudhë kapitali i huaj merr pjesë me vetëm 12%, gjegjesisht me më pak se 50 mil. Eu. Edhe pas privatizimit nuk kishte interesim për investime te huaja direkte. Nga viti 2007 kur masa e investimeve të huaja arriti ne mbi 450 mil. Eu, nga viti në vit vërehet zvoglim i interesimit të kapitalit të huaj për investime në Kosovë.Në vitin 2015 vëllimi i investimeve të huaja bie në 125 mil eu. Në kuadër te procesit të privatizimit, pengesë në tërheqjen e investimeve të huaja del mosdefinimi i të drejtës në pronë,gjegjesisht e drejta e përdorimit e jo e posedimit të pronës mbi tokën.

Por, analistë dhe njohës të rrethanave te të bërit biznes në Kosovë vërejnë se përveq prones së pa definuar në tërheqjen e investimeve të huaja renditen edhe pengesa si infrastruktura ekonomike, mungesa e energjisë, presionet dhe sjelljet burokratike e korruptive të strukturave administrative e politike.

2.Vertetohet po ashtu hipoteza e dytë se institucionet vendore nuk kanë qenë aktivisht dhe në masën e duhur të përfshira në këtë proces.Pushteti lokal ishte plotësisht i përjashtuar nga ky proces.

Në këtë periudhë qeshtjet lidhur me zhvillimin ekonomik, menaxhimin me pasurinë shoqerore dhe qështjet e reformave dhe të tranzicionit ishin te rezervuara për UNMIK-un. Bordet e AKM-s dominoheshin nga ndërkombetaët dhe vendimet mirreshin vetëm në rast se për ishin pjesa e anetarëve ndërkombëtarë të bordit të AKM-s.

Edhe struktura dhe numri i gjyqëtarëve ndërkombëtarë në Dhomën e Posaqme linin në minorancë gjyqëtarët vendorë të Dhomës së Posaqme. Mënyra e vendimarrjes si në bordin e AKM-s ashtu edhe në Dhomën Speciale i ka bërë të pafuqishën anëtarët vendorë në vendimarrje.

3.Procesi i privatizimit në Kosovë ka filluar shumë më vonë se sa në vendet tjera ish-komuniste. Ky proces në Kosovë konsiderohet si tepër kompleks dhe specifik. Specifikat e këtij procesi lidhen me rrethanat e veçanta, në të cilat filloi së realizuari e që lidhen me periudhën e dominimit serb të viteve 90-ta, si dhe pasojat e këtij dominimi në ekonominë e Kosovës, lufta dyvjeçare dhe pasojat e saj shkatërrimtare në ekonomi dhe në fund, administrimi i Kosovës nga Kombet e Bashkuara në periudhën 1999-2008.

Me vendosjen e Administratës së Kombeve të Bashkuara (UNMIK) filloi procesi i shtetndërtimit, përkatësisht i konstituimit të institucioneve shtetërore, të cilat ishin rrënuar përmes politikave represive. Paralelisht me këtë, ekonomia e Kosovës, për një dekadë rresht, ishte plaçkitur e rrënuar pamëshirshëm, qoftë duke i bartë asetet e saja në Serbi përmes integritimeve të dhunshme, me caktimin e stafit menaxherial të ardhur, dhe me dëbimin nga puna të punëtorëve shqiptarë. Në këtë periudhë, sektori shoqëror i ekonomisë së Kosovës, i cili në rrethana normale përbënte 80% të prodhimit shoqëror të vendit, humbi tregjet, paisjet teknologjike u vjetëruan dhe investimet pushuan.

4.Në periudhën që po shqyrtojmë këtë proces, Kosova nuk e kishte të zgjidhur statusin e saj politik. Formalisht, akoma ishte nën juridiksionin e Serbisë, ndërsa, objektivisht e shkëputur nga Serbia dhe administrohej nga Kombet e Bashkuara. Në kuadër të Administratës së Kombeve të Bashkuara, të njohur si UNMIK, segmentet e lidhura me rindërtimin dhe zhvillimin ekonomik udhëhiqeshin nga Bashkimi Evropian, përkatësisht nga Shtylla e IV-të e UNMIK-ut.

Në bazë të *Rezolutës 1244* të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Kosova administrohej nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Me nxjerrjen e *Kornizës Kushtetuese* nga ana e PSSP-së, u krijua baza legale për konstituimin e Institucioneve vendore. Mbi këtë bazë Organizohen zgjedhjet e para dhe

konstituohet Kuvendi i Kosovës. Paralelisht filloi themelimi dhe konstituimi i organeve shtetërore të njohura si Institucionet e Përkohëshme Vetëqeverisëse të Kosovës- Qeveria me disa ministri. Me këtë veprim u krijua një paralelizëm institucional, edhe pse formalisht pushteti ishte i ndarë ndërmjet UNMIK-ut dhe IPVQ-ve. Pjesa e kompetencave të Administratës së KB njiheshin si “kompetenca të rezervuara” dhe mbikëqyreshin nga UNMIK-u derisa kompetencat e transferuara mbikëqyreshin nga IPVQ-të.

Administrimi me pronën shoqërore dhe publike ishte në kompetencë të UNMIK-ut, dhe udhëhiqej nga *Shtylla e IV-të*. Përveç kësaj, UNMIK-u kishte marrur edhe përgjegjësinë e ndërtimit të rendit të ri ekonomik në Kosovë, pra edhe të procesit të tanzicionit, ku vend qendror zinte procesi i privatizimit të pronës shoqërore, si proces dhe i pa evitueshëm i domosdoshëm për kalimin në ekonomi të tregut të lirë.

5. Në rrethanat e atëherëshme, pas çlirimit nga një okupator i egër shekullor, si dhe shembjes së komunizmit, në kushtet e një prapambetjeje ekonomike dhe me shumë probleme zhvillimore e sociale privatizimi konsiderohej si proces i domosdoshëm për dalje nga situata e rëndë ekonomike, dhe si një akt i shkëputjes definitive nga sistemi monist dhe ekonomia kolektive. Privatizimi, po ashu, konsiderohej si mundësi e rritjes së efikasitetit ekonomik të ndërmarrjeve dhe stabilitetit ekonomik të vendit. Së këndejmi, ky proces u përkrah pa rezervë nga opinioni i gjerë vendor, bota akademike, strukturat politike dhe shoqëria civile.

Për realizimin e këtijë procesi, UNMIK-u, si përgjegjës, me qëllim të bartjes së përgjegjësi, kyçi në proces edhe institucionet vendore, duke i bërë ato pjesë të vendimmarrjes, por gjithnjë duke e ruajtur të drejtën e vetos dhe vendimit përfundimtar. Në këtë mënyrë u krijua një dualizëm institucional. Meqë për strukturat ndërkombëtare koncepti i pronës shoqërore ishte i pa definuar dhe i pa qartësuar mjaftueshëm, për rrjedhojë baza ligjore, e ndërtuar nga UNMIK-u rezultoi konfuze dhe e paqartë me shumë mundësi interpretimi dualist.

6. Si kategori e veçantë e pronës së përbashkët, prona shoqërore ekzistonte vetëm në ish-Jugosllavi. Si në çdo vend tjetër komunist, kjo pronë e ka zanafillën e vet në pronat e

konfiskuara nga pushteti komunist nga kundërshtarët politikë, nacionalizimi i tokave bujqësore dhe pasurive tjera dhe pasurive natyrore. Sistemi politik jugosllav, ndryshe nga ai i vendeve tjera komuniste, ndërtoi edhe sistem të posaçëm ekonomik, përmes disa reformave në vitet 60-ta. Kështu, kontrolli i shtetit mbi pronat e nacionalizuara dhe të konfiskuara u zëvendësua me kontrollin nga Këshillat e Punëtorëve, ndërsa prona shtetërore u shdërrua në pronë shoqërore. Prona shoqërore u sanksionua me Kushtetutë dhe ligj të veçantë. Në pronën shoqërore hynin mjetet e punës, pasuria natyrore dhe rezultatet e punës. Pronari i pronës shoqërore ishte shoqëria .Kjo formë e pronës nuk mund të privatizohej nga shfrytëzuesit. Shoqëria përfaqësohej nga organet shtetërore, të të gjitha nivelet dhe Këshillat e Punëtorëve.

7. Një specifikë tjetër e privatizimit në Kosovë është edhe se ky proces ka filluar, para se të bëhet rikthimi i pronave të nacionalizuara , të konfiskuara dhe ekspropriuara. Për këtë çështje nuk kishte as ligj dhe akoma një ligj i tillë nuk është përgatitë e as miratuar. Mungesa e këtij ligji ka sjellur problem dhe vështirësi në proces.

8. Periudha e viteve 90-të trashëgoi probleme të shumta, që u reflektuan në procesin e privatizimit. Masat e dhunshme në ekonomi të vendosura nga pushteti serb ndërruan formën e pronës, menaxhmentin dhe përjashtuan nga puna shumicën e të punësuarve shqiptarë. Në këtë periudhë, duke u bazuar në Ligjin serb për Transformimin e Pronës Shoqërore, disa individëve serb iu njoh e drejta e pronësisë, kryesisht mbi pronat bujqësore. Kjo u mundësua edhe me ndihmën e kadastrave, të cilat ndryshuan të dhënat dhe emrat e pronarëve. Megjithatë, ky ishte një realitet i kohës dhe shumëherë i pamundur të ndryshohej, edhe pse i realizuar në bazë të ligjeve diskriminuese.

9. Metoda *Spin-of* u përcaktua si mënyrë e privatizimit nga Administrata Ndërkombëtare edhe për një arsye tjetër që del si pasojë e statusit të padefinuar politik të Kosovës. Meqenëse mjetet nga shitja e aseteve ruheshin në Fondin e Mirëbesimit, kjo kishte të bënte me kërkesat eventuale, apo pretendimet e shtetit Serb mbi pronësinë e pronës shoqërore të Kosovës. Kjo mënyrë e trajtimit, nga ana e UNMIK-ut, ishte krejt e pa bazë dhe e pakuptimtë. Sipas Kushtetutës së Kosovës së vitit 1974 *prona shoqërore dhe publike e*

Kosovës i takonte popullit të Kosovës. Ndërhyrja ndërkombëtare në Kosovë kishte ndodhë për shkak të suspendimit me dhunë të institucioneve të Kosovës, represionit dhe gjenocidit serb. Në bazë të këtij vendimi, edhe vet UNMIK-u ishte sjellur si mision për administrimin e Kosovës, ndërkaq po i njëjti Mision njihte veprimet e mëhershme të kryera në bazë të atyre ligjeve diskriminuese.

10. Kjo situatë konfuze krijoi edhe një rrethanë të re specifike, që e karakterizoi privatizimin në Kosovë: mosdefinimi i pronarit të pronës së shitur-privatizuar. Fjala është për sipërfaqet e tokave, ku janë të vëndosur Ndërmarrjet Shoqërore (NSH). Një mënyrë shumë specifike e zgjidhjes së këtij problemi u zgjodh nga Administrata Ndërkombëtare. Me rastin e tenderimit të NSH, toka ndahej nga asetet e NSH-ve dhe blerësve të NSH-ve prona iu jepej me qira për 99 vjet. Me këtë, definimi i pronës vazhdoi të mbetet i paqartë. Kjo paqartësi vazhdon të jetë prezente edhe tani pas tetë vjetësh pavarësie dhe udhëheqjes së procesit nga institucionet kosovare.

11. Dualizmat në qeverisjen e vendit dhe në procesin e privatizimit u përcollen me vështirësi të shumta. Mosapajtimet ndërmjet anëtarëve të Bordit të AKM-së, nga pjesa e ndërkombëtarëve dhe atyre vendor ishin të thella dhe të shpeshta. Keto kundërtënie u reflektuan edhe në dinamikën e privatizimit, duke e ndërprerë dhe vonuar procesin. Kjo për pasojë pati degradimin e pronës, rënien e vlerës së pasurisë, humbjen e tregjeve dhe dekurajimin e investitorëve të jashtëm. Përveç humbjeve direkte, humje të konsiderueshme ndodhen nga vonesa e funksionalizimit të këtyre kapaciteteve, vendeve të punës dhe akumulimit të problemeve sociale. Por, nuk ishin të parëndësishëm edhe dëmet politike si: dëmtimi i imazhit gjatë procesit të monitorimit ndërkombëtar, vonesa e realizimit të standardeve për Kosovën, si parakusht i zgjidhjes së statusit politik.

12. Procesi i privatizimit kërkonte ndërtimin e bazës institucionale dhe infrastrukturës ligjore. Me nxjerjen e Rregullores mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) u krijuan kushtet për themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit si institucion i posaçëm dhe me kompetencë të plotë për procesin e privatizimit. Po ashtu, me Rregullore të veçantë u themelua Dhoma e Posaçme në kuader të Gjykatës Supreme të

Kosovës me mandat të plotë për shqyrtimin e padive dhe ankesave që dalin gjatë procesit të privatizimit. Të dy institucionet përbëheshin nga ndërkombëtarë dhe vendor, por gjithnjë dominoheshin nga ndërkombëtarët të cilët i rezervuan vetes pozita me kompetenca dhe autoritet për vendimarrje përfundimtare.

Me Rregulloren për AKM-në u përcaktua edhe metoda *Spin-of* dhe *Spin-of Special* si forma të privatizimit në Kosovë. Po ashtu, u definuan rregullat e punës dhe vendimarrjes nga ana e Bordit të Drejtorëve. Për rrumbullakësimin e kornizës ligjore dhe rregullativës u nxorën edhe *Politikat Operacionale të AKM-së* dhe Rregullorja mbi shfrytëzimin e tokës. Paralelisht me këto vazhduan të aplikohen edhe disa ligje, nga periodha e dominimit serb, të cilat për nga natyra ishin diskriminuese dhe nxorrën pengesa të medha që në fillim të procesit. U nevojiti ndërhyrja e Zyrës Ligjore të OKB-së për shfuqizimin e këtyre ligjeve. Nga Zyra Ligjore e OKB-së u mundësua që nga shuma e gjithëmbarshme e shitjes së aseteve të NSH-ve ish-punëtorëve të iu paguhen, në formë të kompenzimit, 20% e kësaj vlere.

Udhëheqja e procesit nga ndërkombëtarët konsiderohej prioritet, ngase Kosova nuk kishte përvojë në tranzicion dhe si mundësi më e mirë e shfrytëzimit të përvojës së vendeve tjera.

13.Një pengesë tepër serioze paraqiste edhe statusi i pazgjidhur politik i Kosovës. Në aspektin formal, Serbia e konsideronte Kosovën pjesë të saj, kurse pronën shoqërore të saj si pronë të vetën. Për këtë shkak UNMIK-u u përcaktua për një model të veçantë të privatizimit të njohur si metoda SPIN-of. Sipas kësaj metode, nga NSH-të ekzistuese themelohen një ose disa ndërmarrje të reja (sh.a), të cilave iu barten të drejtat mbi pronat, asetet dhe fitimet. Ndërmarrja e re posedonte aksionet e NSH-ve, ndërsa AKM, si mbikëqyrëse kishte të drejtën e shitjes së tyre. Të ardhurat nga shitja e aksioneve duhet të ruheshin në një Fond të Mirëbesimit pranë AKM-së për interesa të pronarëve ose kreditorve (*nëse ka pasë*).Sipas kësaj metode, ndërmarrjes se vjetër i kanë mbetë në barrë obligimet nga e kaluara. Pas përgatitjes me procedura të veçanta, përmes tenderimit këto ndërmarrje i janë nënshtruar procesit të likuidimit. Nëqoftëse në këtë proces nuk paraqiten kërkesa dhe

konteste pranë Dhomës së Posaçme, atëherë ish-punëtorve iu janë kompenzuar 20% nga vlera e shitjes së aseteve.

14. Dihet mirëfilli se realizimi me sukses i procesit të privatizimit kërkon përgatitje serioze paraprake. Në Kosovë kjo nuk ka ndodhë. UNMIK-u këtë process e ka filluar pa plan strategjik për mënyrën, dinamiken dhe kohen e përfundimit të procesit.

Në rast se një NSH e korporatizuar konsiderohej e rëndësishme për zhvillimin ekonomik, i takonte një dege apo sektori kyç, që punësonte numër më të madh të punëtorëve dhe që kishte pozitë të konsoliduar në treg, atëherë ajo tenderohej me kushte të veçanta. Përveç kushteve të përgjithshme për blerësin potencial kërkohej konkurrencë në vellimin e investimeve që do të realizojë, numrin e punëtorëve që do të punësojë dhe Planin e Biznesit me prejardhjen e pasurisë-burimeve financiare. Kjo quhet SPIN-of Special. Derisa për SPIN-of të rregullt çmimi më i lartë i ofruar është kriter bazë konkureues, te SPIN-Off-i Special ofertuesit duhet të plotësojnë edhe kushtet tjera specifike të vendosura nga Bordi i AKM-së.

Nga fillimi i privatizimit e deri në fund të vitit të kaluar (2014), përmes kësaj metode janë privatizuar 26 NSH. Vlera e zotuar për investime nga pronarët e rinj sillet në rreth 200 milionë Euro, numri i të punësuarve në 8600 persona. Për realizimin e obligimeve kontraktuese AKM-AKP i monitoron këto kompani deri në përmbushje të obligimeve.

Privatizimi, përmes SPIN-of-it Special është pjesa më problematike e privatizimeve. Në periudhën 2003-2008 vetëm 6, nga 26 ndërmarrjet e privatizuara me këtë metodë i kanë përmbushur obligimet kontraktuese. Edhe pse këto ndërmarrje para privatizimit ishin mirë të konsoliduara, për shkak të harxhimit të mjeteve financiare me rastin e blerjes (sipas çmimit më të lartë), dhe kushtëzimeve tjera, kamatave të larta bankare, ambientit biznesor, presioneve të ndryshme për zhvatje, shantazheve dhe pengesave të llojllojshme të natyrave korruptive dhe krimit ekonomik, bënë që shumë nga këto ndërmarrje të mos i plotësojnë kushtet e parapara në kontratë dhe pas një afati iu janë tërhequr aksionet nga ana e AKM-AKP-së. Shembulli me tipik i këtyre pengesave është “Hoteli Grand” në qender të Prishtinës.

Proces i monitorimit të këtyre ndërmarrjeve nuk ishte në nivelin e duhur. Parregullsia dhe keqperdorim i detyrës zyrtare, mashtrimi dhe hetimi për vepra penale janë arsyt e operacioneve të policisë dhe drejtorisë për krime ekonomike.

Procesi i monitorimit të ndërmarrjeve të privatizuara, përmes SPIN-of-it Special ende nuk ka përfunduar për shkak se 11 prej tyre nuk i kanë plotësuar kriteret, edhe pse afati iu është vazhduar disa herë nga Bordi i AKP-së. Nga raportet vjetore shohim se katër ndërmarrjeve iu janë tërhequr aksionet dhe pritet ritenderimi i tyre pasi të kompletohet Bordi dhe menaxhmenti i AKP-së.

Vetë metoda e Spin-of-it Special konsiderohet e pa përshtatshme dhe jo adekuate për kushtet e Kosovës. Shmangia nga parimet e ekonomisë së tregut përmes imponimit të punësimit përtej nevojave dhe mundësive të kompanisë së privatizuar, vazhdimi me çdo kusht i veprimtarisë dhe detyrimi i investimeve, bënë që shumë nga këto ndërmarrje, dikur me reputacion të lartë, të gjenden para falimentimit, ose të raportojnë jorealisht investimet dhe të mbajnë në punë njerëz me paga minimale.

15. Analistë dhe specialistë të fushës konsiderojnë që Metoda SPIN-of nuk ka qenë adekuate për privatizim në Kosovë. Shitja, përmes konkurrencës me çmim më të lartë, nuk ka lënë hapësirë për zhvillimin e bizneseve pas privatizimit. Bleresi, në shumicën e rasteve, kanë shpenzuar gjithë kapitalin e tyre për blerjen e aseteve, por nuk u është mbetur mundësi për zëvendësimin e teknologjisë së vjetëruar, rindërtimit dhe depërtimit në tregjet, tanimë të humbura, derisa kreditë bankare, tepër të shtrenjta e kanë percjellë zhvillimin e tyre gjatë gjithë kohës.

Në periudhën e administrimit të Kosovës nga UNMIK-u, AKM ka realizur 30 Valë të Privatizimit. Janë privatizuar gjithsej 498 ndërmarrje të reja, të cilat kanë dalë nga korporatizimi i 313 NSH-ve. Nga shitja e tyre janë depozituar, në Fondin e Mirëbesimit, 392 milionë Euro. Ndërsa, përmes likuidimit janë privatizuar 114 NSH të vjetra.

Në këtë periudhë, po ashtu, është privatizuar 52% e fondit të tokave të Kooperativave Bujqësore –rreth 24 mijë hektarë tokë. Siç është theksuar edhe më pare, tokat në privatizim

janë ndarë nga asetet e ndërmarjeve dhe blerësve iu janë dhanë në shfrytëzim për 99 vjet me qira. Aktualisht pronari i tyre është i pa definuar, por poseduesit kanë të drejtën e shfrytëzimit dhe të vënies hipotekë për periudhën kontraktuese. Specialistet e lëmisë, njohësit e problemeve të agroekonomisë, konsiderojnë se dështimi më i madh në procesin e privatizimit ka ndodhë në transormimin e pronave bujqësore. Ndërrimi i destinimit, çmimet tepër të ulëta, kurdisja e shitjeve dhe format tjera të veprimeve të paligjësme, kanë ndodhë në këtë sektor të ekonomisë gjatë procesit të privatizimit.

16.Privatizimi në Kosovë nuk ka përfunduar ende. Për shkak të skadimit të mandatit të anëtarve të Bordit, që nga fillimi i vitit 2014, puna e AKP-së pothuajse është ndërprerë. Deri atëherë që nga fillimi i privatizimit janë shitur 769 ndërmarrje të reja, kurse përmes procesit të likuidimit janë shitur 534 NSH. Në Fondin e Mirëbesimi tjanë deponuar gjithsejt 662 milionë Euro. Në emër të kompenzimit të ish-punëtorëve janë paguar 96 milionë Eu. Aktualisht, në Fondin e Mirëbesimit qëndrojnë të ngujuara 562 milionë Eu të depozituara në Bankën Qendrore të Kosovës. Nga plasmani i tyre janë realizuar shuma simbolike të pa përfillshme. Këto mjete presin deri në përfundim të procesit të likuidimit për të marrë vizën për rikthim në ekonominë e vendit. Por, kjo do të zgjasë për shkak se Dhoma e Posaçme po e vonon procesimin e ankesave, siç duket për të ia zgjatur jetën ekzistences së vet.

Rreth 70% e ndërmarrjeve të privatizuara janë aktive. Ndërmarrjet e privatizuara janë kryesisht ndërmarrje mikro dhe të vogla, 28 % janë ndërmarrje të mesme dhe vetëm 4% të mëdha. Në strukturën e tyre gjysma janë ndërmarrje prodhuese dhe ndërtimore, pjesa tjetër shërbyese dhe tjera.

17.Pas privatizimit këto ndërmarrje janë ballafaquar me probleme të mëdha si: uzurpimi i pronës së 221 ndërmarrjeve shoqërore, kapacitete të limituara financiare, problemet në bartjen e pronësisë, problem në ratifikimin e kontratës, obligimet nga e kaluara për shpenzimet e energjisë, obligimet ndaj Administratës Tatimore, etj.

Rezultat i metodës së privatizimit (*çmimi më i lartë i ofertuar*) dhe kushteve tjera specifike për ato të privatizuara përmes Spin-of-it Special, ishte edhe shuma e investime, numri i të punësuarve, përcaktimi i veprimtarisë, etj. Rezultatet e afarizmit të këtyre ndërmarrjeve nuk

janë ato të pritura. Numri i gjithmbarshëm i të punësuarvë në këto ndërmarrje është 10% më i vogël se sa para privatizimit.

Efekt pak a shumë i ndjeshëm nga privatizimi është evidentuar në sferën e këmbimit ndërkombëtar të mallrave. Ndikim të posaçëm ka pasur aktivizimi i prodhimit në “Feronikel”, prodhimet e të cilit i destinohen tregut të jashtëm. Kështu, prej fillimit të privatizimit deri në vitin 2008 vëllimi i eksportit është katërfishuar. Në totalin e mallrave të eksportuara mallrat e ndërmarrjeve të privatizuara marrin pjesë më 15%.

Pritjet nga privatizimi ishin të mëdha. Kishte shpresa se me privatizim do të rritet performanca e ndërmarrjeve, do të ndryshojë struktura ekonomike, do të tërhiqen më shumë investime të huaja direkte, do të nxiten investimet e brendshme private dhe do të hapen me shumë vende të reja pune. Meqenëse Kosova disponon resurse të shumta natyrore, sidomos rezerva të lignitit, pasuri nëntoksore minerare, tokë bujqësore cilësore dhe mundësi për zhvillimin e turizmit malor, pritjet më të mëdha kanë qenë nga aktivizimi përmes formave të koncesionimit dhe partneritetit publiko-privat. Fatkeqësisht, deri më tani në këtë drejtim nuk është bërë asgjë. Trepça, dikur gjigant me dhjetëra mijë të punësuar, sot nën administrimin e AKM-së punon me minimumin e kapaciteteve dhe vazhdon të jetë barrë e Buxhetit të Kosovës. Kapacitetet gjeneruese energjetike, me bazë thëngjillin, janë reduktuar për shkak të vjetërsisë, dhe tani prodhimi i tyre nuk mjafton për furnizim të nevojave të vendit me energji elektrike. PTK, fillimisht ndërmarrja më profitabile në vend, për shkak të menaxhimit jo adekuat është shndërruar në një terren ku nepotizmi, korrupcioni, keqpërdorimi i parasë dhe rënja e cilësisë së shërbimeve ia kanë devalvuar drastikisht vlerën e tregut. Pas dështimit të shitjes së aseteve, e pa investime në teknologji, ajo sot nuk tërheq vëmendjen e ndonjë investitori serioz.

18. Ka qenë e pritshme që privatizimi do të largojë nga barra e buxhetit ndërmarrjet publike dhe ato do të bëhen kontribuese në buxhetin e Kosovës. Deri më tani, përveç PTK-së dhe Aeroportit të Prishtinës, gjitha ndërmarrjet tjera publike subvencionohen nga buxheti. Shitja e akcioneve të Aeroportit të Prishtinës terhoqi investime të konsiderueshme, përmirsoi cilësinë e shërbimeve, por ende nuk ka dhënë ndonjë efekt të drejtëpërdrejtë në të hyrat

buxhetore. Një transakcion tepër problematik dhe i përforur ishte shitja e Distribicionit, njësi kjo e dikurshme e KEK-ut. E shitur me një çmim tepër simbolik nuk solli as përfitim për qytetaret ne ofrimin më cilësor të shërbimeve. Ndërmarrjet tjera publike ende nuk janë shitë ose koncesionuar. Nga ndërmarrjet e mëdha e me vlerë që kohët e fundit iu është shitur investitorëve të jashtëm është Qendra Turistike Brezovica. Meqenësë kjo ka ndodhë pak kohë më parë ende nuk kemi të dhëna për efektin e kësaj shitjeje.

Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore, i vënë në prioritet, dikur kërkonte plotësimin e disa kushteve, ndër të cilat më kryesore ishin: infrastruktura ligjore, drejtësia, transparenca, konkurrenca dhe konsensusi shoqëror. Nga të gjitha këto, vetëm ky i fundit, pra konsensusi ishte i plotë dhe i pa rezervë.

19. Infrastruktura ligjore, e nxjerrë nga UNMIK-u, ishte konfuze. Procesi i privatizimit është bazuar në tri grupe ligjesh në fuqi. Grupi i parë i ligjeve dhe akteve tjera nenligjore të nxjerra nga UNMIK-u, grupi i dytë: Ligjet e nxjerra nga Kuvendi i Kosovës, dhe grupi i tretë, grupi i ligjeve të zbatueshme në Kosovë, në të cilin grup hyjnë ligjet që kanë qenë në fuqi deri më 22 mars 1989 (*para suspendimit të autonomisë*) dhe disa ligje të karakterit jodiskriminues të nxjerra nga Serbia në vitet 90-të. Bazuar në grupin e fundit të ligjeve, disa ndërmarrje shoqërore janë transformuar para vitit 1999, kuptohet vetëm për interes të komunitetit serb dhe me ligje diskriminuese. Kryesisht këso transformimesh pronësore lidhen me sipërfaqet tokësore dhe ndonjë aset tjetër, krejt kjo në emër të integritetit të ndërmarrjeve me ndërmarrjet në Serbi.

Pas luftës shumë nga “pronarët” që përfituan nga ligjet diskriminuese kontestuan privatizimin përmes kërkesave të Dhoma e Posaçme. Këto procedura kanë zgjatur dhe kanë penguar procesin e privatizimit të NSH-ve.

Dhoma e Posaçme kishte në jurisdikcion ekskluziv të gjitha lëndet dhe paditë kundër AKM-së. Pastaj, të gjitha çështjet e lidhura me privatizimet, të drejtat e punëtorëve, pronësinë, likuidimin, riorganizimin dhe ristrukturimin e ndërmarrjeve.

Dhoma e Posaçme kishte pesë gjyqtarë, prej tyre tre ndërkombëtarë. Pas shpalljes së pavarësisë, Dhoma e Posaçme ka 20 gjyqëtarë nga të cilët 15 ndërkombëtarë dhe 7 nga Kosova. Pra, ka ndryshuar vetën numri, por jo përmbajtja dhe struktura. Edhe përkundër rritjes së numrit të gjyqtarëve, puna dhe efikasiteti i Dhomës në shqyrtimin e lëndëve nuk ndryshoi. Neglizhenca dhe plogështia e punës janë karakteristikë e këtijë institucioni.

Legjislacioni që ka të bëjë me Dhomen e Posaçme ka një veçori, jo tipike për ndonjë gjykatë që ka të bëjë me: ankesa e kufizuar dhe mungesa e përputhmërisë me standardet për të drejtat e njeriut, mënyrat e emërimit të gjyqëtarëve dhe pavarësia e Dhomës.

Punën e Dhomës e kanë përcjellur dobësi tjera siç janë: mospublikimi i vendimeve, cilësia e përfaqësimit ligjor, vonesat në procedurat e gjykimit, gabimet administrative, etj.

20. Në vitin 2008, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Kuvendi i Kosovës ka nxjerrë ligjet me të cilat janë shfuqizuar Rregulloret e UNMIK-ut, pra edhe Rregulloren për themelimin e AKM-së. Me Ligjin për themelimin e AKP-së, të gjitha përgjegjësitë dhe kompetencat e AKM-së kalojnë të AKP. Pra, krijohet një realitet i ri, të cilin Dhoma e Posaçme pranë Gjykatës Supreme të Kosovës nuk e njeh por vazhdon ta njeh Rregulloren e UNMIK-ut dhe AKM-në. Këtë veprim absurd, Dhoma e Posaçme e bazon te një opinion i Zyrës Ligjore të UNMIK-ut, në vitin 2009 e cila konsideron se ligj në fuqi lidhur me privatizimin është ekskluzivisht Rregullorja e UNMIK-ut. Sipas Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, kjo paraqet shkelje të Kushtetutës së Kosovës, ligjeve dhe injoron pavarësinë e saj.

Edhe mënyra e punës dhe vendimet e Dhomës së Posaçme shumë herë kanë qenë pengesë e procesit të privatizimit. Me këto veprime, ekonomisë së vendit i kanë sjellur dëme të mëdha. Për ilustrim po përmendim vendimet lidhur me Trepçën, Fondin e Mirëbesimit, Fabrikën e Tubave, etj.

Infrastruktura Ligjore ka qenë e paqartë edhe për sa i përket mënyrës së administrimit dhe shfrytëzimit të fondeve nga shitje e N SH-ve. Siç është thënë, mjetet e realizuara nga shitja e aseteve mbahen në llogari të veçantë të AKM-së, dhe njihen me emrin Fondi i

Mirëbesimit. Pra, mbahen në Mirëbesim për një kohë deri në perfundim të likuidimit të NSH dhe shqyrtimit të kërkesave dhe kontesteve eventuale. Se sa shpejt do të mund të lirohen këto mjete nga bllokimi varet nga efikasiteti i Dhomës së Posaçme. Por, nga raporti i fundit i AKP-së shihet se Dhomës së Posaçme nuk i bëhet vonë, pasi që me vite i pushojnë qinda lëndë të pazgjidhura.

21.Shperndarja e 20% ish-punëtorëve nuk është reflektuar në poziten sociale të familjeve të tyre e as nuk i ka zgjidhë problemet ekzistenciale të tyre. Në këtë periudhë numri i të punësuarve në ndërmarrjet e privatizuara është zvogëluar për 10%.

Ndërmarrjet e privatizuara kanë treguar performancë më të keqe se sa ndërmarrjet e reja private. Problemet e tyre lidhen me ambientin biznesor, pra që në fillim të aktivitetit të vet hasin në pengesa dhe vështirësi që lidhen më shërbimet si: regjistrimi i pronës, barra tatimore nga e kaluara, kushtet e kontratës, uzurpimi i pronës nga individë të papërgjegjshëm, mosdefinimi i kufijve kadastralë, etj.

22.Por, pengesat më të mëdha në afarizmin e tyre vijnë nga mungesa e sundimit të ligjit dhe rendit, pengesat administrative dhe korrupsioni, ndërhyrjet politike në proces, konkurrenca jo-lojale, infarstruktura ekonomike e dobët dhe ndërprerjet e shpeshta të energjisë .

Parametrat indikativë të matjes se efektit të privatizimit në dinamikën e zhvillimit ekonomik e social të vendit flasin për rezultate të pamjaftueshme dhe aspak afër pritjeve siç kanë qenë në fillim të procesit. Nga të dhënat e ecursisë së dinamikës së GDP në periudhën nga viti 2003 e deri në viti 2014, nuk vërehet ndonjë ndryshim sasior në rritje të GDP-së në periudhat më dinamike të privatizimit në krahasim me periudhat tjera. Norma e punësimit, gjegjësisht shkalla e papunësisë ka mbetur pothuajse e pandryshuar dhe arrin në rreth 35%, derisa shkalla e varferisë së përgjithshme në mbi 30%.

23.Mjetet e Fondit të Mirëbesimit nuk kanë ndihmuar në përmirësimin e infrastruktures, apo edhe mbështetjes së ndonjë veprimtarie intensive punuese. Së këndejmi, buxheti, tejet modest i Kosovës vazhdon të subvencionojë disa kategori sociale në nevojë, por ky nivel i përkrahjes është i pamjaftueshëm për shkak të kufizimeve buxhetore.

Si përfundim mund të nxjerrim konstatimin se procesi i privatizimit i realizuar gjatë kësaj periudhe në Kosovë nuk i ka përmbushur as për së afermi pritjet dhe nuk ka mbështet në asnjë formë zgjidhjen e problemeve sociale në vend. Përkundrazi, pas privatizimit numri i punëtorëve në ndërmarrjet e privatizuara është zvogëluar. Njëkohësisht, është rritur numri i personave që vihen në barrë të buxhetit, si kategori me nevojë. Shembull tipik janë pensionistët e parakohshëm të “Trepçës”.

24. I tërë sistemi i sigurimeve shoqërore i ndërtuar në Kosovë mbështetet në buxhetin e vendit. Pensionet e moshës, si sistem bazë i pensioneve, janë pasuar me pensionet e punëtorëve të Trepçës, dhe Trupave të Mbrojtjes së Kosoves.

Përfundim bën Sistemi obligativ i Kursimeve Pensionale, i cili obligon të punësuarit në sektorin publik dhe privat për kontribute në Trustin e Kursimeve Pensioneve.

Dështimi i privatizimit në përmirsimin e rrjedhave ekonomike dhe sistemin e sigurimeve sociale në Kosovë lidhet me Modelin e pa përshtatshëm të privatizimit, administratën e korruptuar dhe të dobët, bllokimin e mjeteve të Fondit, dhe në fund mos interesimin e qeverisë për vazhdimin dhe përfundimin sa më të shpejtë të këtij procesi, duke mos i kompletuar organet vendimarrëse të AKP-s, duke e zvarritur në pafundësi përgatitjen e koncesionimit, ose të partneritetit për kapacitetet si: “Trepça”, “Energjia”, “PTK”, etj. Duket se faktori i gjendjes stagnante të ekonomisë është lehtë i identifikueshëm.

6.2.0 Rekomandime

1. Mungesa e një strategjie dhe vizioni janë deshmë e hyrjes së Kosovës në procesin e privatizimit pa përgatitje paraprake, si në përcaktimin e modelit të privatizimit, ashtu edhe në përgatitjen e infrastrukturës ligjore dhe institucionale. Nga mungesa e interesimit të Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës, AKP-ja e ka ndërprerë punën që prej fillimit të vitit 2014. Në mungesë të shumicës së antarëve të Bordit Drejtues për shkak të skadimit të mandatit, të Drejtorit Menaxhues dhe dy zv. Drejtorëve menaxhues AKP ka ndërprerë punën për të gjitha aktivitetet që lidhen me vendimet e Bordit dhe Drejtorit Menaxhues. 2.

2. Prandaj, qeveria duhet t'i propozojë, ndërsa Kuvendi i Kosovës t'i votojë të gjithë Drejtorët e Bordit Mbikqyrës në një afat sa më të shpejtë kohor. Anëtarët e ri të Bordit të Drejtorëve dhe Menaxhmenti duhet të jenë persona me kredibilitet dhe kompetencë profesionale dhe rezistentë ndaj ndërhyrjeve të palejueshme dhe vendimeve të ndikuara nga nivelet e larta politike.

3. Qeveria dhe Kuvendi duhet të angazhohen maksimalisht në ndryshimin e nevojshëm të rregullativës ligjore, të kompletimit të saj, me qëllim të funksionalizimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, të ndryshimit të praktikave të punës së Dhomës së Posaçme dhe gjetjen e mënyrave për kthimin e mjeteve të Fondit të Privatizimit në ekonominë e Kosovës.

4. Hartimi i një strategjie për vazhdimin dhe përmbylljen e procesit të privatizimit nga ana e qeverisë është më se i domosdoshëm dhe përcaktues për këtë proces.

5. Respektimi i afatit ligjor për riorganizimin e “Trepçës” (*deri në fund të tetorit 2016*) kërkon angazhim dhe përkushtim, jo vetëm të AKP-së, menaxhmentit të Trepçës por të Qeverisë dhe ekspertëve.

6. Kompromentimi i procesit gjatë procedurës së shitjes së Telefonisë Mobile “Vala” ndikoi në tërheqjen e investitorëve seriozë, e me vonë edhe të blesit, i cili për shkak të pa aftësisë financiare nuk ishte në gjendje të shlyejë obligimet e veta kontraktuale. Vonesa dhe ndërhyrjet e paligjeshme në përzgjedhjen e investitorit në njërën anë, si dhe ndërhyrjet e Akционерit (Qeverisë) në afarizmin e kompanisë duke, tërhequr një pjesë të të ardhurave të kompanisë si formë të dividendës dhe vendimi për ndërprerjen e investimeve në kompani, shkaktuan dezinvestimin dhe prapambetjen në teknologji, faktor ky kyç në tregun e

shërbimeve telekomunikative. Për përgatitjen e kësaj kompanie për shitjen e pjesëshme ose të tërësishme të aksioneve të saja, kërkohet një afat kohor për përtrirjen e teknologjisë, aftësimin e kompanisë për ofrimin e shërbimeve dhe përballimin e konkurrencës në treg. Po ashtu, kërkohen dhe rekomandohen masa për sigurimin e një menaxhmenti të aftë e profesional, i cili do të zgjidhte problemin e mbipunësimit, eliminimin e nepotizmit, ndikimit të politikës në vendimarrje, dhe sjelljes racionale të akcionerit në raport me afarizmin e kompanisë.

7. Privatizimi i NSH-ve, atyre ende të pa privatizuara dhe likuiduara, duhet përshpejtuar në bazë të një plani operativ për vazhdimin dhe përfundimin e procesit.

8. Përcaktimi i afatit kohor optimal për përmbylljen e procesit të privatizimit kërkon angazhim me përgjegjësi të Qeverisë dhe pushtetit lokal në pajtim me kompetencat që ushtrojnë.

9. Në nivel lokal, komunat duhet të funksionalizojnë shërbimet kadastrale për ofrimin e shërbimeve për pronat e NSH-ve dhe kooperativeve bujqësore, të privatizuara dhe të pa privatizuara, me qëllim që të mundësohet lidhja e kontratave të shitjes për ato që kanë përfunduar procedurat dhe për përgatitjen për tenderim të atyre ndërmarrjeve të pa privatizuara.

10. Organet gjyqësore në bashkëpunim me strukturat e policisë të ndërmarrin veprime konform ligjit për lirin e pasurisë dhe tokave të uzurpuara të N Sh.

11. Urgjentisht të nxirret *Ligji për Përcaktimin e Pronarëve dhe Mbrojtjen e Pronës* për pronarët e ndërmarrjeve tanimë të privatizuara, pronarët e të cilave janë të mbrojtur nga kërkesat e ish-pronarëve. Duhet shfrytëzuar mundësia e kompensimit të ish pronarve nga mjetet e Fondit të Mirëbesimit, ose të kompensimeve përmes zëvendësimit.

12. Duhet ndryshuar dhe plotësuar edhe Ligji për Themelimin e AKP-së, me qëllim të përshtatjes së nevojave për funksionalizim dhe operim pa pengesa të kësaj agjencie.

Po ashtu, duhet me ligj të definohet termi “*Mirëbesim*”, dhe të eliminohen të gjitha pengesat ligjore për zhbllokimin e mjeteve të këtij Fondi.

13. Duhet nxjerë Ligji i ri për Dhomën e Posaçme dhe duhet harmonizuar dispozitat e tij me dispozitat e Ligjit për AKP-në. *Dhoma e Posaçme* duhet të njeh Ligjin për Themelimin e AKP-së, dhe ligjet tjera, të nxjerra në bazë të Kushtetutës së Kosovës.

14. Përmes ndryshimeve në ligjet përkatëse duhen eliminuar dispozitat që janë në kundërshtim me parimet e drejtësisë.

15. Rritja e azhuritetit të Dhomës së Posaçme është e domosdoshme për përfundimin e lëndëve kontestimore dhe krijimit të kushteve për likuidimin e ndërmarrjeve në pritje për likuidim. Me cka hiqen edhe pengesat për pagesën e 20% për ish të punësuarve dhe zhbllokohen mjetet e Fondit të Mirëbesimit.

BIBLIOGRAFIA

a/Botime

1. Angjeli, Anastas: “Tranzicioni dhe Liria Ekonomike në Shqipëri”, GEER 2007,
2. Augenstad, Rita Knudse: “Privatization in Kosovo; the international project 1999-2008 “, NUPI Report, Prishtinë 2010.
3. Civici, Adrian: “Tranzicioni Ekonomik”, UET Press, Tiranë, 2014.
4. Dervisholli, Afërdita:”Pasprivatizimi dhe Performancat e Ndërmarrjeve në Kosovë”, Riinvest, Prishtinë, 2012.
5. Dobi, Teuta& Fatos Tarifa:”Kërkimi në Shkencat Sociale dhe Politikat Sciale në Shqipëri”, UET Press,Tiranë 2011.
6. Grup Autorësh:”Privatizacija-nuzhnost ili sloboda izbora”, Jugoslavenska Knjiga, Beograd, 1994.
7. Hadzibulic,M:” Privatizacija, drzava i kapital, preduzece u reformi”, Privatizacija i restruktuiranje, Beograd, 1991.
8. Madzar, Lj.:”Neke teskoce u daljem usmeravanju privatizacije, skup transformacija drustvenih i mesovita preduzeca”, Beograd, 1991.
9. Mano,Minella S:”Dialogu Social,Studim, monografi”,ISMP, Tiranë, 2009.
10. Mema, Fatmir: “Privatizimi në Shqipëri”,Toena, Tiranë, 1997.
11. Mema, Fatmir:”Privatizimi në Shqipëri:arritje, të meta, e ardhmja”,Monografi, Tiranë, 1997.
12. Minxhozi,Malaj& Xhepa:”Tranzicioni Ekonomik”,UET Press, Tiranë, 2015.
13. Milanovic, B.:”Privatization in the Czech and Slovak Republik”, Beograd, 1991.
14. Llaci, Shyqeri &Mema Fatmir&Pine,Valentina:”Pasojat Sociale të Privazimit në Shqipëri”, Tiranë, 2003.
15. Kastrati ,Ismail:”Rrënimi dhe Rimëkëmbja e Kosovës 1998-2005”, Prishtinë, 2012.

16.Lluboteni, Gazmend: "Sistemi Bankar i Kosovës dhe Mundësitë e tijë për të Kontribuar në Procesin e Privatizimit", Riinvest, Prishtinë, 2002.

17. Tarifa, Fatos & Ksenofon Kristafi & Enea Tarifa: "Paradigma e Tranzicionit Demokratik", OMBRA GVD, 2009.

18. Savic, V.: "Inflacija i nezaposlenost", Beograd, 1986.

19. Selmanaj, Selman: "Globalizimi dhe Tranzicioni-dilemat dhe sfidat, Riinvest, Prishtinë, 2006.

20. Vukotic, V.: "Privatizacija", Institut Drustvenih Nauka", Beograd, 1990.

21. Zager, Lj.: "Pokazatelji finansijske analize poslovanja poduzeca", Zagreb, 1992.

22. Zogaj, Prec: "Institucionet e Tranzicionit", UET Press, Tiranë, 2009.

b/Revista, Studime, Konferenca

1. Agjencia Republike Slovenije za Prestrukturiranje in Privatizacijo: "Agensi 1, 2, 3." Ljubljana, 1993.

2. Agjencia Kosovare e Mirëbesimit: "Strategjia e Privatizimit", Prishtinë, 2004.

3. Agjencia Kosovare e Mirëbesimit: "Politikat Operuese te AKM-s, Prishtinë, 2002.

4. Agjencia Kosovare e Mirëbesimit: "Raport Pune/Gusht 2008, Gusht 2009/, Prishtinë, 2010.

5. Agjencia e Statistikave të Kosovës: "Statistikat e Mirëqenjes Sociale sipas viteve 2001-2008", Prishtinë, 2008.

6. Administrata Tatimore e Kosovës: "Plani Strategjik 2010-2013", Prishtinë, 2013.

7. Banka Botërore, Njësia e Mënaxhimit makroekonomik dhe e uljes së varfërisë: "Raporti nr. 28 880, Prishtinë, 2002.

8. Banka Botërore, Njësia e Mënaxhimit Makroekonomik dhe e Uljes së Varfërisë: "Raporti nr. 24 880, Prishtinë, 2002.

9. Banka Botërore: "Vlerësimi i Varfërisë në Kosovë, Raporti nr. 32 378, Prishtinë, 2005.

- 10.Banka Botërore & Agjencia e Statistikave të Kosovës:”Vlerësimi i Varfërisë në Kosovë”, Prishtinë, 2007.
- 11.Banka Botërore:”Studimi i Tregut tëTpunës në Kosovë”, Prishtinë, 2003.
- 12.Banka Botërore& Agjencia e Statistikave të Kosovës:”Varfëria në Konsum në Republikën e Kosovës në vitin 2009”, Prishtine, 2012.
- 13.Banka Botërore: “Kosova:Dokument Politikash per Shpenzimet Publike në Arsimin Parauniversitar”,Prishtinë, 2009.
- 14.Banka Boterore: “Serbia: Si të bëhet më shumë me më pak para?”, Prishtinë, 2009.
- 15.Demukaj, Agim:”Stock Exchange in Kosova: Ëhy and hoë?”, Prishtinë, Paper 5 , KIPRED,2005.
16. Dika, Ines:”Privatization and post privatization in Albania: a longand difficult path”, Research study, Tiranë, 2005.
- 17.Donbrusch, R &Halger, V.:”East German Ekonomik Reconstruction”, Conference on Tranzition in Eastern Europe, Cambridge, 1992.
- 18.Campbel, Oliver Ehite:”Faktorët e Suksesit apo Dështimit të Privatizimit të N SH-ve në Kosovë”, Riinvest, Prishtinë, 2002.
- 19.Ekonomiska Politika Hrvatske:”Privatizacija u corsokaku”, No.1.1993.
- 20.Grup Autorësh:”Privatization in Eastern Europe”, Viena, 1992.
- 21.Gashi ,Haxhi:”Konflikti Ligjor Lidhur me Privatizimin e Ndërmarrjeve Shoqërore”, Instituti GAP, Prishtinë, 2011.
- 22.Grasman, Franciska& Ketj Roden:”Raport për UNICEF-in ne Kosovë: Ndikimi i Skemës së përfitimit të ndihmës sociale financiare te femijët në Kosovë”,Proishtinë, 2006.
- 23.Forumi 2015:”Privatizimi në Kosovë, Perparim dhe Ngecje”, Riinvest, Prishtinë, 2004.
- 24.Forumi 2015:”Privatizimi dhe post Privatizimi në Kosovë-Një gotë bosh apo gjysmë e plotë”, Raport Studimor, prishtinë, 2008.
- 25.Hashi, Iraj&Xhillari, L.:Privatization and Tranzition in Albania”, Post Communist Economies, Vol.11.No.1.
- 26.Hashi, Iraj:”Privatizimi në Kosovë , Ngritjet dhe Rënjet”, Forumi 2015, tryezë,Prishtinë, 2004.

- 27.Hinds ,M.:”Issues in the introduction of the market in Eastern European Socialist economies”, Internal Diskision Paper, Report, No.IDP-0057, ËB,1990.
- 28.Instituti për Kërkime Ekonomike RIINVEST:”Ndërmarrjet Shoqërore dheTtransformimi i tyre”,Raport Hulumtues, Prishtinë, 2001.
- 29.Instituti për Kërkime Ekonomike RIINVEST :”Privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore dhe Reforma e Ndërmarrjeve Publike”,Konferencë Ndërkombëtare, Prishtinë, Qershor, 2002.
- 30.Instituti për Kërkime Ekonomike RIINVEST:”Sistemi I Ekonomisë së hupur tëTtregut dhe Tranzicioni në Kosovë”,Konferencë Shkencore,Prishtinë, Maj,1998.
- 31.Institutim për Kërkime Ekonomike RIINVEST:”Strategjia e Zhvillimit Ekonomik dhe Gjenerimi i NVM-ve në Kosovë”,Konferencë Shkencore, Prishtinë, 1999.
- 32.Instituti për Kërkime Ekonomike RIINVEST:”Situata Socioekonomike në Kosovë”, Prishtinë, 2008.
- 33.Instituti Për Kërkime Ekonomike RIINVEST:” Përmirsimi i Qeverisjes Korporative dhe Transparenca në Banka dhe Kompani të Sigurimeve në Kosovë”,Prishtinë,2009.
- 34.Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave KIPRED:” Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe Privatizimi i Pronës Shoqerore”, Prishtinë, Qershor, 2005.
- 35.Instituti i Ekonomisë pranë ASHSH:Tiparet e Tranzicionit dhe Strategjia e Zhvillimit Ekonomik të Shqipërisë”, Tiranë, 2002.
- 36.Instituti për Studime të Avancuara GAP:”Privatization in the transition-recent experiences in Eastern Europe”, Prishtinë, Nëntor, 2003.
- 37.Komisioni Europian:”Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2009”, Prishtinë , 2010.
- 38.KFOS:”PTK:Nga Agimi deri në muzg”, Raport Hulumtues, Prishtinë, 2015.
- 39.Kornai, J.:”Put u Slobodnu Privredu”, Ekonomski Institut, Beograd, 1992.

c/Ligje, Rregullore, akte, Raporte;

- 40.Kuvendi i Republikës së Kosovës:” Ligji nr.2003/15 Për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë”, Prishtinë, 2003.

- 41.Kuvendi i Republikës së Kosovës:”Letra e Bardhë-Sfidat e Përfshierjes sociale në Kosovë”, Tetor, 2009.
- 42.Kuvendi i Republikës së Kosovës:”Ligji mbi Administratën Tatimore të Kosovës”,Prishtinë, 2008.
- 43.Kuvendi i Republikës së Kosovës:”Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë”, Prishtinë, 2003.
- 44.Kuvendi i Republikës së Kosovës:”Kushtetuta e Republikës së Kosovës”, Prishtinë, Prill, 2008.
- 45.Lidhja e Ekonomistëve të Kosovës:”Problemet Ekonomike në Kosovë me vështrim të Vecantë në Ekonominë Private”, Këshillim Shkencor, Prishtinë, 1996.
- 46.Lidhja e Ekonomistëve të Kosovës:”Proceset Integruese në Botë dhe Tranzicioni në Vendet ish Socialiste, Prishtinë, 1997.
- 47.Ministra e Punës dhe e Mirëqenjes Sociale:”Sistemi i Mbrojtjes Sociale në Kosovë-Vlerësim i varfërisë, Prishtinë, 2004.
- 48.Mara,H &Gerdeshi,I.:”Privatizimi i Ndërmarrjeve Shtetërore dhe Efektiviteti i Tyre”, Ekonomia dhe tranzicioni, Nr.2. Tiranë, 1995.
49. Mema, Fatmir:”Nga anon Balanca e pas Privatizimit të Ndërmarrjeve? Dështim apo Sukses”, Forumi Shqiptar Socio Ekonomik, Tiranë, 2007.
- 50.OSBE-Departamenti i Monitorimit:”Shqyrtimi Juridik i Qështjeve të AKM-s nga Dhoma e Posaqme e Gjykatës Supreme”, Prishtinë, 2008.
- 51.USAID&UNDP:”Raporti i Paralajmërimit të Hershëm”, Prishtinë, 2007.
- 52.Rregullore e UNMIK-ut Nr.2002/12 Mbi Themelimin e Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit/AKM/, Prishtinë, 2002.
- 53.Rregullore e UNMIK-ut Nr.2001/9 Për Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së përkohshme në Kosovë, prishtinë, Maj, 2001.
- 54.Rregullore e UNMIK-ut Nr. 2002/13 Mbi Themelimin e Dhomës së Posaqme Të Gjykatës Supreme të Kosovës për Cështje të Lidhura me AKM-n, Prishtinë, 2002.
- 55.RRregullore e UNMIK-ut Nr. 2005/48 Mbi Organizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve dhe pasurisë së Tyre në Autorizimin Administrativ të AKM-s, Prishtinë, Nëntor, 2005.

- 56.Rregullore e UNMIK-ut Nr.2001/35 Mbi Pensionet në Kosovë, 2001 dhe e ndryshuara me RRegulloren Nr. 2005/20,Prill 2005.
- 57.Rregullore e UNMI-ut Nr.2003/23 Për Pensionet e Përsonave me aftësi të Kufizuara, Prishtinë, 2003.
- 58.Selmanaj, Selman:”Modeli i Ekonomisë së Hapur –bazë e sistemit të ri ekonomik të Kosovës”, Riinvest, Prishtinë, 1999.
- 59.Vukmir, B.:Privatization in Jugosllavia”, Seminar on Privatization, Ëarshav, October, 1990.
- 60.Vojevoda, L& Rumpis, L.:”Privatization in Latvia”, Institut of Economics, Latvian Academy of Sciences, 1993.
- 61.Zyra Ndërkombëtare e Punës:Profili i Sistemit të sigurisë Sociale në Kosovë”, Budapest, 2010.